



REPUBLIKA E SHQIPËRIË

ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË

RAPORT VJETOR

Gjëndja e Sektorit të Energjisë dhe Veprimtaria e ERE-s gjatë Vitit 2018

Tiranë, 2019

Përmbajtja

Fjala e Kryetarit të Entit Rregullator të Energjisë	7
Hyrje	11
PJESA I: Rregullimi në Tregun e Energjisë Elektrike	22
1.1 Tregu i Energjisë Elektrike	23
1.2 Prodhimi i Energjisë Elektrike	27
1.2.1 Kapacitetet dhe Prodhimi i Energjisë Elektrike	27
1.2.2 Realizimi i Treguesve të Prodhimit dhe Menaxhimi i Rezervës Hidrike.	38
1.2.3 Gjendja e TEC-it Vlorë.....	39
1.2.4 Prodhimi nga HEC-et Private/Koncesion të Energjisë Elektrike.....	40
1.3.1 Veprimtaria e OST sh.a.....	43
1.3.2 Asetet dhe Zhvillimi i Sistemit të Transmetimit	43
1.3.3 Bilanci i Energjisë Elektrike të Transmetuar nga OST sh.a.....	46
1.4 Gjendja e Përgjithshme e Sistemit Eelektroenergjetik referuar Nenit 25 të Ligjit Nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”.....	49
1.5 Operatori i Sistemit të Shpërndarjes së Energjisë Elektrike (OSHEE sh.a.).....	67
1.6 Konsumi i Energjisë Elektrike	73
1.6.1 Struktura e Konsumit të Energjisë Elektrike.....	77
1.6.2 Profili i Konsumit të Energjisë Elektrike	78
1.7 Transaksionet e kryera nga KESH sh.a, OST sh.a. dhe OSHEE sh.a. në Treg të Parregulluar 2018.....	81
PJESA II: Rregullimi i Sektorit të Gazit Natyror	90
2.1 Projekti TAP, (Trans Adriatic Pipeline).....	91
2.2 Ecuria e deritanishme e projektit TAP-AG në Shqipëri.....	93
2.3 Vendimi i Përrjashtimit të TAP AG-s	99
2.4 Zhvillime të tjera rreth Projektit TAP	100
2.5 Metodologjia e Tarifave të Gazit Natyror për TAP AG.....	106
2.6 Metodologjia e Tarifave të Gazit Natyror për Albagaz (OST/OSHT).....	107
2.7 Kodi i Rrjetit të TAP AG dhe Kodi i Rrjetit të Albagaz	107
2.8 Zhvillime për ALBGAZ gjatë vitit 2018.....	107
2.9 Bashkëpunimi me BERZH.....	111
2.10 Bashkëpunimi me Institucionet Ndërkombëtare	112
PJESA III: Aktiviteti i Entit Rregullator të Energjisë	113
3.1 Mbi realizimin e detyrave të ERE-s për vitin 2018. (Rezoluta e Kuvendit)	114

3.2 Licencimi dhe Monitorimi i Veprimtarive në Tregun e Energjisë Elektrike	133
3.2.1 Licencimet dhe Kërkesat e Trajtuarra gjatë Vitit 2018.	133
3.3 Monitorimi i Veprimtarive në Tregun e Energjisë Elektrike	137
3.3.1 Monitorimi i Tregut të Energjisë Elektrike.....	137
3.3.2 Monitorime Specifike nga informacionet periodike të OSHEE sh.a	139
3.3.3 Monitorime Specifike nga informacionet periodike të OST sh.a.....	140
3.4 Aktiviteti i ERE-s në fushën e rregullimit të tarifave dhe çmimeve të Energjisë Elektrike dhe Gazit Natyror	144
3.5 Aktiviteti i ERE-s në Zhvillimin e Legjislacionit Sekondar dhe Ndryshimet e tjera Ligjore të Ndodhura gjatë vitit 2018.....	165
3.6 Proçeset gjyqësore në të cilat ERE ka qënë palë gjatë vitit 2018	172
3.6.1 ERE në Cilësinë e Palës së Paditur në proçeset gjyqësore.....	172
3.6.2 ERE në Cilësinë e Palës së Tretë në proçeset gjyqësore në kuadër zbatimit të kompetencave ligjore.	173
3.7 Zhvillimi i seancave Dëgjimore në ERE.....	173
3.8 Veprimtaria e ERE-s në fushën e Mbrojtjes së Konsumatorit.	173
3.8.1 Ankesat për mbifaturimin e energjisë elektrike.	177
3.8.2 Ankesat për “Energji të pamatur”	177
3.8.3 Ankesat për “faturim aforfe”.....	178
3.8.4 Faturimi i energjisë elektrike për “matje jashtë kushteve teknike”.....	178
3.8.5 Ankesat mbi “kontratat fiktive“ dhe “faturim fiktiv”.	179
3.8.6 Ankesa “të ndryshme”.	179
3.8.7 Ankesa për “vlera referuese”	179
3.9 Komunikime me Pjesëtarët e Tregut.....	181
3.10 Informacioni në Faqen Zyrtare të Internetit.	182
3.11 Marrëdhëniet Ndërkombëtare.	182
3.11.1 Pjesëmarrja Aktive si Anëtare.....	183
3.11.2 Marrëdhëniet Bilaterale të ERE-s.	184
PJESA IV:Administrimi i Burimeve Financiare dhe Burimeve Njerëzore të ERE-s	186
4.1 Administrimi i Burimeve Financiare të ERE-s.....	188
Shtojca 1 Pasqyrat Financiare	190
Shtojca 2 Raport i Audituesve Ligjorë për Performancën e ERE-s.....	207

Tabela e Figurave

Figure 1 Skema e Fluksit të Energjisë Elektrike dhe Tregtare.....	24
Figure 2 Skema e Sistemit Elektroenergjetik (Burimi: ERE)	25
Figure 3 Skema Elektrike e Sistemit Elektroenergjetik Shqiptar.....	26
Figure 4 Struktura e Centraleve Elektrike të Prodhimit Publik (Burimi: KESH sh.a.).....	27
Figure 5 Prodhimi gjatë vitit 2018 nga centralet e lidhura në rrjetin e transmetitmi (MWh)	28
Figure 6 Prodhimi neto i të gjitha centraleve gjatë vitit 2018 (MWh).....	31
Figure 7 Prodhimi neto vendas për vitin 2018	31
Figure 8 Kontribuesit në prodhimin vendas gjatë vitit 2018 (MWh).....	32
Figure 9 Prodhimi vendas për vitin 2018 krahasuar me mesataren e periudhës 2007-2018.....	32
Figure 10 Prodhimi neto vendas historik për periudhën 2003-2018.....	33
Figure 11 Historiku i Prodhimit të Energjisë Elektrike nga HEC-et e Kaskadës së Drinit (Burimi: OST sh.a.).....	33
Figure 12 Prodhimi i Energjisë Elektrike nga HEC-et e Kaskadës së Drinit gjatë vitit 2018 (Burimi: KESH sh.a. , OST sh.a.).....	34
Figure 13 Shkarkimet nga HEC-et e KESH sh.a gjatë vitit 2018.	35
Figure 14 Niveli i Liqenit të Fierzës gjatë vitit 2018 (m)	35
Figure 15 Shkarkimet e Ujit nga H/C-et e Kaskadës së Drinit (2002-2018) (Burimi: KESH sh.a).....	36
Figure 16 Niveli i Liqenit të HEC Fierzë për periudhën 1991 – 2018.....	36
Figure 17 Niveli (m) i Liqenit të Fierzës në raport me mesataren, minimumin dhe maksimumin e periudhës 1991 – 2018.....	37
Figure 18 Prurjet mesatare mujore (m ³ /sek.) në liqenin e HEC-it Fierzë gjatë vitit 2018 krahasuar me mesataren historike.	37
Figure 19 Rezerva Energjetike Ditore në Kaskadën e Drinit gjatë vitit 2018 (Burimi: KESH sha).....	38
Figure 20 Konsumi specifik i Ujit.....	39
Figure 21 Treguesit e Centraleve.....	39
Figure 22 Prodhimi dhe kapacitetet e HEC-eve Private dhe me Koncesion deri në 2018.....	40
Figure 23 Prodhimi nga HEC–et që kanë hyrë në prodhim gjatë vitit 2018.....	42
Figure 24 Struktura e Sistemit të Transmetimit të Shqipërisë.	44
Figure 25 Skema e Sistemit të Transmetimit Shqiptar.....	45
Figure 26 Asetet kryesore të Sistemit të Transmetimit.....	46
Figure 27 Bilanci Energjetik i OST sh.a për vitin 2018 krahasuar me atë të viteve 2015, 2016 dhe 2017 (GWh).	46
Figure 28 Situata e Investimeve.....	48
Figure 29 Të dhënat mbi treguesit kryesorë për çdo Agjenci të Operatorit të Shpërndarjes OSHEE sh.a. gjatë vitit 2018	69

Figure 30 Shpërndarja e Furnizimit me Energji Elektrike sipas Drejtorive rajonale (%).....	69
Figure 31 Sasia në Furnizim, Shitje dhe Humbje të Energjisë Elektrike në Rajonet dhe Agjencitë e Rrjetit të Shpërndarjes (Burimi: OSHEE sh.a).....	70
Figure 32 Numri i Klientëve të OSHEE sh.a 2017 dhe 2018	71
Figure 33 Shpërndarja e numrit të Klientëve 2018 sipas kategorive (%)	71
Figure 34 Të dhëna mbi asetet kryesore të OSHEE (Burimi: OSHEE).....	72
Figure 35 Të dhënat mbi treguesit e Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes gjatë vitit 2018.	72
Figure 36 Konsumi i përgjithshëm në vite.....	73
Figure 37 Treguesit nga operatorët kryesore të sistemit Elektroenergjetik në Shqipëri 2018.	75
Figure 38 Bilanci Energjetik viti 2018.....	76
Figure 39 Kontributet e prodhimit neto vendas dhe balancës Import-Eksport në konsumin total të Energjisë Elektrike në Shqipëri.....	76
Figure 40 Raportet e Faturimit sipas Kategorive të Klientëve 2018.....	77
Figure 41 Klientët Familjarë kundrejt konsumit total të vendit në vite.	78
Figure 42 Konsumit mesatar ditor për çdo muaj të vitit 2018.	79
Figure 43 Profili mesatar ditor me bazë orare i ngarkesës për vitin 2018.	79
Figure 44 Profili dhe piku i ngarkesës në dhjetor 2018 (MW)	80
Figure 45 Profili dhe minimumi i ngarkesës në janar 2018 (MW)	80
Figure 46 Transaksionet e kryera gjatë vitit 2018 nga KESH sh.a dhe OSHEE sh.a	81
Figure 47 Balanca Import - Eksport e energjisë elektrike në vite (Burimi: OST sh.a.). Aktiviteti i Shitjes së Energjisë Elektrike nga OSHEE sh.a.....	82
Figure 48 Humbjet Vjetore në Sistemin e Shpërndarjes në periudhën 2009-2018.	84
Figure 49 Niveli i Arkëtimeve Mujore në periudhën 2011-2018.....	85
Figure 50 Ecuria treguesve të efektivitetit të shitjes së Operatorit të Shpërndarjes (%).....	86
Figure 51 Efektiviteti i shitjeve të OSHEE 2009-2018 (Burim: OSHEE).....	87
Figure 52 Humbjet Totale kundrejt Energjisë së futur në sistemin Elektroenergjetik.....	87
Figure 53 Faturimi/Arkëtimi 2002-2018 me TVSH (Burimi: OSHEE sh.a.).....	88
Figure 54 Pasqyrimi i Statistikave botërore për Energjinë	92
Figure 55 Aksionerët aktualë TAP.....	93
Figure 56 Master Plan.....	110
Figure 57 Disbalancat totale për vitin 2018 (MWh).....	141
Figure 58 Pjesëmarrësit e Tregut gjatë vitit 2018.....	143
Figure 59 çmimet e shitjes së energjisë elektrike të furnizimit nga FMF për vitin 2018 (Burimi: ERE)..	149
Figure 60 Ecuria e kapitalit të vet OSHEE sh.a.....	153
Figure 61 Tabela e Tarifave dhe çmimeve për vitin 2019	154

Figure 62 Të ardhurat e realizuara KESH, OST dhe OSHEE për periudhën 2015-2017 Burimi (KESH,OST dhe OSHEE sh.a)	155
Figure 63 Ecuria e prodhimit nga prodhuesi me Përparësi & Hec Ashta (MWh) (Burimi OSHEE sh.a) .	156
Figure 64 Të ardhurat nga prodhuesit me përparësi (Burimi OSHEE sh.a.)	156
Figure 65 Ecuria e çmimeve të miratuara për Prodhuesit me Përparësi	157
Figure 66 Pesha specifike e prodhimit të prodhuesve me përparësi nga konsumi total (Burimi OST sh.a. OSHEE sh.a. ERE)	157
Figure 67 Struktura e shpenzimeve për blerjen e energjisë elektrike nga OSHEE për vitin 2018 (Burimi OSHEE sh.a.,ERE)	158
Figure 68 Struktura e shpenzimeve për blerjen e energjisë elektrike nga OSHEE për vitin 2017	159
Figure 69 Çmimet e miratuara nga ERE për periudhën 2008-2019 (Burimi ERE- Çmimi mesatar perllogaritet mbi bazën e mesatares aritmetike të të dhënave).....	162
Figure 70 Çmimi mesatar i realizuar (Burimi ERE, OSHEE sh.a.).....	163
Figure 71 Çmimi i realizuar për kategoritë e klientëve (Burimi ERE, OSHEE)	163
Figure 72 Çmimet e energjisë elektrike të konsumatorëve familjar në vendet e rajonit sipas raportimit më të fundit të ERRA për vitin 2018	164
Figure 73 Çmimet e energjisë elektrike të konsumatorëve jo-familjar në vendet e rajonit sipas raportimit më të fundit të ERRA për vitin 2018	164
Figure 74 Ankesat totale sipas problematikave të trajtuara nga ana e OSHEE sh.a.	175
Figure 75 Ankesat e trajtuara nga ERE gjatë 2018.....	176
Figure 76 Ankesat e trajtuara nga ERE gjatë vitit 2018.....	177
Figure 77 Përgjigjet e OSHEE gjatë vitit 2018 lidhur me ankesat e dërguara nga ERE.....	181

Fjala e Kryetarit të Entit Rregullator të Energjisë

I Nderuar Zoti Kryetar i Kuvendit,

Të nderuar Zonja dhe Zotërinj Deputetë,

Në emër të Entit Rregullator të Energjisë, kam kënaqësinë të paraqes përpara Jush, Raportin Vjetor mbi situatën e sektorit të energjisë dhe veprimtaritë e ERE-s për vitin 2018.

Në këtë raport kemi synuar të japim një pasqyrë të plotë dhe sa më të detajuar mbi gjëndjen në sektorin e energjisë elektrike dhe të gazit natyror në vendin tonë si dhe vështirësitë, sfidat apo dhe arritjet me të cilat këta sektorë janë përballur përgjatë vitit 2018. Po ashtu pjesë e këtij raporti është dhe një informacion i përditësuar mbi aktivitetin e shoqërive të cilat operojnë në këta dy sektorë.

Më duhet të theksoj se viti 2018 ka qenë një vit i mbushur me sfida dhe përpjekje të rëndësishme për trajtimin e të cilave në çdo rast janë mbajtur parasysh parimet themelore të mbrojtjes së klientëve, transparencën, ekuilibrimin e interesave të konsumatorëve, investitorëve privatë dhe shtetit, si dhe angazhimet e ndërmarra nga ana e Shtetit Shqiptar në arenën rajonale e atë ndërkombëtare.

Të nderuar deputetë,

Dëshiroj t'Ju informoj se gjatë vitit 2018, Sektori i Energjisë ka patur një qëndrueshmëri në aktivitetin e prodhimit, transmetimit dhe shpërndarjes së energjisë elektrike, duke mbajtur dhe ruajtur parametra të qëndrueshëm operimi dhe rezultate të mira financiare, megjithatë shumë mbetet për të bërë në drejtim të diversifikimit të burimeve gjeneruese dhe adresimit të çështjeve si dhe zgjidhjeve sa më efikente në drejtim të mbështetjes së zhvillimit të burimeve gjeneruese të rinovueshme.

Gjatë vitit 2018 janë shtuar burimet gjeneruese të rinovueshme të cilat aktualisht zënë rreth 32 %, të totalit të burimeve tona gjeneruese.

Po ashtu edhe Sektori i gazit natyror shënoi zhvillime efikase në strukturimin e tij dhe funksionimin normal ku një rol të rëndësishëm luan ecuria e investimit të projektit të TAP brenda afateve të përcaktuara për vënien në operim të tij.

Në vijim të procedurave të certifikimit e më tej të licensimit të shoqërisë Albgaz sh.a, është punuar ngushtësisht me këtë të fundit në kuadër të implementimit të Vendimeve të Grupit të Përhershëm të Nivelit të Lartë (PHLG) të Komunitetit të Energjisë, që përfshijnë ndër të tjera krijimin e Kodit të Rrjetit për mekanizmin e Alokimit, të kapaciteteve të interkonjeksionit të kapaciteteve në sistemet e transmetimit të gazit natyror, mbi themelimin e Kodit të Rrjetit që harmonizon strukturat tarifore të transmetimit të gazit.

Enti Rregullator i Energjisë ka zhvilluar veprimtarinë e tij mbështetur në Ligjin nr. 43/2015, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, i ndryshuar dhe Ligjin Nr. 102/2015 “Për Sektorin e Gazit Natyror”, i ndryshuar.

Realizimi i pavarësisë organizative dhe funksionale të institucionit, ka qenë dhe mbetet objektiv i vazhdueshëm dhe kryesor i Institucionit, gjë që ka rritur më shumë kërkesën për një kualifikim më të lartë profesional dhe përgjegjshmëri më të madhe në vendimmarrje por paralelisht edhe nevojën eminente të zgjerimit të stafit mbështetës teknik për realizimin e qëllimit dhe sfidave që sjellin angazhimet në kuadër të integritetit në tregun rajonal.

Gjatë vitit 2018, jemi munduar të ndërthurim eksperiencën dhe profesionalizmin e ekspertëve tanë me eksperiencën më të mirë të organizmave simotra rajonale dhe PanEvropiane në disa prej të cilave jemi dhe anëtarë me të drejta të plota, bashkëpunim që ka rezultuar mjaft i frytshëm dhe kam bindjen që do të vijojë të japë në të ardhmen dhe më tepër rezultate si në shkëmbimin e eksperiencave ashtu dhe në përmirësimin e aftësive teknike të stafit tonë duke rritur rolin aktiv të ERE-s në rajon e më gjerë.

Në kuadër të objektivave për bashkëpunimin dhe kualifikimin e punonjësve të ERE, në fillim të vitit 2019, përmes eksperiencave më të mira në nivel ndërkombëtar falë punës së vazhdueshme gjatë vitit 2018 është bërë i mundur, pranimi i ERE me statusin e Observer në Këshillin Europian të Rregullatorëve të Energjisë (CEER). Nëpërmjet CEER, rregullatorët bashkëpunojnë në drejtim të shkëmbimit të praktikave më të mira që lidhen me sfidat e rregullimit.

Zonja dhe zotërinj,

Shqipëria është në rrugën e saj të sigurt drejt antarësimit në Bashkimin Evropian, ndaj, puna jonë ka edhe si qëllim kryesor zhvillimet në sektorin e energjisë elektrike dhe të gazit natyror në përputhje me kërkesa rregullatore dhe legjislative të cilat duhet të përputhen plotësisht me ato të BE-së.

Këto zhvillime kërkojnë që ERE të zhvillohet si një institucion me kapacitete teknike të mjaftueshme dhe ekspertizën e nevojshme për t’u përballur me sfidat e sektorit në Shqipëri e më gjerë.

Për këtë arsye i kemi dhënë një rëndësi të veçantë zhvillimit të strukturës organizative të ERE-es, si dhe pavarësinë operacionale të stafit të saj për të përballuar sa më me sukses sfidat e sektorit në përmbushje të detyrave që dalin nga zbatimi i Rezolutës së Kuvendit të Shqipërisë, detyrave që dalin në drejtim të krijimit të Tregjeve rajonale në vendet e Evropës Juglindore dhe më gjerë si në sektorin e Energjisë Elektrike ashtu dhe në atë të Gazit Natyror dhe rritjes së pavarësisë financiare të ERE-s si një ndër kërkesat kryesore të BE-së në kuadër të masave për zbatimin e MSA-së.

Në një analizë të disa treguesve kryesorë të sistemit energjetik gjatë vitit 2018, të tillë si prodhimi i Energjisë Elektrike, duhet thënë se viti 2018 ka shënuar një rritje të prodhimit të Energjisë ndër të cilat do të doja të theksoja;

- (i) Gjatë vitit 2018 janë shtuar 11 HEC-e të reja me një kapacitet të instaluar prej 38.3 MW të cilët kanë prodhuar rreth 19 GWh Energji Elektrike.
- (ii) Prodhimi i përgjithshëm i vendit ka qenë në nivelin 8.5 TWh, më i larti që nga viti 1985 prej të cilave vetëm 68.31% është prodhuar nga Shoqëria publike e gjenerimit, pjesa tjetër është prodhuar nga centralet private koncesionare ose jo.
- (iii) Viti 2018 ka qenë një vit eksportues për vendin tonë me eksporte që arritën vlerën 913 MWh duke i krijuar kompanisë së gjenerimit publik të ardhura shtesë përveç të ardhurave që lidhen me shitjet e energjisë elektrike të Furnizuesi i Shërbimit Universal.
- (iv) Humbjet në sistemin e shpërndarjes së Energjisë Elektrike kanë qenë në nivelin 23.96% krahasuar me 26.41 % të një viti më parë.
- (v) Konsumi ka patur një rritje me 2.7% krahasuar me 2017, duke arritur vlerat mbi 7.6 TWh.

Viti hidrik i mbarë dhe zbatimi i disa prej reformave në sektor kanë ndikuar në përmirësimin e cilësisë dhe sigurisë së furnizimit me energji elektrike të klientëve për vitin që lamë pas.

ERE, ka patur si mision kryesor kryerjen e shërbimeve të sigurta dhe të besueshme për klientët, bazuar në kosto sa më të drejta dhe të arsyeshme për të licensuarit. Sa më sipër është reflektuar në vendimarrjet për përcaktimin e tarifave dhe çmimeve të energjisë elektrike.

Në fushën e Gazit natyror ka vazhduar bashkëpunimi me dy Entet rregullatore në të cilat kalon projekti TAP, Greqisë dhe Italisë, si dhe është mundësuar licensimi i TAP, fakt që ishte dhe kusht paraprak për vënien në operim të tij.

Duke konsideruar që ende mbetet për tu punuar në drejtim të kuadrit rregullator, me aktet nënligjore të përcaktuara në ligjet që rregullojnë sektorin e enegjisë elektrike dhe gazit natyror, për vitin që vjen objektivat e ERE-s do të vijojnë të orientohen drejt plotësimit të legjislacionit me aktet përkatëse, e lidhur ngushtë kjo edhe me mbështetjen e liberalizimit të mëtejshëm të Tregut të Energjisë Elektrike, ngritjes dhe operimit efikas të bursës së Energjisë Elektrike për sa është në kompetencë të ERE-s dhe mbikqyrjes së tij për rritjen e efikasitetit dhe transparencës dhe zbutjen e efekteve tek klientët fundore në fillimet e operimit të tij, zhvillimi më tej i kuadrit Rregullator për sektorin e gazit natyror si një mundësi që i jepet vendit tonë nga vënia në operim i projektit të TAP.

Në këtë prizëm, ERE është tërësisht e angazhuar për një bashkëpunim edhe më të ngushtë me Sekretariatit e Komunitetit të Energjisë në Vienë, si një ndër partnerët kryesorë në përpilimin e legjislacionit primar dhe sekondar, Ministrinë e infrastrukturës dhe Energjisë, Autoritetin e Konkurrencës si dhe të gjithë aktorët e tjerë të Sektorit Energjetik në vend e më gjerë. Ky bashkëpunim gjykoj se është tejet thelbësor për zhvillimin e këtij Sektori në të ardhmen dhe përballimit të sfidave që na dalin përpara në kuadër dhe të Bashkimit me Tregjet Rajonale në kuadër të angazhimeve të ndërmarra tashmë nga ana e Qeverisë Shqiptare në këtë drejtim.

Megjithë arritjet apo përmirësimet e përshkruara në këtë raport puna jonë në vijim do të fokusohet më tepër në çështjet që lidhen me; (i) hapjen e tregut të Sektorit të Energjisë Elektrike te klientët fundore, (ii) ndarjen ligjore të OSHEE sipas parashikimeve të ligjit, (iii) uljen e riskut nga situata hidrike në vend për të mundësuar parandalimin e rrezikut të sigurisë së furnizimit me energji elektrike të popullatës në vit relativisht të thatë, (iv) përpilimin e legjislacionit sekondar për të paraprirë mundësinë e krijimit të një tregu të Gazit natyror në Shqipëri dhe shfrytëzimit të

hapësirave që krijon përfundimi i projektit TAP për realizimin e projekteve të tjera rajonale siç është ai Ionian Adriatic Pipeline, etj.

Një vend të rëndësishëm dhe prioritar ka patur në punën tonë dhe transparenca e sektorit, për këtë jemi munduar dhe besoj se ja kemi arritur të krijojmë kushte për rritjen e transparencës për të mundësuar ekuilibrimin e interesave të klientëve fundorë, kompanive publike si dhe investitorëve privatë në sektorët e rregulluar nga ana jonë. Në kuadër të transparencës, ky Raport Vjetor do të jetë në dispozicion të të gjithë institucioneve, investitorëve por edhe konsumatorëve që janë të interesuar në faqen zyrtare të ERE në internet.

Dëshiroj së fundmi të falenderoj me këtë rast, të gjithë stafin e ERE-s si dhe të gjitha Insitucionet përkatëse për mbështetjen dhe bashkëpunimin dhe në menyrë të veçantë Kuvendin e Shqipërisë por edhe konsumatorët shqiptarë , të cilat në çdo rast kanë patur akses të sigurt në praktikatat e shqyrtuara dhe miratuara nga ana jonë me qëllim marrjen e opinionit të tyre, gjë që është adresuar edhe nëpërmjet shoqatave për mbrojtjen e konsumatorit si dhe bashkëpunimin konstant me Autoritetin e Konkurrencës të cilët dëshiroj ti falenderoj dhe të shpreh bindjen për vazhdimin e këtij bashkëpunimi të frytshëm edhe në të ardhmen.

Ju falenderoj për vëmendjen tuaj,

KRYETARI

Petrit AHMETI



The image shows a handwritten signature in blue ink, which appears to be 'Petrit Ahmeti'. The signature is written over a circular official stamp. The stamp contains the text 'REPUBLIKA E SHQIPËRISË' at the top, 'ENTITETI RREGULLATOR I ENERGJISË' around the inner edge, and 'TIRANË' at the bottom. In the center of the stamp is the coat of arms of Albania.

Hyrje

Enti Rregullator i Energjisë është autoriteti rregullator i Sektorit të Energjisë Elektrike dhe të Gazit Natyror, i cili funksionon në përputhje me ligjin nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, i ndryshuar, Ligjin nr. 102/2015 “Për Sektorin e Gazit Natyror” si dhe aktet të tjera ligjore miratuar në zbatim të tyre.

ERE ushtron aktivitetin e saj më qëllim garantimin e përmbushjes së detyrimeve të operatorëve të tregut për furnizimin e qëndrueshëm dhe të sigurt me energji të klientëve. ERE duke marrë në konsideratë interesat e klientëve, sigurinë e cilësinë e shërbimit të furnizimit me energji elektrike dhe kërkesat për mbrojtjen e mjedisit, monitoron tregun e energjisë elektrike, harton kuadrin rregullator, shqyrton në mënyrë të kujdesshme aplikimet e tarifave dhe çmimeve, e nëpërmjet autoritetit vendimmarrës të saj, dhe në zbatim të ligjit, vepron rast pas rasti duke e shprehur vullnetin nëpërmjet vendimeve të Bordit.

Bordi i ERE-s, është organi vendimmarrës për të gjitha çështjet nën juridiksionin dhe kompetencën e ERE-s. Bordi i ERE-s përbëhet nga Kryetari dhe 4 anëtarë, të cilët emërohen në detyrë nga Kuvendi i Shqipërisë me një mandat 5 vjeçar.

Në përputhje me kërkesat e ligjit për Sektorin e Energjisë Elektrike dhe atë të Gazit Natyror është përgatitur ky raport për Kuvendin e Shqipërisë.

Në raport janë paraqitur të dhëna mbi ecurinë e Sektorit të Energjisë Elektrike dhe të Gazit Natyror për vitin 2018 si dhe krahasimet me vitet parardhës.

Përsa i takon Energjisë Elektrike duhet theksuar se viti 2018 ka qënë nje vit hidrologjik tejet i mire si rrjedhojë e të cilit si dhe zbatimit të disa prej reformave kryesore të sektorit, performanca financiare e operatorëve të licensuar në prodhimin e Energjisë Elektrike si nga Operatorët publik ashtu dhe ato private (koncesionare apo jo) ka qënë e kënaqshme.

Prodhimi vjetor i Energjisë Elektrike ka qënë në vlerën mbi 8.5 TWh, një rritje prej më tepër se 3,7 GWh ose rreth 1.77 herë krahasuar me mesataren shumëvjeçare të llogaritur që nga viti 1985 dhe mbi 1.88 herë krahasuar me vitin 2017.

Si pasojë e një viti tejet të mirë hidrologjik rezultoi se në rang vendi Shqipëria ishte eksportuese e Energjisë Elektrike me nje sasi prej 0.9 TWh krahasuar me nje import prej gati 3 TWh të vitit 2017. Ndër vite përveç vitit 2010, dhe sasirave të pakta në 2016, ky është viti i tretë ndër 12 vitet e fundit që vendi rezulton eksportues.

Në këtë sasi prodhimi mbi 5.8 TWh ose gati 68.4% e sasisë i përket shoqërisë publike të gjenerimit, KESH sh.a. ndërsa pjesa tjetër prej, 2.7 TWh ose gati 31.6% i përket prodhuesve të pavarur të Energjisë Elektrike duke shënuar kështu një rritje dhe të këtyre prodhuesve përgjate vitit 2018.

Për t’u theksuar gjatë 2018 është dhe fakti i fillimit të prodhimit të impianteve fotovoltaike të cilët nisën kryesisht në fund të vitit 2018. Sasitë e prodhuara prej tyre do të pasqyrohen në bilancin energjetik të OSHEE sh.a. duke filluar nga viti 2019 e në vijim.

Një trend në rritje përgjatë 2018, siç dhe ishte e pritshme për shkak të vitit hidrologjik të mirë, ka patur dhe prodhimi nga HEC-et me përparësi private ose të dhënë me konçension (deri 15 MW), si dhe nga HEC Ashta.

Aktualisht gjatë vitit 2018 vetëm një central prodhimi Fotovoltaik i UKKO (Ujësjellës Kanalizimet Korçë) sh.a. me kapacitet të instaluar rreth 1 MW ka prodhuar për nevojat e tij të furnizimit dhe ka pasur marrëveshje netimi të Energjisë me OSHEE sh.a. nëpërmjet së cilës rakordohet sasia e prodhuar dhe sasia e konsumuar. Prodhuesi në fjalë është mjaft interesant pasi i çel rrugën një kategorie të re të klientëve të cilat janë të përhapur tej mase në vendet e Evropës Perëndimore të quajtur *Prosumers* të cilët prodhojnë Energji Elektrike për nevojat e veta dhe mund të shesin një sasi të Energjisë në treg. Aktet teknike dhe rregullative të përthithjes së tyre në treg janë në përpunim e sipër si nga OSHEE sh.a., Ministrisë së linjës dhe nga ana jonë.

Në po këtë prizëm edhe konsumi pati një rritje 2.7% krahasuar me një vit më parë duke shënuar vlerën prej 7.6 TWh përgjatë 2018.

Humbjet e përgjithshme të raportuara nga Shoqëria për vitin 2018, arrijnë në masën 23.96% krahasuar me shifrën prej 26.41% të një viti më parë.

Niveli total i arkëtimeve i raportuar nga OSHEE sh.a. ishte 101.9 % kundrejt Energjisë Elektrike të faturuar për vitin 2018, shifër në të cilën përfshihen edhe arkëtimet e prapambetura të periudhës 2007-2017 në vleftën prej 7.6 Milard lekësh.

Klientet privatë zënë rreth 39% të konsumit total të OSHEE sh.a. po ashtu një peshë të rëndësishme në konsumin total të Energjisë Elektrike në vendin tonë zënë edhe konsumatorët buxhetorë dhe jo buxhetorë të cilët zënë rreth 12 % të faturimit total të OSHEE sh.a., duhet thënë se këta konsumatorë vazhdojnë të kenë problem përse i takon pagesave të faturave të Energjisë Elektrike duke akumuluar një borxh për OSHEE sh.a. dhe duke vënë në vështirësi financiare këtë të fundit.

Në vendin tonë konsumi familjar në raport me konsumin e përgjithshëm të faturuar për klientët tariforë për vitin 2018 përbën rreth 49% të konsumit.

Përse i takon tarifave të klientëve fundorë përgjatë vitit 2018 nuk pati rritje të tyre dhe tarifat kanë mbetur sipas tabelës më poshtë:

Po ashtu një ulje ka patur dhe çmimi i llogaritur dhe miratura për prodhuesit me përparësi të Energjisë Elektrike nga hidrocentralet për periudhën 2004-2019:

Në kuadër të mbrojtjes së konsumatorit është miratuar plani i masave për OSHEE sh.a dhe janë trajtuar në çdo rast nga ERE ankesat në kuadër të kushteve të përgjithshme të furnizimit.

Viti 2018-të ka qënë një vit ku vijoi puna e përbashkët me rregullatorët e Italisë dhe Greqisë për projektin TAP, dhe ku rezultatet kane qënë konkrete dhe të dukshme. Gjatë vitit 2018 filluan procedurat për licensimin e TAP-AG si Operator i Pavarur.

Enti Rregullator i Shqipërisë së bashku me Entet Rregullatore të Greqisë dhe Italisë, kanë marrë vendime të përbashkëta në lidhje me projektin TAP-AG. Këto vendime janë marrë në përputhje të plotë me Direktivën e Parlamentit European dhe të Këshillit, 2009/73/EC, Rregullores (EC)

N0.715/2009 , të Vendimit të Këshillit Ministrial No. D/2011/02/MC-EnC, si dhe ligjit “Për Gazin Natyror” Nr.102/2015, i cili tashmë ka reflektuar të gjitha kërkesat e Bashkimit Europian.

Megjithë arritjet dhe performancën e mirë të Sektorit të Energjisë Elektrike dhe në planin e përgatitjes së legjislacionit sekondar dhe rregullator, përfshirë sektorin e gazit natyror vlen të theksohet se ndër fushat në drejtim të cilave duhej dhe mund të ishte punuar dhe më tepër, të cilat do të jenë ndër objektivat e punës së ERE-s për vitin që vjen përmendim:

- **Liberalizimi i tregut të Energjisë Elektrike**

Nëpërmjet hapjes së bursës së Energjisë në bashkepunim me një partner ndërkombëtar i cili do të mundësojë operimin efikas dhe transparent të tij. Lidhur me këtë është e nevojshme kryerja e një studimi mbi impaktin afatshkurtër dhe masat për amortizimin e këtyre efekteve tek klienti fundor si rezultat i hapjes së tregut të Energjisë Elektrike dhe bashkimit të tregjeve me vendet e Evropës Juglindore dhe atë Evropian. Në gjykimin tonë dhe në bazë të studimeve të kryera nga kompanitë e mirënjohura ndërkombetare me përfundimin e linjës nënujore të interkonjeksionit midis Italisë dhe Malit të Zi, që pritet të vihet në përdorim në fund të vitit 2019, bashkimi i tregjeve të Energjisë Elektrike të vendeve të Evropës Juglindore me ato të Evropës Perëndimore do të sjelli një rritje të çmimit të Energjisë Elektrike në Rajon i cili për një periudhë të shkurtër do të stabilizohet. Ky fakt duhet të shfrytëzohet nga burimet tona gjeneruese hidrike të cilët nëpërmjet optimizimit të portofolit të tyre mund dhe duhet të përfitojnë nga kjo situatë. Gjithsesi impakti që kjo rritje afatshkurtër mund të ketë në klientët familjarë dhe masat për paraprirjen apo amortizimin e saj duhet të kihet parasysh nga ana jonë në bashkëpunim me aktorët e tjerë të sektorit. Kjo do të mundësojë dhe krijimin e kushteve për klientët fundorë të daljes në treg të lirë dhe ndryshimit të furnizuesit duke optimizuar shpenzimet për furnizimin me Energji Elektrike.

- **Ndarja funksionale dhe organizative e OSHEE**

Ndërmarrja e masave të nevojshme për monitormin e ndarjes së OSHEE sh.a. sipas parashikimeve të Ligjit të Sektorit të Energjisë Elektrike, proces i cili duhet të shoqërohet me ndarjen funksionale dhe organizativ si dhe llogarive dhe kostove midis Furnizuesit të Mundësisë së Fundit dhe Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes së Energjisë Elektrike, duke mundësuar shërbim të sigurtë dhe me cilësi të klientëve fundorë. Për këtë një bashkërendim i duhur me Ministrinë e linjës në rolin e pronarit si dhe aktorët ndërkombëtarë si Sekretariati i Energjisë në Vienë është mëse i domosdoshëm. Në këtë prizëm zbatimi i planit të masave miratuar me VKM-në nr.742, dt. 12/12/2018 “Për miratimin e planit strategjik për reformimin e sektorit të energjisë në Shqipëri,” i cili hap perspektivën dhe mundësinë e pranimit të ofertës publike për OSHEE-në, është tejet i rëndësishëm.

- **Vlerësimi mbi menaxhimin e riskut hidrologjik**

Është e domosdoshme marrja e masave nga ana e kompanisë publike të gjenerimit, KESH sh.a. për menaxhimin e riskut hidrologjik. Në këtë kuadër çelja e një fondi (escrow account) për menaxhimin e këtij risku me anë të së cilës KESH sh.a. me përfitimet financiare të

nxjerra përgjatë një viti hidrologjik të mirë mbulon dhe menaxhon humbjet e mundshme në një vit hidrologjik relativisht të keq. Në këtë mënyrë menaxhohen risqet e rritjes së kostove të furnizimit të Energjisë Elektrike për klientët fundorë për shkak të kushteve klimatike.

- **Krijimi i nje tregu të disbalancave dhe shërbimeve ndihmëse**

Është mëse e domosdoshme krijimi i tregut të balancimit dhe shërbimeve ndihmëse bazuar në praktikat më të mira Evropiane duke mundësuar dhënin e shërbimit nga prodhuesit në baza tregu për të reflektuar në mënyrë efektive dhe reale kostot e këtij shërbimi. Ngritja e një tregu të tillë është dhe domosdoshmëri për mirëfunksionimin e bursës së Energjisë Elektrike. Një treg i tillë dhe bashkimi me tregjet rajonale do të mundësonte dhe përfitime financiare nga ana e KESH sh.a. si një ndër prodhuesit me mundësitë më të mira për ofrimin e këtij shërbimi në rajon i cili ka dhe një përfitim tejet të lartë.

- **Montorimi i implementimit të planit të masave për OSHEE për mbrojtjen e konsumatorit**

Një vëmendje e caktuar i duhet kushtuar implementimit të planit të masave për OSHEE sh.a. në drejtim të mbrojtjes së konsumatorit si dhe ndoshta azhurnime të tij në funksion të problematikave që kanë dalë përgjatë zbatimit të tij në terren duke u fokusuar në zgjidhjen e ankesave të klientëve në një kohë sa më të shkurtër dhe me përgjegjësi të plotë.

- **Impakti i Burimeve te Rinovueshme në treg**

Rritja e numrit të impanteve të prodhimit të Energjisë Elektrike nga burimet e rinovueshme si centralet fotovoltaike, hidro dhe ato me erë, ka sjellë si prerogative përgatitjen e kuadrit ligjor dhe Rregullator për absorbimin e tyre si dhe uljen e kostove apo dhe shpërndarjen e drejtë të tyre tek të gjithë klientët jo vetëm ata fundorë. Në këtë prizëm bashkëpunimi me Ministrinë e Linjës si dhe me aktorët e tjerë të rëndësishëm të sektorit për përgatitjen e këtij kuadri Ligjor do të marrë vëmendjen e duhur nga ana jonë.

- **Strategjia mbi masat e sigurisë së rrjeteve dhe sistemeve të informacionit në sektorin e Energjisë Elektrike dhe atë të Gazit natyror**

Në zbatim të planit të masave pjesë përbërëse e direktivës nr. 2016/1148 “Mbi Sigurinë e Sistemit dhe Sistemeve Informatike” (NIS) e njohur ndryshe dhe si Direktiva “Mbi masat për një nivel të përbashkët të lartë të sigurisë së rrjeteve dhe sistemeve të informacionit në Bashkimin Europian, është i domosdoshëm përpilimi i një strategjie për marrjen e masave për zbatimin sa më të shpejtë të saj në infrastrukturat kritike të sektorit të Energjisë Elektrike siç janë OST sh.a. dhe OSHEE sh.a. siç janë përcaktuar në VKM-në nr. 222 datë 26.04.2018 "Miratimin e listës së infrastrukturave kritike të informacionit". Gjykojmë po me aq rëndësi përfshirjen në listën e këtyre infrastrukturave edhe të kompanisë publike të gjenerimit apo dhe impiantet private të gjenerimit të cilët mund të kenë impakt në sigurinë territoriale, siç janë HEC-et me diga. Në këtë prizëm bashkëpunimi me Autoritetin përgjegjës sipas ligjit nr. 2/2017, “Për sigurinë kibernetike”, si dhe me institucionet e tjera të interesuara për

sigurinë kombëtare është tejet i rëndësishëm për parandalimin dhe marrjen e masave paraprake në këtë drejtim. Me mbështetjen e NARUC dhe USAID do të punohet për hartimin e një strategjie për infrastrukturën kritike në sektorin e energjisë.

- **Studimi i zgjidhjeve dhe përgatitja e propozimeve përkatëse për shuarjen e detyrimeve reciproke**

Aktualisht detyrimet e prapambetura financiare midis operatorëve publik të sektorit të Energjisë Elektrike kanë marrë përmasa të mëdha, kjo vlen dhe për detyrimet që klientët, kryesisht ato buxhetore kanë në drejtim të OSHEE për faturat e Energjisë Elektrike duke vënë këtë të fundit në një situatë të vështirë financiare. Zgjidhja përfundimtare e tyre dhe gjetja e rrugëve dhe mënyrave për moskrijimin e tyre në të ardhmen me mbështetjen dhe të Minitrisë së Linjës si dhe asaj të Financave dhe Ekonomisë dhe Këshillit të Ministrave është mëse e domosdoshme dhe aktuale.

Në përputhje me zhvillimet e tregut të energjisë dhe legjislacionit që rregullon këtë sektor, puna e ERE do të fokusohet gjithashtu në drejtim të:

- shqyrtimit dhe analizimit të planeve të investimit për të orientuar investime të kujdeseshme në sektor në përputhje me parimin e kostos më të ulët, eficensës dhe gjendjes financiare të shoqërive publike,

- Sigurimin e informacion dhe raportimeve pranë Kuvendit në përputhje me kërkesat e ligjit dhe siç përcaktuar në rezolutën respektive apo aktet e tjera të kuvendit,

- angazhimin e një bashkëpunimi të vazhdueshëm me të gjithë pjesëmarrësit e tregut dhe grupet e interesit me qëllim adresimin dhe gjetjen e zgjidhjeve që balancojnë interesat e palëve në proceset vendimmarrëse të ERE ,

- bashkëpunimi me institucionet e tjera vendimmarrëse në vend në kuadër të implementimit të kushteve të certifikimit të operatorëve të transmetimit në sektorin e energjisë elektrike dhe gazit natyror.

- vendosja e platformave që mundësojnë një shërbim interaktiv përmes komunikimit elektronik që do të rriste më tej aksesin e palëve të treta në praktikën dhe vendimmarrjet e ERE.

-bashkëpunimi në nivel rajonal dhe në kuadër të organizmave rregullator ndërkombëtare ku aderohet.

- vijimi i projekteve të përbashkëta të tillë si vijimi i punës në kuadër të, fazës së dytë të projektit KEP (Know-How Exchange Program) kushtuar shkëmbimit të aftësive rregullatore drejt zonës ballkanike i cili ka vijuar gjatë vitit 2018.

Projekti, aktivizuar në janar 2018 nga Autoriteti Rregullator për Energji, Rrjetet dhe Mjedisin (ARERA) në bashkëpunim me TERNA (Operatori i Sistemit të Transmetimit Italian), GME (Operatori i tregut të energjisë elektrike, Italian) dhe me mbështetjen e I-COM (Instituti për Konkurrencën), është pjesë e Programit InCe / BERZH (Banka Europiane për rikonstrukcion dhe zhvillim) të Programit të Bashkëpunimit Teknik - Know-How Exchange (KEP) me titull

"Mbështetje për Forcimin e Autoriteteve Rregullatore të Energjisë në Ballkanin Perëndimor" në favor të rregullatorëve të Shqipërisë, Malit të Zi dhe Serbisë. ARERA ka propozuar të fokusojë aktivitetet në zbatimin e mekanizmave të bashkimit të tregut në vendet e Ballkanit për të favorizuar krijimin e një tregu rajonal të energjisë elektrike në zonë dhe integrimin e tij në tregun e vetëm evropian.

Pas përfundimit me sukses të fazës së parë të projektit, aktivitetet e reja do të fokusohen në masat konkrete që rregullatorët e Ballkanit do të duhet të miratojnë për të përmbushur kuadrin rregullator evropian, në mënyrë që të favorizojnë procesin e integritit të tregjeve të energjisë elektrike në Ballkan në atë evropian.

NIVELI I PLOTËSIMIT DHE RESPEKTIMIT TË DETYRIMEVE NDËRKOMBËTARE

Në përmbushje të detyrimeve të vendimeve të Grupit të përhershëm të nivelit të lartë të komunitetit të Energjisë (PHLG) janë miratuar nga Bordi i ERE-s Kodet e mëposhtme të rrjetit :

- Kodi i Rrjetit për Kërkesat për Lidhjen e Rrjetit të Sistemeve me Tension të Lartë me Rrymë të Vazhduar dhe Parqet me Module të Energjisë të lidhur me rrymë të vazhduar – mbi zbatimin e vendimit 2018/04/PHLG-EnC për përfshirjen e Rregullores së Komisionit (BE) 2016/1447 datë 26 Gusht 2016.
- Kodi i Rrjetit për Lidhjen e Kërkesës – mbi zbatimin e Vendimit 2018/05/PHLG-EnC për përfshirjen e Rregullores së Komisionit (BE) 2016/1388 datë 17 Gusht 2016.
- Kodi i Rrjetit mbi kërkesat për lidhjen me Rrjetin e Gjeneruesve” – mbi zbatimin e Vendimit të 2018/03/PHLG-EnC për përfshirjen e Rregullores së Komisionit (BE) 2016/631 datë 14 Prill 2016.
- Kodi i Rrjetit mbi Rregullat e Ndërveprimit dhe Shkëmbimit të të Dhënave- mbi zbatimin e Vendimit 2018/02/PHLG-EnC mbi miratimin e Rregullores së Komisionit (BE) Nr 2015/703 datë 30 Prill 2015.

Progresi me strukturën rregullatore në lidhje me përshtatjen me zbatimin e Paketës së 3-të të BE dhe angazhimeve të OST shqipëtare, si anëtare me të drejta të plota në Rrjetin European të transmetimit (ENTSOE).

- Miratimi i udhëzimeve për Kërkesat Kryesore Organizative, Rolet dhe Përgjegjësitë (KORP) në lidhje me Shkëmbimin e të Dhënave.
- Propozimi i gjithë OST-ve për një metodologji të ofrimit të dhënave të gjenerimit dhe ngarkesës në përputhje me nenin 17 të Rregullores së Komisionit (BE) 2016/1719 të datës 26 shtator 2016 për krijimin e një udhëzuesi mbi alokimin e kapaciteteve në avancë.
- Propozimi i gjithë OST-ve për një metodologji të modelit të përbashkët të rrjetit në përputhje me Nenet 67 (1) dhe 70 (1) të Rregullores së Komisionit (BE) 2017/1485 të datës 02 gusht 2017 për krijimin e një udhëzuesi mbi operimin e sistemit të transmetimit të energjisë elektrike.
- Miratimi i disa ndryshimeve tek Propozimi i OST-ve për udhëzimet për Kërkesat Kryesore Organizative, Rolet dhe Përgjegjësitë (KORRR) në lidhje me Shkëmbimin e të Dhënave.

- Propozimi i të gjitha OST-ve të Evropës Kontinentale dhe Nordike për hipotezat dhe një metodologji të Analizës së Kosto-Përfitimit në përputhje me Nenin 156 (11) të Rregullores së Komisionit (BE)2017/1485 të datës 2 gusht 2017, që përcakton një udhëzues mbi operimin e sistemit të transmetimit të energjisë elektrike

MBI REKOMANDIMET E PROGRESRAPORTIT TË BE.

ERE ka informuar periodikisht, në kuadër të raportimeve për Nënkomitetin e Transportit, mjedisit, energjisë dhe zhvillimit rajonal, lidhur me rekomandimet e progresraportit të BE për vitet respektive e konkretisht për vitin 2018 si më poshtë:

Për ndarjen e OSSH

- Pas regjistrimit të tre kompanive të reja në Qendrën Kombëtare të Biznesit, Enti Rregullator i Energjisë (ERE) ka licensuar “Furnizuesin e Tregut të Lirë” (FTL) sh.a në aktivitetin e tregëtimit dhe furnizimit me energji elektrike, për një periudhë prej pesë vjetësh.
- Pas kërkesës së kompanisë OSHEE për transferimin e licensës tek Shoqëria e sapo krijuar, ERE miratoi transferimin e licensës së furnizimit me energji elektrike nga OSHEE sh.a tek Shoqëria e re Furnizuesi i Shërbimit Universal (FSHU) sh.a dhe transferimin e licensës për operimin e sistemit të shpërndarjes së energjisë elektrike të OSHEE tek “Operatori i Sistemit të Shpërndarjes” e vlefshme deri në 27.10.2044.
- Pas fillimit të punës për vlerësimin financiar dhe atë të aseteve të të treja kompanive, OSHEE i kërkoi udhëzime të tjera në lidhje me veçimin funksional Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë dhe pas marrjes së opinionit të Ministrisë si aksioner i vetëm i OSHEE sh.a, kjo e fundit paraqiti një kërkesë në ERE, ku kërkonte ofrimin e një periudhe tranzitore për transferimin e licensës.
- Bordi i ERE pas vlerësimit të kërkesës, miratoi një periudhë tranzitore prej 12 muajsh, për të bërë efektiv transferimin e licensës për operimin e sistemit të shpërndarjes së energjisë elektrike nga OSHEE tek Operatori i Sistemit të Shpërndarjes (OSSH) sh.a dhe transferimin e licensës për furnizimin e energjisë elektrike dhe detyrimin të shërbimit universal për furnizimin me energji elektrike nga OSHEE tek “Furnizuesi i Shërbimit Universal” sh.a.
- Deri në përfundimin e periudhës tranzitore (prej 12 muajsh), aktivitetet e operimit tek sistemi i shpërndarjes së energjisë elektrike, furnizimi elektroenergjetik dhe detyrimi i shërbimit universal për furnizimin me energji elektrike do të vazhdojnë të kryhen nga Shoqëria OSHEE.
- Ligji Nr. 7/2018 “Mbi disa shtesa dhe ndryshime tek Ligji nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike” ka përcaktuar që klienti fundor që furnizohet nga furnizuesi i mundësisë së fundit që del për herë të parë në treg të liberalizuar, është i detyruar të lidhë një kontratë furnizimi me një furnizues të ri, brenda 2 viteve nga fillimi i kontratës së furnizimit nga furnizuesi i mundësisë së fundit.
- Shtyrja e periudhës tranzitore (një periudhë dy vjecare) para se të dalë në treg të liberalizuar nuk e pengon mundësinë e konsumatorëve të lidhur në rrjetin 35 kV për të gjetur një furnizues në treg të liberalizuar por merr parasysh problemet e konsumatorëve në lidhje me mungesën e eksperiencës për të operuar në treg të liberalizuar, pamundësinë e tyre për të gjetur një furnizues dhe u jep konsumatorëve kohën e nevojshme që të përshtasin kalimin

nga tregu i rregulluar në tregun e liberalizuar si dhe kufizimet teknike të konsumatorëve për të kaluar në treg të liberalizuar.

- Sipas ndryshimeve tek Ligji Nr 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, të gjithë konsumatorët e lidhur në rrjetin 35 kV, duke filluar nga fundi i vitit 2019 nuk do të furnizohen nga OSHEE si Furnizues i Mundësisë së Fundit.

GAZI: Ndarja e OST – Ndjekja e certifikimit të kompanisë Albgaz

- Bordi i ERE miratoi me Vendimet Nr. 236 datë 02.11.2018 “Për një ndryshim në Vendimin e Bordit të ERE-s, nr. 179, datë 08.11.2017, “Mbi certifikimin e shoqërisë “Operatori i kombinuar i gazit natyror” Albgaz sh.a.”
- Sipas këtij Vendimi, ERE miratoi kërkesën e Albgaz sh.a që të shtyjë deri në 10.04.2019 afatin për përmbushjen e detyrimeve të përcaktuara në pikat 2;3;5;5.2 dhe 7 të Vendimit të Bordit të ERE Nr. 179 datë 08.11.2017. Ky vendim është marrë pasi ERE vlerësoi që Albgaz sh.a ka ndjekur vazhdimisht procedurat e kërkuara dhe masat nën kontrollin e saj për të realizuar veçimin e OST dhe përmbushjen e kushteve të përcaktuara tek vendimi.
- Albgaz ka raportuar në ERE se po ndjek hapat e nevojshëm për regjistrimin e aseteve.
- Albgaz ka paraqitur në ERE kërkesën e saj për miratimin paraprak të kandidaturës së Zyrtarit të Pajtueshmërisë. ERE pas shqyrtimit të kërkesës ka vendosur miratimin paraprak të Zyrtarit të Pajtueshmërisë të Operatorit të Sistemit të Transmetimit për Gazin Natyror.
- Shoqëria Albgaz ka raportuar në ERE që audituesit financiarë të emëruar për auditimin e pasqyrave financiare të kompanisë Albgaz janë të pavarur nga Audituesit Financiare të cilët kryejnë auditin e kompanive/ndërmarrjeve të integruara vertikalisht të gjenerimit ose furnizimit.
- Për sa i përket tarifave në rrjetin e transmetimit dhe shpërndarjes së gazit natyror, (ERE) ka marrë Vendimin nr. 178, datë 8.11.2017, "Për miratimin e" Metodologjisë së llogaritjes së tarifave të rrjetit të transmetimit dhe shpërndarjes së gazit natyror "; Vendimi Nr. 97, datë 23.04.2018 "Për miratimin e tarifës së transmetimit të gazit natyror të Albgaz sh.a. për vitin 2018".

Hapja e tregut me pakicë

Lidhur me zbatimin e profileve të ngarkesës së standardizuar për kategoritë e konsumatorëve, sipas përcaktimeve të Ligjit nr. 43/2015 "Për Sektorin e Energjisë Elektrike", i ndryshuar, është detyrë e Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes të përcaktojë profilet e ngarkesës së standardizuar për kategoritë e përcaktuara të konsumatorëve, në rast se të dhënat e matjes të nevojshme për llogaritjen e pabarazive nuk janë të përshtatshme dhe të disponueshme. Në korrik 2018, u paraqit një draft rregullash për hapjen dhe funksionimin e tregut të shitjes me pakicë të profilit të ngarkesës së standardizuar të miratuar nga OSSh, të propozuar nga Sekretariati i Komunitetit të Energjisë. Aktualisht, këto rregulla janë në procesin e konsultimit me palët e interesit.

Përditësimi i masave të marra dhe të dhënat për reduktimin e humbjeve të shpërndarjes dhe përmirësimin e mbledhjes së pagesave të faturës së energjisë

Me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 763, datë 20.12.2017 u miratuan disa ndryshime në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 1086, datë 14.12.2013" Për ngritjen e Task Forces për

përmirësimin e normës së mbledhjes së faturave dhe uljen e humbjeve në rrjetin e shpërndarjes së energjisë elektrike", i ndryshuar. Vendimi i Këshillit të Ministrave zgjati veprimtarinë e Task Force-it nga data 31.12.2017 deri më 31.12.2019, me qëllim përmirësimin e nivelit të mbledhjes dhe reduktimit të humbjeve në sistemin e shpërndarjes së energjisë elektrike. Në anën tjetër, OSHEE sh.a. po vazhdon punën e mirë në reduktimin e humbjeve të energjisë elektrike dhe rrit nivelin e arkëtimeve.

Aktualisht rezultojnë të dhënat e mëposhtme:

- Niveli i humbjeve të energjisë elektrike në rrjetin e shpërndarjes

Viti 2013 - 45.04%

Viti 2014 - 37.81%

Viti 2015 - 31.34%

Viti 2016 - 28.04%

Viti 2017 - 26.41%

Viti 2018 - 23.96%

- Niveli i arkëtimeve

Viti 2013 - 81.04%

Viti 2014 - 92.69%

Viti 2015 - 100.65%

Viti 2016 - 93.50%

Viti 2018 - 101.9%

Vonesa e hapjes së tregut; faza e heqjes nga subvencionimi dhe rregullimi i çmimeve / miratimi i akteve të detyrimeve të shërbimit publik

Sipas nenit 109 të Ligjit 43/2015 "Për Sektorin e Energjisë Elektrike", konsumatorët e lidhur me rrjetin 110 ose 110, 35 dhe 20 kV duhet të furnizohen në tregun e liberalizuar. Për këtë qëllim, Këshilli Mbikëqyrës i OSHEE sh.a. miratoi vendimin e tij nr. 13, datë 10.05.2016, Për investimet në sistemin e matjes për konsumatorët e lidhur me rrjetet e energjisë elektrike 35 kV. OSHEE sh.a.. përfundoi investimet në sistemin e matjes për konsumatorët e lidhur me rrjetet e energjisë 35 kV dhe bëri teknikisht të mundur daljen e këtyre klientëve në tregun e liberalizuar. Duke marrë këto masa, Bordi i ERE-së, me Vendimin e tij nr. 24, datë 15.02.2017 ka miratuar marrëveshjen e Shërbimit të Shpërndarjes në mes të OSHEE S.A dhe furnizuesve të energjisë elektrike.

Ministria e Infrastrukturës dhe Energjetikës kërkoi nga OSHEE SH.A. të dërgojë njoftim ligjor duke filluar nga data 1 nëntor 2017, për të gjithë konsumatorët e lidhur me rrjetin shpërndarës 35 kV për ndryshimin e furnizuesit të energji sëelektrike. Kështu, OSHEE SH.A. njoftoi ligjërisht

konsumatorët e lidhur me rrjetin 35 kV për të marrë masa për t'u furnizuar në tregun e parregulluar duke filluar nga 1 janari 2018.

Ligji nr. 7/2018 "Për disa ndryshime dhe plotësime të Ligjit nr. 43/2015" Për sektorin e energjisë elektrike "", ka përcaktuar që konsumatori fundor, i cili hyn për herë të parë në tregun e liberalizuar, është i detyruar të nënshkruajë një kontratë furnizimi me një furnizues të ri brenda dy viteve nga fillimi i kontratës së furnizimit nga furnizuesi i mundësisë së fundit.

Zgjatja e periudhës tranzitore (periudha dy vjeçare) para hyrjes në tregun e liberalizuar nuk pengon mundësinë e konsumatorëve të lidhur me 35 kV për të gjetur një furnizues në tregun e liberalizuar, por merr parasysh shqetësimet e konsumatorëve në lidhje me mungesën e përvojës për të operuar në tregun e liberalizuar, pamundësinë e tyre për të gjetur një furnizues dhe u jep konsumatorëve kohën e nevojshme për t'u përshtatur me kalimin nga tregu i rregulluar në tregun e liberalizuar si dhe kufizimet teknike të klientit për të kaluar në treg të liberalizuar.

Sipas ndryshimeve në Ligjin nr. 43/2015 "Për Sektorin e Energjisë Elektrike", të gjithë konsumatorët e lidhur me rrjetin 35 kV, deri në fund të vitit 2019 nuk do të furnizohen nga OSHEE SH.A. si Furnizues i mundësisë së fundit.

Siç është përmendur në pikën 4.3 "Harmonizimi dhe zbatimi i paketës së tretë të energjisë të BE-së", Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 729, datë 8.12.2017 "Për disa shtesa dhe ndryshime në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 244, datë 30.03.2016" Mbi miratimi i kushteve për vendosjen e detyrimeve të shërbimit publik që do të zbatohen për të licencuarit në sektorin e energjisë elektrike, të cilat veprojnë në prodhimin, transmetimin, shpërndarjen dhe furnizimin me energji elektrike ", i ndryshuar, Ligjin nr. 43/2015 të datës 30.04.2015 "Për Sektorin e Energjisë Elektrike" dhe Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 244, datë 30.03.2016 "Për miratimin e kushteve për vendosjen e detyrimit të shërbimit publik, që do të zbatohet për të licencuarin në fuqi sektori, i cili kryen prodhimin, transmetimin, shpërndarjen dhe aktivitetin e furnizimit me energji elektrike ", të ndryshuar me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 729 datë 8.12.2017, ERE nuk miraton më një metodologji për llogaritjen e tarifave të prodhimit të energjisë elektrike.

Sipas Ligjit nr. 43/2015, datë 30.04.2015 "Për Sektorin e Energjisë Elektrike", tarifat e transmetimit, shpërndarjes dhe shërbimit universal miratohen nga ERE bazuar në metodologjinë e miratuar nga ERE. Në lidhje me këtë, ERE pas daljes së Ligjit Nr. 43/2015 të datës 30.04.2015 "Për Sektorin e Energjisë Elektrike" ka miratuar metodologjitë e kërkuara si më poshtë:

- Vendimi i Bordit të Komisionerëve të ERE nr. 180, datë 8.11.2017 "Për miratimin e metodologjisë për llogaritjen e tarifave të transmetimit të energjisë elektrike";
- Vendimi i Bordit të Komisionerëve të ERE Nr. 182, datë 10.11.2017 "Për miratimin e metodologjisë për llogaritjen e tarifave të operatorit të shpërndarjes së energjisë elektrike";
- Vendimi i Bordit të Komisionerëve të ERE Nr. 189, datë 23.11.2017 "Për metodologjinë e përcaktimit të çmimit të shitjes me pakicë të energjisë elektrike për konsumatorët e përdoruesit të fundit të furnizuar nga Furnizuesi Universal i Shërbimit (USS)";

- Vendimi i Bordit të Komisionerëve të ERE Nr. 201, datë 4.12.2017 "Për miratimin e metodologjisë për përcaktimin e çmimit të shitjes me pakicë të energjisë elektrike nga Furnizuesi i Fundit të Burimeve";
- Vendimi i Bordit të Komisionerëve të ERE Nr 144, datë 25.06.2018 "Për rishikimin e metodologjisë për përcaktimin e çmimit të shitjes me pakicë të energjisë elektrike nga Furnizuesi i fundit i Burimeve, miratuar me Vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE Nr. 201, datë 4.12.2017 "

Kontrata në mes palëve KESH sh.a dhe OSHEE sh.a është në përputhje me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 244 datë 30.03.2016 "Për miratimin e kushteve për vendosjen e detyrimeve të shërbimit publik për të licencuarit në sektorin e energjisë elektrike, të cilat veprojnë në prodhimin, transmetimin, shpërndarjen dhe furnizimin me energji elektrike ".

Kontrata në mes palëve KESH sh.a dhe OSHEE sh.a për mbulimin e humbjeve në sistemin e transmetimit , u ndërpre në fund të 2017. OST sh.a. blen energji elektrike për të mbuluar humbjet e saj në tregun e hapur.

Kapaciteti administrativ i ERE

ERE është organizuar sipas Vendimit të Kuvendit nr. 181, datë 5.05.2008 "Mbi miratimin e strukturës dhe personelit të Rregullatorit të Energjisë në Shqipëri" sic sqaruar edhe më tej në Raport.

PJESA I: Rregullimi në Tregun e Energjisë Elektrike

1.1 Tregu i Energjisë Elektrike

ËPër vitin 2018, Tregu i Energjisë Elektrike ka funksionuar bazuar në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 244, datë 30.03.2016 i ndryshuar “Për miratimin e kushteve për vendosjen e detyrimit të shërbimit publik”, që do të zbatohen ndaj të licensuarve në sektorin e Energjisë Elektrike, të cilët ushtrojnë aktivitetin e prodhimit, transmetimit, shpërndarjes dhe furnizimit me Energji Elektrike. Për sa përçaktuar nga Këshilli i Ministrave ky vendim shërben si Model i Përkohshëm Tregu deri në zbatueshmërinë e VKM Nr. 519 dt 13.07.2016 “Për Miratimin e Modelit të Tregut të Energjisë Elektrike”, implementimi i së cilës lidhet me bërjen efektive të Tregut të Një Dite më parë dhe ngritjen e Bursës së Energjisë Elektrike. Veç të tjerash, modeli aktual, ka përçaktuar qartë pjesëmarrësit e tregut të Energjisë Elektrike në Shqipëri (TEE), si dhe rolin dhe përgjegjësitë e secilit pjesëmarrës në treg të ngarkuar me detyrimin e shërbimit publik.

Me hyrjen në fuqi të Ligjit Nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike” i ndryshuar, Enti Rregullator i Energjisë me qëllim reflektimin e kërkesave të këtij ligji ka vijuar punën për të miratuar aktet rregullatore nënligjore në zbatim të tij.

Për sa është parashikuar dhe në nenin 98 të Ligjit Nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, dhe në VKM-në Nr. 244 datë 30.03.2016 të ndryshuar, Rregullat e Përkohshme të Tregut miratuar nga ana e ERE-s me Vendimin Nr. 139, datë 15.08.2016, të ndryshuar kanë qënë në zbatim përgjatë vitit 2018.

Gjithashtu, me Vendimin e ERE-s Nr. 193, datë 27.11.2017 janë miratuar "Rregullat e përkohshme për mekanizimin balancues të Energjisë Elektrike", me qëllim dhënien e një zgjidhje të pranueshme dhe transparente për të gjithë pjesëmarrësit e tregut në trajtimin e balancimit të sistemit Elektro-Energjistik Shqiptar dhe përgjegjësisë së tyre.

Janë hedhur hapa konkrete për liberalizimin e Tregut të Energjisë Elektrike sa i përket krijimit të kushteve teknike dhe të kuadrit nënligjor e rregullator për daljen në treg të hapur edhe për klientët e lidhur në nivelin e tensionit 35 kV në zbatim të Ligjit nr. 7/2018.

Aktualisht numri i tyre për të cilat është bërë e mundur krijimi i kushteve teknike është mbi 80, gjithsesi në këtë drejtim pritet të bëhet më tepër në krijimin e kushteve teknike nga ana e OSHEE për liberalizimin e mëtejshëm të tij.

Me vendimin Nr. 519 datë 13.07.2016, Këshilli i Ministrave në zbatim të nenit 97/3 të këtij ligji ka miratuar Modelin e Tregut, në bazë të të cilit ERE me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 214 dt. 28.12.2017 ka miratuar “Rregullat e Tregut Shqiptar të Energjisë Elektrike si dhe marrëveshjen e pjesëmarrjes në bursën Shqiptare të Energjisë Elektrike”, të cilat sëbashku dhe me ndryshimet e fundit të Ligjit të Sektorit të Energjisë Elektrike në Shkurt të 2018 krijojnë bazën e duhur ligjore për krijimin dhe operimin e Bursës së Energjisë Elektrike në Shqipëri.

Në figurat e mëposhtëme paraqitet Skema e Fluksit të Energjisë Elektrike dhe Tregtare si dhe Skema e Sistemit Elektroenergjetik Shqiptar.




Figure 1 Skema e Fluksit të Energjisë Elektrike dhe Tregtare

(Burimi: ERE Ligji Nr. 43/2015 VKM Nr. 244, datë 30.03.2016 i ndryshuar)

SKEMA E SISTEMIT ELEKTRO-ENERGJITIK




Figure 2 Skema e Sistemit Elektroenergjetik (Burimi: ERE)

SKEMA ELEKTRIKE E SISTEMIT ELEKTRO-ENERGJITIK SHQIPTAR




Figure 3 Skema Elektrike e Sistemit Elektroenergjetik Shqiptar

1.2 Prodhimi i Energjisë Elektrike

Prodhimi i Energjisë Elektrike nga shoqëritë prodhuese realizohet si një aktivitet i licensuar nga ERE, në bazë të Ligjit Nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike” i ndyshuar.

KESH sh.a, është shoqëria më e madhe prodhuese në Shqipëri me kapital tërësisht shtetëror e ngarkuar me detyrimin e shërbimit publik për furnizimin me Energji Elektrike të Furnizuesit Universal dhe mbulimin e humbjeve të Energjisë Elektrike në rrjetin e Shpërndarjes sipas VKM Nr. 244 datë 30.03.2016, e cila për vitin 2018 ka shfrytëzuar kapacitetet ekzistuese të kaskadës së lumit Drin.

Shoqëritë e tjera (Private/ Koncesionare) prodhuese paraqiten në tabelat e mëposhtme shoqëruar dhe me treguesit e prodhimit përkatës. Këto subjekte të licencuara në vite nga ERE shfrytëzojnë centrale ekzistuese, apo dhe të reja kryesisht nëpërmjet marrëveshjeve të koncesionit apo kontrata për shfrytëzimin dhe administrimin e impianteve prodhuese të Energjisë Elektrike, të nënshkruara me Qeverinë Shqiptare apo Autoritetet përgjegjëse, privatizimit të disa centraleve si ato të Lumit Mat dhe Bisticë si dhe një pjesë e vogël, shfrytëzojnë centrale deri në 2 MW, të privatizuar në kuadër të Ligjit Nr. 8527, datë 23.09.1999. Një numër i konsiderueshëm i centraleve prodhuese është i lidhur në rrjetin e shpërndarjes.

1.2.1 Kapacitetet dhe Prodhimi i Energjisë Elektrike

Prodhimi publik i energjisë elektrike kryhet nga shoqëria aksionere KESH sh.a. me 100% të aksioneve shtetërore. Përbërja e grupit të centraleve të zotëruara nga KESH sh.a dhe fuqia e instaluar e secilit prej tyre, të cilët realizojnë prodhimin publik është paraqitur në tabelë. Fuqia e përgjithshme e instaluar arrin në 1,448 MW, nga të cilat fuqia e instaluar e HEC-ve është 1,350 MW dhe e TEC Vlorë 98 MW.

Karakteristikat e Centralit	Centralet Prodhuese Publike			
	HEC Fierzë	HEC Koman	HEC V.Dejës	TEC Vlorë
Nr. Agregateve.	4	4	5	2
Fuqia e Agregateve. MW	125	150	50	70+28
Fuqia Instaluar e centralit MW	500	600	250	98
Fuqia Totale MW	1,448			

Figure 4 Struktura e Centraleve Elektrike të Prodhimit Publik (Burimi: KESH sh.a.)

Kapaciteti total i instaluar prej 2,204 MW përbëhet nga kapaciteti total i prodhuesve publike dhe kapaciteti total i instaluar i prodhuesve privatë/koncesion të Energjisë Elektrike prej 755.2 MW që përbën rreth 34.3% të fuqisë totale të instaluar. Prodhimi neto i energjisë elektrike nga KESH sh.a. në vitin 2018 u realizua 100% nga burimet hidrike.

Prodhimi neto vendas prej **8,552,152 MWh** u realizua:

5,850,932 MWh nga centralet prodhuese të KESH sh.a. ose 68.4% dhe
2,701,220 MWh nga centralet prodhuese të tjerë ose 31.6%.

Kapaciteti i instaluar i centraleve të lidhura në rrjetin e transmetimit gjatë vitit 2018 është rreth **1,964 MW** dhe prodhimi neto i tyre arrin në **7,809,069 MWh**. Kapaciteti i instaluar i centraleve të lidhura në rrjetin e Tensionit të mesëm përgjatë vitit 2018 është rreth **240 MW** dhe prodhimi neto i tyre arrin në **743,083 MWh**.

Në tabelën e mëposhtme jepen të dhëna të të gjithë centraleve, shoqërive, kapacitetit të instalimit në licensim dhe prodhimit neto për vitin 2018 të marra nga të dhënat zyrtare të OST sh.a. dhe OSHEE sh.a.

PRODHIMI GJATE VITIT 2018 NGA CENTRALET E LIDHURA NE RRJETIN E TRANSMETIMIT (MWh)				
HECET DHE KAPACITETI	MW	SUBJEKTI	LIDHJA	2018
Hec "Fierze" me fuqi 500 MW	500.000	"KESH" sha	220 kV	5,850,932
Hec "Koman" me fuqi 600 MW	600.000		220 kV	
Hec "V. Dejes" me fuqi 250 MW	250.000		220 kV	
Tec Vlora me fuqi 98 MW	98.000	"KESH" sha	220 kV	0
Hec "Ulez" me fuqi 25.2 MW	25.200	"Kurum International" sh.a.	110 kV	377,767
Hec "Shkonef" me fuqi 24 MW	24.000		110 kV	
Hec "Bistrica 1" me fuqi 22.5Mw	22.500		110 kV	
Hec "Bistrica 2" me fuqi 5 Mw	5.000		110 kV	
Hec "Peshqesh" me fuqi 27.94 MW,;	27.940	"Ayen As Energji" sha	220 kV	95,957
Hec "Fangu" me fuqi 74.6 MW,;	74.600		220 kV	238,690
Hec "Banie" me fuqi 73 MW	73.000	"Devoll Hydropower" sha	110 kV	292,561
Hec "Ashta" me fuqi 48.2 MW	48.200	"Energji Ashta" shpk	110 kV	298,107
Hec "Bishnica 2" me fuqi 2.5 MW	2.500	"HEC Bishnica 1.2" shpk	110 kV	10,739
Hec "Dardhe" me fuqi 5.8 MW	5.800	"Wenerg" shpk	110 kV	17,856
Hec "Truen" me fuqi 2.5 MW	2.500	"TRUEN" shpk	110 kV	
Hec "Ternove" me fuqi 8.385 Mw	0.921	"TEODORI 2003" shpk	110 kV	9,745
Hec "Gjorice" me fuqi 4.18 MW	29.610	"DITEKO" shpk	110 kV	115,714
Hec "Sllabinie" me fuqi 13.8 MW	13.800	"Power Elektrik Sllabinie" shpk	110 kV	44,034
Hec "Bele 1" me fuqi 5 MW ;	5.000	"Euron Energy" shpk	110 kV	132,347
Hec "Topoian 2" me fuqi 5.8 MW,;	5.800			
Hec "Bele 2" me fuqi 11 MW ;	11.000	"Alb-Energy" shpk		
Hec "Topoian 1" me fuqi 2.9 MW,;	2.900	"Energjal" shpk		
Hec "Orgjost I Ri" me fuqi 4.8 MW	4.800			
Hec "Cerunie-1" me fuqi 2.3 MW;	2.300	"Energy partners Al" shpk		20,799
Hec "Cerunie-2" me fuqi 2.8 MW;	2.800			
Hec "Rrupe" me fuqi 3.6 MW;	3.600			
Hec "Rapuni 1.2" me fuqi 4 dhe 4.1 MW	8.100	"C & S Construction" shpk	110 kV	33,392
Hec "Rapuni 3.4" me fuqi 8.857 MW	8.850	"C & S Energy" shpk	110 kV	35,808
Hec "Llapani" me fuqi 13.62 MW	13.620	"Gio.Spa.POWER" shpk	110 kV	48,023
Hec "Lengarice" me fuqi 8.94 MW	8.940	"Lengarica & Energy" shpk	110 kV	27,075
Hec "Lura 1" me fuqi 6.54 MW	6.540	"Erdat Lura" shpk	110 kV	48,079
Hec "Lura 2" me fuqi 4.02 MW	4.020		110 kV	
Hec "Lura 3" me fuqi 5.66 MW	5.660		110 kV	
Hec "Malla" me fuqi 5.455 MW	5.455	"Giure Rec" shpk	110 kV	16,958
Hec Prella me fuqi 14.97 MW	14.970	"Prella Energji"	110 kV	41,966
HEC Cemerica 1	0.88	"REJ ENERGY" shpk	110 kV	11,360
HEC Cemerica 2	1.08		110 kV	
HEC Cemerica 3	2.1		110 kV	
HEC TUC	4.47	MC Inerte Lumzi	110 kV	27,287
HEC Lumzi	11		110 kV	
Hec Denas	14.5	"Denas Power" shpk	110 kV	7,459
Llënga 1	1.73	"HEC LLËNGË" sh.p.k	110 kV	1,615
Llënga 2	0.3		110 kV	
Llënga 3	1.5		110 kV	
HEC Shpella Poshte 2	2.3	Liria Energji shpk	110 kV	3,446
HEC Germani 1	4.8	SA'GA-MAT shpk	110 kV	1,351
HEC Germani 2	1.5		110 kV	
				7,809,069

Figure 5 Prodhimi gjatë vitit 2018 nga centralet e lidhura në rrjetin e transmetimit (MWh)

PRODHIMI GJATE VITIT 2018 NGA CENTRALET E LIDHURA NE RRJETIN E SHPERNDARJES (MWH)				
Emërtimi i HEC DHE KAPACITETI	MW	SUBJEKTI	LIDHJA	2018
Hec "Lanabregas" me fuqi 5 MW	5.000	"Hec Lanabregas" sha	35	33,607
Hec "Lenie" me fuqi 400 kW	0.400	"EMIKEL 2003" sh.p.k	10kV	2,791
Hec "Çorovode" me fuqi 200 kW	0.200		10kV	831
Hec "Smokthine" me fuqi 9,2 MW	9.200	"Albania Green Energy" sh.p.k	35 kV	37,072
Hec "Bulqize" me fuqi 0,6 MW (Diber)	0.600	"Balkan Green Energy" shpk	10kV	1,583
Hec "Homesh" me fuqi 0,395 MW (Diber)	0.395		10kV	617
Hec "Zerqan" me fuqi 0,625 MW (Diber)	0.625		6kV	1,563
Hec "Arras" me fuqi 4,8 MW (Diber)	4.800		20kV	16,890
Hec "Orgjost" me fuqi 1,2 MW (Kukes)	1.200		10kV	5,607
Hec "Lekbibaj" me fuqi 1,4 MW (Tropoje)	1.400		10kV	5,463
Hec "Dukagjin" me fuqi 0,64 MW (Shkoder)	0.640		10kV	1,807
Hec "Marjan" me fuqi 0,2 MW (Korce)	0.200		10kV	61
Hec "Lozhan" me fuqi 0,1 MW (Korce)	0.100		10kV	-
Hec "Barmash" me fuqi 0,83 MW (Kolonje)	0.830		10kV	1,680
Hec "Treske 2" me fuqi 0,25 MW (Korce)	0.250		10kV	825
Hec "Nikolice" me fuqi 0,7 MW (Korce)	0.700		10kV	1,813
Hec "Funares" me fuqi 1,92 MW (Librazhd)	1.920		10kV	6,376
Hec "Lunik" me fuqi 0,2 MW (Librazhd)	0.200		10kV	1,013
Hec "Kerpice" me fuqi 0,42 MW (Gramsh)	0.420		6kV	1,020
Hec "Ujanik" me fuqi 0,63 MW (Skrapar)	0.630		10kV	1,361
Hec "Borsh" me fuqi 0,25 MW (Sarande)	0.250		6kV	1,046
Hec "Leshnice" me fuqi 0,38 MW (Sarande)	0.380		10/6kv	692
Hec "Velcan" me fuqi 1,2 MW (Korce)	1.200		10kV	3,343
Hec "Muhur" me fuqi 0,25 MW (Diber)	0.250		6kV	728
Hec "Rajan" me fuqi 1,02 MW (Kolonje)	1.020	10kV	3,020	
Hec "Lure" me fuqi 0,75 MW (Diber)	0.750	10kV	643	
Hec "Gjanç" me fuqi 2,96 MW	2.960	"Spahiu Gjanç" sh.p.k.	35 kV	12,220
Hec "Bogove" me fuqi 2,5 MW	2.500	"Wonder power" sha	35 kV	11,520
Hec "Xhyre" me fuqi 570 kW	0.570	"Amal" sh.p.k	10kV	2,286
Hec "Stranik" me fuqi 4.6 MW	4.600	"Hidroinvest 1" shpk	35kV	13,937
Hec "Zall Tore" me fuqi 3 MW	3.000		35kV	4,088
Hec "Klos" me fuqi 1,95 MW	1.950	"Malido-Energji" shpk	6kV	3,390
Hec "Borje" me fuqi 1.5 MW	1.500	"HIDROALBANIA Energji" shpk	35kV	23,007
Hec "Cernaleve" me fuqi 2.95 MW	2.950	"HIDROALBANIA Energji" shpk	35kV	9,916
Hec "Cernaleve 1" me fuqi 3.27 MW	3.270	"HIDROALBANIA Energji" shpk	35kV	11,375
Hec "Murdhar 1" me fuqi 2.68 MW	2.680	"HydroEnergy" shpk	10kV	11,780
Hec "Murdhar 2" me fuqi 1 MW	1.000		10kV	6,219
Hec "Dishnice" me fuqi 0.2 MW	0.200	"Dishnica Energy" shpk	10kV	689
hec "Lubonje" me fuqi 0.3 Mw	0.300	"Elektro Lubonje" shpk	10kV	425
Hec "Peshke" me fuqi 3.43 MW	3.430	"Koka & Ergi Energy Peshk" shpk	35kV	12,505
Hec "Labinot –Mal" me fuqi 0.25 MW	0.250	"Ansara Koncension" shpk	6kV	310
Hec "Pobreg" me fuqi 12,3 MW	12.300	"Energy Plus" shpk	35kV	41,554
Hec "Vlushe" me fuqi 14.2 MW	14.200	"Hec Vlushe" shpk	35kV	47,506
Hec "Belesova 1" me fuqi 0.150 MW	0.150	"Korkis 2009" shpk	6kV	247

Hec "Faqekuq 1,2" me fuqi (3 MW; 3.4 MW)	6.400	"HP OSTROVICA" shpk	35kV	18,843
Hec"Shemri" me fuqi 1 MW	1.000	"Erald Energjitik" shpk	10	2,448
Hec"Mgulle" me fuqi 0.28 MW	0.280		10kV	1,582
Hec"Kryezi 1" me fuqi 0.6 Mw	0.600	"Bekim Energjitik" shpk	10kV	3,396
Hec"Selishte" me fuqi 2 MW	2.000	"Selishte" shpk	35kV	5,663
Hec"Carshove" me fuqi 1.5 Mw	1.500	"ERMA MP" shpk	10kV	3,757
Hec"Ura e Dashit" me fuqi 1,2MW	1.200		10kV	11,206
Hec"Gizavesh" me fuqi 0.5 MW	0.500	"Dosku Energy" shpk	10kV	2,366
Hec "Koka 1" me fuqi 3,2 MW	3.200	"Snow Energy" shpk	35kV	6,082
Hec "Stravaj" me fuqi 3,6 MW	3.600	"Stravaj Energji" shpk	35kV	12,094
Hec"Picar 1" me fuqi 0,2 MW	0.200	"Peshku Picar 1" shpk	6kV	647
Hec"Vertop" me fuqi 1,52 Mw	1.520	"Hydro Salillari Energy" shpk	35kv	5,491
Hec"Martanesh" me fuqi 10,5 MW	10.500	"Albanian Power" shpk	35kV	17,524
Hec"Verba 1,2" me fuqi (2 MW, 3 MW)	5.000	"Hydro power Plant Of Korca" shpk	35kV	11,897
Hec"Fterra" me fuqi1,08 MW	1.080	"Hidro Borshi" shpk	35kV	11,015
Hec"Ostren i Vogel" me fuqi 0,32 MW	0.320	"Lu & Co Eco Energy" shpk	10kV	1,086
Hec"Kozel" me fuqi 0,5 MW	0.500	"E.T.H.H." shpk	10kV	1,506
Hec"Helmes 1" me fuqi 0,8 MW	0.800		10kV	2,449
Hec"Helmes 2" me fuqi 0,5, MW	0.500		10kV	1,353
Hec"Qafezeze" me fuqi 0,4 MW	0.400	"Caushi Energji" shpk	10kV	2,161
Hec"Trebisht" me fuqi 1,775 MW	1.775	"SA.GLE.Kompani" shpk	10kV	4,456
Hec"Mollaj" me fuqi 0,6 MW	0.600	"Energji Xhaci" shpk	10kV	1,568
Hec"Tucep" me fuqi 0,4 MW	0.400	"Tucep" shpk	10kV	2,883
Hec"Treska4" me fuqi 3,6 MW	3.600	"Hec-Treske" shpk	35kV	8,402
Hec"Treska3" me fuqi 0.3 MW	0.300		35kV	1,085
Hec"Treska 2T" 5 me fuqi 0.62 MW	0.620		35kV	2,749
Hec"Sotire 1 & 2" me fuqi 2,2 MW	2.200	"Hidro Energy Sotire" shpk	35kV	8,495
Hec"Shutine" me fuqi 2,4 MW	2.400	"Shutina energji" shpk	10kV	2,741
Hec"Cekreze 1,2" me fuqi (0,23 MW; 0.43 MW)	0.660	"Zall Herr Energji 2011" shpk	6kV	4,259
Hec"Qarr" me fuqi 1 MW	1.000	"Hec Qarr & Kaltanj" shpk	35kV	5,544
Hec"Bisak" me fuqi 1,3 MW	1.300	"Bardhgjana" shpk	6kv	3,764
Hec"Shales" me fuqi 1,08 MW	1.080	"Gjoka Konstruksion Energji" shpk	35kV	2,512
Hec"Strelce" me fuqi 1,174 MW	1.174		35kV	7,731
Hec "Shpelle" me fuqi 400 kW	0.400	"Sarolli" sh.p.k	10kV	1,318
Hec "Treska 1" me fuqi 130 kW	0.130	Star NRG sh.p.k	10kV	0
Hec "Bicaj" me fuqi 3,1 MW	3.100	"EN-KU" sh.p.k	10kV	-
Hec "Leskovik 1" me fuqi 1072 kW	1.072	"Maksi Elektrik" sh.p.k	10kV	399
Hec "Leskovik 2" me fuqi 1100 kW	1.100		10kV	547
Hec "Orenjë" me fuqi 875 kW	0.875	"Juana" sh.p.k	10kV	1,021
Hec "Tamarë" me fuqi 750 kW	0.750	"WTS Energji" shpk	10kV	711
Hec "Benë" me fuqi 1000 kW	1.000	"Marjakaj" shpk	6kV	1,259
Hec "Vithkuq" me fuqi 2,715 MW	2.715	"Favina 1" shpk	35/10kV	13,232
Hec "Selce" me fuqi 1600 kW	1.600	"Selca Energji" shpk	10kV	5,141
Hec" Kumbull- Merkurth" me fuqi 0.83 Mw	0.830	"DN & NAT Energy" shpk	6kV	2,043
Hec "Sasaj" me fuqi 8,6 MW	8.600	"Energo – Sas" shpk	35kV	27,884
Hec "Tervol" me fuqi 10.6 MW	10.600	"Hec i Tervolit" shpk	35kV	42,181
Hec "Radove" me fuqi 2,5 MW	2.500	"MTC Energy" shpk	10kV	10,336

Hec"Gurshpat 1"me fuqi 0,84 MW,	0.840	"Gurshpat Energy" shpk	10kV	4,393
Hec"Gurshpat 2"me fuqi 0,83 MW	0.830		10kV	5,185
Hec"Bistrica 3"me fuqi 1,57 MW,	1.570	"Bistrica 3 Energy" shpk	6kv	9,358
Hec"Hurdhas 1"me fuqi 1,71MW,	1.710	"Komp Energji" shpk	6kV	7,241
Hec"Perrollaj" me fuqi 0,5 MW	0.500	"Fatlum" shpk	10kV	624
Hec"Koxheraj" me fuqi 0,62 MW	0.620	"Koxherri Energji" shpk	10kv	1,640
Hec"Kacni" me fuqi 3,87 MW	3.870	"Kisi-Bio-Energji" shpk	20kV	7,319
Hec"Lena 1"me fuqi 1,95 MW,;	1.950	"Gama Energy" shpk	35kv	8,014
Hec"Lena 2" me fuqi 2,3 MW	2.300		35kv	
Hec"Lena 2A" me fuqi 0,25 MW	0.250		35kv	
Hec "Driza" me fuqi 3,408 MW	3.408	"Mesopotam Energy" shpk	35kv	3,710
Hec Strelca 1,2,3 (1.504 MW, 0.325 MW, 3.52 MW)	5.349	"Strelca Energy" shpk	35kv	16,035
Hec "Ujanik 2" me fuqi 2,5 MW	2.500	"HP Ujaniku Energy" shpk	35kv	7,525
Hec "Nishove" me fuqi 1,36 MW	1.360	"Nishova Energy" shpk	35kv	2,467
Hec "Shtika" me fuqi 1,3 MW	1.300	"Perparimi SK" shpk	10kv	3,420
Hec "Ballenje" me fuqi 1,9 MW	1.900	"Ballenja Power Martanesh" shpk	35kv	4,026
Hec Gavran 1	0.998	"Gavran Energy" shpk	35kv	3,212
Hec Gavran 2	1.215	"Gavran Energy" shpk	35kV	2,312
Hec Kasollet e Selces 1	4.000	"Xhango Energji" shpk	35kV	10,882
Hec Holta Kabash	2.200	HEC Kabash Porocan shpk	35kV	5,251
Hec Holta Poroçan	3.300		35kV	
Hec Lusen 1	0.315	"Eurobiznes" shpk	35kV	733
Hec Ura e Fanit	1.000	"Ayen As Energji" sha	35kV	5,392
HEC Gorice	1.747	"THE BLUE STAR" sh.p.k	35kV	2,178
HEC Kabash 1&2	5.800	"Univers Energji" shpk	35kV	1,470
HEC "Tucep 2"	1.7	"DUKA T2" shpk	35kV	866
Hec Dobrenje Tomorrice	2.4	DAAB Energy Group shpk	35kV	581
Total	240			743,083

Figure 6 Prodhimi neto i të gjitha centraleve gjatë vitit 2018 (MWh)

Në figurën më poshtë paraqitet prodhimi neto vendas për vitin 2018 duke evidentuar kontributin në prodhim të KESH sh.a., si prodhuesi i vetëm publik si dhe kontributet e prodhuesve të tjerë Privat/me Koncesion. Siç shihet, prodhimi publik vazhdon të ketë peshën kryesore në prodhimin vendas siç raportuar nga OST sh.a.




Figure 7 Prodhimi neto vendas për vitin 2018




Figure 8 Kontribuesit në prodhimin vendas gjatë vitit 2018 (MWh)

Figurat më poshtë krahasojnë prodhimin mujor neto gjatë vitit 2018 me mesataren e prodhimit të periudhës 2007 – 2018.




Figure 9 Prodhimi vendas për vitin 2018 krahasuar me mesataren e periudhës 2007-2018




Figure 10 Prodhimi neto vendas historik për periudhën 2003-2018

Nga analiza e historikut të prodhimit të energjisë elektrike të regjistruar në vend, viti 2018 ka shënuar një rekord përsa i takon totalit të prodhimit duke filluar nga viti 2003 nga burimet vendase. Krahasuar me mesataren shumë-vjecare prej 5,476 GWh duhet thënë se prodhimi për vitin 2018 ka patur një rritje. Prodhimi maksimal mujor për vitin 2018, është shënuar në muajin Mars me vlerën **1,284,372 MWh**. Ky prodhim është realizuar nga hidrocentralet në administrim të KESH sh.a. në masën deri 68.4 %. Prodhimi mujor minimal gjatë vitit 2018 është realizuar në muajin Nëntor me vlerën prej **261,760 MWh**.

Në grafik vihet re se si pasojë e një viti hidrologjik të mbarë dhe rritjes së kapaciteteve prodhuese, prodhimi për vitin 2018 ka arritur në **8,552 GWh** pra një prodhim mbi mesataren shumë-vjecare 2003 - 2018 me rreth **3,076 GWh**.

Prodhimi nga hidrocentralet e kaskadës së lumit Drin ka peshën kryesore në prodhimin vendas dhe më poshtë paraqiten rezultatet historike të prodhimit nga tre hidrocentralet kryesore në administrimin e KESH sh.a.




Figure 11 Historiku i Prodhimit të Energjisë Elektrike nga HEC-et e Kaskadës së Drinit (Burimi: OST sh.a.).

Diferencat ndërmjet prodhimeve maksimale e minimale përkatesisht viteve 2010 dhe 2007, i cili rezulton rreth 2.7 herë, si dhe viteve 2017 dhe 2018 gati dyfish, shpreh në mënyrë të dukshme shkallën e lartë të riskut hidrologjik në stabilitetin e prodhimit të Energjisë Elektrike për furnizimin e panderprerë të klientëve të Sistemit Elektroenergjetike të mbështetur vetëm në burime hidrike.

Më poshtë paraqitet në mënyrë të detajuar prodhimi mujor i energjisë elektrike nga hidrocentralet e kaskadës së lumit Drin në administrim të KESH sh.a.




Figure 12 Prodhimi i Energjisë Elektrike nga HEC-et e Kaskadës së Drinit gjatë vitit 2018 (Burimi: KESH sh.a. , OST sh.a.).

Sipas tabelës së mësipërme prodhimi maksimal është regjistruar në muajin Mars prej 838,386 MWh dhe minimalja në muajin Nëntor 160,664 MWh.

Sipas raportimeve të KESH sh.a., shfrytëzimi i rezervës hidroenergjetike duke marrë parasysh koeficientin e ngarkimit të agregatëve sipas tabelës së mëposhtme bëri të mundur që të shkarkohen sasi të vogla uji nga portat e hidrocentraleve, pa u përdorur më parë për prodhimin e energjisë elektrike.

	HEC FIERZË	HEC KOMAN	HEC VAUDEJËS
Koeficienti mesatar i ngarkimit të agregatëve (%)	90	85	85.5

Figura më poshtë tregon shkarkimet nga hidrocentralet gjatë vitit 2018.

SHKARKIMET E UJIT NGA H/C-et SË KASKADES SE LUMIT DRINI GJATË VITIT 2018 (MILION m ³)												
	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qeshor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nentor	Dhjetor
FIERZE	0	0	434	39	0	0	0	0	0	0	0	0
KOMAN	0	188	913	367	0	0	0	0	0	0	0	0
VAU DEJES	0	345	1,514	311	0	0	0	0	0	0	0	0

Figure 13 Shkarkimet nga HEC-et e KESH sh.a gjatë vitit 2018.

Siç shihet shkarkimet e ujit nga HEC-et e kaskadës janë kryer vetëm gjatë muajve Shkurt, Mars dhe Prill të vitit 2018 kur kanë qënë dhe prurjet më të mëdha për të zbatuar Rregulloren e menaxhimit të rezervës hidrike sipas tabelës së mëposhtme dhe për efekt të prurjeve nga prodhimi i HEC Fierzë dhe prurjeve anësore në HEC Koman gjatë këtyre muajve.

Më poshtë jepet niveli në metra i Liqenit të Fierzës për vitin 2018 në fund të çdo muaji.




Figure 14 Niveli i Liqenit të Fierzës gjatë vitit 2018 (m)

Baseni i HEC-it të Fierzës funksionon si rregullator vjetor i rezervës hidrike të lumit Drin, çka ndikon drejtpërsëdrejti dhe në shfrytëzimin e Kaskadës mbi lumin Drin (HEC-eve të Komanit, të Vaut të Dejës dhe të Ashtës), të cilët furnizohen kryesisht me ujë nga prurjet e rregulluara të Hidrocentralit të Fierzës.

Në figurën 15, janë paraqitur në mënyrë grafike shkarkimet e ujit nga HEC-et e KESH sh.a të Kaskadës së lumit Drin, për secilin vit për periudhën 2002-2018.




Figure 15 Shkarkimet e Ujit nga H/C-et e Kaskadës së Drinit (2002-2018) (Burimi: KESH sh.a).

Të dhënat historike mbi nivelin e liqenit të HEC Fierzë për periudhën 1991 – 2018 paraqiten më poshtë duke evidentuar kuotat minimale (ngjyrë blu) e maksimale (ngjyrë të kuqe).

	NIVELI FIERZES 1991-2018											
	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nentor	Dhjetor
1991	254.4	260.8	268.6	279.9	293.4	296.1	294.0	291.5	289.4	288.3	288.8	285.1
1992	278.0	274.1	268.0	278.8	281.0	279.6	275.2	268.7	263.9	271.4	281.9	280.6
1993	275.2	265.3	264.7	278.5	280.5	277.3	271.0	261.1	253.6	249.9	255.6	270.2
1994	254.4	260.8	268.6	279.9	293.4	296.1	294.0	291.5	289.4	288.3	288.8	285.1
1995	253.8	260.3	262.5	275.3	289.0	288.7	284.5	282.2	288.2	283.8	279.9	287.5
1996	287.1	288.7	286.5	294.7	295.8	293.1	287.6	282.2	285.1	284.3	289.2	291.3
1997	289.4	284.5	281.7	285.2	294.1	292.0	287.0	280.0	272.9	272.4	270.8	277.2
1998	273.7	270.0	265.2	278.9	288.1	287.4	281.8	277.6	276.0	277.1	279.0	277.1
1999	272.7	275.6	281.5	290.5	295.9	293.3	288.3	279.5	271.0	257.6	263.6	276.9
2000	276.4	276.7	276.8	286.9	286.6	280.1	273.5	267.5	261.6	248.4	249.3	252.1
2001	253.6	258.2	275.1	282.9	287.6	283.8	273.7	271.1	269.2	263.6	263.2	252.1
2002	245.3	247.1	252.6	264.0	268.6	271.3	270.1	267.8	274.3	286.1	285.3	284.0
2003	291.1	289.5	286.3	287.0	292.3	290.3	285.9	280.8	276.0	282.6	285.6	283.3
2004	284.7	290.8	293.4	296.0	296.2	296.2	293.1	286.3	281.1	280.0	286.1	288.0
2005	281.2	281.5	293.3	296.1	295.6	294.1	286.7	277.2	266.5	256.9	253.6	279.0
2006	283.5	288.6	294.4	295.9	296.5	295.9	293.8	290.2	285.3	278.7	266.2	256.2
2007	256.1	263.7	272.0	276.8	276.8	274.8	268.5	263.6	261.8	261.1	275.8	282.1
2008	285.1	289.7	290.9	295.5	295.3	295.7	294.3	288.6	283.9	280.9	285.2	286.5
2009	283.6	281.8	283.4	292.5	293.7	292.4	288.0	281.2	276.2	271.6	266.3	280.1
2010	290.1	289.2	293.9	296.0	296.3	294.4	291.8	288.6	284.9	285.2	284.3	287.5
2011	281.6	274.4	275.0	276.6	281.0	286.1	284.7	279.0	273.9	268.2	261.6	264.5
2012	265.8	267.7	262.0	280.2	293.4	294.4	288.4	280.4	261.4	261.6	269.0	276.6
2013	278.3	281.5	294.8	296.9	296.9	294.2	289.7	283.6	280.8	281.4	282.5	276.1
2014	275.1	277.5	274.6	285.3	292.9	294.9	291.7	286.8	285.5	285.0	284.8	286.3
2015	288.7	289.4	292.2	296.3	296.1	293.3	287.5	280.1	272.1	275.4	278.9	275.9
2016	289.9	292.4	291.8	296.5	296.2	295.6	290.5	285.4	283.3	288.4	288.9	281.6
2017	271.5	277.7	280.9	278.7	281.6	272.4	270.2	268.0	271.0	264.6	269.6	289.9
2018	289.7	292.0	295.0	296.5	296.4	296.0	294.0	287.5	277.9	270.2	266.5	267.3

Figure 16 Niveli i Liqenit të HEC Fierzë për periudhën 1991 – 2018.

Më poshtë paraqitet grafikisht niveli i ujit në metra në rezervuarin e Fierzës për çdo muaj të vitit 2018, krahasuar me nivelet mesatare historike mujore për vitet 1991– 2018.




Figure 17 Niveli (m) i Liqenit të Fierzës në raport me mesataren, minimumin dhe maksimumin e periudhës 1991 – 2018.

Siç shihet, deri në muajin korrik 2018, niveli i Fierzës ka qenë më i lartë krahasuar me nivelin mesatar historik, në vijim deri në tetor ka ruajtur mesataren historike dhe në muajt e fundit të vitit ka zbritur nën mesataren historike. Në Figurën në vijim paraqiten prurjet mesatare për vitin 2018 në Liqenin e Fierzës krahasuar me prurjet mesatare historike për çdo muaj.




Figure 18 Prurjet mesatare mujore (m3/sek.) në liqenin e HEC-it Fierzë gjatë vitit 2018 krahasuar me mesataren historike.

Siç shihet gjatë vitit 2018 ka patur prurje mbi mesataren historike gjatë nëntë muajve të parë të vitit (më e larta në mars me rreth 710 m³/sek). Gjatë muajve Tetor-Dhjetor prurjet ishin nën nivelin mesatar historik.

Në grafikun e figurës që vijon është paraqitur shfrytëzimi i rezervës hidroenergjetike në Kaskadën e lumit Drinit gjatë vitit 2018.




Figure 19 Rezerva Energjetike Ditore në Kaskadën e Drinit gjatë vitit 2018 (Burimi: KESH sha).

Kriteret e shfrytëzimit të rezervës hidroenergjetike janë pothuajse analoge edhe në vitet paraardhëse. Ato janë mbështetur në tre parimet themelore të Rregullores së Shfrytëzimit të Digave, të cilat konsistojnë në:

1. Respektimin e kushteve të sigurisë së digave.
2. Shfrytëzimin optimal të rezervës hidroenergjetike.
3. Minimizimin e efekteve të përmytjeve.

1.2.2 Realizimi i Treguesve të Prodhimit dhe Menaxhimi i Rezervës Hidrike.

KESH sh.a, gjatë vitit 2018 ka menaxhuar rezervën hidrike në përmbushje të detyrimit për furnizimin me Energji Elektrike për Furnizuesin e Shërbimit Universal, si dhe ofrimin e shërbimeve ndihmëse dhe energjisë për balancimin e Sistemit.

Sipas informacioneve të KESH sh.a, më poshtë paraqiten zhvillimet në menaxhimin e situatave të krijuara gjatë vitit 2018.

Niveli në Liqenin e Fierzës në Janar 2018 ka qënë 289.7 m, ndërsa rezerva energjetike e kaskadës së lumit Drin ka qënë **1,097** GWh. Ndryshimet klimatike shënuan një periudhë tepër të lagësht në

gjashtëmujorin e parë të pasuar nga një periudhë relativisht të thatë gjatë gjashtëmujorit të dytë. Prurjet gjatë vitit 2018 kulmuan në mars 2018 ku arritën në liqenin e Fierzës në 710 m³/sek dhe në Tetor 2018 zbritën deri në 49 m³/sek. Gjatë periudhës së parë të këtij viti u realizua nivel i lartë shfrytëzimi dhe konsum i ulët i ujit për njësi të gjeneruar krahasuar me mesataren shumëvjeçare kurse pjesa e mbetur e vitit u karakterizua nga përpjekjet për administrim të rezervës hidrike me qëllim përmbushjen e detyrimeve të shërbimit publik ndaj FSHU-së për furnizimin e klientëve fundorë dhe OST-së për balancimin e sistemit Elektroenergjetik.

KONSUMI SPECIFIK I UJIT NE m ³ /kWh NGA HEC-et E KESH sh.a TE KASKADES SE DRINIT GJATE VITIT 2018 (krahasuar me mestaren shumevjeçare)													
HEC		Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qeshor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nentor	Dhjetor
Fierze	(2018 (m ³ /kWh))	3.60	3.54	3.47	3.45	3.45	3.45	3.52	3.70	4.03	4.35	4.46	4.48
	<i>Mest.sh.vjeçare</i>	4.07	4.08	3.98	3.82	3.63	3.61	3.72	3.90	4.07	4.20	4.22	4.11
Koman	(2018 (m ³ /kWh))	4.20	4.24	4.24	4.18	4.18	4.14	4.13	4.13	4.12	4.12	4.19	4.15
	<i>Mest.sh.vjeçare</i>	4.22	4.22	4.22	4.20	4.19	4.18	4.18	4.18	4.19	4.20	4.22	4.22
V.Dejes	(2018 (m ³ /kWh))	8.54	8.50	8.43	8.43	8.33	8.48	8.47	8.50	8.52	8.49	8.50	8.50
	<i>Mest.sh.vjeçare</i>	8.59	8.59	8.49	8.43	8.42	8.44	8.43	8.44	8.46	8.47	8.49	8.55

Figure 20 Konsumi specifik i Ujit.

TE DHENAT PER SHFRYTEZIMIN E KAPACITETEVE GJENERUESE PER VITIN 2018						
HEC	Viti	Prodhimi	Fuqia mes.lejuar	Koef.mes.ngark.Agregatit (%)	Ore Pune gjithsej	Koef.mes.shfrytz.Agregatit (%)
Fierze	2018	0	100	90	20,891	60%
Koman		0	130	85	19,233	55%
Vau Dejes		261	43	85.5	29,272.04	67%

Ngarkesa Mesatare e Agregatëve gjatë vitit 2018 ne HEC-et e KESH ne Kaskadën e Drinit (%)		
	2018	Mesatarja shumevjeçare
HEC Fierzë	90	85
HEC Koman	85	77
HEC Vau Dejes	85.5	85

Figure 21 Treguesit e Centraleve.

Sa më sipër tregon se koeficientët e shfrytëzimit kanë qënë mbi mesataren shumëvjeçare për të tre HEC-et e kaskadës.

1.2.3 Gjendja e TEC-it Vlorë.

Edhe përgjatë vitit 2018 nuk është prodhuar asnjë KWh Energji Elektrike nga TEC Vlora, por janë realizuar shërbimet e mirëmbajtjes profilaktike dhe mirëmbajtjes së programuar të impiantit, sipas një grafiku vjetor.

Ky TEC ishte parashikuar të vihej në punë gjatë vitit 2011, por për shkak të defektit në sistemin e ftohjes ky objekt ende nuk është vënë në punë.

Me urdhërin e Ministrit të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë Nr. 279 dt. 27.03.2018, është urdhëruar ngritja e një komisioni për dhënien me konçesion/PPP të Termocentralit të Vlorës. Ky komision fillimisht është ngarkuar me përgatitjen e një studim Fisibiliteti për vlefshmërinë e kësaj procedurë.

1.2.4 Prodhimi nga HEC-et Private/Koncesion të Energjisë Elektrike

Prodhimi dhe kapacitetet e HEC-eve Private dhe me Koncesion deri në 2018, janë paraqitur në mënyrë të përmbledhur në figurën 22. Shihet qartë një rritje e prodhimit të energjisë elektrike nga këto centrale për vitin 2018.

CENTRALET PRIVATE/KONCESION 2018 TË LIDHURA NE RRJETIN E TRANSMETIMIT (MWh)				
Hec "Ulez" me fuqi 25.2 MW	25.200		110 kV	377,767
Hec "Shkonet" me fuqi 24 MW	24.000	"Kurum International" sh.a.	110 kV	
Hec "Bistrica 1" me fuqi 22.5Mw	22.500		110 kV	
Hec "Bistrica 2" me fuqi 5 Mw	5.000		110 kV	95,957
Hec "Peshqesh" me fuqi 27.94 MW:.	27.940	"Ayen As Energji" sha	220 kV	
Hec "Fangu" me fuqi 74.6 MW:.	74.600		220 kV	238,690
Hec "Banie" me fuqi 73 MW	73.000	"Devoll Hydropower" sha	110 kV	292,561
Hec "Ashta" me fuqi 48.2 MW	48.200	"Energji Ashta" shpk	110 kV	298,107
Hec "Bishnica 2" me fuqi 2.5 MW	2.500	"HEC Bishnica 1.2" shpk	110 kV	10,739
Hec "Dardhe" me fuqi 5.8 MW	5.800	"Wenerg" shpk	110 kV	17,856
Hec "Truen" me fuqi 2.5 MW	2.500	"TRUEN" shpk	110 kV	
Hec "Termove" me fuqi 8.385 Mw	0.921	"TEODORI 2003" shpk	110 kV	9,745
Hec "Gjorice" me fuqi 4.18 Mw (+h/c)	29.610	"DITEKO" shpk	110 kV	115,714
Hec "Sllabinie" me fuqi 13.8 MW	13.800	"Power Elektrik Sllabinie"	110 kV	44,034
Hec "Bele 1" me fuqi 5 MW :	5.000	"Euron Energy" shpk	110 kV	132,347
Hec "Tonoian 2" me fuqi 5.8 MW	5.800			
Hec "Bele 2" me fuqi 11 MW :	11.000	"Alb-Energy" shpk	110 kV	132,347
Hec "Tonoian 1" me fuqi 2.9 MW	2.900	"Energal" shpk		
Hec "Orjost I Ri" me fuqi 4.8 MW	4.800	"Energy partners Al" shpk	110 kV	20,799
Hec "Cerunie-1" me fuqi 2.3 MW:	2.300			
Hec "Cerunie-2" me fuqi 2.8 MW:	2.800			
Hec "Rrune" me fuqi 3.6 MW:	3.600			
Hec "Rapuni 1.2" me fuqi 4 dhe 4.1	8.100	"C & S Construction Energy"	110 kV	33,392
Hec "Rapuni 3.4" me fuqi 8.857	8.850	"C & S Energy" shpk	110 kV	35,808
Hec "Llapaj" me fuqi 13.62 MW	13.620	"Gio Spa POWER" shpk	110 kV	48,023
Hec "Lengarice" me fuqi 8.94 MW	8.940	"Lengarica & Energy" shpk	110 kV	27,075
Hec "Lura 1" me fuqi 6.54 MW	6.540	"Erdat Lura" shpk	110 kV	48,079
Hec "Lura 2" me fuqi 4.02 MW	4.020		110 kV	
Hec "Lura 3" me fuqi 5.66 MW	5.660		110 kV	
Hec "Malla" me fuqi 5.455 MW	5.455	"Giure Rec" shpk	110 kV	16,958
Hec Prella me fuqi 14.97 MW	14.970	"Prelle Energji"	110 kV	41,966
HEC Cemerica 1	0.88	"REJ ENERGY" shpk	110 kV	11,360
HEC Cemerica 2	1.08		110 kV	
HEC Cemerica 3	2.1		110 kV	
HEC TUC	4.47	MC Inerte Lumzi	110 kV	27,287
HEC Lumzi	11		110 kV	
Hec Denas	14.5	"Denas Power" shpk	110 kV	7,459
Llënga 1	1.73	"HEC LLËNGË" sh.p.k	110 kV	1,615
Llënga 2	0.3		110 kV	
Llënga 3	1.5		110 kV	
HEC Shpella Poshte 2	2.3	Liria Energji shpk	110 kV	3,446
HEC Germani 1	4.8	SA'GA-MAT shpk	110 kV	1,351
HEC Germani 2	1.5		110 kV	
	516.086			1,958,137

Figure 22 Prodhimi dhe kapacitetet e HEC-eve Private dhe me Koncesion deri në 2018

H/C PRIV/KONC SIPAS NIVELIT TË LIDHJES				
Tensioni	Nr. Impianteve	Nr. Subjekteve	Kapaciteti MW	Prodhimi 2018 (MWh)
220,110 kV	43	27	516.0	1,958,137
35 kV	49	40	173.8	541,384
20 kV	2	2	8.7	24,209
10 kV	54	29	46.2	140,614
6 kV	13	10	10.5	36,875
TOTAL	161	108	755.2	2,701,220

TE DHENA MBI SUBJEKTET DHE IMPIANTET NGA PRODHUESIT E PAVARUR TE ENERGIJE ELEKTRIKEGJATE VITIT 2018				
HECET DHE KAPACITETI	MW	SUBJEKTI	LIDHJA	2018
Hec "Ulez" me fuqi 25,2 MW	25.200	"Kurum International" sh.a.	110 kV	377,767
Hec "Shkopet" me fuqi 24 MW	24.000		110 kV	
Hec "Bistrice 1" me fuqi 22,5Mw	22.500		110 kV	
Hec "Bistrice 2" me fuqi 5 Mw	5.000		110 kV	
Hec "Peshqesh" me fuqi 27,94 MW,;	27.940	"Ayen As Energji" sha	220 kV	95,957
Hec "Fangu" me fuqi 74.6 MW	74.600		220 kV	238,690
Hec "Banje" me fuqi 73 MW	73.000	"Devoll Hydropower" sha	110 kV	292,561
	227.040			1,004,975

TE DHENA MBI SUBJEKTET DHE IMPIANTET E PRODHUESVE ME PERPARESIT TE ENERGIJE ELEKTRIKE, GJATE VITIT 2018			
NUMRI IMPIANTEVE	KAPACITETI	NUMRI SUBJEKTEVE	PRODHIMI MWh
154 IMPIANTE	504 MW	106 SUBJEKTE	1,696,245

Një central prodhimi Fotovoltaik i UKKO (Ujësullës Kanalizimet Korçë) sh.a. me kapacitet të instaluar rreth 1 MW ka prodhuar për nevojat e saj të furnizimit dhe ka pasur marrëveshje netimi të energjisë me OSHEE sh.a. nëpërmjet së cilës rakordohet sasia e prodhuar dhe sasia e konsumuar për këtë arsye prodhimi i këtij centrali nuk është përfshirë në bilancin Energjetik të OSHEE sh.a.

REZULTATET E MARRËVESHJES UKKORÇË-OSHEE (PËR PRODHIMIN FOTOVOLTAIK) MWh					
UK Korce	2014	2015	2016	2017	2018
Prodhuar (Mwh)	528	1,397	1,362	1,222	1,334

Gjatë vitit 2018 janë licencuar nga ana e ERE pas marrjes së Autorizimit nga ana e MIE 10 subjekte për prodhim Energjie Elektrike nga centrale fotovoltaikë.

SUBJEKTI	PRODHUES ENERGIJE ELEKTRIKE (FOTOVOLTAIK)	FUQIA E INSTALUAR
"AGE Sunpower" sh.p.k	Centrali fotovoltaik Topojë (Sheq Marinas)	2,000 kW
"Seman Sunpower" sh.p.k	Centrali fotovoltaik Topojë (Sheq Marinas)	2,000 kW

“Malësia Solar 1” sh.p.k	Centrali fotovoltaik “Lahë e Poshtëme” Shkrel, Koplík, Qarku Shkodër.	2,500 kW
“Malësia Solar 2” sh.p.k	Centrali fotovoltaik “Lahë e Poshtëme” Shkrel, Koplík, Qarku Shkodër.	2,500 kW
“Malësia Solar 3” sh.p.k	Centrali fotovoltaik “Lahë e Poshtëme” Shkrel, Koplík, Qarku Shkodër.	2,500 kW
“OSOJA Energy” sh.p.k	Centrali fotovoltaik Seman-1 Sheq Marinas Fier.	2,000 kW
“Seman2Sun” sh.p.k	Centrali Fotovoltaik Seman – 2, Sheq Marinas, Fier	2,000 kW
“SONNE” sh.p.k	Centrali Fotovoltaik, Topojë	1,998 kW
“AED Solar” sh.p.k	Centrali fotovoltaik Topojë	1,998 kW
“AEE” sh.p.k	Centrali Fotovoltaik “Plug”	2,000 kW
TOTAL		21.496 MW

Prodhimi i përgjithshëm neto për vitin 2018 nga gjeneruesit privatë/koncesion ishte rreth **2,701,220 MWh** ose rreth **31.6 %** e prodhimit të përgjithshëm vendas prej **8,552,152 MWh** të 2018.

Në Figurën 23, është paraqitur prodhimi vjetor neto i energjisë elektrike i HEC-eve që kanë hyrë në prodhim gjatë vitit 2018. Siç shihet përgjatë vitit 2018 kanë hyrë në prodhim gjithsej 11 centrale me një fuqi të instaluar prej 38.3 MW.

PRODHIMI NE MWh I CENTRALEVE QE KANE HYRE NE PRODHIM GJATE VITIT 2018																
CENTRALET	KAPACITETI (MW)	SUBJEKTI	lidhja	JANAR	SHKURT	MARS	PRILL	MAJ	QERSHOR	KORRIK	GUSHT	SHTATOR	TETOR	NETOR	DHJETOR	2018
Hec Denas	14.5	"Denas Power" shpk	110 kV					522	1,453	791	193	149	167	1,773	2,411	7,459
Llënga 1	1.73	"HEC LLËNGË" sh.p.k	110 kV													
Llënga 2	0.3		110 kV					232	346	278	99	39	27	246	348	1,615
Llënga 3	1.5		110 kV													
HEC Shpella Poshte 2	2.3	Liria Energji shpk	110 kV					842	633	496	189	113	122	464	587	3,446
HEC Germani 1	4.8	SA'GA-MAT shpk	110 kV											6	424	921
HEC Germani 2	1.5		110 kV													1,351
HEC Gorice	1.747	"THE BLUESTAR" sh.p.k	35kV			273	514	516	209	117	-	-	-	-	547	2,178
HEC Kabash 1&2	5.800	"Univers Energji" shpk	35kV			735	315	-	-	-	-	-	-	-	420	1,470
HEC "Tucep 2"	1.7	"DUKA T2" shpk	35kV									371	187	165	142	866
Hec Dobrenje Tomorrice	2.4	DAAB Energy Group shpk	35kV												581	581
	38.3															18,966

Figure 23 Prodhimi nga HEC-et që kanë hyrë në prodhim gjatë vitit 2018.

1.3 Transmetimi i Energjisë Elektrike

1.3.1 Veprimtaria e OST sh.a.

Veprimtaria e Transmetimit të Energjisë Elektrike kryhet nga Operatori i Sistemit të Transmetimit (OST sh.a.), një shoqëri publike me 100% të aksioneve shtetërore. OST sh.a. është krijuar në vitin 2004, si rezultat i reformimit dhe ndarjes së Koorporatës Elektroenergjetike Shqiptare, nga një shoqëri e organizuar vertikalisht që kryente funksionet e Gjenerimit, Transmetimit dhe Shpërndarjes së Energjisë Elektrike, në tre shoqëri të veçanta.

Në zbatim të Ligjit Nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, “Sistemi i Transmetimit” është sistemi i përdorur për transmetimin e Energjisë Elektrike në tension të lartë dhe shumë të lartë, i lidhur në paralel me sistemet e vendeve të tjera, që përfshin midis të tjerave linjat, strukturat mbështetëse, pajisjet transformuese dhe kyçëse/shkyçëse për lëvrimin e Energjisë Elektrike të klientët ose në rrjetin e shpërndarjes, pa përfshirë furnizimin.

OST sh.a. aktualisht kryen funksionet e Operatorit të Rrjetit të Transmetimit, Operatorit të Tregut si dhe Operatorit të Sistemit të Dispeçerimit.

OST sh.a. ka garantuar kapacitetet e nevojshme transmetuese për:

- (i) furnizimin e pandërprerë me energji elektrike të nënstacioneve të sistemit të shpërndarjes, si dhe klientëve të energjisë elektrike të lidhur direkt në rrjetin e transmetimit,
- (ii) transmetimin e energjisë elektrike të prodhuar nga burimet e vendit,
- (iii) si dhe për tranzitimin dhe shkëmbimet e nevojshme me vendet e rajonit.

Në këtë kuadër ai zhvillon Sistemin e Transmetimit në përputhje me kërkesat afatgjata të furnizimit të vendit me Energji Elektrike, me planet e zhvillimit të burimeve të reja të Energjisë Elektrike dhe koordinon zhvillimin e rrjetit të interkoneksionit me vendet fqinje. OST sh.a. dispeçeron sistemin Elektroenergjetik Shqiptar nëpërmjet menaxhimit të flukseve të energjisë në sistem, duke marrë parasysh realizimin e të gjitha shërbimeve ndihmëse që lidhen me qëndrueshmërinë e sistemit si dhe shkëmbimet me sistemet e tjera fqinje.

1.3.2 Asetet dhe Zhvillimi i Sistemit të Transmetimit

Sistemi i Transmetimit të Energjisë Elektrike të Shqipërisë përfshin të gjitha linjat me tension 400 kV, 220 kV, 110 kV dhe nënstacionet lidhëse midis tyre që shërbejnë për transmetimin e energjisë elektrike dhe interkonjeksionit.

Gjatësitë e linjave të sistemit të transmetimit, sipas nivelit të tensionit janë:

- | | |
|--------------------------------|----------|
| • Linjat e transmetimit 400 kV | 445.7 km |
| • Linjat e transmetimit 220 kV | 1,250 km |
| • Linjat e transmetimit 150 kV | 34.4 km |

- Linjat e transmetimit 110 kV 1,658 km

Në përbërje të linjave të mësipërme janë pjesë e sistemit të Transmetimit dhe linjat e interkonjeksionit me vendet fqinje si:

- Linja e interkonjeksionit 400 kV Zemblak (Shqipëri) – Kardia (Greqi)
- Linja e interkonjeksionit 400 kV Tiranë (Shqipëri) – Podgoricë (Mali i Zi)
- Linja e interkonjeksionit 400 kV Tiranë (Shqipëri) – Prishtinë (Kosovë)
- Linja e interkonjeksionit 220 kV Fierzë (Shqipëri) – Prizren (Kosovë)
- Linja e interkonjeksionit 220 kV Koplík (Shqipëri) – Podgoricë (Mali i Zi)
- Linjë e interkonjeksionit 150 kV Bisticë (Shqipëri) – Myrtos (Greqi).

Në lidhje me linjën e interkonjeksionit 400 kV Tiranë (Shqipëri) – Prishtinë (Kosovë), sqarojmë se nuk është në operim për shkaqe që nuk varen nga vullneti i OST

Kapaciteti teknik i shkëmbimit me vendet fqinje është i mjaftueshëm për të realizuar shkëmbimet e nevojshme dhe tranzitimet e kërkuara në çdo kohë megjithatë në periodha të caktuara, ka konxhestion të kapaciteteve transmetuese në interkonjeksion.




Figure 24 Struktura e Sistemit të Transmetimit të Shqipërisë.




Figure 25 Skema e Sistemit të Transmetimit Shqiptar.

Më poshtë janë listuar Nënstacionet kryesore të Sistemit të Transmetimit:

Nr	Tipi i Nënstacionit	
1	400 kV	N/St. 400/220 kV, 840 MVA Tirana 2
2		N/St. 400/220 kV, 600 MVA Elbasan 2
3		N/St. 400/110 kV, 300 MVA Zëmlak 2
4		N/St. 400/220 kV, 345 MVA Koman
5	220 kV	N/St. 220/110 kV, 240 MVA Vau i Dejës
6		N/St. 220/110 kV, 120 MVA Fierzë
7		N/St. 220/110 kV, 90 MVA Koplík
8		N/St. 220/110/20 kV, 486 MVA Tirana 1
9		N/St. 220/110 kV, 190 MVA Sharrë
10		N/St. 220/110 kV, 200 MVA Rrashbull
11		N/St. 220/110 kV, 360 MVA Fier
12		N/St. 220/110 kV, 200 MVA Babiçë
13		N/St. 220/110 kV, 120 MVA Komsí
14		N/St. 220/110 kV, 240 MVA Elbasan 1
15	150 kV	N/St. 154/110 kV, 80 MVA Bistriçë

Figure 26 Asetet kryesore të Sistemit të Transmetimit

1.3.3 Bilanci i Energjisë Elektrike të Transmetuar nga OST sh.a.

Në tabelën e mëposhtme paraqitet bilanci energjetik i OST sh.a. për vitin 2018 krahasuar me atë të vitit 2015,2016,2017 (GWh).


Nr.	Bilanci Energjetik i OST sh.a (GWh)	2015	2016	2017	2018
I	ENERGJI TOTALE NE SISTEMIN E TRANSMETIMIT	7,830	8,462	7,577	9,848
1.	- Prodhimi vendas	5,475	6,636	4,174	8,076
2.	- Energji në marrje	2,355	1,827	3,403	1,772
II	ENERGJIA TOTALE E TRANSMETUAR	7,672	8,272	7,419	9,606
1.	- Energji në dhënie	956	1,869	488	2,685
2.	- Energji e transmetuar për OSHEE sh.a.	6,106	5,901	6,148	5,963
3.	- Energji transmetuar për klientë të lidhur në rrjetin e transmetimit	610	503	781	957
III	HUMBJE NE SISTEMIN E TRANSMETIMIT+Nevojat Vetjake	159	190	158	242
	HUMBJE NE SISTEMIN E TRANSMETIMIT+Nevojat Vetjake (%)	2.03	2.25	2.08	2.46

Figure 27 Bilanci Energjetik i OST sh.a për vitin 2018 krahasuar me atë të viteve 2015, 2016 dhe 2017 (GWh).

Rezultati i nivelit të humbjeve në Sistemin e Transmetimit për vitin 2018 është i kushtëzuar nga rritja e prodhimit të HEC-eve të lidhura në Transmetim si dhe Rritja e energjisë së transmetuar në sistem.

TË DHËNA MBI TRANSMETIMIN E ENERGJISË ELEKTRIKE NGA OPERATORI I SISTEMIT TE TRANSMETIMIT NË SHQIPËRI PËR VITIN 2018 (MWh)														
	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nentor	Dhjetor	2018	
HYRJE	Dhene nga H/C e KESH ne rrjetin e Transmetimit	556,225	692,169	838,226	765,659	678,756	349,883	423,564	468,107	411,856	215,215	160,493	288,871	5,849,025
	Dhene nga H/C e me perparesi ne rrjetin e Transmetimit	70,335	78,443	117,562	115,355	93,962	46,081	30,428	16,470	7,827	7,827	25,611	44,218	655,055
	Energji nga Hec-et Lokale levruar ne Rrjetin e Transmetimit	25,423	34,175	55,625	60,135	46,963	16,620	6,698	1,793	701	643	8,514	12,239	269,530
	Gjenerim KURUM (prodhues i pavarur)	50,188	47,135	52,475	49,627	43,145	30,963	19,341	16,883	14,835	14,833	13,681	24,661	377,767
	HEC ASHTA (prodhues i pavarur Kontr.me OSHEE)	32,413	34,875	34,738	38,297	34,868	19,215	19,742	21,905	20,029	11,506	11,122	19,398	298,107
	HEC BANJE (prodhues i pavarur)	27,182	46,070	50,908	43,421	31,977	15,881	19,037	15,817	10,250	5,905	10,274	15,839	292,561
	HEC PESHQESH-T1/637 (prodhues i pavarur)	16,849	16,562	19,457	14,071	7,722	3,350	2,502	1,266		478	3,806	9,894	95,957
	HEC FANGU (prodhues i pavarur)	45,467	44,569	49,638	31,635	15,047	8,260	10,626	11,526	2,777	1,732	4,586	12,828	238,690
	Importi(Hyre) nga Linjat e Interkonjeksionit	97,366	10,377	6,913	6,436	11,847	120,234	141,176	177,609	151,130	316,999	379,644	352,011	1,771,740
	9,848,433													
DALJE	Humbjet ne Transmetim	20,933	28,547	37,116	35,763	26,518	12,925	16,437	16,469	12,027	10,490	11,757	13,723	242,705
	Transmetuar ne Rrjetin e Shperndarjes	604,642	535,861	532,011	412,435	418,122	428,419	474,985	515,310	448,930	459,821	494,379	638,443	5,963,357
	Klientene treg te hapur (TL)	51,047	60,676	75,901	82,709	87,403	88,692	86,592	89,002	77,830	84,087	84,658	88,726	957,323
	Eksporti (Dale) nga Linjat e Interkonjeksionit	244,825	379,292	580,513	593,729	432,244	80,451	95,101	110,593	81,555	20,740	26,937	39,067	2,685,045
9,848,433														
Energjia Hyrese ne Transmetim	921,447	1,004,375	1,225,541	1,124,636	964,287	610,486	673,115	731,374	620,342	575,138	617,731	779,959	9,848,433	
Humbjet ne Transmetim	20,933	28,547	37,116	35,763	26,518	12,925	16,437	16,469	12,027	10,490	11,757	13,723	242,705	
Totali I Energjise se Transmetuar+Dalje Interkoneksion	900,514	975,829	1,188,425	1,088,874	937,769	597,561	656,677	714,905	608,315	564,648	605,974	766,235	9,605,727	
Eksporti (Dale) nga Linjat e Interkonjeksionit	244,825	379,292	580,513	593,729	432,244	80,451	95,101	110,593	81,555	20,740	26,937	39,067	2,685,045	
Energjia e Transmetuar Brenda rrjetit te OST	655,689	596,537	607,912	495,144	505,525	517,111	561,576	604,313	526,760	543,908	579,037	727,169	6,920,682	
Humbjet ne Transmetim	20,933	28,547	37,116	35,763	26,518	12,925	16,437	16,469	12,027	10,490	11,757	13,723	242,705	
Humbjet ne Transmetim ne %	2.27	2.84	3.03	3.18	2.75	2.12	2.44	2.25	1.94	1.82	1.90	1.76	2.46	

Burimi OST sha



Parashikimi i Investimeve për vitin 2018 dhe realizimi i tyre deri në tetor 2018

	INVESTIME 2018	Fondi i Prokurimit	Fondi i Pageses 2018	Vlera e kontrates	Vlera e realizuar deri ne vitin 2017	TOTAL Vlera e realizuar 10-mujor 2018	Vlera e mbetur
4	Linja e re 220 kV Burrel – Peshkopi plus 1(nje) trakt 220 kV Lot 1	1,206,410,976	241,282,195	1,206,410,976		241,282,195	965,128,781
5	Furnizim vendosje e Shunt reaktorit 400kV 120 MVAR, Sistemit Total te monitorimit te tij, Konfigurimin ne sistemin SCADA, furnizimin dhe vendosjen e Traktit 400 kV ne Nst Zemblak si dhe kryerja e te gjitha punimeve civile ne lidhje me kete projekt.	543,142,511	296,204,701	543,142,511		262,518,427	280,624,084
6	Rikonstruksioni i linjave 110 kV Laç2-Ura e Matit dhe Skuraj Ura e Matit	204,607,000	40,921,400			-	-
7	Rehabilitimi i trakteve te linjave 110 kV te nenstacionit Jagodine	187,048,800	70,000,000	187,048,800		37,409,760	149,639,040
8	Ndertimi i linjes 110 kV Nst Sallmore – Gjiri i Lakziti	182,877,080	36,575,416	182,877,081		36,575,416	146,301,665
9	Rehabilitimi i trakteve te linjave 110 kV te nenstacionit F.Arrez	156,942,899	31,388,580	156,942,899		31,388,580	125,554,319
10	Rehabilitimi i trakteve te linjave 110 kV te nenstacionit Ibe	97,243,480	19,448,696	97,243,480		19,442,058	77,801,422
11	Rehabilitimi i trakteve te linjave 110 kV te nenstacionit Plasmas	95,161,092	19,032,218	95,161,092		19,032,218	76,128,874
12	Rehabilitimi i trakteve te linjave 110 kV te nenstacionit Kajan	105,633,163	21,126,633	105,633,163		21,126,633	84,506,530
13	Rehabilitimi i trakteve te linjave 110 kV te nenstacionit Prepnas	106,934,131	21,386,826			-	-
14	Punimet primare dhe sekondare ne nenstacionin 220 kV Elbasan, demontimi i nje celsi egzistues, furnizimi dhe vendosja e nje celsi te ri 245 kV me gas SF6, integrimi i plote i tij me sistemin, si dhe furnizimi i pjeseve reserve per cylesat aktual dhe pajise elektrike suport.	128,400,000	36,821,802	128,400,000		102,000,000	26,400,000
	Furnizim i mbrojtjes distancionale REL670, se bashku me panelet e tyre ose rele tjetër ekuivalent me te qe realizon te njejat kerkesa, 8 (tete) cope. Percaktimi i defektit dhe riparimi i dy analizatorve te vajit te autotransformatorve						
15	Rikonstruksioni i anes 110 kV te nenstacionit Rubik	125,308,324	80,000,000	125,308,324		25,061,665	100,246,659
16	Rehabilitimi i trakteve te linjave 110 kV te nenstacionit Librazhd	99,946,077	45,000,000	99,946,077		19,989,214	79,956,863
17	Punimet primare dhe sekondare ne nenstacionin 220 kV Koman, demontimi i dy celsave egzistues, furnizimi dhe vendosja e dy celsave te rinj 245 kV me gas SF6, integrimi i plote i tyre me sistemin, si dhe furnizimi i pjeseve reserve per cylesat aktual dhe pajise elektrike suport.	56,872,000	56,872,000			-	-
18	Aksesi dhe monitorimi i rrjetit te transmetimit te sistemeve te komunikimit me kapacitete	64,119,000	64,119,000	64,119,000		44,235,000	19,884,000
19	Instalimi i OPGW ne linjen 220 kV Burrel – Elbasan 1	60,491,245	50,000,000	60,491,245		12,098,249	48,392,996
20	Blerje e nje rregullatori te ndryshimit të degëzimeve në ngarkesë (on load tap changer) ana e TL per autotransformator fuqje 220 kV tip MR si dhe 2(dy) Display LCD per mbrojtjen NR tip RCS dhe percaktimi i defektit dhe riparimi i 2(dy) analizatorve te vajit te Autotransformatorve te difektuar	50,000,000	50,000,000	50,000,000		50,000,000	-
21	Rinovimi i mbrojtjeve te zharave 20 kV Tiranal	46,151,000	46,151,000	46,151,000		46,151,000	-
22	Implementimi i Sistemit te Analizimit te Rrjetit ne permetjet PMU (Phasor Measuring Unit)	39,514,000	26,512,333			-	-
23	Blerje dhe instalimi i analizatorëve të vajit dhe përcaktimit të gjendjes së izolacionit për Autotransformatorët 60MVA 220/110/11 kV ne Koms-Burrel	39,480,000	39,480,000	39,000,000		39,000,000	-
24	Ndertimi i Magazineve pranë Nstacionit Tirana2	36,000,000	7,200,000	36,503,650		7,300,730	29,202,920
25	Ri-vendosje ne gjendje te plote pune sistemi i kontrollit te nenstacionit 400 kV Elbasan 2.	34,689,200	34,689,200	34,689,200		34,689,200	-
26	Furnizim vendosje e traktit te linjes 110-13 ne Nstacionin Laç1 dhe punime civile	31,704,481	20,000,000	31,704,481		6,340,896	25,363,585
27	Photesimi dhe venia ne pune e Traktit 110 kV ne nstacion Fier per Nstacionin 110/20 kV te OSHEE + trainimi i personelit Inxhiniero –teknik te DSHMT	50,000,000	16,000,000	40,952,000		8,190,400	32,761,600
28	Sistemi i problematikave te drenazhimit ne Nenstacionin Tirana2	14,668,679	9,500,000	14,669,678		2,933,935	11,735,743
29	Blerje te pajiseve elektrike specifike per Njesine Operative Shkoder	14,447,000	14,447,000	14,447,000		14,447,000	-
30	Nderhyrje ne linjat e transmetimit 110/220 kV te rajonit te Njesise Operative Shkoder	19,205,000	19,205,000	19,205,818		3,841,164	15,364,654
31	Blerje te pajiseve elektrike specifike per Njesine Operative Burrel	12,660,000	12,660,000			-	-
32	Blerje programi kompjuterik aplikim online për lidhjet e reja	6,620,000	6,620,000			-	-
33	Mbikqyrja e punimeve per objektet e reja.	34,637,331	7,000,000			-	-
34	Vleresimi i ndikimit ne mjedis per projektet e reja	1,000,000	1,000,000			-	-
35	Ngritja e nje sistemi per lokalizimin e avarive ne linjat e trasmetimit. Blerje, instalim, konfigurim i serverit per analizatoret e vajit te AT -ve dhe celsave te nivelit 110kV e lart.	159,883,412	120,000,000	158,000,000		31,600,000	126,400,000
36	Nderhyrje ne linjat e transmetimit 110 kV te rajonit te Njesise Operative Fier.	30,000,000	12,000,000			-	-
37	Instalim i infrastrukturave per sigurimin e perimetrit, monitorimin dhe lajmerimin ne disa zyra dhe nenstacione te OST sh.a.	52,000,000	52,000,000			-	-
38	Furnizim i nje celsi te ri 245 kV me gas SF6 si dhe pjese reserve te tij dhe per cylesat aktual, 3(tre) analizatore per celsat e niveleve te ndryshme tensioni si dhe 2(dy) pajise mbrojtjeje, automatizimi dhe monitorimi.	49,086,000	49,086,000	49,086,000		13,350,000	35,736,000
39	Perditesim dhe përmirësim i infrastrukturës TI dhe SCADA	38,720,000	38,720,000	38,720,000		10,105,000	28,615,000
40	Pajise testuese diagnostikuese per pajiset transformuese qe OST sh.a disponon	14,000,000	14,000,000			-	-
41	Testimet elektrike ne TN te nje AT -300 MVA,400/ kV.	9,450,000	9,450,000			-	-
42	Përmirësim i infrastrukturës së sigurisë kibernetike.	80,000,000	16,000,000			-	-
43	Lyerja e shtyllave të transmetimit të TL	70,000,000	21,000,000			-	-
44	RELE	20,000,000	20,000,000			-	-
	TOTAL	4,375,053,881	1,792,900,000	3,625,853,475	-	1,140,108,741	2,485,744,735

Figure 28 Situata e Investimeve

INVESTIMET E OST SH.A. PËR VITIN 2018 SIPAS PLANIT DHJETËVJECAR TË ZHVILLIMIT TË RRJETIT

Informacioni i saktë mbi realizimin e investimeve të parashikuara si dhe kontabilizimit të tyre është i lidhur me depozitimin e kopjes së audituar të pasqyrave financiare të vitit 2018 të OST sh.a afati për të cilat është qershori 2019. Sipas informacionit të OST, për vitin 2018 janë planifikuar 41 zëra investimi me fond të parashikuar prej 4,375,053 881 lekë.

Duke qënë se disa nga investimet shtrihen në zbatim për më shumë se një vit, fondi i parashikuar për investime vetëm për vitin 2018 është parashikuar 1,792,900 000 lekë, pjesa tjetër e fondit do të shpërndahet në vitet në vijim.

Për 26 zëra investimet ose janë realizuar ose janë në proces realizimi. Aktualisht ERE është duke vazhduar monitorimin për masën e realizuar të investimeve për vitin 2018. Nga përpunimi i të dhënave paraprake rezulton se deri në tetor 2018 investimi i realizuar është 1,140,108,741 lekë ose 77.27 % e vlerës së parashikuar për vitin 2018 për këto zëra.

Shqyrtimi i Planit të Investimeve kryhet në përputhje me kërkesat e “Rregullore e procedurave të paraqitjes dhe miratimit të planit të investimeve nga operatorët e transmetimit dhe shpërndarjes së Energjisë Elektrike”, miratuar me Vendimin e Bordit të ERE-s Nr. 135 dt. 06.09.2017 dhe ERE vazhdon monitorimin periodik të këtij plani.

Operatori i Sistemit të Transmetimit paraqet pranë ERE-s, së bashku me aplikimin për miratimin e tarifës, planin e përditësuar të investimeve për vitin pasardhës.

OST për vitin 2018 ka aplikuar për tarifë por pa e shoqëruar këtë aplikimin me kërkesën për miratimin e planit të investimeve dhe ERE ka konsideruar shifrën e miratuar të Planit 10 vjeçar të Zhvillimit të Rrjetit 2015 - 2025.

1.4 Gjendja e Përgjithshme e Sistemit Eelektroenergjetik referuar Nenit 25 të Ligjit Nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”.

a) Siguria operative e rrjetit.

Një nga detyrat kryesore të OST-së është sigurimi i aftësisë afatgjatë të Sistemit për të plotësuar kërkesën e arsyeshme për transmetimin e Energjisë Elektrike, duke operuar, ruajtur dhe zhvilluar në mënyrë të sigurtë, të besueshme dhe efikase Sistemin e Transmetimit, duke kontribuar njëkohësisht në sigurinë e furnizimit nëpërmjet sigurisë së Sistemit dhe kapaciteteve të qëndrueshme të transmetimit.

Duhet theksuar se me vënien në punë të linjës 400 kV Elbasan 2 – Tirana 2 – Podgorica 2, dhe N/St. 400/220/110 kV Tirana 2 në vitin 2011, siguria e operimit të rrjetit transmetues është rritur së tepërmi. Për më tepër me finalizimin e projektit të zgjerimit të N/St. Koman në 400 kV, dhe çarjen e linjës Tirana 2-Kosova B, e cila është gati për t’u vënë në operim pjesa Koman-Kosova B, rrjeti 400 kV, rritet edhe më tej siguria e operimit të sistemit. Me investimet e bëra në rrjetin e transmetimit dhe sidomos me mirë funksionimin e sistemit të kontroll monitorimit SCADA/EMS, OST sh.a. siguron shërbime me cilësi të lartë për të gjithë përdoruesit e Sistemit të Transmetimit, bazuar në standardet dhe praktikatat më të mira, të cilat aplikohen nga operatorët e sistemeve të transmetimit të ENTSO-E, duke kontribuar në shkëmbim të sigurtë dhe cilësor të energjisë elektrike në vend dhe rajon.

Sigurinë operative të rrjetit, OST sh.a. e garanton nëpërmjet zbatimit të kodit të operimit, pjesë e Kodit të Rrjetit të Transmetimit, i cili përcakton kërkesat minimale të qarta dhe objektive për sigurinë e punës në kohë reale, dhe arritjen e qëllimit kryesor për të mbajtur në operim të vazhdueshëm Sistemin Transmetues Shqiptar të ndërlidhur me Sistemin Europian të Transmetimit

(zona sinkrone e Europës Kontinentale) në mënyrë që të kontribuojë për një kuadër të harmonizuar për zbatimin e Ligjit 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike” dhe për të siguruar mos-diskriminim, konkurrencën efektive dhe funksionimin efikas të tregut. Rregullat për Sigurinë e Operimit paraqesin principet e sigurisë operative në aspektin e nevojave teknike, duke konsideruar operimin e tregut në pajtueshmëri dhe në mbështetje me sigurinë e furnizimit. Këto parime të sigurisë operative janë thelbësore për OST-në për të menaxhuar përgjegjësitë e saj për funksionimin e Sistemit të interkoneksionit, me një nivel të lartë të koordinimit, besueshmërisë, cilësisë dhe stabilitetit. Një objektivi kyç i OST-së është arritja e një kuadri teknik të harmonizuar dhe të qëndrueshëm, duke përfshirë zbatimin e të gjitha proceseve të nevojshme të kërkuara për sigurinë e operimit, duke marrë parasysh sfidat aktuale dhe të pritura, përfshirë rritjen e shpejtë të burimeve të ripërtëritshme të energjisë dhe ndikimin e tyre në operimin e Sistemit.

Garantimi i Sigurisë Operacionale, besueshmërisë dhe cilësisë nënkupton sigurimin e një niveli të përbashkët të sigurisë brenda Sistemit Interkonektiv Europian, që kërkon bashkëpunimin e ngushtë të OST-ve, DSO-ve, dhe Përdoruesve të rëndësishëm të Rrjetit. Në mënyrë që të përcaktohen kërkesa të qarta dhe objektive, nga ana e OST-së janë konsideruar kategoritë e mëposhtme:

- Gjëndjet e Sistemit

Monitorimi i vazhdueshëm i situatës së Sistemit, bazuar në sistemin SCADA, me vlerat e matura në kohë reale të parametrave operacionale, me informacione permanente online të gjëndjes së ndërsjelltë të Sistemit midis OST-ve fqinje, bën të mundur vlerësimin efektiv të situatës së Sistemit, dhe gjithashtu mundëson përgatitjen e veprimeve përmirësuese, në mënyrë që të mbahet Sistemi në një gjendje normale apo të kthehet në normalitet sa më shpejt të jetë e mundur në raste të avarive. Monitorimi i gjëndjes së Sistemit kontribuon për një sjellje koherente dhe të koordinuar të Sistemeve të ndërlidhura të Transmetimit, si në zonën e përgjegjësisë të OST-së ashtu edhe ndërmjet zonave të përgjegjësisë.

Qendra e kontrollit të Sistemit në OST sh.a. është e pajisur me një sistem hardware dhe software që siguron grumbullimin dhe përpunimin e të dhënave nga disa objekte (nënstacionet dhe centralet). Disponueshmëria e tyre mbështetet në redundancën e komponenteve të hardware-it dhe software-it, si dhe bazat e tyre të të dhënave. Pra, qendra e kontrollit në QDS është e pajisur me një sistem kontrolli kompjuterik (SCADA/EMS) që kryen këto funksione kryesore:

- Grumbullimin, përpunimin, shfaqjen (në ekran) dhe arkivimin e të dhënave të marra në distancë;
- Analizën sistematike të sigurisë operative në kohë reale dhe në mënyrë të studimit (study mode);
- Kontrollin fuqi-frekuencë;
- Kontrollin e tensionit.

Gjithashtu janë të përfshira sisteme të tjera kompjuterike, të tilla si:

- Mjetet e specializuara (softe) për analiza të Sigurisë Operative;
- Video-Wall për të siguruar shfaqjen e nyjeve të Rrjetit të Transmetimit sipas lidhjes së tyre, nivelin e tensionit dhe mbingarkesës, rrjedhën e fluksit në linja dhe transformatorë.

Këto mjete e lejojnë Operatorin e Sistemit të monitorojë situatën e Sistemit dhe gjëndjen e elementeve të sistemit të transmetimit, të shfaqë statusin e një nënstacioni apo të një zone (topologjinë, flukset dhe tensionet), dhe për të kontrolluar në distancë pajisjet. Duhet patur parasysh se me hyrjen në fuqi të VKM-së nr. 222 dt. 26/04/2018 “Për miratimin e listës së Infrstrukturave kritike të informacionit dhe të listës së infrastrukturave të rëndësishme të informacionit”, ndër të cilat është edhe Sistemi i Transmetimit, përballë OST sh.a. dalin detyra të reja për sigurinë kibernetike.

▪ Rrjeti i Sigurisë së Telekomunikacionit

Rrjeti i telekomunikacionit është një rrjet i sigurtë i telekomunikacion-transmetimit që është i dedikuar për përdorim ekskluziv të funksionimit të rrjetit të energjisë. Infrastruktura e tij bazohet në fibrën optike të instaluar pothuajse në të gjitha linjat e sistemit të transmetimit. Rrjeti i telekomunikacionit i mundëson personelit operativ veprimin në nivele të ndryshme të kontrollit, përfshirë komunikimin me OST-të fqinje, për të shkëmbyer komandat dhe informacionet. Ai siguron bartjen e sinjaleve të destinuara për funksionimin e sistemeve të mbrojtjes në rrjetat dhe objektet elektrike ose për kryerjen e veprimeve në distancë nga pajisjet automatike të kontrollit lokal. Funksionimi normal i rrjetit të telekomunikacionit është jetike për funksionimin e Sistemit dhe sigurinë operationale dhe nënkupton redundancën e kanaleve të transmetimit në rrjetin e telekomunikacionit, dhe dublikimin e pajisjeve lidhëse (routerave).

▪ Sistemi i Telekontrollit

Pajisjet e kontrollit dhe të sigurisë së rrjetit përbëjnë të ashtuquajturin sistem telekontrolli. Ky sistem shërben për:

- Garantimin e vrojtimit të Sistemit të Transmetimit, duke i siguruar Operatorit regjistrimin e të dhënave, në çdo kohë, për flukset e energjisë, topologjinë e rrjetit dhe vlerën e madhësive elektrike (frekuenca dhe tensioni) karakteristike e operimit të Sistemit. Ky observim përfshin gjithashtu të dhënat nga OST-të fqinje, informacion që shërben për të menaxhuar kompleksitetin e shkëmbimeve në mënyrën më të mirë të mundëshme, duke siguruar njëkohësisht besueshmërinë e operimit të Sistemit interkonektiv;
- Garantimin e kontrollit të Sistemit të Transmetimit duke i ofruar Operatorit dhe pajisjeve automatike të kontrollit mundësinë e operimit nëpërmjet telekontrollit të çelsave, dhe nëpërmjet kontrollit automatik të centralizuar të frekuencës;
- Furnizimin me informacion të besueshëm për funksionet komplekse të analizës së sigurisë operative, të cilat i mundësojnë Operatorit:
 - o të parashikojë pasojat e ngjarjeve të tilla si stakim të objekteve gjeneruese apo të elementëve të sistemit të transmetimit,
 - o përgatitjen e veprimeve përmirësuese.

Sistemi i telekontrollit është me rëndësi jetike për besueshmërinë dhe sigurinë e Sistemit, dhe për këtë arsye merren të gjitha masat për të siguruar vazhdimësinë e të gjitha karakteristikave relevante të tij:

- Rrjeti i telekomunikacionit është i dedikuar për operimin e sigurt të Sistemit, dhe për këtë arsye OST sh.a. ka një qendër rezervë të kontrollit të lidhur në rrjetin e telekomunikacionit të sigurisë dhe e pajisur me pajisje të kontrollit;

- Të gjitha të dhënat që merren në distancë, thirren apo përftohen dhe përpunohen në mënyrë të dyfishtë me anë të kanaleve të ndryshme;
- Së fundi, furnizimi i pandërprerë me energji elektrike i paisjeve të telekontrollit dhe pajisjeve të telekomunikacionit në QDS sigurohet nga burime mikse dhe të pavarura të jashtme dhe burime të brendshme.

- Menaxhimi i Kontrollit të Frekuencës

Qëllimi i menaxhimit të kontrollit të frekuencës është mbajtja e një ekuilibri të vazhdueshëm ndërmjet prodhimit dhe konsumit, duke siguruar cilësi të frekuencës dhe stabilitet të Zonës Sinkrone. Për këtë qëllim, OST siguron (aktualisht nëpërmjet një kontratë bilaterale me KESH) rezerva adekuate (në rritje dhe ulje) të fuqisë aktive. Në Kodin e Transmetimit janë vendosur kriteret për dimensionimin dhe krijimin e këtyre rezervave.

- Kontrolli i Tensionit dhe Menaxhimi i Fuqisë Reaktive

Kushtet e tensionit në Sistemin e Transmetimit janë të lidhura direkt me situatën e energjisë reaktive në nyjet e sistemit. Për të kompensuar për një konsum të tepërt të energjisë reaktive, OST sh.a sigurohet që prodhuesit më efikas dhe efektiv (aktualisht centralët e KESH-it) të gjenerojnë/absorbojnë mjaftueshëm energji reaktive, përveç fuqisë reaktive nga burime të tjera të instaluar në Sistemin e Transmetimit. OST sh.a siguron gjithashtu një ekuilibër të vazhdueshëm dhe lokalisht të mjaftueshëm të fuqisë reaktive, që të jetë në gjëndje për të ruajtur nivelet e duhura të tensionit. Në këtë kontekst, qëllimi i kontrollit të tensionit dhe të menaxhimit të energjisë reaktive është për të siguruar që:

- Nivelet e tensionit, flukset e energjisë reaktive dhe burimet e energjisë reaktive monitorohen, kontrollohen dhe mbahen në kohë reale brenda kufijve të Sigurisë Operative, me qëllim mbrojtjen e pajisjeve të Sistemit të Transmetimit dhe sigurimin e stabilitetit të tensionit,
- Rezerva adekuate e menjëherëshme e fuqisë reaktive është në dispozicion në gjeneratorët në punë, në reaktorët dhe kapacitorët, në mënyrë që të sigurojë funksionimin teknik të të gjithë sistemit energjetik, dhe të jetë në gjëndje për të rivendosur gjëndje normale pas avarive.

Për këtë qëllim, në Kodin e Rrjetit për sigurinë operative të ENTSO-E është vendosur të bëhet monitorim permanent online dhe shkëmbimi i informacionit që realizohet nga OST-të në zonat përkatëse të observimit.

- Menaxhimi i rrymës së lidhjes së shkurtër

Menaxhimi i rrymës së qarkut të shkurtër është i nevojshëm për të parandaluar nga dëmtimi të gjitha llojet e objekteve të gjenerimit, elementet e Sistemit të Transmetimit dhe pajisjeve të lidhura me të, dhe për të ruajtur sigurinë e personave; nëpërmjet shkyçjes së shpejtë dhe selektive të pjesës në qark të shkurtër. Pra objektivi i menaxhimit të rrymës së qarkut të shkurtër është mbajtja e ndikimit të rrymave të lidhjes së shkurtër në një nivel që siguron funksionimin e sigurt të sistemit të transmetimit, me anë të sistemit përkatës të mbrojtjes. Kjo nënkupton:

- Llogaritjen e saktë të rrymave të lidhjes së shkurtër nga ana e specialistëve të planifikimit të OST-së duke ndjekur parimet e standardizuara dhe sigurimin e të dhënave nga OST-të fqinje, OSHEE dhe Përdoruesit e rëndësishëm të Rrjetit;
- Monitorimin e rrymave të lidhjes së shkurtër dhe marrjen e masave përmirësuese, parandaluese dhe kuruese në qoftë se kufijtë e sigurisë operative janë, ose kanë tendencë për t'u shkelur;
- Sigurimin e informacionit dhe të komunikimit me OST-të fqinje, OSHEE dhe Përdoruesit e rëndësishëm të Rrjetit, të afektuar, në mënyrë që të jenë në gjëndje të marrin në konsideratë efektin e sistemeve të tjera të transmetimit dhe shpërndarjes.

- Menaxhimi i fluksit të energjisë

Çdo element i Sistemit të Transmetimit ka kufijtë e sigurisë operative në drejtim të rrjedhës së energjisë. Këto kufizime janë të rëndësishme për mbrojtjen e pajisjeve dhe njerëzit në afërsi të një elementi të caktuar të Sistemit të Transmetimit, duke marrë parasysh kufizimet teknike të materialeve të përdorura, me qëllim shmangien e dëmtimit apo vjetërimit e parakohëshëm të pajisjes. Pra, menaxhimi i fluksit të energjisë ka të bëjë me krijimin apo përcaktimin e mjeteve operacionale për të mbajtur rrjedhën e energjisë brenda kufijve të sigurisë operative në çdo element të sistemit të transmetimit. Për të qënë në gjëndje për të monitoruar dhe kontrolluar parametrat operacionale është e nevojshme që të ketë informacion të saktë mbi gjëndjen e Sistemit dhe gjithashtu të vlerësimit të gjëndjes së Sistemit. Për këtë, OST sh.a. kontrollon parametrat operacionale brenda zonës së vet të përgjegjësisë dhe, në mënyrë të koordinuar, merr në konsideratë parametrat operative nga zona e observimit që përfshin pjesë të OST-ve fqinje. Kjo nënkupton të dhëna strukturore dhe në kohë reale të shkëmbimit të informacionit ndërmjet OST-ve në zonat e ndërthurura të observimit, dhe ndërmjet OST dhe OSSH në zonën e përgjegjësisë të OST-së. Për të qënë në gjëndje për të përballuar avaritë në Sistem, nga ana e OST-së përgatiten veprimet përmirësuese individuale dhe të koordinuara, dhe zbatohen kur është e nevojshme, për të parandaluar shkeljen e limiteve të Sigurisë Operative dhe për të suportuar kthimin në normalitet në rastet e situatave alerte ose në emergjencë.

- Analiza e kontigjencave dhe trajtimi

Me qëllim mbajtjen e sigurisë së operimit të Sistemit, bëhet analiza e kontigjencës (e ndodhjes së ngjarjeve të pa-parashikuara) që do të thotë kryerja e simulimit të stakimit të elementëve të Sistemit të Transmetimit. Kjo analizë kryhet duke përdorur modelin individual të OST-së dhe modelin e bashkuar të rrjetit, duke respektuar kufijtë e sigurisë operative dhe ndërkohë bëhet përgatitja për kryerjen e veprimeve përmirësuese para dhe pas incidentit, kur kërkohet nga rezultati i analizës. Parimet kryesore që ndiqen në lidhje me analizën e kontigjencave, të cilat gjithashtu përshkruajnë qëllimet e përgjithshme dhe objektivat e analizës së kontigjencës në kohë reale dhe në fazën e planifikimit operativ janë:

- Sigurimi i parandalimit dhe/ose kurimit për sa i përket veprimeve përmirësuese, të kërkuara për të ruajtur sigurinë e operimit, për të gjitha kontingjencat e besueshme që ndikojnë në Sistemin e Transmetimit.
- Koordinimi i analizave dhe veprimeve përmirësuese, kurdo që është e nevojshme, për të siguruar rezultatin e dëshiruar - ruajtjen e sigurisë operative në Sistem dhe në Interkoneksion.

- Mbështetja në të dhënat e duhura dhe informacionin në kohë reale dhe atë të bazuar në parashikimin e ngarkesave. Përdorimi i modelit të bashkuar të rrjetit rajonal, dhe shkëmbimi i të gjitha të dhënave të nevojshme dhe informacionit ndërmjet OST-së, OSSh-së dhe përdoruesve të rëndësishëm të rrjetit.
- Suportimi i përpunimit të dispozitave të standardeve pan-Europiane për analizat e kontingjencave për të ruajtur sigurinë e operimit duke maksimizuar përdorimin e Sistemit.

Në aspektin e analizave të kontingjencave, OST sh.a. në Qershor të vitit 2018, ka filluar të përftojë analiza sigurie nga Qendra e Koordinimit të Sigurisë, SCC Ltd. Belgrade (Regional Security Coordinator for SEE) nëpërmjet një kontrate si përdorues i shërbimeve të SCC Ltd. Belgrade. Kjo kontratë zgjat një vit dhe përfshin 5 shërbimet ndër më kryesoret si më poshtë:

- Validim dhe përmirësimi i modelit të rrjetit individual/të përbashkët (IGM/CGM),
- Kalkulimi i koordinuar i kapacitetit (ndërkufitar),
- Koordinimi i analizës së sigurisë (përfshirë masat përmirësuese, parandaluese),
- Mjaftueshmëria, besueshmëria e punës në terma afat shkurtër/mesëm,
- Koordinimin e planifikimit të remonteve.

- Mbrojtja

Pajisja e mbrojtjes është përdorur për të mbrojtur asetet e Sistemit të Transmetimit nga dëmtimet. Skemat e sistemit të mbrojtjes janë përdorur për të zbuluar kushtet anormale të sistemit dhe ndërmarrin veprime korigjuese të paracaktuara, për të ruajtur integritetin e sistemit, me një performancë të pranueshme të sistemit, në mënyrë të koordinuar. Funkcionet për mbrojtjen e Sistemit analizohen duke u mbështetur në llogaritjet e rrjetit, duke konsideruar funksionimin korrekt dhe jo korrekt. Nëse parashikohen pasojat të papranueshme, funksionaliteti dhe redundanca e Skemës së Mbrojtjes së Sistemit përshtaten në përputhje me rrethanat për të përmbushur kërkesat e sigurisë operationale. Funksionaliteti dhe statusi i gjëndjes së sistemit monitorohen, komunikohen dhe koordinohen ndërmjet OST-ve fqinje dhe palëve të tjera të prekura nga sistemi i mbrojtjes.

- Menaxhimi i Stabilitetit Dinamik

Qëllimi i Vlerësimit të Stabilitetit Dinamik (VSD) është për të siguruar ndërgjegjësimin e operatorit të OST-së në lidhje me gjëndjen aktuale dhe parashikimin në të ardhmen të situatës së Sistemit në lidhje me stabilitetin, në situatën (N) dhe në atë të mundëshme (N-1). Përveç kësaj, VSD mbështet vendimet ndaj veprimeve më efektive dhe efikase përmirësuese, për parandalimin e incidenteve ose korigjimin e pasojave të tyre, nëse ato ndodhin.

Përdorimi i gjërë i VSD lejon aplikime të ndryshme, jo vetëm në kohë reale, por edhe në fazat e planifikimit operacional. Një theks është vënë në trajnimin e stafit operativ të OST sh.a. duke bërë përdorimin e VSD, si dhe për mirëmbajtjen e vazhdueshme të modeleve dhe të simulatorit përkatës.

- Trajnimi Operativ dhe Certifikimi

Në përputhje me Udhëzimet e Praktikës së Mirë për Sigurinë Operationale, trajnimi është i nevojshëm në mënyrë që të garantojë se Operatorët e Sistemit dhe personeli tjetër operativ janë të

aftë, të mirëtrajnuar, dhe se punonjësit që operojnë Sistemin në kohë reale janë të certifikuar për të vepruar në mënyrë të sigurtë gjatë të gjitha situatave operacionale.

Në këtë kontekst, OST sh.a. ka filluar zbatimin e një trajnimi dhe procesi të gjërë certifikimi, i cili do të mundësojë njohjen dhe reagimin ndaj kushteve operative jonormale në afatet kohore përkatëse dhe, kur është e përshtatëshme, në mënyrë të koordinuar me OST-të e tjera. Për më tepër, zbatimi i standardeve operative mund të sigurohet nga zhvillimi i programeve që përfshijnë trajnimin fillestar, zhvillimin e vazhdueshëm të personelit dhe ri-vlerësimin e rregullt të certifikimit.

Kodi i Operimit vendos detyrimin për OST-në që të ketë të aktivizuar programet e vazhdueshme zhvillimore për stafin e saj në dhomën e kontrollit dhe të bashkërendojë e bashkëpunojë në trajnimet ndër-sistimore për çështje të transmetimit rajonal. Stafin e trajnuar OST-së do të jëtë në gjëndje të veprjë në mënyrë efikase në balancimin e Sistemit dhe në maksimizimin e mundësisë për transfertat ndërkufitare të cilat të dyja ofrojnë përfitime reale ekonomike për konsumatorët, mjaft më sinjifikative se sa rritja e kostos së investuar më shumë në trajnimin e stafit të OST-së në QDS.

Për më tepër, duke investuar në trajnimin e stafit operativ të OST-së, do të zvogëlohet probabiliteti i avarive të medha me përhapje të gjërë të shoqëruara me ndërprerjen e furnizimit, të cilat nëse ndodhin mund të zgjasin për shumë orë apo edhe ditë, dhe për të cilat ka një kosto shumë të madhe ekonomiko sociale.

b) Balancën e parashikuar të kërkesës dhe furnizimit me energji elektrike në tregun e brendshëm për një periudhë pesëvjeçare, dhe

c) Niveli i pritshëm i kërkesës dhe perspektivën e sigurisë së furnizimit për një periudhë pesë deri në pesëmbëdhjetë vjeçare nga data e raportit.

Në bazë të të dhënave historike të OST-së, dhe duke konsideruar rritjen potenciale të gjenerimit të PPE + PVE dhe reduktimin e humbjeve jo teknike në rrjetin e shpërndarjes, është pranuar që rritja e pritëshme e volumit të energjisë elektrike që do të transmetohet nga OST sh.a., të jetë e rendit 1-1.5%, dhe mbi këtë bazë, duke përdorur profilin e ngarkesës me bazë orare për ditën e mesatarizuar të çdo muaji, është bërë parashikimi i parametrave kryesore energjetike dhe sigurimi i balancës së Sistemit për pesë vjeçarin, siç jepet në tabelën e mëposhtme:

PLANIFIKIMI I PARAMETRAVE KRYESORE ENERGITIKE PER VITIN 2019														
VITI 2019	Njesia	JANAR	SHKURT	MARS	PRILL	MAJ	QERSHOR	KORRIK	GUSHT	SHTATOR	TETOR	NENTOR	DHJETOR	TOTAL
Konsumi për OSHEE	GWh	630	549	490	432	427	430	482	513	450	486	300	580	3969
Konsumi për klientët në treg të hapur	GWh	73	86	101	113	117	119	117	110	115	118	116	125	1310
Humbje+Nevoja Vetiake	GWh	16	15	15	14	15	15	15	16	13	14	15	16	179
Kerkesa totale	GWh	719	650	606	559	559	564	614	639	578	618	631	721	7458
PLANIFIKIMI I PARAMETRAVE KRYESORE ENERGITIKE PER VITIN 2019														
VITI 2019	Njesia	JANAR	SHKURT	MARS	PRILL	MAJ	QERSHOR	KORRIK	GUSHT	SHTATOR	TETOR	NENTOR	DHJETOR	TOTAL
Prodhimi	GWh	500	683	674	585	649	350	355	350	310	240	320	355	5371
KESH	GWh	370	540	510	465	530	310	340	335	290	130	200	260	4280
Prodhues të tjerë	GWh	130	143	164	120	119	40	15	15	20	110	120	95	1091
PLANIFIKIMI I PARAMETRAVE KRYESORE ENERGITIKE PER VITIN 2019														
VITI 2019	Njesia	JANAR	SHKURT	MARS	PRILL	MAJ	QERSHOR	KORRIK	GUSHT	SHTATOR	TETOR	NENTOR	DHJETOR	TOTAL
Importi	GWh	178	123	112	52	54	177	211	221	247	257	244	265	2141
OSHEE	GWh	123	73	57	0	0	117	151	151	182	192	169	190	1405
Tregtarët	GWh	55	50	55	52	54	60	60	70	65	65	75	75	736
PLANIFIKIMI I PARAMETRAVE KRYESORE ENERGITIKE PER VITIN 2020														
VITI 2020	Njesia	JANAR	SHKURT	MARS	PRILL	MAJ	QERSHOR	KORRIK	GUSHT	SHTATOR	TETOR	NENTOR	DHJETOR	TOTAL
Konsumi për OSHEE	GWh	485	465	475	455	435	445	465	475	395	405	430	500	5430
Konsumi për klientët në treg të hapur	GWh	283	123	106	84	91	112	140	151	162	194	196	305	1947
Humbje+Nevoja Vetiake	GWh	16	15	14	14	12	12	15	15	13	13	14	16	169
Kerkesa totale	GWh	784	603	595	553	538	569	620	641	570	612	640	821	7546
PLANIFIKIMI I PARAMETRAVE KRYESORE ENERGITIKE PER VITIN 2020														
VITI 2020	Njesia	JANAR	SHKURT	MARS	PRILL	MAJ	QERSHOR	KORRIK	GUSHT	SHTATOR	TETOR	NENTOR	DHJETOR	TOTAL
Prodhimi	GWh	532	690	695	642	705	451	450	447	406	245	339	425	6027
KESH	GWh	402	575	550	502	565	341	375	372	326	160	234	295	4697
Prodhues të tjerë	GWh	130	115	145	140	140	110	75	75	80	85	105	130	1350
PLANIFIKIMI I PARAMETRAVE KRYESORE ENERGITIKE PER VITIN 2020														
VITI 2020	Njesia	JANAR	SHKURT	MARS	PRILL	MAJ	QERSHOR	KORRIK	GUSHT	SHTATOR	TETOR	NENTOR	DHJETOR	TOTAL
Importi	GWh	198	132	79	87	68	123	188	200	133	140	158	233	1739
OSHEE	GWh	128	67	9	22	3	53	108	120	58	65	78	148	859
Tregtarët	GWh	70	65	70	65	65	70	80	80	75	75	80	85	880
PLANIFIKIMI I PARAMETRAVE KRYESORE ENERGITIKE PER VITIN 2021														
VITI 2021	Njesia	JANAR	SHKURT	MARS	PRILL	MAJ	QERSHOR	KORRIK	GUSHT	SHTATOR	TETOR	NENTOR	DHJETOR	TOTAL
Konsumi për OSHEE	GWh	465	445	455	435	415	425	445	455	375	385	405	475	5180
Konsumi për klientët në treg të hapur	GWh	326	142	122	97	104	128	161	174	186	223	225	351	2239
Humbje+Nevoja Vetiake	GWh	19	18	17	16	15	13	14	14	14	15	15	17	187
Kerkesa totale	GWh	810	605	594	548	534	566	620	643	575	623	645	843	7606
PLANIFIKIMI I PARAMETRAVE KRYESORE ENERGITIKE PER VITIN 2021														
VITI 2021	Njesia	JANAR	SHKURT	MARS	PRILL	MAJ	QERSHOR	KORRIK	GUSHT	SHTATOR	TETOR	NENTOR	DHJETOR	TOTAL
Prodhimi	GWh	654	579	599	570	546	544	549	564	474	495	539	670	6783
KESH	GWh	460	440	450	430	410	420	440	450	370	380	400	470	5120
Prodhues të tjerë	GWh	194	139	149	140	136	124	109	114	104	115	139	200	1663
PLANIFIKIMI I PARAMETRAVE KRYESORE ENERGITIKE PER VITIN 2021														
VITI 2021	Njesia	JANAR	SHKURT	MARS	PRILL	MAJ	QERSHOR	KORRIK	GUSHT	SHTATOR	TETOR	NENTOR	DHJETOR	TOTAL
Importi	GWh	209	162	126	130	117	157	206	214	166	171	184	239	2081
OSHEE	GWh	89	47	6	15	2	37	76	84	41	46	54	104	601
Tregtarët	GWh	120	115	120	115	115	120	130	130	125	125	130	135	1480
PLANIFIKIMI I PARAMETRAVE KRYESORE ENERGITIKE PER VITIN 2022														
VITI 2022	Njesia	JANAR	SHKURT	MARS	PRILL	MAJ	QERSHOR	KORRIK	GUSHT	SHTATOR	TETOR	NENTOR	DHJETOR	TOTAL
Konsumi për OSHEE	GWh	445	425	435	415	395	405	425	435	355	365	385	455	4940
Konsumi për klientët në treg të hapur	GWh	354	167	150	124	131	153	184	198	208	246	250	382	2547
Humbje+Nevoja Vetiake	GWh	18	18	18	17	16	15	14	15	15	16	17	19	198
Kerkesa totale	GWh	817	610	603	556	542	573	623	648	578	627	652	856	7685
PLANIFIKIMI I PARAMETRAVE KRYESORE ENERGITIKE PER VITIN 2022														
VITI 2022	Njesia	JANAR	SHKURT	MARS	PRILL	MAJ	QERSHOR	KORRIK	GUSHT	SHTATOR	TETOR	NENTOR	DHJETOR	TOTAL
Prodhimi	GWh	747	613	634	604	579	576	580	595	504	527	573	710	7242
KESH	GWh	480	460	470	450	430	440	460	470	390	400	420	490	5360
Prodhues të tjerë	GWh	267	153	164	154	149	136	120	125	114	127	153	220	1882
PLANIFIKIMI I PARAMETRAVE KRYESORE ENERGITIKE PER VITIN 2022														
VITI 2022	Njesia	JANAR	SHKURT	MARS	PRILL	MAJ	QERSHOR	KORRIK	GUSHT	SHTATOR	TETOR	NENTOR	DHJETOR	TOTAL
Importi	GWh	207	160	126	130	117	157	206	214	166	171	184	239	2077
OSHEE	GWh	89	45	6	15	2	37	76	84	41	46	54	104	599
Tregtarët	GWh	118	115	120	115	115	120	130	130	125	125	130	135	1478
PLANIFIKIMI I PARAMETRAVE KRYESORE ENERGITIKE PER VITIN 2023														
VITI 2023	Njesia	JANAR	SHKURT	MARS	PRILL	MAJ	QERSHOR	KORRIK	GUSHT	SHTATOR	TETOR	NENTOR	DHJETOR	TOTAL
Konsumi për OSHEE	GWh	449	429	439	419	399	409	429	439	359	369	389	460	4989
Konsumi për klientët në treg të hapur	GWh	358	169	152	125	132	155	186	200	210	248	253	386	2574
Humbje+Nevoja Vetiake	GWh	18	18	18	17	16	15	14	15	15	16	17	19	198
Kerkesa totale	GWh	825	616	609	561	547	579	629	654	584	633	659	865	7761
PLANIFIKIMI I PARAMETRAVE KRYESORE ENERGITIKE PER VITIN 2023														
VITI 2023	Njesia	JANAR	SHKURT	MARS	PRILL	MAJ	QERSHOR	KORRIK	GUSHT	SHTATOR	TETOR	NENTOR	DHJETOR	TOTAL
Prodhimi	GWh	754	619	640	610	585	582	586	601	509	532	578	717	7313
KESH	GWh	485	465	475	455	434	444	465	475	394	404	424	495	5413
Prodhues të tjerë	GWh	269	154	165	155	151	138	121	126	115	128	154	222	1898
PLANIFIKIMI I PARAMETRAVE KRYESORE ENERGITIKE PER VITIN 2023														
VITI 2023	Njesia	JANAR	SHKURT	MARS	PRILL	MAJ	QERSHOR	KORRIK	GUSHT	SHTATOR	TETOR	NENTOR	DHJETOR	TOTAL
Importi	GWh	209	162	128	132	118	159	208	216	168	172	186	241	2099
OSHEE	GWh	90	45	6	16	2	38	77	85	41	46	55	105	606
Tregtarët	GWh	119	117	122	116	116	121	131	131	127	126	131	136	1493

c) Niveli i pritshëm i kërkesës dhe perspektivën e sigurisë së furnizimit për një periudhë pesë deri në pesëmbëdhjetë vjeçare nga data e raportit

Në bazë të të dhënave historike të zhvillimit të ngarkesës, duke përdorur profilin e ngarkesës me bazë orare për ditën e mesatarizuar të çdo muaji, është bërë parashikimi i kërkesës për energji elektrike, siç jepet në tabelat e mëposhtme, për një periudhë 15-vjeçare:

2019 - 2035

Viti	Kerkesa (GWh)
2019	7,450
2020	7,628
2021	7,812
2022	7,991
2023	8,175
2024	8,355
2025	8,539
2026	8,718
2027	8,901
2028	9,079
2029	9,261
2030	9,446
2031	9,625
2032	9,808
2033	9,995
2034	10,184
2035	10,378

ç) Kapacitetin shtesë prodhues të propozuar, të planifikuar apo në fazë ndërtimi.

Për këtë çështje kemi informacion vetëm për ato centrale të cilat janë parashikuar të lidhen në rrjetin e transmetimit (janë në fazë ndërtimi apo kanë marrë miratimin paraprak ose opinion paraprak, për lidhjen me rrjetin e transmetimit), si më poshtë:

- Me Marrëveshje Lidhje:

Nr.	Emërtimi Njesisë (ve) gjeneruese	Fuqia e instaluar (MW)
1	Kaskada e Lumit Devoll, HEC Moglica	171.000
2	Parqet Fotovoltaik Malsia Solar (1-2-3_	7.500
3	HEC-t Kalivare (1,2,3,4)	5.463
4	HEC-et Seta (1,2,3,4)	14.900
5	HEC-et Sllabinja 2a,2c,2e	11.000
6	HEC-et Seka & Zais	14.96
97	HEC Lashkiza	5.200
8	HEC-et Stavec & Stavec 1	14.770
9	HEC-et Gjadër (1,2,3,4,5,6)	24.938
10	HEC-er Darsi (1,2,3)	20.520
11	HEC Bushtrica 1	5.230
12	HEC Bushtrica 2	4.800

- **Me Miratim Paraprak ose Opinion Paraprak:**

Nr.	Emertimi Njësise (ve) gjeneruese	Fuqia e instaluar (MW)
1	HEC Kalivaç	111.000
2	HEC Gomsiqe 1	13.300
3	HEC Gomsiqe 2	8.250
4	Kaskada Curraj	105.223
5	HEC Dragobia	5.000
6	HEC Ceremi	11.900
97	HEC Zalli Bulqizës	6.470
8	HEC-et e Fletit (1-2-A-B)	9.100
9	HEC-et Shkopet 2-3	23.000
10	HEC-et Kiri 1&2	25.187
11	HEC-et Mati	38.000
12	HEC-et Zajë, Turaj, Xhaferaj, etj.	5.940
13	HEC-et Gur i Zi, Shelli, Daznjanë	4.760
14	HEC-et Gostima (1,2,3,4)	16.100
15	HEC Egnatia	6.000
16	Kaskada Shmil	16.720
17	HEC-et Qarishtë	37.300
18	HEC Fushbull	21.520
19	HEC-et Rreshpë, Çota, etj.	7.772
20	HEC-et Kardhiq	13.820
21	Kaskada Langaricë	7.630
22	HEC-et Vernik (1,2,3,4)	11.683
23	HEC –Dragostunjë	10.000
24	HEC-et Iballë, Sapac, Berishë, etj.	20.524
25	Kaskada Yllon (1,2,3,4)	8.000
26	HEC-et Veleshica 1 & 2	13.900
27	Impianti Fotovoltaik V.Dejës	12.900
28	Impianti Fotovoltaik Topojë	50.000
29	Gas Power Plant Korçë	500.00

d) Parashikimin e investimeve, për jo më pak se pesë vitet e ardhshme, që planifikohen të realizohen nga OST sh.a apo çdo palë tjetër, lidhur me rritjen e kapacitetit ndërkufitar të interkoneksionit:

- **Parimet e menaxhimit të kufizimit të kapaciteteve në linjat ekzistuese dhe ato të planifikuara të sistemit të transmetimit.**

Me investimet e bëra gjatë viteve të fundit në sistemin e transmetimit është bërë e mundur plotësimi i kriterit të sigurisë N-1 në rrjetin e brendshëm të Sistemit për të gjitha regjimet e punës, dhe nuk kemi probleme të kufizimit të kapaciteteve transmetuese. Lidhur me menaxhimin e kapaciteteve ndërkufitare, në zbatim të rregullave të ENTSO-E, zbatohet procedura e mëposhtme.

Përcaktimi i kapacitetit transmetues ndërkufitar, NTC, aktualisht bëhet sipas Marrëveshjeve bilaterale ndërmjet OST-ve fqinje, dhe bazohet në Manualin Operacional të ENTSO-E,

respektivisht në Politikën Nr. 4, dhe Aneksin e saj. Është e rëndësishme të theksohet dallimi i qartë ndërmjet vlerave komerciale dhe atyre fizike, pasi siç dihet, ekzistojnë dy sete definimesh, një i lidhur me vlerat e programit (skedulimit) dhe tjetri me fluksin fizik të energjisë elektrike, që në shumicën e rasteve nuk përputhen kur merret në konsideratë një interkonektor i veçuar nga pjesa tjetër e rrjetit. Komplexiteti i anës fizike të fluksit të energjisë trajtohet nga OST-të, që janë përgjegjëse përkundrejt Autoriteteve përkatëse për kryerjen e kësaj detyre në mënyrë transparente dhe jo diskriminuese.

Periudhat kohore të përcaktimit të kapacitetit transmetues ndërkufitar

Proçesi i përcaktimit të NTC prodhon rezultate për periudhat kohore: vjetore, mujore, një ditë përpara (D-1) dhe brenda ditës.

Të dhënat për modelin individual të rrjetit

Sipas dispozitave të Kodit të Transmetimit, Përdoruesit e rëndësishëm të Rrjetit i mundësojnë OST-së informacionin e nevojshëm për përcaktimin e kapacitetit transmetues. Ky informacion përfshin por nuk kufizohet në:

- Informacionin lidhur me të dhënat teknike;
- Informacionin lidhur me disponueshmërinë e pajisjeve dhe elementëve të rrjetit;
- Informacionin lidhur me skedulimin e njësive gjeneruese.

Për çdo periudhë kohore të përcaktimit të kapacitetit, çdo njësi gjeneruese apo ngarkesë i mundëson OST-së të gjitha të dhënat e specifikuar, dhe ndërkohë Operatori i Sistemit (specialistët e planifikimit të regjimit të punës) përgatisin me kujdesin e nevojshëm modelin e rrjetit të zonës tonë të kontrollit, të cilit i kontrollon konvergjenca para se t'i dërgohet OST-së koordinatorë të rajonit, në mënyrë që të mundësojë llogaritjen e flukseve të fuqisë aktive, reaktive dhe tensionit, në analizat e qëndrueshmërisë statike që duhet të performohen.

Inputi kryesor për llogaritjen e NTC-së është dokumenti për përgatitjen e modelit rajonal të rrjetit "SEE regional common grid model for different time horizons" i përgatitur nga Grupi Rajonal i Europës Jug-Lindore nën Komitetin e Tregut të ENTSO-E. Ky dokument ofron dy elementë themelore për proçesin e llogaritjes së NTC:

- Tabela e harmonizuar e rastit bazë të shkëmbimit (BCE);
- Modeli i Bashkuar i Rrjetit Rajonal për periudha kohore të ndryshme.

OST-të e SEE përgatisin supozimet për Rastin Bazë të Shkëmbimit (BCE), të cilat janë parashikimet e skeduleve tregtare në modelin mujor dhe i nisin ato OST-së koordinatorë. Këto tabela përgatiten në bazë të historikut të fundit dhe eksperiencës së OST-ve. OST-ja koordinatorë pasi mbledh të gjitha tabelat e BCE-ve të OST-ve të rajonit SEE bënë harmonizimin e saj. Totalët e shkëmbimeve të deklaruara në këto tabela vendosen më pas në modelet individuale të çdo OST-je.

Për çdo periudhë kohore të përcaktimit të kapacitetit, një Model i Bashkuar i Rrjetit Rajonal krijohet në nivel rajoni duke bashkuar inputet (modelet individuale) nga të gjithë Operatorët e Sistemit, nëpërmjet funksionit të OST-së koordinatorë. Funksioni i OST-së koordinatorë performohet nga një OST e SEE në nivel mujor. Në kuadrin e grupit të punës RG SEE, Operatorët e Transmetimit kanë rënë dakord që aktiviteti i koordinimit rajonal të bëhet me rotacion me bazë mujore.

Rolin e koordinatorit për skenarët referenca vjetore, dimër dhe verë, për zonën sinkrone të Evropës Kontinentale (RG CE), e kryejnë qendrat e koordinimit të sigurisë (RSC) CORESO, TSCNET, ose SCC Ltd Belgrade, nëpërmjet të dhënave që sigurohen në nën grupin e punës të ENTSO-E Network

Modelling and Forecasting Tools (NMFT). Aktualisht OST sh.a. i merr këto shërbime nëpërmjet SCC Ltd. Beograd.

Skenarët e Modelit të Bashkuar të Rrjetit

Të gjitha OST-të e Sistemit Elektroenergjetik emëtojnë një skenar bazë për çdo periudhë kohore të përcaktimit të kapacitetit, i cili krijohet në Modelin e Bashkuar të Rrjetit.

Në rast të nevojës së përcaktimit të skenarëve shtesë për periudha kohore, OST-ët fqinje duhet të bien dakort rreth periudhave karakteristike shtesë, duke konsideruar programin e mirëmbajtjes (remonteve) dhe angazhimin e gjeneratorëve, të cilët mund të ndikojnë përcaktimin e vlerës së NTC-së.

Metodologjia e Kalkulimit të NTC-së

1. Metodologjia përmban paragrafët e mëposhtëm:
 - a. Përcaktimin e hapave të ndryshimit të gjenerimit “Generation Shift Keys”,
 - b. Përcaktimin e kufizimeve të sigurisë operative,
 - c. Përcaktimin e marzheve të sigurisë.
2. Çdo Operator Sistemi i rajonit do të përdorë metodologjinë e përshkruar në Manualin Operacional të ENSTO-E “P4-Polica 4: Koordinimi i Planifikimit Operacional”, Apendiksi 4.

3. Vlera e NTC-së, Kapaciteti Neto i Transmetimit përcaktohet si:

$$NTC = TTC - TRM$$

$$TTC = BCE + E$$

Ku:

BCE: Shkëmbimi në Rastin Bazë (shkëmbimi i skeduluar)

E: Maksimumi i ndryshimit (rritjes/uljes) së gjenerimit që i caktohet zonës së kontrollit të përfshirë në interkoneksion duke parandaluar çdo violencë të principit të sigurisë N-1.

4. Kapaciteti total i transmetimit (TTC) përfaqëson vlerën maksimale të programit të shkëmbimit ndërmjet dy zonave (OST-ve), duke plotësuar standartet e sigurisë së punës të detyrueshme për çdo Sistem, nëse për periudhën për të cilën bëhet vlerësimi i TTC, kushtet e rrjetit dhe modeli gjenerim – konsum, njihen mirë në avancë.
5. Marzhi i Sigurisë së Transmetimit (TRM) është një marzh sigurie që përfshin pasiguritë në vlerat e llogaritjes së TTC.
6. Kapaciteti tashmë i Alokuar (AAC) është totali i të drejtave të transmetimit të alokuara me parë p.sh. në ankandin vjetor ose në ndonjë formë tjetër, varësisht nga metoda e alokimit.
7. Kapaciteti disponibël (ATC) është pjesa e NTC që mbetet e disponueshme, pas çdo fazë alokimi, për aktivitete komerciale të mëtejshme. ATC jepet nga ekuacioni i mëposhtëm:
 $ATC = NTC - AAC;$ ku: AAC është kapaciteti tashmë i alokuar.

Metoda e Ndryshimit të Gjenerimit me Hap (me shkallë)

Gjeneratorët të cilët marrin pjesë në përcaktimin e NTC-së duhet të karakterizohen nga limitet e tyre maksimale dhe minimale. Metoda e ndryshimit të gjenerimit është në përputhje me mënyrën se si ndryshimi global i shkëmbimit ndahet midis njësive të ndryshme gjeneruese.

Gjeneratorët e zgjedhur (për rastin tonë të gjitha njësitë gjeneruese të kaskadës së Drinit) përdorën për përcaktimin e NTC-së në mënyrën e mëposhtme: në zonën e një OST-je (gjeneratorët $i=1, n$) fuqia aktive e gjeneratorëve rritet, dhe në zonën e OST-së tjetër (gjeneratorët $j=1, m$) fuqia aktive e gjeneratorëve zvogëlohet me të njëjtën vlerë njëkohësisht. Të gjithë injektimet e zgjedhura modifikohen proporcionalisht me kapacitetin gjenerues të mbetur të disponueshëm.

Ndryshimi realizohet si më poshtë:

$$P_{new}^{inc} = P_i + \Delta E \cdot \frac{P_i^{max} - P_i}{\sum_n (P_i^{max} - P_i)} \quad P_{new}^{dec} = P_i + \Delta E \cdot \frac{P_i^{min} - P_i}{\sum_n (P_i^{min} - P_i)}$$

ku:

- P_i Gjenerimi aktual i fuqisë aktive (MW),
 P_{new}^{inc} Injektimi i ri i rritur, në iteracionin e radhës do të jetë P_i
 P_{new}^{dec} Injektimi i ri i ulur, në iteracionin e radhës do të jetë P_i
 ΔE Ndryshimi i gjenerimit, negativë për rritjen dhe pozitiv për uljen,
 P_i^{max} Maksimumi i gjenerimit të lejuar (MW),
 P_i^{min} Minimumi i gjenerimit të lejuar (MW),
 Kushte shtesë: $|E| \propto (P_{max} - P_i)$, dhe $|E| \propto (P_{min} - P_i)$

Avantazhi i kësaj metode është se mbi-përdorimi i gjenerimit është i pamundur dhe kapacitetet e gjenerimit arrihen njëkohësisht. Gjithashtu, kjo metodë respekton limitet fizike ndërkohë që operohet rrjeti i transmetimit. Vlera e fundit e E_{max} përcaktohet kur të gjithë gjeneratorët ose çdo element tjetër i rrjetit arrin limitet e tij të operimit.

Kufizimet e Sigurisë Operacionale

Gjatë procesit të përcaktimit të kapaciteteve, OST sh.a. do të respektojë së paku Kufizimet e Sigurisë Operative të mëposhtme, gjatë kontigjencave të ndryshme të përcaktuara nga Kodi i Sigurisë Operacionale:

- Limitet termike të elementeve kritike të rrjetit;
- Limitet e Tensioneve, duke vendosur diapazone të tensioneve të lejueshme të nënstatcioneve;
- Limitet e Gjenerimit, duke siguruar disponueshmërinë e rezervës së gjenerimit në mënyrë që të arrihen kërkesat e përcaktuara nga Kodi i Sigurisë Operative.

Elementet kritikë të rrjetit, që janë si ato të Rrjetit Rajonal ashtu edhe ato të Rrjetit të Brendshëm, përcaktohen nga modeli i bashkuar rajonal, dhe definoohen si elementë me koeficient të ndjeshmërisë mbi 10%, pra dalja nga puna e një elementi kritik shkakton në të paktën një element tjetër të rrjetit të brendshëm ose të jashtëm, një ndryshim ngarkese prej 10% ose më shumë. Lista e elementeve kritikë azhurnohet vazhdimisht me ndryshimin e kushteve të punës së çdo Sistemi, dhe i bëhet disponibël grupit të punës të menaxhimit të konxhestioneve të RG SEE.

Përcaktimi i Marzhit të Sigurisë (TRM)

Përcaktimi i madhësisë së Marzhit të Sigurisë bazohet në përjasje statistikore, duke marrë parasysh evidencat historike dhe parashikimet në të ardhmen. Marzhi i Sigurisë përfshin pa-siguritë e mëposhtme:

- a) Devijimet e paqëllimshme të flukseve fizike gjatë operimit, për shkak të funksionimit fizik të rregullimit fuqi-frekuencë,
- b) Shkëmbimet emergjente midis OST-ve për t'u përballur në kohë reale me situata të disbalancave të papritura,
- c) pasaktësitë, p.sh në mbledhjen e të dhënave dhe matjeve,
- d) Pasaktësitë në rastin bazë të përdorur për llogaritje, si parashikimet e gjenerimit, konsumit, shkëmbimeve dhe topologjisë së rrjetit, etj.

Aktualisht, në Marrëveshjet Bilaterale, është pranuar që madhësia e marzhit TRM të jetë 100 MW në kufirin me Malin e Zi dhe Greqinë respektivisht, ndërsa në kufirin me Kosovën (Serbinë) 50 MW.

Harmonizimi i Rezultateve të Përcaktimit të Kapacitetit NTC

Vlera vjetore e NTC për çdo kufi dhe drejtim fluksi, llogaritet duke konsideruar vlerën minimale mujore që është përdorur, shfrytëzuar, në tre vitet e fundit, dhe rakordohet me OST-të fqinje respektive brënda muajit Nëntor të çdo viti.

Vlerat mujore të NTC, llogariten dhe harmonizohen me OST-të fqinje për çdo kufi veçmas, brënda datës 6 të çdo muaji, për muajin e ardhshëm. Për këtë ndiqet procedura e mëposhtme:

- a) 10 ditë para përfundimit të afatit të harmonizimit, shkëmbehen të dhënat, modeli nacional me të gjitha nyjet e nivelit 220/400 kV, ndërmjet OST-ve, në formatin e aprovuar UCT, përfshirë rezervën e fuqisë aktive për rritjen/uljen e gjenerimit, dhe të dhëna mbi programin e remonteve (elementët jashtë pune) për periudhën e konsideruar,
- b) 5 ditë para përfundimit të afatit të harmonizimit, kryhen llogaritjet (simulimet) për vlerat e TTC/NTC, që kryhen me anë të analizatorit të rrjetit (softit TNA) me të cilin janë të pajisur të gjitha OST-të e rajonit,
- c) 2 ditë para përfundimit të afatit të harmonizimit, shkëmbehen vlerat e përcaktuara të TTC për çdo kufi, dhe fillon procesi i harmonizimit të tyre. Në rast mospërputhje të vlerave të llogaritura, dhe nëse palët nuk arrijnë të bindin njëra tjetrën, atëherë vlera më e vogël e TTC hyn automatikisht në fuqi.

Në rast të ndryshimeve sinjifikative të situatës së Sistemit në krahasim me situatën e parashikuar, kur janë llogaritur kapacitetet ndërkuftare, OST-të fqinje, pas shkëmbimit të të dhënave relevante të situatës së rë, bëjnë ri-kalkulimin e kapacitetit ndërkuftar, dhe përcaktojnë bashkarisht vlerat e reja të NTC e respektivisht ato të ATC.

Alokimi i kapacitetit ndërkuftar për pjesmarrësit e tregut në rajonin tonë bëhet nga Zyra e Ankandit të Koordinuar SEE CAO në Podgoricë zyrë e cila menaxhon dhe ankandet e kufijve me Malin e Zi dhe Greqinë, përsa i takon interkonjeksionit me Kosovën kapacitetet alokohen në ankande të veçanta të menaxhuara nga ana e OST-së dhe EMS (Serbi) për shkak të mosnjohjes së Kosoves si

zonë sinkrone më vete nga ana e ENTSO-E fakt që ka penguar dhe operimin tregtar të linjës së re të interkonjeksionit 400 kV Tirana – Prishtinë.

Përdorimi i këtyre kapaciteteve transmetuese është pjesë e tregut të energjisë, e nëse pjestarët e tregut janë të motivuar për t'i përdorur të dy drejtimet e fluksit ndërkufitar, atëherë kjo do të lehtësonte qarkullimin e fluksit ndërkufitar duke kontribuar në rritjen e nivelit të sigurisë operacionale të punës së Sistemit Elektroenergjetik.

- **Modelet e pritshme të prodhimit, furnizimit, shkëmbimeve ndërkufitare dhe konsumit, duke mundësuar marrjen e masave për menaxhimin e kërkesës.**

Siç është dhënë edhe më sipër është kryer parashikimi i kërkesës për energji elektrike, mbulimi i saj nëpërmjet prodhimit vendas dhe importit për pesë vitet e ardhshme, 2019-2023. Të gjitha këto jepen të grupuara në tabelën e mëposhtme:

Viti	2019	2020	2021	2022	2023
Prodhimi Vendas [GWh]	5371	6027	6781	7241	7314
Shkëmbimi [GWh]	2086	1519	825	444	449
Konsumi [GWh]	7457	7546	7606	7686	7762

- **Objektivat e zhvillimit të qëndrueshëm në nivel kombëtar, rajonal dhe evropian.**

OST sh.a. kryen studime të vazhdueshme si për zona të veçanta të rrjetit të transmetimit ashtu edhe të lidhjes së sistemit elektroenergjetik Shqiptar me sistemet e vendeve fqinje. Studimet më të rëndësishme dhe që kanë rëndësi të veçantë kryhen në bashkëpunim me institucionet studimore ndërkombëtare në kuadrin e WBIF (Western Balkans Infrastructure Facility).

Gjatë fazave të planifikimit të zhvillimit të rrjetit të transmetimit me qëllim: (i) Rehabilitimin dhe fuqizimin e rrjetit të transmetimit, (ii) Krijimin e nyjeve të reja lidhëse, (iii) përmirësimin e procesit të menaxhimit, kontrollit, matjes etj, OST sh.a. merr në konsideratë zhvillimin kombëtar dhe rajonal në përputhshmëri të plotë me direktivat e ENTSO-E (Rrjetit Evropian të Operatorëve të Sistemit të Transmetimit për Energjinë Elektrike).

Të gjitha projektet në proces implementimi dhe ato të planifikuara janë të lidhura me shërbimin e sistemit të transmetimit, i cili mund të kryhet plotësisht vetëm nëpërmjet realizimit të investimeve të nevojshme për fuqizimin dhe modernizimin e tij.

- **Informacion i hollësishëm i OST sh.a., për investimet e parashikuara për linjat e interkoneksionit dhe për ndërtimin e linjave të brendshme të rrjetit, të cilat në mënyrë të drejtpërdrejtë ndikojnë në linjat e interkoneksioneve ndërkufitare.**

Nga pikpamja strategjike, projektet që përforcojnë lidhjet interkonektive me rajonin, duke krijuar kushte më të mira për shkëmbime tregtare dhe tranzitime pa kufizim të energjisë elektrike në rajonin e Evropës Juglindore, janë:

Linja e Interkoneksionit 400 kV Elbasan 2 (AL) – Manastir (MK).

Ky projekt përfshin:

- Ndërtimin e linjës së re ajrore 400 kV, Elbasan2 - Manastir, afërsisht 151 km, 56 km në territorin Shqiptar.
- Zgjerimin e nënstacionit 400 kV Elbasan2 me zbarrë dyfishe 400 kV, një dalje të re linje 400 kV dhe një shunt-reaktor 120 MVAR. Projekti në fjalë nuk është pjesë e planit dhjetë vjeçar të Zhvillimit të Rrjetit.

Projekti do të ketë impakt të rëndësishëm në:

- Krijimin e mundësive tregtare për shkëmbime ekonomike të energjisë elektrike nëpërmjet vendeve të rajonit.
- Ndarjen e rezervës kapacitive që do të kontribuojë në një siguri më të madhe të funksionimit të sistemeve elektroenergjetike të Shqipërisë dhe Maqedonisë.
- Suportin reciprok në raste emergjente
- Shfrytëzimin optimal të burimeve të rajonit që rezultojnë me kosto më të ulët të energjisë elektrike
- Dispatchimin optimal të njërive gjeneruese
- Reduktimin e kostos së gjenerimit
- Reduktimin e humbjeve të energjisë elektrike në rrjetin e transmetimit

Linja 400 kV Elbasan 2 – Fier

Ky projekt përfshin:

- Ndërtimin e linjës së re 400 kV, Elbasan2 – Fier, rreth 70 km, dhe dy daljet 400 kV respektivisht në nënstacionet Elbasan 2 dhe Fier
- Zgjerimin e nënstacionit Fier me një transformim 400/220 kV dhe lidhjen e tij me rrjetin e transmetimit.

Ky projekt, si pjesë e projektit të mësipërm, do të ketë impakt në:

- Në rritjen e standardeve, cilësisë dhe efikasitetit të sistemit të transmetimit në zonën qendrore dhe jugore të vendit
- Reduktimin e humbjeve të energjisë elektrike në rrjetin e transmetimit, sidomos në rrjetin 220 kV
- Zvogëlimin e energjisë së mosfurnizuar (ENS)
- Zvogëlimin e mbingarkimit të rrjetit 220 kV

dh) Cilësia dhe niveli i mirëmbajtjes së rrjetit

Për sa i përket mirëmbajtjes së rrjetit të transmetimit, OST në zbatim të Rregullores së shfrytëzimit teknik organizon monitorimin dhe kontrollin periodik të të gjithë elementëve të Sistemit të Transmetimit, duke hartuar planin e kontrollit dhe mirëmbajtjes, në të cilin detajohen veprimet që do të realizohen për kryerjen e remonteve për paisjet e nënstacioneve dhe kontrollet periodike për linjat e transmetimit. Kontrollet periodike dhe skanimi me kamera termike i linjave të transmetimit dhe nënstacioneve kanë ndihmuar në identifikimin në kohë të problemeve të cilat pas punimeve riparuese dhe ndërhyrjeve jashtë radhe janë eliminuar në kohë të shkurtër duke bërë dhe parandalimin e dëmtimeve të paisjeve. Kontrollet me qëllim parandalues të difekteve kanë ndikuar në rritjen e cilësisë së furnizimit me energji elektrike.

Sa i përket paisjeve transformuese që përbëjnë asetin kryesor në marrjen e kapaciteteve të prodhimit dhe transmetimit, defektet në to mund të sjellin probleme, të cilat lidhen me shpërndarjen e ngarkesës dhe mungesën e kapaciteteve rezervë. Në rastin e dëmtimeve të riparueshme, për zëvendësimin e transformatorëve kërkohet kohë e gjatë, e cila shoqërohet me humbje të mëdha financiare. Për këtë, për transformatorët 400 kV të sistemit të transmetimit OST merr masa për zbulimin e defekteve që në fillësë nëpërmjet vlerësimit të gjëndjes së transformatorit në kohë reale, duke mundësuar eliminimin e anomalive që në gjëndjen fillestare të shfaqjes së tyre.

Për një pasqyrë të cilësisë së punës së Sistemit të Transmetimit më poshtë jepen tabelat për stakimin të Energjisë Elektrike për avari për vitin 2018.

Emertimi	stakime gjithsej	tranzi tore	qendru eshme	kushte atmosf.	difekt linje	paisje primare	mbrojtja	SHAM SHAF	OSHEE te tjere	te ndrysh me	kohe zgjatja
Linja 400kV	13	5	8	9	0	2	1	0	1	0	4h 35'
Linja 220kV	95	49	46	39	25	3	22	0	6	0	173h 25'
Linja 110kV	397	245	152	202	55	18	78	13	29	2	400h 35'
Linja gjithsej	505	299	206	250	80	23	101	13	36	2	

N/stacione	stakime gjithsej	tranzi tore	qendru eshme	kushte atmosf.	probleme vaji,gazi	paisje primare	mbrojtja	SHAM SHAF	personel Oshee	te ndrysh me	kohe zgjatja
AUTO, TR	21	7	14	2	2	9	2	0	5	1	39h 50'

e) Masat për menaxhimin e kërkesës në pik dhe ndërprerjeve në furnizimin me energji elektrike dhe masat e përshtatshme, në rast nevojë, të rritjes së sigurisë së furnizimit.

Masat për menaxhimin e kërkesës në pik dhe ndërprerjeve të furnizimit, si dhe masa të tjera në rast nevojë për të ruajtur sigurinë e punës së Sistemit përmbledhen në të ashtuquajturat veprime përmirësuese, që paraqesin masat e zbatuara nga OST-ja, për të ruajtur sigurinë operacionale. Ato kategorizohen si veprime përmirësuese para-avari (dmth parandaluese) ose pas-avari (dmth korrigjuese ose kurative) brenda zonës së kontrollit të OST-së ose ndërmjet OST-ve të ndërlidhura.

Veprimet përmirësuese parandaluese zbatohen normalisht në stadin e planifikimit operacional ose të skedulimit, për të ruajtur gjëndjen normale të Sistemit në situatën e ardhëshme operative, dhe për të parandaluar përhapjen e avarive jashtë zonës së përgjegjësisë të OST. Veprimet përmirësuese parandaluese mund të përfshijnë, por nuk kufizohen vetëm në sa më poshtë:

- Veprime të ri-dispeçimit (të agregatëve) ose të lejimit të tregtimit në kah të kundërt, kur është e mundur;
- Ndryshime në topologjinë e rrjetit;
- Komutime manuale të pajisjeve të energjisë reaktive (ancafkat e transformatorëve, reaktorët, blloqet e kondensatorëve statike, ose ndryshimin e nivelit të set-point të kontrollorëve të tyre;
- Kërkesës për suport shtesë të energjisë reaktive nga centralët;
- Mundësisë së skemave disponibël të sistemit të mbrojtjes (SHAM).

Veprimet përmirësuese korigjuese janë veprime, të cilat zbatohen menjëherë ose relativisht shpejt pas ndodhjes së një emergjence, e cila çon në një gjendje të ndryshme nga situata normale. Me veprimet korigjuese Sistemi do të kthehet përsëri në gjendje normale. Veprimet përmirësuese korigjuese mund të përfshijnë, por nuk kufizohen vetëm në sa më poshtë:

- Veprime të ri-dispeçimit ose të tregtimit në kah të kundërt, duke përfshirë aktivizimin e rezervave të OST-së;
- Kontroll të pajisjeve të energjisë reaktive (ancafkat e transformatorëve, reaktorët, blloqet e kondensatorëve, etj);
- Menaxhim të tensionit me anë të gjenerim/absorbimit të energjisë reaktive nga centralët,
- Veprime të skemave të sistemit të mbrojtjes, p.sh. ndryshimi i topologjisë së rrjetit, kufizim i prodhimit apo i ngarkesës, në varësi të specifikimeve të mbrojtjes.

Plani i Sistemit të Mbrojtjes në rast të Situatës në Emergjencë

Siguria operationale nënkupton aftësinë për të siguruar funksionimin normal të Sistemit, për të kufizuar kohëzgjatjen dhe numrin e çrregullimeve, për të parandaluar shqetësime të mëdha, dhe për të kufizuar pasojat e një shqetësimi të madh në rast se kjo ndodh, dhe gjithashtu me qëllim për të lehtësuar Rivendosjen e Sistemit pas një shqetësimi të madh (black-out), për kthimin e Sistemit në funksionimin normal.

Plani i mbrojtjes së Sistemit është i lidhur me një gjendje emergjente, me procesin relevant të informacionit dhe veprimeve përmirësuese dhe përbëhet nga një sërë masash të koordinuara, të cilat synojnë të mbajnë integritetin e Sistemit, në rast të kushteve që rezultojnë nga trazirat ekstreme.

Masat e Planit të Mbrojtjes të Sistemit

Masat e Planit të Mbrojtjes së Sistemit paraqiten si veprime emergjente përmirësuese. Në vijim, jepen shembuj të masave të aplikueshme të Planit të Mbrojtjes së Sistemit në rastet e kufizimeve për ngarkesën, frekuencën, flukset e energjisë dhe të tensionit.

Kufizime të ngarkesës/frekuencës

- Lëshimi ose ndalimi i njësive të prodhimit të energjisë;
- Rritja ose zvogëlimi (automatikisht ose me kërkesë) i nivelit të prodhimit të njësive gjeneruese;
- Përshtatja e mënyrës së kontrollit të LFC aktive;
- Përdorimi manual apo automatik i reduktimeve, shkarkimit të ngarkesës;
- Ndryshimet e pikave të punës të rregullatorëve të tensionit të transformatorëve në nivelin e shpërndarjes.

Kufizime të flukseve të Energjisë Elektrike

- Anullimi i remonteve të elementëve të rrjetit dhe vënia në punë sa më urgjentisht të jetë e mundur;

- Stakimi automatik i njësisë (gjeneruese) që aktivizohet nga stakimi i një linje relevante të transmetimit;
- Tregëtimi në kah të kundërt me zonat fqinje të përgjegjësisë;
- Ngrirja e shkëmbimeve të planifikuara;
- Reduktimi i programit të shkëmbimit;
- Reduktimi i kapaciteteve të interkoneksionit;
- Shkarkimi manual i ngarkesës i objekteve me marrëveshje për ndërprerje;
- Shkarkimi automatik i objekteve me marrëveshje për ndërprerje, shkaktuar nga stakimi i një linje transmetimi;
- Shkarkimi i mëtejshëm i ngarkesës në varësi të situatës.

Kufizimet tensionit

- Kërkesa për vlera maksimale apo minimale të gjenerimit të fuqisë aktive dhe reaktive;
- Zvogëlimi i fuqisë aktive në favor të prodhimit shtesë të fuqisë reaktive;
- Parandalimi i njësive me ofrimin, injektimin e energjisë reaktive shtesë;
- Ndalimi i mirëmbajtjes, dhe kyçja e elementeve që më parë ishin në remont;
- Bllokimi i pozicionit të rregullatorëve të tensionit në transformatorët me rregullim nën ngarkesë.

1.5 Operatori i Sistemit të Shpërndarjes së Energjisë Elektrike (OSHEE sh.a.)

Shpërndarja e energjisë elektrike kryhet nga Operatori i Sistemit të Shpërndarjes, i licencuar nga ERE sipas dispozitave të Ligjit për Sektorin e Energjisë Elektrike. Operatori i Sistemit të Shpërndarjes ka në pronësi asetet në sistemin e shpërndarjes së energjisë elektrike, me qëllim lëvrimin e saj te klientët, ku kufiri i tij me sistemin e transmetimit është ai i përcaktuar në ligj.

Operatori i Sistemit të Shpërndarjes është përgjegjës për sigurimin e zhvillimit të sigurt dhe të qëndrueshëm të sistemit të shpërndarjes; përmbushjen e kërkesave për shpërndarjen e energjisë elektrike; mirëmbajtjen dhe operimin e sigurt të sistemit të shpërndarjes së energjisë elektrike në gjithë territorin për të cilin është licencuar. Në përputhje me Ligjin për Sektorin e Energjisë Elektrike, OSHEE sh.a. prokuron energji elektrike në tregun e hapur, për mbulimin e humbjeve në rrjetin e shpërndarjes, në përputhje me rregulloren e miratuar nga ERE dhe nëpërmjet platformës elektronike për procedurat e blerjes së energjisë.

Në zbatim të Ligjit Nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike” dhe VKM Nr. 244, datë 30.3.2016, OSHEE sh.a ka vijuar të kryej funksionin e Furnizuesit të Shërbimit Universal për nevojat e klientëve fundorë që përfitojnë nga ky shërbim.

Operatori i Sistemit të Shpërndarjes (OSHEE sh.a.) është organizuar në 11 Zona Shpërndarje dhe 42 Agjenci .

Më poshtë paraqiten të dhënat mbi treguesit kryesorë për çdo Agjenci të Operatorit të Shpërndarjes OSHEE sh.a. gjatë vitit 2018.

Treguesit e Energjisë së Furnizuar, shitur dhe humbur në çdo rajon e agjenci të OSHEE sh.a për vitin 2018 (MWh)

Drejtoria Rajonale/Agjencia	VITI 2018			
	Energjia e Hyre MWh	Energjia e Shitur MWh	Humbjet MWh	Humbjet ne %
Tirana1	809,468	715,947	93,521	12%
Tirana2	812,617	665,890	146,727	18%
Tirana3	618,200	507,864	110,336	18%
Dr. Rajonale Tirane	2,240,284	1,889,701	350,583	16%
Durres	386,532	320,765	65,767	17%
Kavaje	150,804	118,910	31,894	21%
Kruje	148,261	91,728	56,533	38%
Shijak	157,185	118,676	38,509	24%
Dr. Rajonale Durres	842,782	650,079	192,703	23%
Ballsh	53,449	44,242	9,208	17%
Fier	294,487	246,213	48,274	16%
Patos	65,847	53,442	12,405	19%
Dr. Rajonale Fier	413,783	343,896	69,887	17%
Elbasan	282,123	231,637	50,486	18%
Gramsh	19,445	16,573	2,872	15%
Librazhd	55,360	40,866	14,494	26%
Peqin	31,697	22,774	8,923	28%
Dr. Rajonale Elbasan	388,626	311,851	76,775	20%
Bilisht	34,480	27,750	6,730	20%
Kolonje	14,273	9,448	4,825	34%
Korce	181,546	144,395	37,151	20%
Pogradec	69,475	56,975	12,500	18%
Dr. Rajonale Korce	299,774	238,568	61,206	20%
Delvine	17,194	13,700	3,494	20%
Gjirokaster	96,615	78,474	18,142	19%
Permet	22,102	18,016	4,085	18%
Saranda	107,542	90,469	17,073	16%
Tepelene	30,921	21,341	9,580	31%
Dr. Rajonale Gjirokaster	274,374	221,999	52,375	19%
Koplik	64,799	27,789	37,009	57%
Lezhe	159,406	102,936	56,470	35%
Puke	27,856	13,498	14,358	52%
Shkoder	395,225	242,081	153,144	39%
Dr. Rajonale Shkoder	647,286	386,304	260,982	40%
Berat	123,482	100,665	22,816	18%
Kuçove	45,826	37,619	8,207	18%
Lushnje	164,272	128,583	35,689	22%
Skrapar	23,912	17,924	5,988	25%
Dr. Rajonale Berat	357,492	284,792	72,701	20%
Has	27,080	11,769	15,311	57%
Kukes	85,982	47,379	38,603	45%
Tropoje	48,835	15,212	33,623	69%
Dr. Rajonale Kukes	161,897	74,360	87,537	54%
Bulqize	49,207	41,013	8,195	17%
Diber(Peshkopi)	60,252	38,893	21,360	35%
Lac	148,971	94,029	54,943	37%

Mat (Burrel)	50,616	33,108	17,508	35%
Mirdite	38,416	24,193	14,223	37%
Dr. Rajonale Burrel	347,463	231,236	116,228	33%
Himare	23,385	20,488	2,897	12%
Selenice	40,435	18,263	22,172	55%
Vlore	254,586	208,503	46,084	18%
Dr. Rajonale Vlore	318,406	247,254	71,153	22%
	-	-	-	
Total Dr.Rajonale	6,292,169	4,880,040	1,412,129	22.44 %

Figure 29 Të dhënat mbi treguesit kryesorë për çdo Agjenci të Operatorit të Shpërndarjes OSHEE sh.a. gjatë vitit 2018

Treguesit sa më sipër, sipas agjencive, në krahasim me ato të vitit 2017, rezultojnë të përmirësuar e konkretisht në vlerat sa më poshtë të vitit 2017 gjatë të cilit u shënuar një sasi e humbjeve në masën 1,574,809 MWh, kundrejt sasisë prej 1,412,129 MWh për vitin 2018.

Humbjet më të larta i takojnë Drejtorive Rajonale Kukës dhe Shkodër, ndërkohë që nivel më të ulët të humbjeve gjatë vitit 2018 kanë patur Drejtoritë Rajonale Himarë dhe Tiranë.




Figure 30 Shpërndarja e Furnizimit me Energji Elektrike sipas Drejtorive rajonale (%)

Siç evidentohet edhe në figurën nr.30, pjesën më të madhe të konsumit të energjisë elektrike në vend për vitin 2018 e zë Drejtoria Rajonale Tiranë, ndërkohë që pjesën më të vogël të konsumit e zë Drejtoria Rajonale Kukës.






Figure 31 Sasia në Furnizim, Shitje dhe Humbje të Energjisë Elektrike në Rajonet dhe Agjencitë e Rrjetit të Shpërndarjes (Burimi: OSHEE sh.a).

Siç vërehet peshën specifike të humbjeve në raport me konsumin në vlerë më të vogël rezulton ta ketë Agjensia e Gjirokastrës dhe më të madhe agjensia e Tiranës kjo për shkak të vetë sasise së konsumuar për agjensitë në fjalë.

NUMRI I KLIENTËVE TË OSHEE sha 2017 DHE 2018												
DREJTORITË RAJONALE	Buxhetor		Familjare		Jo-Buxhetore		Privat		Konsum vetjak		TOTAL	TOTAL
	2017	2018	2017	2018	2017	2018	2017	2018	2017	2018	2017	2018
BERAT	879	943	87,612	88,054	315	315	13,398	13,650	36	36	102,240	102,998
BURREL	628	643	52,279	53,266	254	258	5,960	6,124	37	36	59,158	60,327
DURRËS	847	876	145,267	146,246	319	319	17,972	18,405	29	25	164,434	165,871
ELBASAN	860	901	93,643	94,173	435	434	12,725	12,839	34	32	107,698	108,379
FIER	604	657	71,764	72,072	240	240	9,778	9,868	23	23	82,409	82,860
GJIROKASTËR	1,210	1,233	67,933	68,659	275	274	9,472	9,633	24	25	78,914	79,824
KORÇË	873	917	80,968	80,889	266	266	9,250	9,324	26	26	91,383	91,422
KUKËS	303	321	17,372	17,609	90	89	2,112	2,178	9	10	19,886	20,207
SHKODËR	908	922	92,988	95,870	305	349	13,045	13,383	24	28	107,270	110,552
TIRANË	1,366	1,456	266,745	272,162	443	441	48,151	49,816	58	60	316,763	323,935
VLORË	516	552	69,008	70,382	193	193	10,073	10,500	13	14	79,803	81,641
TOTAL	8,994	9,421	1,045,579	1,059,382	3,135	3,178	151,936	155,720	313	315	1,209,958	1,228,016

Figure 32 Numri i Klientëve të OSHEE sh.a 2017 dhe 2018




Figure 33 Shpërndarja e numrit të Klientëve 2018 sipas kategorive (%)

Në tabelën e mëposhtme janë paraqitur të dhëna mbi Linjat, Kabinat dhe Transformatorët në rrjetin e Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes 2018.

NENSTACIONE, KABINA DHE TRANSFORMATORE	
Numri i Nënstacioneve	177
Numri i transformatoreve ne nenstacione	302
Numri i Kabinave total	25,574
Numri i Transformatorëve TM/TU	25,849

Gjatesia Totale e rrjetit TM (km)	16,350
Linja 35 kV (km) Ajrore	1,132.23
Linja 35 Kv (km) Kablllore	15.54
Linja 20 Kv (km) Ajrore	167.77
Linja 20 Kv (km) Kablllore	2,101.12
Linja 10 Kv (km) Ajrore	7,402.66
Linja 10 Kv (km) Kablllore	235.89
Linja 6 Kv (km) Ajrore	5,040.04
Linja 6 Kv (km) Kablllore	254.79

Gjatesia Totale e rrjetit TU (km)	24,973
Ajror me percjelles te xhveshur (km)	19,373
Ajror me kabell ABC(km)	3,765
Kabllor nentokesor (km)	1,835

KABINAT	TIPI DHE NUMRI I KABINAVE												FUQIA E INSTALUAR (kVA)				NUMRI I TRANSFORMATOREVE TE FUQISE TMTU				
	METALIKE			MURATURE			BOX			SHYLLLORE			NUMRI I KABINAVE								
	6 kV	10kV	20kV	6 kV	10kV	20kV	6 kV	10kV	20kV	6 kV	10kV	20kV		Total	6 kV	10kV	20kV	Total			
Gjithsej	344	297	10	2,854	3,780	3,710	44	116	1469	7,141	5,724	85	25,574	1,674,049	1,734,158	2,377,069	5,785,276	10,330	9,979	5,540	25,849
Pronesi OSHEE	268	210	1	1,795	2,776	2,148	25	80	1,400	2,031	2,372	52	13,158	841,230	1,064,288	1,376,090	3,281,608	4,131	5,472	3,740	13,345
Pronesi Jo e OSHEE	76	87	9	1,059	1,004	1,562	19	36	69	5,110	3,352	33	12,416	832,819	669,870	1,000,979	2,503,668	6,199	4,507	1,800	12,504

Figure 34 Të dhëna mbi asetet kryesore të OSHEE (Burimi: OSHEE).

Treguesit e Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes së Energjisë Elektrike për vitin 2018 paraqiten në tabelën në vijim:

TABELA ME TE DHENA PERIODIKE (MUJORE) TE OSHEE Sh.a 2018	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nentor	Dhjetor	Progresive	
A Energji Totale e Hyrë në OSHEE Sh.a (MWh)	659,778	590,823	597,595	468,417	467,468	468,885	508,892	539,134	465,468	471,407	517,882	681,162	6,436,911	
A.1 Energji e transmetuar nepermjet OST per llogari te OSHEE Sh.a	579,219	501,685	476,385	352,300	371,159	411,799	468,286	513,518	448,229	459,177	485,865	626,204	5,693,828	
A.1.1 Nga KESH - Gen nepermjet OST	471,759	385,008	319,022	194,596	237,209	340,191	416,776	474,491	418,286	218,710	127,906	271,608	3,875,562	
A.1.2 Nga OST si importi OSHEE Sh.a	4,712	3,360	4,458	2,880	3,720	5,040	-	-	-	218,795	318,975	288,540	850,480	
A.1.3 Energji e transmetuar per klientet_35kV (te dal ne treg te parregulluar)				606	1,172	1,400	1,272	1,340	652	1,150	2,340	2,251	2,441	14,624
A.1.4 Nga OST per llogari te Klienteve te OSHEE Sh.a prodhuar nga HEC-et ne rry	102,748	113,318	152,300	153,652	128,830	65,296	50,170	38,374	28,793	19,332	36,733	63,615	953,162	
A.1.5 Nga TEC VLORA nepermjet OST	n/a	n/a	n/a	n/a	n/a	n/a	n/a	n/a	n/a	n/a	n/a	n/a	n/a	
A.1.6 Nga Bistrica 1,2 nepermjet OST	n/a	n/a	n/a	n/a	n/a	n/a	n/a	n/a	n/a	n/a	n/a	n/a	n/a	
A.2 Energji e transmetuar direkt ne rrjetin e OSHEE Sh.a	80,559	89,137	121,209	116,117	96,308	57,086	40,606	25,616	17,239	12,229	32,017	54,958	743,083	
A.2.1 HEC Ulez, Tanabregas	3,268	2,958	3,101	3,021	3,140	2,920	2,809	2,713	2,468	2,236	1,960	3,014	33,607	
A.2.2 Impjantet Private/me Koncesion	77,291	86,180	118,108	113,096	93,169	54,166	37,798	22,903	14,772	9,993	30,057	51,944	709,476	
B Energji Totale ne Rrjetin e Shpërndarjes (MWh)	659,778	590,823	596,989	467,245	466,067	467,614	507,552	538,482	464,318	469,667	515,631	678,721	6,422,287	
C Humbjet Totale ne OSHEE Sh.a (MWh)	202,192	147,162	162,684	109,325	107,654	97,346	109,188	111,991	89,945	101,472	117,705	181,841	1,538,503	
C.1 Humbje Teknikë njesite e TL (MWh)	12,038	12,044	12,108	11,350	9,260	8,326	9,942	11,041	7,757	8,587	10,855	12,666	125,974	
C.2 Humbje Teknikë ne Zona (MWh)	111,242	98,092	97,806	68,436	69,296	67,557	71,478	73,815	60,429	58,879	63,325	104,232	944,587	
C.3 Humbje JoTeknikë ne Zona (MWh)	78,912	37,026	52,770	29,539	29,098	21,463	27,768	27,135	21,759	34,006	43,524	64,943	467,943	
C.1 Humbjet Totale ne OSHEE Sh.a (%)	30.65%	24.91%	27.25%	23.40%	23.10%	20.82%	21.51%	20.80%	19.37%	21.63%	22.83%	26.79%	23.96%	
C.1.1 Humbje Teknikë njesite e TL (%)	1.82%	2.04%	2.03%	2.42%	1.98%	1.78%	1.95%	2.05%	1.67%	1.82%	2.10%	1.86%	1.96%	
C.2.1 Humbje Teknikë ne Zona (%)	16.86%	16.60%	16.38%	14.65%	14.87%	14.45%	14.08%	13.71%	13.01%	12.55%	12.3%	15.4%	14.71%	
C.3.1 Humbje JoTeknikë ne Zona (%)	11.96%	6.27%	8.84%	6.32%	6.24%	4.59%	5.04%	4.69%	7.25%	8.44%	9.57%	7.29%		
D Energjia e shitur per te gjithë konsumatoret e OSHEE Sh.a	457,587	443,661	434,305	357,920	358,414	370,269	398,364	426,491	374,373	367,595	397,926	496,879	4,883,784	
D.1 Shitur Klienteve FMF (MWh)	4,536	4,513	6,446	4,086	4,616	5,230	5,260	5,165	5,338	3,812	3,728	3,956	56,686	
D.1.1 Shitur Klienteve FMF Privat (MWh)	4,145	4,106	5,886	3,724	4,489	5,155	5,212	5,120	5,264	3,692	3,495	3,604	53,891	
D.1.2 Shitur Klienteve FMF JoBuxhetore (MWh)	391	408	560	362	127	75	48	45	74	120	233	352	2,795	
D.2 Shitur Klienteve Private (MWh)	123,260	125,689	129,020	109,885	123,011	132,463	150,816	156,265	135,972	128,174	127,186	147,239	1,588,800	
D.2.1 Shitur nga rrjeti i Transmetimit per llogari te OSHEE Sh.a														
D.2.2 Shitur per nevoja te veta te OSHEE Sh.a	1,031	1,152	933	539	673	545	710	685	613	605	788	1,139	9,413	
D.3 Shitur Klienteve Private (pa ate per nevoja te veta dhe Ne TL)	122,229	124,536	128,087	109,346	122,337	131,918	150,106	155,580	135,179	127,569	126,398	146,101	1,579,387	
D.3.1 Shitur Klienteve JoBuxhetore (MWh)	26,767	24,328	26,227	21,199	24,019	24,802	26,652	30,330	26,185	27,911	28,717	33,410	320,545	
D.4 Shitur Klienteve Buxhetore (MWh)	25,192	24,792	24,816	15,795	15,657	14,662	16,900	16,883	16,280	16,974	20,202	27,753	235,905	
D.5 Shitur Klienteve Familjare (MWh)	277,831	264,339	247,797	206,954	191,112	193,112	198,736	217,848	190,779	190,724	218,094	284,521	2,681,848	
D.5.1 Shitur Klienteve Familjare (MWh)	271,648	257,914	241,203	200,560	184,248	186,089	191,879	210,683	184,020	184,313	211,415	277,790	2,601,763	
D.5.2 Shitur Klienteve Familjare per Ambjentet e Perbashketa	6,183	6,425	6,594	6,394	6,864	7,023	6,869	7,166	6,759	6,411	6,679	6,730	80,085	
E Faturuar muajit Parardhës (000/leke)	6,347,229	5,939,299	5,685,334	5,680,352	4,671,224	4,731,173	4,976,161	5,403,874	5,805,751	5,047,859	4,975,893	5,318,350	64,582,498	
F Arketimet e muajit aktual (000/leke)	6,118,178	5,683,429	6,016,056	5,618,824	5,214,970	4,738,737	5,224,991	5,518,612	5,400,919	5,489,875	4,788,703	5,999,241	65,812,534	
F.1 Arketuar per faturat korrente te vitit aktual	4,343,390	3,853,504	3,928,363	3,709,587	3,207,116	3,101,594	3,374,133	3,701,686	3,670,367	3,360,933	2,937,979	3,722,281	42,910,990	
F.3 Arketuar per faturat e tjera te vitit aktual	4,101	1,396,808	1,481,707	1,632,237	1,293,628	1,521,663	1,440,066	1,418,283	1,801,094	1,379,145	1,856,841	15,225,572		
F.4 Arketuar per faturat e tjera te viteve te kaluara	1,774,788	1,825,823	690,885	427,530	375,617	343,516	329,195	376,861	312,269	327,849	471,580	420,120	7,676,032	
F.1 Arketimet e muajit aktual (%)	96.4%	95.7%	105.8%	98.9%	111.6%	100.2%	105.0%	102.1%	93.0%	108.8%	96.2%	112.8%	101.9%	
F.1.1 Arketuar per faturat korrente te vitit aktual (%)	68.4%	64.9%	69.1%	65.3%	68.7%	65.6%	67.8%	68.5%	63.2%	66.6%	59.0%	70.0%	66.4%	
F.1.3 Arketuar per faturat e tjera te vitit aktual (%)	0.0%	0.07%	24.6%	26.1%	34.9%	27.3%	30.6%	26.6%	24.4%	35.7%	27.7%	34.9%	23.6%	
F.1.4 Arketuar per faturat e tjera te viteve te kaluara (%)	28.0%	30.7%	12.2%	7.5%	8.0%	7.3%	6.6%	7.0%	5.4%	6.5%	9.5%	7.9%	11.9%	
G Faturuar muajit Raportues (000/leke)	5,939,299	5,685,334	5,680,352	4,671,224	4,731,173	4,976,161	5,403,874	5,805,751	5,047,859	4,975,893	5,318,350	6,625,289	64,860,558	
1 Nr. Konsumatoreve gjithesej (Nr.)	1,211,903	1,214,078	1,216,367	1,216,641	1,224,193	1,219,455	1,221,979	1,229,332	1,234,896	1,230,161	1,237,407	1,228,016	1,228,016	
2 Fatura te emetuara me lexim konsumi (Nr.)	968,821	956,470	962,998	967,711	965,130	972,085	995,760	1,001,602	997,163	985,967	980,866	971,729	11,726,302	
3 Sasia e energjise se faturuar me lexim konsumi (MWh)	457,159	443,217	433,858	357,656	358,167	369,990	398,021	425,594	374,096	367,286	397,587	496,442	4,879,073	
4 Fatura te emetuara me lexim "0" (Nr.)	244,346	260,093	256,336	252,300	259,238	252,986	230,980	227,785	237,767	249,483	256,647	263,548	2,991,509	
5 Nr.Faturave te emetuara pa lexim (energjie e pa matur) (Nr.)	-	1	1	-	1	1	1	2	1	1	-	-	9	
6 Sasia e energjise se faturuar si energji e pamatur (MWh)	-	62	62	-	4	50	98	629	20	42	-	-	967	
7 Nr.Faturave te emetuara pa lexim (dem ekonomik) (Nr.)	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	
8 Shuma e faturuar si dem ekonomik (000/leke)	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	
9 Nr.Faturave per cilat eshte arketuar kamat vonese (Nr.)	412,656	345,822	428,221	396,350	432,304	397,041	449,988	512,573	412,729	450,341	430,442	464,489	5,132,956	
10 Vlera e Kamat vonesave te arketuara (000/leke)	96,322	81,872	90,248	90,035	101,183	95,977	94,428	99,399	86,058	91,304	71,732	89,871	1,088,430	

Figure 35 Të dhënat mbi treguesit e Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes gjatë vitit 2018.

Nga rezultatet e vitit 2018 evidentohet një performacë në rritje në drejtim të uljes së humbjeve dhe rritjes së nivelit të arkëtimeve. Në paragrafet e mëposhtme paraqiten analizat e këtyre rezultateve.

1.6 Konsumi i Energjisë Elektrike

Konsumi total vjetor i Energjisë Elektrike (duke përfshirë edhe konsumin e klientëve në treg të parregulluar) në Shqipëri për periudhën 2003 deri në 2018 paraqitet në mënyrë grafike me poshtë.




Figure 36 Konsumi i përgjithshëm në vite.

Siç vërehet në paraqitjen grafike rezulton një rritje proporcionale në të gjitha kategoritë e konsumatorit sa i përket konsumit në krahasim me vitin 2017, gati 0.2 GWh ose 2.7%. Konsumi më i ulët është rregjistruar në vitin 2007 me 5,767,652 MWh dhe konsumi i lartë është ai i rregjistruar në vitin 2013 me 7,957,698 MWh

Në tabelat vijuese jepen treguesit e sintetizuar nga operatorët publik (OST sh.a. dhe OSHEE sh.a.) të sistemit energjetik në Shqipëri.

TABELA ME TE DHENA TE OSHEE Sh.a 2018			Progressive
A	Energji Totale e Hyrë në OSHEE Sh.a (MWh)	$A=A.1+A.2$	6,436,911
A.1	Energji e transmetuar nepermjet OST per llogari te OSHEE Sh.a	$A.1=Sum(A.1.1,A.1.6)$	5,693,828
A.1.1	Nga KESH - Gen nepermjet OST		3,875,562
A.1.2	Nga OST si import i OSHEE Sh.a		850,480
A.1.3	Energji e transmetuar per klientet 35kV (te dal ne treg te parregulluar)		14,624
A.1.4	Nga OST per llogari te klienteve te OSHEE Sh.a prodhuarnga HEC-et ne rrjetin e transmetimit		953,162
A.1.5	Nga TEC VLORA nepermjet OST		n/a
A.1.6	Nga Bistrica 1,2 nepermjet OST		n/a
A.2	Energji e transmetuar direkt ne rrjetin e OSHEE Sh.a	$A.2=A.2.1+A.2.2$	743,083
A.2.1	HEC Ulez,Lanabregas		33,607
A.2.2	Implantet Private/me Koncesion		709,476
B	Energji Totale ne Rrjetin e Shperndarjes (MWh)	$B=A.1.3$	6,422,287
C	Humbjet Totale ne OSHEE Sh.a (MWh)	$C=C.1+C.2+C.3$	1,538,503
C.1	Humbje Teknike njesite e TL (MWh)		125,974
C.2	Humbje Teknike ne Zona (MWh)		944,587
C.3	Humbje JoTeknike ne Zona (MWh)		467,943
C.1	Humbjet Totale ne OSHEE Sh.a (%)	$C.1=C/B$	23.96%
C.1.1	Humbje Teknike njesite e TL (%)		1.96%
C.2.1	Humbje Teknike ne Zona (%)		14.71%
C.3.1	Humbje JoTeknike ne Zona (%)		7.29%
D	Energjia e shitur per te gjithë konsumatorët e OSHEE Sh.a	$D=D.1+D.2+D.3+D.4+D.5$	4,883,784
D.1	Shitur Klienteve FMF (MWh)	$D.1=D.1.1+D.1.2$	56,686
D.1.1	Shitur Klienteve FMF Privat (MWh)		53,891
D.1.2	Shitur Klienteve FMF JoBuxhetore(MWh)		2,795
D.2	Shitur Klienteve Private (MWh)	$D.2=D.2.1+D.2.2+D.2.3$	1,588,800
D.2.1	Shitur nga rrjeti i Transmetimit per llogari te OSHEE Sh.a		-
D.2.2	Shitur per nevoja te veta te OSHEE Sh.a		9,413
D.2.3	Shitur Klienteve Private (pa ate per nevoja te veta dhe Ne TL)		1,579,387
D.3	Shitur Klienteve JoBuxhetore (MWh)		320,545
D.4	Shitur Klienteve Buxhetore (MWh)		235,905
D.5	Shitur Klienteve Familjare (MWh)	$D.5=D.5.1+D.5.2$	2,681,848
D.5.1	Shitur Klienteve Familjare (MWh)		2,601,763
D.5.2	Shitur Klienteve Familjare per Ambientet e Perbashketa		80,085
E	Faturuar muaji Parardhes (000/leke)		64,582,498
F	Arketimet e muajit aktual (000 leke)	$G=F.1+F.2+F.3+F.4$	65,812,534
F.1	Arketuar per faturat korrente te vitit aktual		42,910,930
F.3	Arketuar per faturat e tjera te vitit aktual		15,225,572
F.4	Arketuar per faturat e tjera te viteve te kaluara		7,676,032
F.1	Arketimet e muajit aktual (%)	$F.1=F/E$	101.9%
F.1.1	Arketuar per faturat korrente te vitit aktual (%)	$F.1.1=F.1/E$	66.4%
F.1.3	Arketuar per faturat e tjera te vitit aktual (%)	$F.1.3=F.3/E$	23.6%
F.1.4	Arketuar per faturat e tjera te viteve te kaluara (%)	$F.1.4=F.4/E$	11.9%
G	Faturuar muaji Raportues (000/leke)		64,860,558

Bilanci i Sistemit Elektroenergjetik (MWh)	Viti 2018
Dhënë nga KESH në transmetim	5,849,025
Dhënë nga HEC-et e vogla në transmetim	269,528
Dhënë nga HEC-et e lidhura në transmetim	655,055
Dhënë nga HEC Peshqesh	95,957
Dhënë nga HEC Banje	292,561
Dhënë nga HEC FANG	238,690
Dhënë nga HEC Ashta	298,107
Dhënë nga KURUM to Transmission (Ulez-Shkopet&Bistrica1,2)	377,767
Dhënë në Interkoniuksion (-)	2,685,045
Marrë në Interkoniuksion (+)	1,771,740
Balanca totale në Interkoniuksion	913,306
Totali në marrje në transmetim	9,848,431
Humbjet në transmetim (përfshirë dhe nevojat vetjake)	242,705
Humbjet në transmetim (%)	2.46
Totali në dhënje në transmetim	9,605,725
<i>Dhënë në Interkoniuksion (-)</i>	<i>2,685,045</i>
<i>Dhënë për klientët e lidhur në transmetim</i>	<i>957,323</i>
<i>EL Kurum</i>	<i>279,775</i>
<i>Fushe Arrez</i>	<i>3,231</i>
<i>Titan</i>	<i>88,524</i>
<i>F.Kruje 220 kv</i>	<i>117,884</i>
<i>N/ST 220/6,3 Colacem</i>	<i>9,978</i>
<i>ACR T1</i>	<i>106,061</i>
<i>ACR T2</i>	<i>8,195</i>
<i>AES T1</i>	<i>77,302</i>
<i>AES T2</i>	<i>79,243</i>
<i>N/ST 220kV Moglice</i>	<i>9,925</i>
<i>Hec Peshqesh</i>	<i>250</i>
<i>Hec Ashta</i>	<i>8</i>
<i>Hec BANJE</i>	<i>148</i>
<i>Hec FANG</i>	<i>287</i>
<i>Gjenerim KURUM</i>	<i>103</i>
<i>Tec Ballsh T1</i>	<i>34,737</i>
<i>Ferro Krom</i>	<i>141,673</i>
<i>Dhënë për sistemin e shpërndarjes së energjisë</i>	<i>5,963,357</i>
<i>Dhënë për sistemin e shpërndarjes së energjisë (niveli 110 kV)</i>	<i>4,953,455</i>
<i>Dhënë për sistemin e shpërndarjes së energjisë (niveli 35 kV)</i>	<i>595,568</i>
<i>Dhënë për sistemin e shpërndarjes së energjisë (Tension i mesëm)</i>	<i>414,334</i>

Figure 37 Treguesit nga operatorët kryesore të sistemit Elektroenergjetik në Shqipëri 2018.

Bazuar në të dhënat e mësipërme të tabelave dhe informacioneve periodike apo specifike të operatorëve të tregut të energjisë u ndërtua Bilanci Energjetik për vitin 2018 si më poshtë.

BILANCI ENERGJITIK 12-Mujori 2018 (MWh)												
	Neto KESH	Blerje ne Treg te hapur OSHEE	Neto (Selit)	HC.Priv/Kon ne Rrjetin e OSHEE	HC.Priv/Kon ne Rrjetin e OST	UKKO	Neto Ashta	Neto Banja	Neto KURUM	H/C Peshqesh	H/C Fangu	Prodhim neto vendas
Prodhimi Neto KESH sha	5,850,932		33,607	709,476	655,055		298,107	292,561	377,767	95,957	238,690	8,552,152
Ballanca e shkembimeve në Interkoneksion.												
Ballanca e shkembimeve të brendëshme (pa OST,OSHEE).												
Shitur OST per Humbje+konsum vetiak	-1,975,370	850,480										
Konsumuar nga Tec Vlora												
Devijime nga Programi i Interkoneksionit												
Energji per sherbime ndihmes+disbalanca												
Energji per OSHEE sha nga KESH sha	3,875,562	850,480	33,607	709,476	655,055	0	298,107					
								292,561	377,767	95,957	238,690	
				6,422,287				14,624	Energji për FMF jo Klient			
				6,436,911								
				0								
				6,436,911								Ballanca në interkoneksion (dhënie)
												913,306
Energji e transmetuar ne rrjetin e OSHE për FMF jo klient				14,624								
Shitur Kons Familjare FSHU	2,681,875											
Shitur Kons Jo Familjare FSHU	2,145,223	4,883,784										
Shitur Kons Jo Familjare FMF	56,686			6,422,287								
Humbje tekn TL	125,974											
Humbje teknike ne zona	944,587	1,538,503										
Humbje Jo teknike ne zona	467,943											
Konsumi i OSHEE (shitje+humbje)				6,422,287								
Konsumuar nga Klientet ne TL ("kualifikuar")				957,323								
Konsumuar nga TEC Vlora 2018				1,907								
Konsumuar nga OST (humbje +nevoja vetiake)				242,705								
Energji e transmetuar ne rrjetin e OSHE për FMF jo klient				14,624								
KONSUMI TOTAL 2017				7,638,846								7,638,846
												Burimi OST, OSHEE sha

Figure 38 Bilanci Energjetik viti 2018.




Figure 39 Kontributet e prodhimit neto vendas dhe balancës Import-Eksport në konsumin total të Energjisë Elektrike në Shqipëri.

1.6.1 Struktura e Konsumit të Energjisë Elektrike

Në figurën e mëposhtme paraqiten peshat specifike në faturim që zënë kategoritë e klientëve tariforë.





Figure 40 Raportet e Faturimit sipas Kategorive të Klientëve 2018.




Figure 41 Klientët Familjarë kundrejt konsumit total të vendit në vite.

Klientët familjare zënë rreth 35.1 % të konsumit total shifër pak më e ulët kjo krahasuar me konsumin për të njëjtën kategori për vitin 2017 i cili ishte në masën 35.7 %.

Një peshë të rëndësishme në konsumin e energjisë elektrike zënë edhe konsumatorët buxhetorë dhe jo buxhetorë të cilët zënë rreth 12 % të faturimit total të OSHEE sh.a.,

Në vendin tonë konsumi familjar në raport me konsumin e përgjithshëm të faturuar për klientët tariforë për vitin 2018 përbën rreth 48 %, të faturuar nga OSHEE sh.a./FSHU

1.6.2 Profili i Konsumit të Energjisë Elektrike

Nga studimi i profilit vjetor të konsumit të Energjisë Elektrike, tipari karakteristik i këtij profili është simetria thuajse e plotë e konsumit dimër – verë.

Ashtu sikurse në raportimet e viteve të mëparshme, edhe këtë vit vërehet i njëjti fenomen, ai i përdorimit të energjisë elektrike për ngrohje në dimër. Çdo ndryshim i temperaturës së mjedisit reflektohet menjëherë në konsumin ditor të energjisë elektrike, pikërisht prej efektit të përdorimi ose mospërdorimit të ngrohjes me energji elektrike të banesës.

Gjatë stinës së verës, në muajt Korrik dhe Gusht tendenca e pikut është në rritje, i cili nga viti në vit po bëhet më evident dhe lidhet me ndryshimet klimatike, përmirsimin e kushteve të jetesës që çon në përdorimin gjithnjë e në shkallë më të gjerë të pajisjeve klimatizuese gjatë muajve të nxehtë.

Më poshtë paraqiten të dhënat e konsumit mesatar ditor për çdo muaj të vitit 2018 krahasuar me të dhënat mesatare të periudhës 2007-2017.



Figure 42 Konsumit mesatar ditor për çdo muaj të vitit 2018.

Në grafikun më poshtë jepet profili mesatar ditor me bazë orare të ngarkesës për vitin 2018.




Figure 43 Profili mesatar ditor me bazë orare i ngarkesës për vitin 2018.

PIKU I NGARKESËS për vitin 2018 (1,480 MW) është shënuar në datë 31.12.2018 ora 18:00

PIKU I NGARKESËS për vitin 2017 (1 424 MW) është shënuar në datë 12.01.2017 ora 19:00

Edhe gjatë këtij viti vërehet se profili mesatar i ngarkesës dhe në ai i regjistruar në kohë PIKU nuk kanë ndryshim të konsiderueshëm.




Figure 44 Profili dhe piku i ngarkesës në dhjetor 2018 (MW)




Figure 45 Profili dhe minimumi i ngarkesës në janar 2018 (MW)

NGARKESA MINIMALE (434 MW) datë 02.01.2018 ora 04:00

1.7 Transaksionet e kryera nga KESH sh.a, OST sh.a. dhe OSHEE sh.a. në Treg të Parregulluar 2018

OSHEE sh.a ka blerë në treg të parregulluar me qëllim sigurimin e furnizimit me energji elektrike për klientët fundorë, në zbatim të detyrimeve që burojnë nga VKM 244/2016, dhe sipas Rregullave të përkohëshme të tregut si dhe Rregullores për shitblerjen e energjisë elektrike miratuar me vendimin e bordit të ERE nr. 103/2016 , ndryshuar.

KESH sh.a. për gjashtë mujorin e parë të vitit 2018 ka shitur/blerë energji në treg të parregulluar në zbatim të Rregullores së miratuar nga ERE nr 30/2011, ndërsa për gjashtëmujorin e dytë Shit blerjet e KESH sh.a të energjisë elektrike në tregun e parregulluar janë kryer në zbatim të “Rregullores së Tregimit të Energjisë Elektrike nga Korporata Elektroenergjetike Shqiptare KESH sh.a” miratuar me vendimin nr. 2762/8 datë 06.06.2018, të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, në rolin e pronarit të KESH sh.a.

OST sh.a ka blerë në treg të parregulluar me qëllim mbulimin e humbjeve në rrjetin e transmetimit në zbatim të detyrimeve që burojnë nga VKM 244/2016, dhe sipas Rregullave të përkohëshme të tregut si dhe Rregullores për shitblerjen e energjisë elektrike miratuar me vendimin e bordit të ERE nr. 103/2016, ndryshuar.

Më poshtë po paraqesim një tabelë me të dhëna të transaksioneve të kryera gjatë vitit 2018 nga KESH dhe OSHEE.

TRANSAKSIONET NË TREG TË HAPUR PËR KESH sha DHE OSHEE sha gjatë vitit 2018														
KESH sha		Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nentor	Dhjetor	Total [MWh]
		Transaksione hyrëse nga interkoneksioni	0	-1,533	-832	0	-1,910	-5,390	13,020	13,098	-6,660	-2,880	-883	-4,926
	Blerje në tregun e brendëshëm						-22,330	27,342			-1,920	-8,104	-2,520	-62,216
	Transaksione dalëse nga interkoneksioni	62,120	126,942	277,090	249,953	248,229	13,640	21,000	0	0	300	5,201	1,910	1,006,385
	Shitje në tregun e brendëshëm	19,560	181,148	228,731	324,167	195,762	25,529	26,596	8,767	2,185	3,490	31,046	21,121	1,068,102

OSHEE sha		Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nentor	Dhjetor	Total [MWh]
		Blerje në treg të hapur	-4,712	-3,360	-4,458	-2,880	-3,720	-5,040	0	0	0	-218,795	-318,975	-288,540

Figure 46 Transaksionet e kryera gjatë vitit 2018 nga KESH sh.a dhe OSHEE sh.a.

Në grafikun e Figurës 47 është paraqitur balanca (hyrje – dalje) import-eksport e energjisë elektrike për periudhën 2007 – 2018.

Për 10-vjeçarin e fundit, me përjashtim të vitit 2010, 2016 (vlera të vogla) dhe 2018 vendi ynë rezulton të jetë një importues neto i energjisë elektrike. Sqarojmë se vlerat e paraqitura përfaqësojnë të gjitha flukset hyrëse e dalëse nga të gjithë aktorët e tregut të energjisë elektrike në Shqipëri.




Figure 47 Balanca Import - Eksport e energjisë elektrike në vite (Burimi: OST sh.a.). Aktiviteti i Shitjes së Energjisë Elektrike nga OSHEE sh.a

Në vitin 2018 është realizuar vlerë më e lartë e eksportit në sasinë 913 GWh, krahasuar me 10 vitet e fundit ose gati 11% të prodhimit total.



Gjatë vitit 2018 efektiviteti i shitjes të energjisë elektrike vazhdon në vlera të rritura në referencë gjithnjë të faktorëve përcaktues në nivelin e efijencës së konsumit të energjisë elektrike të cilët janë:

1. Niveli i humbjeve të energjisë elektrike në shpërndarje.
2. Niveli i arkëtimeve të energjisë elektrike së faturuar.

Humbjet e përgjithshme të raportuara nga Shoqëria për vitin 2018, arrijnë në **23.96%**, duke shënuar një rënie të ndjeshme krahasuar edhe me vitin 2017.

Niveli total i arkëtimeve i raportuar nga OSHEE sh.a. është 101.9 % kundrejt energjisë elektrike të faturuar për vitin 2018 (shih tabelën e Faturim Arkëtimeve më poshtë).

Kjo shifër përfshin edhe arkëtimet e prapambetura të periudhës 2007-2017 në vleftën 7.676 Milard **lekë**.






Figure 48 Humbjet Vjetore në Sistemin e Shpërndarjes në periudhën 2009-2018.




Figure 49 Niveli i Arkëtimeve Mjuzore në periudhën 2011-2018.

PERFORMANCA E OPERATOTRIT TE SHPERNDARJES 2009-2018 (%)												
NIVELI I HUMBJEVE (%) 2009-2018												
	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nentor	Dhjetor
2009	40.75	37.05	38.05	32.93	33.44	30.75	32.60	30.20	25.34	30.67	33.44	36.89
2010	38.62	35.41	36.90	31.37	35.17	31.45	26.94	29.69	21.47	20.61	22.16	29.05
2011	55.55	38.00	36.95	23.11	24.85	21.29	21.88	19.41	22.95	25.15	32.20	35.70
2012	35.72	59.16	55.23	45.41	38.87	39.77	45.51	45.51	42.09	35.53	41.89	49.32
2013	51.12	48.71	48.29	39.66	39.52	40.33	43.33	38.50	35.08	45.98	48.08	53.04
2014	47.00	42.14	42.78	35.69	36.85	34.10	36.59	36.36	31.67	34.52	32.88	37.54
2015	36.68	31.82	32.88	30.54	31.24	28.60	30.62	29.29	25.30	29.92	30.82	34.50
2016	34.69	29.00	29.93	26.07	26.97	24.35	25.97	25.15	22.12	27.11	29.30	30.99
2017	33.50	27.63	28.66	25.81	25.88	28.31	24.69	23.29	19.79	23.76	23.55	27.90
2018	30.65	24.91	27.22	23.33	23.03	20.76	21.46	20.77	19.32	21.53	22.73	26.70
												26.41
												23.9
Niveli i Arketimeve (%) 2009-2018												
	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nentor	Dhjetor
2009	69.32	85.95	74.38	86.58	86.31	76.37	75.40	72.46	83.20	80.82	61.77	70.01
2010	55.37	66.28	86.63	89.46	86.70	79.42	74.84	124.98	84.20	70.81	56.15	66.48
2011	67.26	57.61	87.66	71.61	96.73	73.00	65.00	81.00	66.00	63.86	51.47	87.30
2012	59.80	79.20	78.50	78.00	94.70	83.50	91.60	102.90	74.00	98.00	72.60	78.00
2013	61.40	63.70	86.20	80.70	79.10	69.60	87.90	90.10	78.50	84.30	89.00	102.00
2014	84.90	77.10	85.90	85.50	81.90	80.20	86.70	83.60	102.60	101.00	101.90	141.00
2015	112.70	120.50	103.70	86.60	95.70	97.10	98.40	104.70	95.30	100.30	92.20	100.70
2016	92.10	87.00	95.60	90.10	99.10	92.00	94.20	96.70	91.50	96.70	90.30	96.70
2017	85.20	87.60	105.70	94.50	105.70	91.80	104.80	97.40	94.60	103.80	92.70	100.10
2018	96.39	95.69	105.82	98.92	111.64	100.16	105.00	102.12	93.03	108.76	96.24	108.94
												96.6
												101.9
Efektiviteti i shitjeve (%) 2009-2018												
	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nentor	Dhjetor
2009	41.1%	54.1%	46.1%	58.1%	57.4%	52.9%	50.8%	50.6%	62.1%	56.0%	41.1%	44.2%
2010	34.0%	42.8%	54.7%	61.4%	56.2%	54.4%	54.7%	87.9%	66.1%	56.2%	43.7%	47.2%
2011	29.9%	35.7%	55.3%	55.1%	72.7%	57.5%	50.8%	65.3%	50.9%	47.8%	34.9%	56.1%
2012	38.4%	32.3%	35.1%	42.6%	57.9%	50.3%	49.9%	56.1%	42.9%	63.2%	42.2%	39.5%
2013	30.0%	32.7%	44.6%	48.7%	47.8%	41.5%	49.8%	55.4%	51.0%	45.5%	46.2%	47.9%
2014	45.0%	44.6%	49.2%	55.0%	51.7%	52.9%	55.0%	53.2%	70.1%	66.1%	68.4%	88.1%
2015	71.4%	82.2%	69.6%	60.2%	65.8%	69.3%	68.3%	74.0%	71.2%	70.3%	63.8%	66.0%
2016	60.2%	61.8%	67.0%	66.6%	72.4%	69.6%	69.7%	72.4%	71.3%	70.5%	63.8%	66.7%
2017	56.7%	63.4%	75.4%	70.1%	78.3%	65.8%	78.9%	74.7%	75.9%	79.1%	70.9%	72.2%
2018	66.8%	71.9%	77.0%	75.8%	85.9%	79.4%	82.5%	80.9%	75.1%	85.3%	74.4%	79.9%
												71.1%
												77.5%

Figure 50 Ecuria treguesve të efektivitetit të shitjes së Operatorit të Shpërndarjes (%)

Efektiviteti i shitjeve praktikisht përfaqëson energjinë që është shitur dhe arkëtuar.

Efektiviteti i shitjeve për periudhën 2009-2018 jepet në grafikun e mëposhtëm.




Figure 51 Efektiviteti i shitjeve të OSHEE 2009-2018 (Burim: OSHEE).




Figure 52 Humbjet Totale kundrejt Energjisë së futur në sistemin Elektroenergjetik.

Në figurën 52 është paraqitur ecuria e humbjeve totale e cila përfshin edhe ato në sistemin e transmetimit, gjatë periudhës 2002–2018, i cili dëshmon për një përmirësim në masën 1.2 % të nivelit të humbjeve në sistemin elektroenergjetik shqipëtar ku për vitin 2018 shënohet vlera 24.0 % humbje në rrjet, kundrejt 25.2 % të vitit 2017.

Në grafikun e figurës 53 është paraqitur marrëdhënia e faturim-arkëtimeve gjatë periudhës 2005-2018.




Figure 53 Faturimi/Arkëtimi 2002-2018 me TVSH (Burimi: OSHEE sh.a.).

SITUATA E INVESTIMEVE

PLANI I INVESTIMEVE VITI 2018 ME FONDET E OSHEE (sipas zërave) Lekë		
Nr.	Emertimi i Investimit	Vlera 2018
I	Ndërtim/rikonstrukcion elektrik për Nenstacionet	128,528,375
II	Ndërtim/Rikonstrukcion linjash të TL	450,000,000
III	Blerje Pajisje makineri për N/Stacione dhe likuidim avarish	1,320,000,000
IV	Ndërtim Rrjeti TM	87,991,908
V	Ndërtim/Rikonstrukcion Rrjeti TM /TU	1,798,240,973
VI	Ndërtim/Rikonstrukcion kabinash elektrike	500,000,000
VII	INVESTIMET PRIORITARE (Rrjet TU - ABC lines)	1,059,205,517
VIII	Teknologji Monitorimi	376,936,514
IX	INVESTIME NE MATJE	1,380,000,000
X	Vlera 10% që do të paguhet nga OSHEE për investimet Bankes Boterore	179,201,439
XI	Kosto lokale për investimet e Bankes Boterore	1,347,314,549
XII	Oponenc, Supervizion, Kolaudim	10,000,000
XIII	Projektme N/Stacionesh	80,000,000
XIV	Vlere e parashikuar për shpronësim	10,000,000
XV	Studime me të treta për marrjen e lejeve të ndërtimit (Topografik,gjeologjik,arkeologjik,mjedisor)	10,000,000
XVI	Programe Inxhinjerike	20,000,000
TOTALI		8,757,419,274

Janë realizuar një sërë investimesh në ndërtim rrjeti TM 20 kV, kabina elektrike të reja, rrjet TU me percjellësa ABC si dhe rikonstrukcione e ndërtime të N/Stacioneve gjatë viteve 2017-2018 sipas tabelës së mëposhtme.

Rajoni/ Viti	Kontratat 2017 dhe 2018			
	Vlera e punimeve te kontraktuara(Leke)	Përqindja e kontratave (%)	Realizimi i punimeve në terren(Leke)	Realizimi (%)
Rajoni TIRANE	1,678,125,699	18	1,274,259,645	76
Rajoni ELBASAN	427,030,288	5	427,030,288	100
Rajoni BURREL	587,879,494	6	582,456,677	99
Rajoni SHKODER	987,152,552	10	635,684,646	64
Njesia KUKES	42,271,043	4	42,271,043	100
Rajoni BERAT	207,904,365	2	178,130,072	86
Rajoni DURRES	3,358,758,143	36	2,855,158,498	85
Rajoni KORCE	233,233,035	2	232,600,233	99.7
Rajoni GJIROKASTER	525,700,669	6	512,008,051	97
Rajoni FIER	312,503,801	3	271,046,001	87
Rajoni VLORË	1,075,170,920	11	937,533,490	87
Total	9,435,730,009	100	7,948,178,644	84

Informacioni i saktë mbi realizimin e investimeve të parashikuara si dhe kontabilizimit të tyre do të kryhet pas depozitimit të kopjes së audituar të pasqyrave financiare të vitit 2018 të OSHEE sh.a afati për të cilat është Qershori i vitit 2019.

Zbatimi i Investimeve të OSHEE sh.a në disa raste shtrihet në një periudhë kohore mbi një vit kalendarik. Duhet të minimizohen dhe të punohet më shumë në ndryshimet në investimet e parashikuara dhe realizuar faktikisht. Nga studimi i raportimeve teknike rezulton se investimet e realizuara kanë ndikuar në përmirësimin e cilësisë së shërbimit dhe furnizimit me energji elektrike.

Nga të dhënat paraprake rezulton që OSHEE gjatë vitit 2018 të ketë realizuar një investim prej 6.8 miliardë lekë, shifër kjo që do të verifikohet me daljen e pasqyrave financiare të audituara.

PJESA II: Rregullimi i Sektorit të Gazit Natyror

2.1 Projekti TAP, (Trans Adriatic Pipeline)

Projekti i Gazsjellësit Trans Adriatik (TAP) është pjesë e sistemit të transmetimit të gazit të prodhuar nga vendburimi Shah Deniz 2 (SD 2) në Azerbajxhan drejt Tregut European të Gazit. Transportimi përmes Azerbajxhanit dhe Gjeorgjisë do të kryhet me anë të tubacionit South Caucasian Pipeline, ndërsa transportimi përmes Turqisë do të kryhet me anë të tubacionit TANAP deri në kufirin Turko-Grek. Theksojmë se në Qershorin e vitit 2018-të fillojë operimi i kësaj linje duke sjell drejt Turqisë një sasi gazi prej 6 bcm/vit (6 miliard metër kub gaz natyror në vit).



Korridori Jugor i Gazit (SGC)

Korridori Jugor i Gazit (SGC) është një nga zinxhirët më të ndërlikuar të gazit në botë, i cili synon të sjellë burime nga rajoni Kaspik në tregjet Europiane të energjisë për herë të parë. Gazi Natyror nga fusha e Shah Deniz do të bëjë një rrugë prej 3,500 km nga Deti Kaspik në Europë. Kjo do të kërkojë përmirësimin e disa infrastrukturave ekzistuese dhe zhvillimin e një zinxhiri për gazsjellësat e rinj.

- Zhvillimi i Shah Deniz II, puset e shpimit dhe prodhim detar i gazit në Detin Kaspik.
- Zgjerimi i impiantit të përpunimit të gazit në terminalin e Sangachal në bregun e Detit Kaspik në Azerbajxhan.
- Tre projekte gazsjellësish:
 - Gazsjellësi i Kaukazit të Jugut (SCPX) – Azerbajxhan, Gjeorgji
 - Gazsjellësi Trans Anatolian (TANAP) – Turqi
 - Gazsjellësi Trans Adriatik (TAP) – Greqi, Shqipëri, Itali
- Zgjerimi i rrjetit Italian të transmetimit të gazit.

Mundësi për lidhje të tjera me rrjetet e gazit në Europën Juglindore, Qëndrore dhe Perëndimore

Transportimi i mëtejshëm do të kryhet me anë të tubacionit Trans Adriatic Pipeline (TAP). TAP do të shtrihet përmes Greqisë, Shqipërisë, në tabanin e detit Adriatik për tu bashkuar me Sistemin Italian të Transmetimit të Gazit në zonën e San Foca në Italinë Jugore çka mundëson lëvizjen e mëtejshme drejt tregjeve evropiane. Deri tani ende nuk kanë filluar punimet në territorin Italian pavarësisht se SNAM është aksionere në TAP AG por edhe njëkohësisht si Shoqëria më e madhe që merret me transmetimin, shpërndarjen dhe prodhimin e energjisë nga gazi natyror.

Dihet se territori ku do të merret kjo sasi gazi është nga më të mëdhatë e krahasuar me Evropën, Afrikën Veriore dhe Rusinë. Në pamjen e mëposhtme jepen rezervat që disponojnë këto rajone. (Trilion m³)




Figure 54 Pasqyrimi i Statistikave botërore për Energjinë

Projekti fillimisht do të transportojë 10 bcm/vit, me mundësinë për zgjerimin më vonë të kapacitetit deri në 20 bcm/vit nëpërmjet shtimit të stacioneve të reja të kompresorëve. TAP është i projektuar gjithashtu që të mundësojnë rrjedhjen fizike të gazit në drejtim të kundërt.

Projekti TAP është zhvilluar nga Shoqëria TAP AG. Aksionerët fillestarë të kompanisë kanë qënë: Shoqëria zvicerane Axpo (42.5%), Shoqëria norvegjeze Statoil (42.5 %) dhe Shoqëria gjermane E.ON Ruhrgas (15%). Statoil është gjithashtu aksionere (25,5 %) në Konsorciumin Shah Deniz që është Shoqëria që shfrytëzon SD2.

Gjatë viteve ka patur ndryshim aksionerësh, për të cilin janë njoftuar të gjitha palët e interesuara përfshirë edhe tre autoritetet kombëtare, atë Grek, Italian dhe Shqiptar.

Disa ndryshime në pronësinë e TAP AG - sidomos, dalje e përgjithshme e Total Gas Transport Ventures S.A.S. dhe E.ON (përmes Global Commodities SE), dalja e Statoil ASA si aksionerëve dhe hyrjen e Enagás Internacional SLU dhe SNAM S.p.A (Itali) Aksionerët aktualë paraqiten sipas tabelës së mëposhtme:

Aksionerët	Aksionerët përpara ndryshimit të parashikuar në 23 Korrik 2013	Aksionerët aktualë Për 2016	Ndryshimi
AzTAP (më parë e njohur si SOCAR GAS Pipelines GmbH)	20%	20%	0%
BP Gas Marketing Ltd	20%	20%	0%
SNAM S.p.A(Itali)	0%	20%	+20%
Fluxys Europe BV	16%	19%	+3%
Enagás Internacional S.L.U	0%	16%	+16%
Axpo Holding AG	5%	5%	0%
Total Gas Transport Ventures SAS	10%	0%	-10%
E.ON,Global Commodities SE	9%	0%	-9%
Statoil ASA	20%	0%	-20%

Figure 55 Aksionerët aktualë TAP

2.2 Ecuria e deritanishme e projektit TAP-AG në Shqipëri

TAP një Projekt Strategjik për Shqipërinë dhe Europën Jug-Lindore

- TAP është pjesa Europiane e zinxhirit të vlerave të Korridorit Jugor të Gazit me një investim prej 40 miliard USD \$, e cila ka si objektiv kryesor strategjik shumëllojshmërinë e furnizimit me energji për Europën.
- TAP është një gazsjellës strategjik i gazit natyror dhe një nga investimet më të mëdha për Shqipërinë dhe rajonin e Europës Jug Lindore, e cila sjell shumëllojshmëri dhe siguri në furnizimin me energji përmes një rruge të re të gazit e cila vjen nga fushat e Detit Kaspik në tregjet Europiane.
- TAP do të rrisë sigurinë e energjisë dhe shumëllojshmerinë në furnizim për Europën dhe do ta mbajë gazin natyror si lëndën djegëse më të pastër e cila do të vazhdojë të luajë një rol kyç në sigurimin e një përzierje të qëndrueshme të energjisë.
- Gazsjellësi është projektuar për të dyfishuar kapacitetin në një fazë të mëvonshme duke i dhënë mundësi Shqipërisë dhe vendeve të tjera të Ballkanit Perëndimor që të kenë akses tek gazi nga fushat e Detit Kaspik dhe duke mundësuar gazifikimin e ekonomive të tyre.
- TAP është një projekt me rëndësi të madhe strategjike, komerciale dhe gjeopolitike për Shqipërinë, Ballkanin Perëndimor dhe Evropën. Projekti e bën Shqipërinë pjesë të infrastrukturës energjetike Evropiane duke shtuar sigurinë e furnizimit në vend.

- Gazi natyror i ofruar dhe shërbyer nga TAP do të kontribuojë në dekarbonizimin e ekonomive të vendit, veçanërisht në Europën Jug Lindore dhe të Ballkanit Perëndimor, ku sektori i energjisë është tepër i varur nga përdorimi i lëndëve djegëse fosile për prodhimin e energjisë elektrike.
- TAP për të mundësuar ndërlidhje më të madhe dhe bashkëpunim ekonomik më të fortë midis vendeve të rajonit, përfshirë krijimin e një tregu rajonal të gazit të integruar plotësisht në tregun European.

Përditësimi i përgjithshëm i projektit TAP:

- **Projekti ka përfunduar në mbi 84% të tij**, përfshirë të gjitha punimet inxhinierike dhe të ndërtimit.
- **100% të gjurmës ku kalon tubacioni janë pastruar dhe përmirësuar tashmë** (në Greqi dhe në Shqipëri)
- **97% të instalimeve të tubacionit të gazit janë vendosur përgjatë gjurmës (backfilled)**
- **Mbi 89% e tubacioneve janë rivendosur** (Në Greqi dhe në Shqipëri)
- Pjesa në det (offshore) është në **vazhdimësi** sipas programit të projektit

Përditësim i ecurisë të projektit TAP në Shqipëri:

Në Shqipëri, punimet e ndërtimit kanë përparuar vazhdimisht dhe janë në përputhje me programin e projektit. Nuk ka patur ndonjë problem të rëndësishëm në pjesën Shqiptare të gazsjellësit.

- | | |
|---|---------------|
| • Korridor i Kalimit pastruar dhe përmirësuar | 215 km |
| • Tubat e Salduar | 214 km |
| • Janë gërmuar | 214 km |
| • Vendosja e Korridorit të Kalimit | 211 km |
| • Rikthim i Korridorit të Kalimit në gjendje fillestare | 183 km |
| • Stacionet e Valvulave të Bllokimit është realizuar në masën | 97% |
| • Stacioni i Kompresorit në Fier është realizuar në masën | 75% |
| • Stacioni i Matjes në Bilisht është realizuar në masën | 7% |

Punimet (Inxhinierike, ato të Prokurimit dhe të Ndërtimit) në det të hapur:

- Ka përfunduar ndërtimi i objekteve të përkohshme (rrugëve ndihmëse dhe kampeve të ndërtimit) dhe janë drejt përfundimit punimet paraprake për daljen në det.

- Instalimi i tubave në pjesën në det të hapur pritet të fillojë në fillim të muajit Mars 2019.


Pritet që dorëzimet për shfrytëzimin e pjesës detare dhe asaj në tokë të përfundojnë brenda vitit 2020.

Përfitimet për Shqipërinë:

- TAP është investimi më i madh Direkt i Huaj, i cili aktualisht është në fazën përfundimtare të ndërtimit, me një vlerë totale të investimit prej 1.5 miliard € në Shqipëri.
- Projekti TAP po zhvillohet në përputhje me bazën ligjore të BE dhe standartet ndërkombëtare më të mira mjedisore dhe sociale duke lënë një përvojë pozitive dhe një trashëgimi për Shqipërinë.
- Gjatë pikut të ndërtimit u punësuan rreth 3,800 punëtorë për projektin 85% e tyre vinin nga komuniteti lokal.
- Në kuadër të këtij projekti, TAP po kontribuon në shtimin dhe përmirësimin e infrastrukturës përfshirë ndërtimin dhe rehabilitimin e rrugëve dhe urave.
- TAP është një ndërtim kryesor i infrastrukturës në Shqipëri i cili parashikon hapjen e tregjeve të gazit dhe lidhjen ndërkufitare në rajonin e Europës Juglindore/Ballkanit Perëndimor me pjesën tjetër Evropiane të rrjetit të gazit.
- TAP do të jetë një mundësi për shpërndarjen e gazit natyror në Shqipëri, duke përmirësuar sigurinë energjetike në vend, diversifikimin e burimeve Shqiptare të Energjisë dhe zhvillimin e rrjetit dhe tregut të gazit në vend.
- Një Pikë Dalje në Kuçovë dhe në Fier mund të përdoren për furnizimin e rrjetit për shpërndarjen e gazit të vendit dhe ndërtimin e ndërlidhësave të tjerë me vendet fqinje.
- TAP ofron një mbështetje të prekshme për forcimin e kapacitetit të Operatorit të sapo krijuar për Transmetimin e Gazit Natyror (Albgaz).
- Marrëveshja e Mirëmbajtjes Albgaz -Snam është pjesë e angazhimit të TAP për të mbështetur zhvillimin e tregut të gazit në Shqipëri. Ajo do të sjellë të ardhura të qëndrueshme dhe do të mbështesë zhvillimin e Albgaz si një Operator European i Sistemit të Transmetimit dhe homologe e TAP.

Vështrim i Shpejtë mbi Projektin TAP:

- Gjatësia në total: 878 km (Greqia: 550 km; Shqipëria: 215 km; Deti Adriatik: 105 km dhe Italia: 8 km + mikro tunel 1.5 km)
- Kapacitet fillestar: 10 miliard metër kub gaz natyror në vit, mjaftueshëm për të furnizuar rreth 7 milion familjarë.
- Diametri i Jashtëm: 48 inch (1.2 m) në tokë; 36 inch (0.91 m) në det.
- Rasti kryesor: Dy stacione kompresorash (një në Kipoi, Greqi dhe një në Fier, Shqipëri)
- I zgjeruar: mbi 20 miliard metër kub gaz natyror në vit, duke instaluar dy stacione të tjera kompresimi, një në Serres, në Greqi dhe një në Bilisht, Shqipëri.
- Rrjedha fizike e brendshme e tubacionit është e integruar



Informacion mbi Projektin TAP në Shqipëri (detajet teknike)

Pjesa tokësore e projektit ne territorin Shqiptar

- Gjatësia e gazsjellësit në Tokë është 215 km
- Fillon në Bilisht në Rajonin e Korçës në kufirin Shqiptaro-Grek dhe shtrihet deri në zonën bregdetare në veri të Fierit, në fshatin Topojë.
- Diametri i jashtëm i tubit: 48''
- Pika më e lartë: 2100 m, në zonën e Trepollarit, në të gjithë gjatësinë e projektit ky është terreni më i vështirë në të gjithë gjatësinë e këtij projekti
- Infrastruktura shtesë e lidhur me gazsjellësin: stacion i kompresimit në Fier; stacion i matjes afër Bilishtit; 8 stacione të valvulave të bllokimit (BVS) dhe një stacion për daljen në det
- Presioni maksimal që mund të funksionojë në Stacionin e Kompresorit është 97 / 147 bar
- Rrugët ndihmëse: më shumë se 175 km rrugë (në dy faza)
- Ura: më shumë se 40 janë rehabilituar dhe 2 ura janë të reja

Pjesa në det e projektit

Pjesa nën det e TAP do të kalojë nëpër Detin Adriatik në kanalën e Otrantos midis bregdetit Shqiptar në jug-perëndim të Fierit dhe bregdetit Italian në San Foca.

- Gjatësia totale (përfshirë pjesën Shqiptare dhe Italiane): 105 km
 - 37 km në ujërat territoriale Shqiptare
 - 25 km në ujërat territoriale Italiane
 - 43 km në ujëra ndërkombëtare.
- Thellësia maksimale e ujit : 820 m
- Diametri i Jashtëm i Tubacionit: 36''

Aspektet rregullatore të Projektit TAP:

Përveç kontributit të saj të rëndësishëm për krijimin e tregut Shqiptar të gazit, TAP është unik nga perspektiva rregullatore:

- Së pari, TAP mbulon tre shtete: vendin tonë, i cila është Palë Kontraktore tek Komuniteti i Energjisë dhe dy Vende Anëtare të BE (Italia dhe Greqia);
- Së dyti, ERE i dha TAP-it, së bashku me Rregullatorët Grekë dhe Italiane (përkatësisht RAE dhe ARERA) *përrjashtimin e parë* nga dispozitat themelore të Direktivës së Tretë të BE për Gazin (aksesin e palëve të treta, tarifa të rregulluara dhe veçimin e pronësisë) për një periudhë 25 vjecare;
- Së treti, marrja e Vendimit të Përrjashtimit **përrfshin edhe një bashkëpunim të shkëlqyer të ERE me autoritetet e tjera rregullatore (Greqia dhe Italia), të cilat kanë vepruar si një e vetme për qëllimet e TAP**. Kjo është treguar në dokumenta të përbashkëta të dala prej Autoriteteve Rregullatore, si mund të përmendim Opinionin e Përbashkët për Përrjashtimin, Vendimin e Përbashkët për Certifikimin e Operatorit të Pavarur të Transmetimit (ITO), Udhëzimet për menaxhimin dhe alokimin e kapacitetit, dokumenta të tjera që kanë lidhje me testimin e parë të tregut, miratimin e Programit Rregullator të Pajtueshmërisë së TAP dhe Kodin e Tarifave.

TAP aktualisht po bashkëpunon ngushtë me ERE për:

- Miratimin e Kodit të Rrjetit të TAP, i cili ka për qëllim të drejtojë operimin e sistemit të transportit të TAP. TAP e ka paraqitur Kodin e tij të Rrjetit tek Autoritetet Rregullatore për miratim në fund të vitit që kaloi;
- Në marrjen e liçensës së Transmetimit në Shqipëri dhe zbatimin e kërkesave për Certifikimin si Operator i Pavarur i Transmetimit. Në lidhje me liçensën e transmetimit TAP e ka paraqitur aplikimin në fund të vitit 2018, e cila është ndjekur me vendimin e Bordit të ERE për fillimin e procedurave të liçensimit në aktivitetin e transmetimit të gazit natyror dhe në përfundim i është dhënë kjo liçensë për 25 vjet.

Në lidhje me pikat e Hyrje/Dalje në Fier, Kuçovë dhe Korçë

Sipas Nenit 4.7.7 të Opinionit të Përbashkët Përfundimtar të Rregullatorëve të Energjisë lidhur me përrjashtimin e TAP-it (Opinionin i Përbashkët Përfundimtar), TAP-i ndërton dhe vë në funksion që prej Datës së Operacioneve Tregtare, të paktën një pikë daljeje në territorin e Shqipërisë në afërsi të qytetit të Fierit, ose sipas sipas marrëveshjes me autoritetet shqiptare. Ashtu siç është rënë dakord me autoritetet shqiptare, TAP-i po ndërton një pikë daljeje në Kuçovë, Shqipëri. Që kjo pikë daljeje të vihet në funksion si pikë hyrjeje në TAP, duhen ndërmarrë veprime të tjera shtesë të cilat kanë të bëjnë me Ministrinë e linjës dhe TAP.

Marrëveshja e Angazhimit për Zhvillimin e Tregut të Gazit (MAZHTG) u arrit në 1 Mars 2017, midis Republikës së Shqipërisë, që vepron përmes Këshillit të Ministrave dhe TAP-it, miratuar me Vendim të Këshillit të Ministrave nr.233/2017, datë 21 mars 2017 ‘‘Për Miratimin e Marrëveshjes së Angazhimit për Tregun e Gazit dhe Marrëveshjes për Përrfitimet Vendore’’, e cila përcakton detyrimin e TAP-it për të projektuar, prokuruar dhe ndërtuar pajisjet e uljes së trysnisë dhe matjes fiskale në një pikë të vetme daljeje, përkatësisht Pikën Fillestare të Daljes në Shqipëri në Fier, dhe

TAP po e ndërton këtë pikë daljeje. Duhet të theksojmë se ndërtimi i një pikë daljeje në Kuçovë, është një detyrim i veçuar dhe i ndarë nga të gjitha detyrimet e tjera në kuadër të termave dhe kushteve sipas Opinionit të Përbashkët.

Është shumë e rëndësishme të theksojmë se pikat e Hyrje/Dalje shtesë mund të përcaktohen bazuar në rezultatet e një **Testimi të Tregut**, i cili është parashikuar gjatë vitit 2019-të. Me synimin për përmbushjen e kërkesave të ministrisë së linjës, TAP-i ka shtuar Kuçovën, dhe së bashku me pikën e Fierit, si pika interkonjeksioni, të pasqyruara edhe në Kodin e Rrjetit të TAP, po vazhdojnë punimet dhe faktikisht janë drejt përfundimit, megjithëse në këto pika interkonjeksioni nuk është rezervuar kapacitet.

Në këto kushte kemi një bashkëpunim midis TAP-it dhe Albgaz-it për t'i dorëzuar ENTSOG (Shoqatës së rrjetit të transmetimit europiane të gazit) kërkesën për Kodet e Identifikimit për pikat e daljes në Kuçovë dhe Fier. Në lidhje me shtesën e një pike të tretë interkonjeksioni në Korçë, midis Ministrisë së linjës dhe TAP-it vazhdojnë bisedimet. Qeveria me vendimin nr. 30/4 datë 14.02.2018, Për miratimin me kusht të statusit “Investim/Investitor strategjik procedurë e veçantë”.

Për projektin e investimit me potencial strategjik “Gas Power Plant Korça me subjekt aplikues “GPP Korça shpk” NUIS/NIPT: L73724004N”. Projekti parashikon realizimin në zonën e Korçës të një termocentrali me gaz me cikël të kombinuar, me rendiment të shndërrimit të energjisë termike me energji elektrike me 60% me kapacitet 480 MW dhe një sasi gazi prej 600 milion metër kub gaz në vit. Impianti do të furnizohet me gaz nga projekti TAP sipas një kontrate që vetë subjekti propozues do të negocijojë me kompaninë TAP AG dhe me furnizuesit e gazit. Për këtë duhet të arrihet një marrëveshje, dhe kjo marrëveshje të propozohet nga TAP-i, tre agjencive të energjisë (ITALI; GREQI dhe Shqipëri). Është në kopetencën e tyre që ta miratojnë atë, dhe për më tepër pritjet që në periudhën e Market Testit, që do të kryhen gjatë këtij viti, të përcaktohen edhe kapacitetet për këtë pikë daljeje në Korçë. Gjithmonë opsioni është i hapur, kërkohet vetëm sigurim kapacitetesh për pikat e daljeve apo të hyrjeve.

Aktet nënligjore të nxjerra nga Ministria dhe Këshilli i Ministrave për sektorin e Gazit Natyror

- **VKM Nr. 417, datë 10.05.2017**, “Për miratimin e planit të emergjencës për gazin natyror, në përputhje me standardet minimale të sigurisë së furnizimit, si dhe rregullat për të garantuar furnizim të sigurt dhe të efektshëm me gaz natyror”
- **VKM Nr. 69, datë 07.02.2018**, “Për miratimin e kushteve dhe të procedurës për përcaktimin e furnizuesit të mundësisë së fundit me gaz natyror”
- **VKM Nr. 590, datë 9.10.2018** “Për miratimin e modelit të tregut të gazit natyror”.
- **VKM Nr. 573, datë 3.10.2018** “Për miratimin e rregullave dhe procedurave në ushtrimin e funksioneve mbikëqyrëse në sektorin e gazit natyror të ministrisë përgjegjëse për energjinë”
- **VKM Nr. 685, datë 14.11.2018**, “Për miratimin e praktikave për promovimin e investimeve të përbashkëta rajonale në infrastrukturën e sektorit të energjisë”.
- **VKM Nr. 612, datë 27.10.2017**, “Për miratimin e rregullave teknike e të kritereve të sigurisë, pjesa e tretë, për kërkesat minimale të projektimit teknik, ndërtimit dhe operimit të sistemeve të transmetimit e të shpërndarjes së gazit natyror, të instalimeve të GNL-së, hapësirave të depozitimit dhe të linjave direkte”.

- **Urdhëri Nr. 96, datë 23.01.2018, i Ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë**, “Për miratimin e kushteve të përgjithshme për akses në rrjetet e gazsjellësave të veprimtarive të kërkim prodhimit”.
- **Urdhëri Nr. 912, datë 27.12.2018, i Ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë** “Për miratimin e udhëzuesit për përcaktimin e zonave për aktivitetin e transmetimit dhe të shpërndarjes së gazit natyror”.

Në paketë përfshihen gjithashtu edhe aktet nënligjore që ishin ekzistuese në kohën kur është miratuar ligji 102/2015, datë 23.09.2015, “Për sektorin e gazit natyror”, të cilët janë konsideruar të vlefshëm edhe pas hyrjes në fuqi të këtij ligji:

- **VKM Nr. 713, datë 25.8.2010**, “Për përcaktimin e rregullave për kushtet e proçedurat për dhënien e lejeve për ndërtimin dhe përdorimin e tubacioneve e të infrastrukturës së sistemeve të gazit natyror”,
- **VKM Nr. 1030, datë 27.11.2013**, “Për miratimin e rregullave teknike e të kriterëve të sigurisë, pjesa e parë, për kërkesat minimale të projektimit teknik, ndërtimit dhe operimit të sistemeve të transmetimit e të shpërndarjes të gazit natyror, të instalimeve të GNL-së, hapësirave të depozitimit dhe të linjave direkte”,
- **VKM Nr. 104, datë 4.2.2015**, “Për miratimin e rregullave teknike e të kriterëve të sigurisë, pjesa e dytë, për kërkesat minimale të projektimit teknik, ndërtimit dhe operimit të sistemeve të transmetimit e të shpërndarjes të gazit natyror, të instalimeve të GNL-së, hapësirave të depozitimit dhe të linjave direkte”,
- **VKM Nr. 551, datë 18.6.2015**, “Për miratimin e kriterëve dhe të proçedurave për pajisjen me certifikatën e lejes profesionale për veprimtaritë studimore-projektuese dhe zbatuese për kërkimin, prodhimin, përpunimin, transportimin, depozitimin dhe tregtimin e lëndëve hidrokarbure”,
- **Urdhri Nr. 666, datë 3.8.2009, i Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës**, “Për miratimin e rregullave teknike dhe kriterëve të sigurisë, të përkohshme, për kërkesat minimale të projektimit teknik, ndërtimit dhe operimit të sistemeve të transmetimit e të shpërndarjes së gazit natyror, të instalimeve të GNL-së, hapësirave të depozitimit dhe të linjave direkte”,
- **Urdhri Nr. 449, datë 21.6.2011, i Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës**, “Për mënyrën e funksionimit të komisionit të vlerësimit të kërkesave dhe të dokumentacionit shoqëruar të shoqërive që do të pajisen me leje për ndërtimin e përdorimin e infrastrukturës së sistemeve të gazit”.

2.3 Vendimi i Përrjashtimit të TAP AG-s

Vendimi i Përrjashtimit është i mbështetur në paragrafin 4.5 të FJO i cili përrjashton TAP-AG nga dispozitat e pronësisë, si përrcaktohet në nenin 9(1) të Direktivës së Gazit.

I gjithë investimi që do të kryhet për këtë projekt do jëtë rreth 40 miliard dollarë duke përrshkruar gjashtë shtete me një gjatësi tubacioni 3500 km.

Final Joint Opinion i qershorit 2013 përrcaktonte se Vendimi Përrjashtues do të humbte efektin dhe vlefshmërinë e tij nëse ndërtimi nuk do të fillonte brenda 3 viteve (pra, brenda Qershorit 2016) dhe nëse nuk fillonte veprimtaria operationale brenda 6 viteve të ardhshme. Gjithsesi, Komisioni i BE-

së do të mund të aprovonte një shtyrje në rastin e ndonjë vonese të shkaktuar nga pengesa madhore përtej fuqisë së TAP-it. (kjo bazuar në nenin 36.9 të Direktivës 79/2003/EC).

Në vendimin e Komisionit Europian të majit 2013 parashikohej se roli TAP-it është vetëm një nga elementet në vazhden e investimeve që nevojiten të kryhen për të siguruar prodhimin e Gazit të Shah Deniz 2 dhe transportimin e gazit për në BE.

Veçanërisht, vendimi parashikonte se TAP-i nuk ka asnjë influencë mbi zhvillimin e mëtejshëm të procesit; pra, asnjë influencë mbi fushën e gazit të Shah Deniz 2, infrastrukturën e transportit nga Azerbajxhani për në Gjeorgji, si dhe infrastrukturën e transportit përgjatë Turqisë.

Në kohën që është marrë Vendimi Përrjashtues për TAP-in, duke patur parasysh edhe kërkesën për shtyrje nga Konsorciumi nëpërmjet TAP-it dhe të miratuar nga tre Autoritetet, Janari i vitit 2020 deri në Dhjetor të vitit 2020, është vlerësuar si periudha kohore kur gazi do të hyjë në sistemin e transportit të TAP-it.

Bordi i Entit Rregullator të Energjisë, në zbatim të Direktivës 2009/73/EC të Parlamentit Europian dhe të Këshillit të Ministrave të datës 13 korrik 2009; Rregullores 715/2009/EC të Parlamentit Europian dhe Këshillit të datës 13 korrik 2009, Ligjit nr.102/2015 “Për Sektorin e Gazit Natyror”; Vendimit të Komisionit Europian C(2013) 2949 të datës 16 Maj 2013; “Opinionit të Përbashkët Përfundimtar të Rregullatorëve të Energjisë “mbi Aplikimin e TAP AG për Përrjashtim (Autoriteti për Energjinë Elektrike dhe Gazin në Itali) AEEGSI, Enti Rregullator i Energjisë Shqipëri (ERE) dhe Autoriteti Rregullator Greqi (RAE), në vijim të Final Joint Opinion; Vendimit të Bordit Nr. 12, datë 14.02.2014 “Për Miratimin e Programit të Përrputhshmërisë Rregullatore/Regulatory Compliance Programme”, paraqitur nga TAP AG në bazë të Opinionit të Përbashkët Përfundimtar/Final Joint Opinion në kuadër të procedurës së përrjashtimit të Gazësjellësit TAP. Kjo ishte një shtesë ose një amendim që u realizua në sajë të një diskutimi të gjatë midis tre Autoriteteve rregullatore të Italisë, Greqisë dhe Shqipërisë, sigurisht që ky diskutim i gjërë është bërë në përrputhje të ndryshimeve të fundit të bëra nga Komisioni Europian në kuadër të transparencës.

2.4 Zhvillime të tjera rreth Projektit TAP

Rreth vendimeve të marra për projektin.

Viti 2018-të ka qënë një vit ku puna për projektin TAP është intensifikuar së tepërmi dhe ku rezultatet kanë qënë konkrete dhe të dukshme. Ne jemi vendi i parë që filluam punimet e TAP-it duke u krahasuar me dy vendet fqinje Italinë dhe Greqinë.

Enti Rregullator i Shqipërisë së bashku me Entin Rregullator të Greqisë dhe Italisë, kanë marrë vendime të përbashkëta në lidhje me projektin TAP-AG.

Këto vendime janë marrë në përrputhje të plotë me Direktivën e Parlamentit Europian dhe të Këshillit, 2009/73/EC, Rregullores (EC) N0.715/2009, të Vendimit të Këshillit Ministrial No.D/2011/02/MC-EnC, si dhe ligjit “Për Gazin Natyror” Nr.102/2015, i cili tashmë ka reflektuar të gjitha kërkesat e Bashkimit Europian.

Aktet nënligjore të miratuara gjatë vitit 2018 për ushtrimin e veprimitarisë në sektorin e Gazit Natyror

Vendimmarrjet e mëposhtme lidhen me miratimin e kuadrit ligjor të ERE-s në funksion të zbatimit të ligjit 102/2015 për sektorin e gazit natyror si dhe përgatitja e kushteve të tregut me fillimin e operimit të gazit në vitin 2020, i cili përkon me startimin e projektit TAP, por, kjo nuk do të pengojë edhe hapjen e tregut të gazit para këtij viti, mbasi jemi duke pritur rezultatete pozitive nga burimet tona të gazit (kemi parasysh rezultatet e SHELL në zonën e Shpiragut).

Aktet nënligjore janë të renditura si më poshtë:

1. “MBI MIRATIMIN E LIÇENCËS TIP TË AKTIVITETIT TË SHPËRNDARJES SË GAZIT NATYROR “ VENDIM Nr. 7, Datë 10.01.2018

Miratimi i liçencave TIP në sektorin e gazit ka qënë ndër prioritetet e detyrave të sektorit të legjislacionit në ERE përgjatë këtij viti. Liçenca e Shpërndarjes së Gazit Natyror është një praktikë e punuar dhe konsultuar gjerësisht me palët e interesit por edhe me subjekte që kanë ekspertizë të duhur për të ndërtuar një akt që do të rezistojë kohës. ERE ka kërkuar komente dhe opinione nga MIE, MFE, Autoriteti i Konkurrencës, Alb gaz sh.a dhe Albpetrol sh.a. Drafti është përcjellë për komente edhe pranë Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë. Rezultoi se mbi këtë draft-liçencë janë shprehur; Autoriteti i Konkurrencës, Sekretariati i Komunitetit të Energjisë, Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Alb gaz sh.a, komentet e të cilave janë pranuar kryesisht dhe përpunuar nga ERE, duke konkluduar në miratimin e kësaj liçence me vendimin e sipërcituar.

2. “ MBI MIRATIMIN E LIÇENCËS TIP TË AKTIVITETIT TË TRANSMETIMIT TË GAZIT NATYROR” VENDIM. Nr. 8, Datë 10.01.2018

Neni 22 pika 1 e Ligjit nr. 102/2015” Për Sektorin e Gazit Natyror “ përcakton së çdo person juridik, që kryen një veprimtari në sektorin e gazit natyror, sipas pikës 2, të këtij neni, duhet të pajiset me liçencën përkatëse, të lëshuar nga ERE, në përputhje me përcaktimet e këtij ligji. • Është ERE që ngarkohet me detyrimin draftimit të liçencës TIP si dhe lëshon këtë liçencë për veprimtarinë e transmetimit të gazit natyror. Edhe kjo praktikë është konsultuar gjerësisht me palë interesi dhe grupe ekspertize.

3. “MBI MIRATIMIN E LIÇENCËS TIP TË AKTIVITETIT TË TREGTIMIT TË GAZIT NATYROR “ VENDIM Nr. 24, Datë 30.01.2018

Në zbatim të parashikimeve të Ligjit nr. 102/2015” *Për Sektorin e Gazit Natyror*”, Bordi i ERE me vendimin nr. 163, datë 12.10.2017, filloi procedurën për miratimin e Liçencës së tregtimit të Gazit Natyror. Në vijim të kësaj vendimmarrje ERE ka vijuar me publikimin me media të njoftimit dhe ka kërkuar komente dhe opinione nga MIE, MFE, Autoriteti i Konkurrencës, Alb gaz sh.a dhe Albpetrol sh.a. Drafti është përcjellë elektronikisht edhe pranë Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë. Mbi këtë draft-liçencë janë shprehur Autoriteti i Konkurrencës, Sekretariati i Komunitetit të Energjisë dhe Ministria e Financave dhe Ekonomisë, surgjerimet e të cilëve janë pranuar kryesisht dhe përpunuar nga ERE në draft -liçencë.

4. “MBI MIRATIMIN E LIÇENCËS TIP NË AKTIVITETIN E FURNIZIMIT TË GAZIT NATYROR” VENDIM Nr. 25, Datë 30.01.2018

Në zbatim të parashikimeve të Ligjit nr. 102/2015” Për Sektorin e Gazit Natyror”, Bordi i ERE me vendimin nr. 162, datë 12.10.2017, filloi procedurën për miratimin e Liçencës së furnizimit të Gazit Natyror. Në vijim të kësaj vendimmarrje ERE ka vijuar me publikimin në media të njoftimit dhe ka kërkuar komente dhe opinione nga MIE, MFE, Autoriteti i Konkurrencës, Albgaz sh.a dhe Albpetrol sh.a. Drafti është përcjellë elektronikisht edhe pranë Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë.

Në përfundim të afatit të marrjes së komenteve dhe opinioneve nga palët rezultoi se mbi këtë draft-liçencë janë shprehur Autoriteti i Konkurrencës, Sekretariati i Komunitetit të Energjisë dhe Ministria e Financave dhe Ekonomisë, komentet e të cilave janë pranuar kryesisht dhe përpunuar nga ERE në draft -liçencë.

5. “PËR MIRATIMIN E “RREGULLORES MBI KUSHTET E PËRGJITHSHME TË SHËRBIMIT TË FURNIZIMIT ME GAZ NATYROR PËR KLIENTËT FUNDORË”. VENDIM NR. 161, DATË 09.07.2018

Neni 16, i Ligjit 102/2015” Për Sektorin e Gazit Natyror” në pikën 10 të tij përcakton si përgjegjësi të ERE-s, “Miratimin e kushteve të përgjithshme të furnizimit, duke përfshirë këtu edhe hartimin në mënyrë transparente të të drejtave dhe detyrimeve kontraktuale të përgjithshme”. ERE ka kërkuar opinionin e të gjitha palëve të treta dhe grupeve të interesit, për draftin e “Rregullore mbi Kushtet e Përgjithshme të Shërbimit të Furnizimit me Gaz Natyror për Klientët Fundorë”. ERE gjithashtu në referencë të nenit 16, pika 25 e Ligjit nr. 102/2015 “Për Sektorin e Gazit Natyror” e ka konsultuar këtë Draft Rregullore dhe me Sekretariatit e Komunitetit të Energjisë. Sekretariati i Komunitetit të Energjisë (ENC) ka paraqitur komentet dhe sygjerimet lidhur me këtë draft rregullore, të cilat janë marrë në konsideratë nga grupi i punës, duke u mbështetur edhe në praktika të tjera të rregulloreve të ngjashme.

Komentet dhe ndërhyrjet e EnC kanë të bëjnë me sigurimin e plotë dhe të duhur, në përputhje me Direktivën 2009/73/EC si dhe me Ligjin Nr. 102/2015 “Për Sektorin e Gazit natyror”.

6.”MBI MIRATIMIN E NDRYSHIMEVE TË PROPOZUARA NGA TAP-AG NË METODOLOGJINË E TARIFAVE TË TAP-AG TË MIRATUAR ME VENDIMIN E ERE-S NR.127 DATË 7/11/2013”. VENDIM NR. 168, DATË 19. 07.2018

Bazuar në autoritetin që i është dhënë dhe në përputhje me përcaktimet e Ligjit nr. 102/2015, “Për Sektorin e Gazit Natyror”, ERE rregullon çështjet që lidhen ndër të tjera me përjashtimin e aksesit të palëve të treta. Rregullimi i çështjeve që lidhen me përjashtimin e aksesit të palëve të treta, bazohet në përcaktimet e: (1) Direktivës 2009/73/EC të Parlamentit Europian dhe të Këshillit të datës 13 korrik 2009 (në tekstin në vijim: Direktiva); (2) Rregullore 713/2009/CE të Parlamentit Europian dhe të Këshillit të datës 13 korrik 2009 (në tekstin e mëtejme : Rregullorja ACER), Rregullore 715/2009/CE të Parlamentit Europian dhe të Këshillit të datës 13 korrik 2009, (4) Rregullore së Parlamentit Europian dhe Komisionit, e datës 11 maj 2016, (Rregullore EU 2016/792), Vendimit Nr 27, datë 01.03.2013, të Bordit të Komisionerëve të ERE, “Për miratimin e

përfashtimit të kushtëzuar të kompanisë TAP – AG prej kërkesave të neneve 9, 32 dhe 41 (6), (8) dhe (10) të Direktivës 2009/73/EC për projektin Trans Adriatik Pipeline”; Vendimit nr. 64, datë 13.06.2013, të Bordit të Komisionerëve të ERE “Për amendimin e Vendimit të Bordit të Komisionerëve të ERE, nr. 27 datë 1.03.2013 “Për miratimin e përfashtimit të kushtëzuar të kompanisë TAP- AG prej kërkesave të neneve 9, 32 dhe 41(6), (8) dhe (10) të Direktivës 2009/73/EC për projektin Trans Adriatik Pipeline”, për marrjen në konsideratë të Opinionit të Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë (nr 1/2013) dhe Vendimit të Komisionit European (C(2013)2949” nëpërmjet miratimit të dokumentit “Opinion i Përfundimtar i Përbashkët i Rregullatorëve të Energjisë mbi Aplikimin e TAP-AG për Përfashtim. Autoriteti për Energjinë Elektrike dhe Gazin (Itali), Enti Rregullator i Energjisë (Shqipëri) dhe Autoriteti Rregullator i Greqisë (Greqi)”/ “Final Joint Opinion of the Energy Regulators on TAP AG’s Exemption Application Autorita per l'Energia Elettrica e il Gas (Italy), Enti Rregullator i Energjisë (Albania) and Regulatory Authority of Greece (Greece)”; Sipas paragrafit 4.2, pika 1 e Final Joint Opinion, dhënia e përfashtimit nga tarifat e rregulluara për produktet forward-flow sanksionohet edhe me plotësimin e disa kushteve të tilla si :

- a. Metodologjia e Tarifave që do të aplikohet nga TAP-AG do jetë subjekt i aprovimit të përbashkët të Autoriteteve;
- b. Tarifat duhet të jetë koherente me parimet e formuluar në Vendimin e Autoriteteve për Përfashtim (Final Joint Opinion), që përfshin ndërmjet të tjerave aplikimin e të njëjtës tarifë për të njëjtin produkt pavarësisht nëse ai është i ofruar prej kapacitetit të përfashtuar nga aksesimi i palëve të treta apo prej kapacitetit jo të përfashtuar;
- c. Metodologjia e tarifave të përbëjë një strukturë tarifore të tipit hyrëse-dalëse/“entry – exit”. Ajo duhet të përmbajë mekanizmat e përcaktimit të çmimeve për llojet e ndryshme të produkteve në drejtimin forward flow që kanë kohëzgjatje të ndryshme, janë të vazhdueshëm ose që mund të ndërpriten dhe në varësi të pikës së hyrjes (entry point) dhe të daljes (exit point).
- d. Tarifa duhet të reflektojë kostot efikase, të jetë transparente dhe jo diskriminuese;
- e. Tarifat duhet të jenë zbritëse në vijim të rritjes së kapaciteteve transportuese që do të përdoren;
- f. Tarifa duhet të konsiderojë nivelin e ndryshëm të riskut të investimit fillestar dhe atë të zgjerimit të mëtejshëm kapacitetit.

Paragrafi 4.2, pika 1 e Final Joint Opinion, i atribuon Autoriteteve edhe detyrën e monitorimit të vazhdueshëm në mënyrë që tarifa e aplikuar nga TAP-AG të jetë në përputhje me metodologjinë e tarifave të miratuara. TAP-AG duhet të bashkëpunojë me Autoritetet për këtë qëllim. Shoqëria TAP AG me letrën e datës 11 Tetor 2013, në kuptim të pikës 4.2, pika 1 të Final Joint Opinon, ka paraqitur pranë ERE një propozim të dokumentit të metodologjisë së tarifave, TAP Tariff Code.

E njëjta kërkesë në të njëjtën kohë dhe e shoqëruar nga i njëjti dokument i është paraqitur për miratim edhe Autoriteteve Rregullatore të Italisë (AEEG) dhe Greqisë (RAE); Në këtë kuadër Enti Rregullator i Energjisë, miratoi Metodologjinë e Tarifave për Gazin me anë të Vendimit Nr. 127, datë 7.11.2013 , “Mbi miratimin e Metodologjisë së Tarifave (TAP Tariff Code), të propozuar nga TAP-AG, sipas detyrimeve të përcaktuara në “Opinionin e Përbashkët Përfundimtar/Final Joint Opinion”.

Në fillim të muajit Nëntor 2013, Autoritetet miratuan, me vendime të veçanta, Kodin e Tarifave të TAP (TAP Tariff Code). (Vendimin e AEEG 495/2013/R/gas, datë 6/11/2013, vendimin e RAE 531/2013 datë 6/11/2013, Vendimin e ERE nr. 127 datë 7/11/2013). Kodi i miratuar i Tarifave të TAP përfshin pikën e mëposhtme: “Transportuesi duhet të marrë miratimin e rregullatorit para se të miratojë ndryshimet tek Kodi i Tarifave të TAP si kërkohet nga Neni 4.2.1 i Opinionit të Përbashkët.”

Në datë 22 Qershor 2018, TAP AG u dërgoi një letër Autoriteteve ku u kërkonte disa ndryshime tek Kodi i Tarifave të TAP, tek formula që synon përshkallëzimin e të ardhurave (§2.1), indeksi MUICP (Indeksi i Bashkimit Monetar për Çmimet e Konsumatorëve) si përcaktohet në Rregulloren e Këshillit (EC) Nr 2494/95 datë 23 Tetor 1995 është zëvendësuar me HICP (Indekset e Harmonizuara të Çmimeve të Konsumatorëve) si përcaktohen në Rregulloren (EU) 2016/792 të Parlamentit Europian dhe të Këshillit datë 11 Maj 2016 mbi indekset e harmonizuara të çmimeve të konsumatorëve dhe indeksin e çmimit të banesave, siç përcaktohet nga Eurostat.

Ndryshimi parashikon shtrirjen e periudhës së rishpërndarjes me fundin e çdo viti për të mundësuar llogaritjen përfundimtare të të ardhurave shtesë krahasuar me të Ardhurat e Pritshme të vitit. TAP AG u konsultua me transportuesit/tregtarët egzistues që kanë nënshkruar Gas Transportation Agreements, dhe paraqiti rezultatin e tyre pozitiv, të dokumentuar për Autoritetet nga TAP AG; (Lidhja/Ankesi C), Duke konsideruar se: - ndryshimet e propozuara janë në përputhje me parimet e përmendura tek Opinioni Përfundimtar i Përbashkët dhe veçanërisht të përmbledhura në pikat nga a tek f; - në veçanti ato kanë për qëllim të përmirësojnë saktësinë dhe transparencën e metodologjisë së tarifave dhe nuk paraqesin pengesa të panevojshme për procesin e parashikuar të rezervimit afatshkurtër të kapacitetit; - Aprovimi i këtyre ndryshimeve në Kodin e Tarifave është konsultuar me rregullatorët e Greqisë dhe Italisë, përkatësisht RAE dhe ARERA.

7. “MBI MIRATIMIN E “KËRKESAVE MINIMALE PËR ZYRTARIN E PËRPUTHSHMËRISË, KRITERET PROFESIONALE SI DHE KRITERET E TJERA PËRZGJEDHËSE” DHE MIRATIMIN PARAPRAK TË ZYRTARIT TË PËRPUTHSHMËRISË SË OST TË GAZIT NATYROR”. VENDIM NR. 223, DATË 16.10.2018

Bordi i ERE me vendimin nr. 179, datë 08.11.2017, ka certifikuar “Operatorin e Kombinuar të Gazit Natyror” ALBGZ sh.a.. Bordi i ERE me Vendimin nr. 207, datë 27.09.2018 filloi procedurën për shqyrtimin e kërkesës së shoqërisë “ALBGZ” sh.a. mbi miratimin paraprak të Zyrtarit të Përputhshmërisë së OST të Gazit Natyror. Në vijim të kësaj vendimmarrje, ERE ka përcjellë kërkesën për opinion pranë MIE dhe Autoritetit të Konkurrencës, për dijeni “Albgaz” sh.a., me anë të së cilës ka ftuar institucionet sipërpërmendur të shprehin opinionet apo komentet e tyre mbi këtë vendimmarrje.

ERE i është drejtuar shoqërisë “ALBGZ” sh.a. dhe MIE duke i bërë me dije vendimin e ERE për fillimin e procedurës dhe i ka kërkuar të paraqesë për miratim në ERE, “Kërkesat minimale për Zyrtarin e Përputhshmërisë, kriteret profesionale si dhe kriteret e tjera përzgjedhëse”, sipas detyrimit që buron nga Programi i Përputhshmërisë së Operatorit të Sistemit të Transmetimit për Gazin Natyror të miratuar nga me Vendimin e Bordit të ERE-s nr. 77, datë 26.05.2017.

Sa më sipër Shoqëria “Albgaz” sh.a. ka përcjellë për miratim “Kërkesat minimale për Zyrтарin e Përputhshmërisë, kriteret profesionale si dhe kriteret e tjera përzgjedhëse”, ERE ka kompetencë të miratojë Programin e Përputhshmërisë të propozuar nga OST e Gazit Natyror, në bazë të nenit 47, pika 1 të Ligjit nr. 102/2015 “Për Sektorin e Gazit Natyror”. OST e gazit natyror, nëpërmjet organeve të saj drejtuese ka të drejtë të miratojë Zyrтарin e Përputhshmërisë, pas miratimit paraprak nga ERE, në bazë të nenit 47, pika 2 të Ligjit nr. 102/2015 “Për Sektorin e Gazit Natyror”.

ERE ka kompetencën për të miratuar kriteret dhe detyrat për pozicionin e Zyrтарit të Përputhshmërisë, në bazë të nenit 47, pika 3 të Ligjit nr. 102/2015 “Për Sektorin e Gazit Natyror”. Kushtet e kontratës së zyrтарit të pajtueshmërisë janë në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe vendimmarrjet e ERE-s, në lidhje me operatorin e sistemit të transmetimit të gazit natyror. Kontrata e zyrтарit të pajtueshmërisë ka listuar kushtet që duhet të përmbushë zyrтарit i pajtueshmërisë dhe që nënshkruhen pas miratimit në ERE të Zyrтарit të Përputhshmërisë.

8. “PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN E BORDIT TË ERE-S, NR. 179, DATË 08.11.2017, “MBI CERTIFIKIMIN E SHOQËRISË “OPERATORI I KOMBINUAR I GAZIT NATYROR” ALBGAS SH.A”. VENDIM Nr. 236, Datë 02.11.2018

Bordi i ERE me vendimin nr. 179, datë 08.11.2017, certifikoi shoqërinë “Albgaz” sh.a si Operator i kombinuar i gazit natyror, në përputhje me nenet 37, 50, 59, 68, dhe 80 të Ligjit nr. 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror” dhe nenin 9, pika 6, të Direktivës 73/2009 EC. Shoqëria “Albgaz” sh.a nuk ka përmbushur kërkesat e vendimit sipërcituar si vijon:

Pika 2. Brenda 1 muaji nga hyrja në fuqi e këtij vendimi Albgaz sh.a të zëvendësojë përfaqësuesit e MIE tek Këshilli Mbikqyrës i kompanisë me antarë të cilët nuk janë të punësuar tek MIE ose tek kompanitë e prodhimit dhe/ose furnizimit të energjisë elektrike që kontrollohen nga ajo.

Pika 3. Albgaz të raportojë çdo muaj në ERE procedurën për rregjistrimin e aseteve të transmetimit dhe t’a përfundojë procedurën brenda gjashtë muajve pas miratimit të Vendimit Përfundimtar.

Pika 4. Paragrafi “ si dhe duhet që të hartojë dhe t’i dorëzojë ERE-s, Raportin e përcaktuar sipas Programit të Përputhshmërisë rregullatore jo më vonë se 12 muaj nga miratimi i Vendimit të Certifikimit të Albgaz sh.a., konform përcaktimeve të nenit 21 të Direktivës nr.73/2009 të Komisionit Europian, “Mbi Rregullat për Tregun e Gazit Natyror” dhe nenit 47 të ligjit nr. 102/2015, “Për Sektorin e Gazit Natyror”.

Pika 5. Brenda 12 muajve nga hyrja në fuqi e këtij vendimi, për qëllime të implementimit të rekomandimeve në Opinionin e Sekretariatit, Albgaz sh.a., të paraqesë në ERE dëshmi që tregon garancinë në lidhje me: 5.2 Bashkëpunimin ndërinstitucional për realizimin e ndryshimeve në kuadrin ligjor, Neni 11 dhe 46 (10) i Ligjit për Sektorin e Gazit Natyror dhe transferimi i kompetencave tek Ministria e Ekonomisë.

Për përmbushjen e këtij detyrimit, Albgaz sh.a. do të paraqesë ERE provat dokumentare që ndryshimet ligjore dhe nënligjore të nevojshme që lidhen me transferimin e kompetencave të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë tek aksioneri i Albgaz sh.a., Ministria e Ekonomisë dhe Financave, kanë ndodhur janë efektive. Pika 7. Albgaz sh.a., do të raportojë çdo 3 muaj tek ERE

dhe Sekretariati i Komunitetit të Energjisë në lidhje me përmbushjen e detyrimeve të pikave 2, 3, 4 dhe 5 të këtij vendimi si dhe me ecurinë e procesit të transferimit të kompetencave nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë tek Ministria e Ekonomisë dhe Financave.

Në vijim të sa më sipër, shoqëria Albgaz sh.a në pamundësi për të plotësuar kushtet e vendosura në vendimin ERE-s nr. 179, datë 08.11.2017, me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 233/7 Prot., datë 16.10.2018, ka kërkuar shtyrjen e afatit të plotësimit të kushteve të parashikuara në vendimin nr. 179, datë 08.11.2017 deri në datën 10.04.2019 dhe bëri me dije se po merr të gjitha masat e nevojshme për plotësimin e pikave të kërkuara në këtë vendim. Albgaz sh.a argumenton se shkak për mosplotësimin në kohë të kushteve të sipërpërmendura janë vonesat administrative nga institucionet e tjera si ZRPP, MIE etj.

2.5 Metodologjia e Tarifave të Gazit Natyror për TAP AG

Enti Rregullator i Energjisë miratoi Metodologjinë e Tarifave për Gazin me anë të Vendimit Nr. 127, datë 7.11.2013, “Mbi miratimin e Metodologjisë së Tarifave (TAP Tariff Code), të propozuar nga TAP AG, sipas detyrimeve të përcaktuara në “Opinionin e Përbashkët Përfundimtar/Final Joint Opinion”.

Në datën 8 Nëntor 2013, tre Rregullatorët e Shqipërisë (ERE), Greqisë (RAE) dhe Italisë (Aeeg) aprovuan Kodin e Tarifave të propozuar nga Shoqëria TAP AG për TAP, tubacionin e gazit që do të sjellë gazin e Azerbajxhanit në Itali, nëpërmjet Greqisë dhe Shqipërisë.

Kodi i Tarifave për TAP përshkruan metodologjitë e përdorura për përcaktimin e termave dhe kushteve të çmimeve që do të aplikohen për TAP do të aplikohen si për kapacitetet subjekt i aksesit të detyrueshëm të palëve të treta, edhe për kapacitetet e përjashtuara nga këto kërkesa.

Metodologjia e tarifave e propozuar nga TAP AG është transparente dhe jo diskriminuese. Kodi i Tarifave parashikon një zvogëlim të tarifës në rast të rritjes së kapacitetit të rezervuar në të ardhmen. Nga ana tjetër, në përputhje me Opinionin Final të Përbashkët, struktura e tarifave merr në konsideratë nivelin e ndryshëm të riskut ndërmjet investimit në kapacitetin fillestar dhe investimit për zgjerim në të ardhmen.

Metodologjia e Tarifave ka pësuar një sërë ndryshimesh që prej versionit të saj fillestar në sajë të komenteve të bëra prej të tre Rregullatorëve në mënyrë që dokumenti të reflektojë parimet bazë të përmendura në Final Joint Opinion. Versioni përfundimtar i metodologjisë së Tarifave është paraqitur në ERE për miratim në datën 14 tetor 2013.

Në datë 22 Qershor 2018, TAP AG u dërgoi një letër Autoriteteve ku u kërkonte disa ndryshime tek Kodi i Tarifave të TAP, tek formula që synon përshkallëzimin e të ardhurave (§2.1), indeksi MUICP (Indeksi i Bashkimit Monetar për Çmimet e Konsumatorëve) si përcaktohet në Rregulloren e Këshillit (EC) Nr 2494/95 datë 23 Tetor 1995 është zëvendësuar me HICP (Indekset e Harmonizuara të Çmimeve të Konsumatorëve) si përcaktohen në Rregulloren (EU) 2016/792 të Parlamentit Europian dhe të Këshillit datë 11 Maj 2016 mbi indekset e harmonizuara të çmimeve të konsumatorëve dhe indeksin e çmimit të banesave, siç përcaktohet nga Eurostat.

Në përmbajtjen e kësaj metodologjie zbatohen kërkesat themelore të përcaktuara në Opinionin e Përbashkët në lidhje me tarifën; reflektimi në tarifë i kostove efikase, që ato të jenë transparente dhe jo diskriminuese; mekanizmi që tarifën të jenë zbritëse në vijim të rritjes së kapaciteteve transportuese që do të përdoren; marrja në konsideratë e nivelit të ndryshëm të riskut të investimit fillestar dhe zgjerimit të mëtejshëm; tarifa të njëjta për të njëjtin produkt pavarësisht nëse ai është i ofruar prej kapacitetit të përjashtuar nga aksesit i palëve të treta apo prej kapacitetit jo të përjashtuar.

2.6 Metodologjia e Tarifave të Gazit Natyror për Albagaz (OST/OSHT)

Me miratimin e ligjit Nr.102/2015 “Për Gazin Natyror” nga ana e ministrisë së linjës u propozua në qeveri “Modeli i Tregut të Gazit Natyror” dhe më pas ERE vazhdojë me miratimin e “Metodologjisë së Tarifave të Gazit Natyror”. Aktualisht ne kemi miratuar “Metodologjinë e Tarifave të Gazit” me kompaninë Becker Buttner Held (bbh), e cila është një kompani e specializuar në këtë fushë. Jemi në periudhën e rishikimit të kësaj metodologjie me kompaninë ECA të zgjedhur nga BERZH së bashku me Albagaz për përmirësimin e kësaj metodologjie në kushtet konkrete të tregut të gazit natyror në vëndin tonë.

2.7 Kodi i Rrjetit të TAP AG dhe Kodi i Rrjetit të Albagaz

Enti Rregullator i Energjisë është duke punuar së bashku me TAP AG, Baringa Partners një kompani Angleze e specializuar për problemet e gazit, si dhe përfaqësuesit e autoriteteve të rregullatorit të Italisë dhe Greqisë, për përfundimin sa më shpejtë të jetë e mundur të Kodit të Rrjetit (Network Code).

Është shumë e rëndësishme edhe hartimi i Kodit të Rrjetit të Albagaz-it, sepse i paraprin proceseve të fillimit të operacioneve të TAP AG në vëndin tonë. Me kodin e rrjetit kombëtar po merret BERZH e cila ka zgjedhur një kompani të specializuar Angleze ECA. Bashkëpunimi i Albagaz, ERE dhe ECA është shumë i mirë dhe ecuria e punimeve është jashtëzakonisht e shpejtë.

Duhet të theksoj se kodi i rrjetit si i TAP AG ashtu edhe i Albagaz, është një punë voluminoze dhe shumë specifike për kushtet në të cilën ndodhemi. Në përbërje të tyre përfshihen:

Kapitujt e Kapaciteteve të prodhimit, Kapaciteteve të bukingut, nominimet, balancimet dhe alokimet, menaxhimi i konxheksioneve, tregu sekondar, konsumi vetjak i gazit dhe konsumi për prodhim energji elektrike, humbjet e gazit, sistemi i matjes, mirëmbajtja, kuadri rregullator dhe dispozitat e ndryshme për penalitetet.

2.8 Zhvillime për ALBGAZ gjatë vitit 2018

Me vendimin e Qeverisë në **Dhjetor 2016** për krijimin e shoqërisë “Albagaz sh.a” dhe themelimin në praktikë të saj, me kapital 100% shtetëror, u kalua në një hap të rëndësishëm për fillimin e përgatitjes për tregun e gazit në vëndin tonë.

Në veçanti gjatë vitit 2018, “Albagaz” ka ushtruar aktivitet intensiv në disa aspekte të zhvillimit të tregut dhe konkretisht:

Në sektorin e brendshëm;

- Identifikimin e asetëve ekzistuese në territorin ku shtrin aktivitetin Albgaz;
- Bashkëpunim me ERE për përditësimin e :
 - ✓ "Kodit të Rrjetit për harmonizimin e strukturave tarifore të transmetimit të gazit natyror "
 - ✓ "Kodit të Rrjetit për mekanizmat e ndarjes së kapaciteteve në sistemet e transmetimit të gazit natyror "
 - ✓ Kodit mbi Harmonizimin e strukturave Tarifore.

Të gjitha këto janë kryer në bashkëpunim me Komitetin e Energjisë në Vienë me vendimet përkatëse nr.2018106/PHLG-EnC dhe 2018107/PHLG-EnC, si dhe në zbatim të rregullores së Komisionit (BE) 2017/460 16 Mars 2017, mbi themelimin e kodit të rrjetit që harmonizon strukturat tarifore të transmetimit të gazit versioni i përshtatur sipas Nenit 24 të Traktatit të Komunitetit të Energjisë për t'u përafuar nga Grupi i të nivelit të lartë.

- Janë duke bashkëpunuar me ECA, dhe BERZH për **Kodin e Rrjetit të Transmetimit të Albgaz**;
- Bashkëpunimin institucional me ERE për aspekte të certifikimit dhe licencimit dhe vetë kodeve të mësipërm;
- Licencimin si **“Operator i Kombinuar Gazit Natyror”**, pra edhe për Transmetimin (TSO level) dhe për Shpërndarjen (DSO level);
- Ristrukturimin e vetë shoqërisë;
- Zhvillimin e **kapaciteteve dhe burimeve njerëzore** në të gjitha drejtimet (relativisht komplekse për shkak të një kuadri rregulltor po kaq kompleks) të sektorit (...projektim, administrim asetesh, menaxhimi tregëtar, etj);
- Fillimin e **Analizës Tekniko-Financiare** për realizimin e një “projektit pilot” të LNG në “shkallë të vogël” (small scale) në zonën industriale Tiranë-Durrës, me qëllim zhvillimin në kohë të tregut, marketimit të gazit natyror si burim alternativ ekonomik energjie;
- Ndjekjen e projektit të parë të rëndësishëm të transmetimit për Albgaz (PIP1) siç është **Gazsjellësi FIER-VLORE** që do të furnizojë **TEC-in e Vlorës** me gaz.

Në sektorin e jashtëm;

- Negocimet për zgjedhjen e partnerit strategjik për mirëmbajtjen e **TAP**, një proces tashmë i përfunduar: **SNAM** spa, Milano, Itali. SNAM është partneri i Albgaz në shoqërinë e përbashkët **Albanian Gas Services Company sha** (shkurt AGS), ku Albgaz kontrollon 75% të aksioneve. AGS do të punësojë rreth 52 vetë, nga të cilët vetëm 5-6 në pozicione drejtuese nga SNAM dhe e gjithë pjesa tjetër është staf shqiptar. Këto të fundit po trajtohen në Shqipëri dhe Itali.
- Negocimet e kontratës së **Mirëmbajtjes së TAP** midis AGS dhe TAP, e cila është nënshkruar në dhjetor të 2018. Kontrata e nënshkruar për pesë (5) vjet vlerësohet në rendin e 18-20 milionë Euro.
- Forcimin e bashkëpunimit institucional me **Komitetin e Energjisë** në kuadër të **WBIF** (Western Balkans Investment Framework) dhe në kuadër të marrëdhënieve rregullatore me ERE dhe ENTSO-G, ku Albgaz është vëzhgues në këtë të fundit.

- Kontaktet e para për konfigurimin e marrëdhënieve me **Homologët në rajon** dhe më gjërë për të shkëmbyer eksperiencë në analizë, projektim dhe implementim të rrjeteve të gazit, qoftë në transmetim (**TSO level**) qoftë në shpërndarje (**DSO level**);
- Ndjekjen insitucionale të të gjitha përpjekjeve që po bëhen për analizën dhe fizibilitetin e gazsjellësit **IAP**, që do të interkonektojë **Shqipërinë, Malin e Zi, Bosnje & Hercegovinën dhe Kroacinë**;
- Ndjekjen dhe koordinimin e punës për zhvillimin e interkoneksionit me Kosovën (**ALKOGAP**). Gjatë vitit 2019 priten edhe rezultatet e një studimi paraprak fizibiliteti.

Qeveria ka aprovuar tashmë që në 2016-n **Master Planin për Zhvillimin e Tregut të Gazit Natyror (MZGN)** në Shqipëri, një projekt i financuar nga Organizma Europiane dhe që vlerëson potencialet e zhvillimit të Sektorit të Gazit Natyror në “territor, në kohë (20 vitet e ardhshme), në teknologji dhe në konsiderata financiare”.

Kalimi i gazit nëpër Shqipëri lejon që në vend të kemi disa zhvillime të rëndësishme energjetike, në linjë me ato të këtij sektori në industrinë globale, si: (i) zhvillimin e prodhuesve të mëdhenj të energjisë ose **TEC-eve me gaz**, si version më i “pastër” në shfrytëzimin e hidrokarbureve për prodhim energjie, (ii) furnizimin e **konsumatorëve industrialë**, duke mundësuar uljen e kostos së tyre të prodhimit, por edhe (iii) furnizimin e **konsumatorëve rezidencialë**:

- Kështu, një nga zhvillimet e para të sektorit do të jetë linja e gazsjellësit **Fier-Vlorë**, me një qëllim të dyfishtë, furnizimin me gaz të **TEC-it të Vlorës** dhe zhvillimin e **rrjetit të distribucionit në qytetin e Vlorës** në mbështetje të industrisë, bizneseve lokale dhe gjithashtu tregut rezidencial.
- **Qarku i Fierit** është gjithashtu në zhvillim paralel nga prania e TAP në vend. Afërsia me tubacionin e TAP, përqëndrimi i disa **industrive konsumatore tradicionale të gazit**, kultura praktike edhe familjare e përdorimit të gazit për shkaqe historike, e bën shumë të mundshme zhvillimin e tregut industrial e rezidencial në këtë qytet.
- **Qarku i Korçës**, pritet të jetë pjesë e zhvillimeve të tregut të gazit natyror në vend duke konsideruar kalimin e gazsjellësit të TAP nëpër territorin e e tij, si edhe të zhvillimeve në burime shtesë energjetike, sic është **TEC i Korçës**.
- Por ndërsa objektivat afatshkurtra të zhvillimit të sektorit janë këto si më sipër, ato afatmesme përfshijnë objektiva edhe më impenjuese, si në financim ashtu edhe në volume pune, kështu :




Figure 56 Master Plan

- **Perspektiva e Zhvillimit të Rrejtit të Gazit Natyror në Shqipëri (Gas Master Plan).**
 - Lidhja e zonës më të zhvilluar ekonomike të Shqipërisë **Tiranë-Durrës** si dhe ajo e **Elbasanit**, për shkak të konsumatorëve të mëdhej industrial të energjisë që shtrihen në qytet dhe rrethinat e tij.
 - Lidhja me Elbasanin është interesante edhe për një aspekt tjetër, që ka të bëjë me **zhvillimin potencial të depozitimeve nëntokësore të gazit (Dumre)**, për të krijuar rezerva të domosdoshme si për mirëshfrytëzimin e asetëve transmetuese që do të ndërtohen në vënd (nivel OST), por edhe për të garantuar një lloj sigurie dhe stabiliteti në furnizimin me gaz të tregut dhe operatorëve të tij në nivel fundor. Në këtë kuadër hapësirat nëntokësore të Dumresë marrin një perspektivë totalisht tjetër.
 - Zhvillimi afatmesëm i rrjetit të transmetimit në Shqipëri nga Albgaz do të mundësojë edhe **transmetimin e gazit që eventualisht mund të prodhohet në Shqipëri**, qoftë nga aktivitete si ato të **SHELL-it** në zonën e Beratit, apo aktivitete të tjera gaz-zbuluese dhe në veçanti gaz-prodhuese në jug të Shqipërisë (Delvinë, Jon, etj).

Duke mos e patur të zhvilluar këtë sektor, Shqipëria nuk ka ekspertizë lokale në kapacitete njerëzore. Në këtë kuadër Albgaz po përfshihet në disa aktivitete që zhvillojnë këto kapacitete duke u nisur nga gjëndja aktuale.

Kështu krijimi i shoqërisë Joint-Venture “AGS” sha midis Albgaz sha dhe SNAM spa (Itali) në kuadër të mirëmbajtjes së rrjetit të TAP në territorin e Republikës së Shqipërisë, bën të mundur që **stafi i përzgjedhur shqiptar (në proces e sipër) të trajnohet dhe të certifikohet me standartet evropiane të sektorit**, në shkollat kualifikuese të SNAM. SNAM është një nga aksioinerët e TAP me 20%, është mirëmbajtësi i TAP në territorin Italian, është një kompani me mbi 70 vjet eksperiencë dhe praktikisht operatori më i madh në Evropë, me afro 42,000 Km tubacion nën kontrollin e vet. Asocimi i Albgaz në kuadër të AGS me SNAM është **një nga shembujt më të mirë të përpjekjeve reale për ngritjen e kapaciteteve të sektorit** dhe përgatitjen e zhvillimeve kapitale të tij në vënd.

2.9 Bashkëpunimi me BERZH

Në bashkëpunim me **BERZH** (Banka Europiane për Rindërtim dhe Zhvillim) Albgaz po punon për **trajnimin e specializuar** të stafit të vet në drejtim të: përfundimit të kodit të rrjetit, metodologjisë së llogaritjes së tarifave, koncepteve komerciale vendore dhe ndërkufitare, në balancimin e gazit natyror, alokimit të kapaciteteve si dhe operimit të sistemit të rrjetit, etj. Të gjithë këto elemente janë njohuri bazë themelore për krijimin e një **OST apo “Operatori të Sistemit të Transmetimit”**, i cili në fakt përbën edhe aktivitetin kryesor të Albgaz.

Përfitimet e gjithë kësaj politike zhvillimi, me hapat e saj të parë si më sipër, përgjatë edhe plotësimin të kuadrit të plot ligjor (ligje dhe akte nënligjore) **në bashkëpunim me MIE, ERE dhe me Organizma dhe Instrumenta Europiane** që mbulojnë sektorin e gazit (siç është plotësimi i kuadrit përkatës në ERE dhe përafrimi me legjislacionin evropian, në kuadër edhe të angazhimeve që i dalin Shqipërisë në procesin e saj të integritimit, etj) pritet të krijojnë mundësi reale, siguri dhe transparencë për të patur zhvillime kapitale në sektorin e gazit në Shqipëri.

Theksojmë se ky është një proces kompleks, i shtrirë në kohë, sepse aktivitete të tilla janë shumë intensive në “investime kapitale”, si në volume projektimi dhe financimi, ashtu dhe në shtrirje kohore, por rezultati final i tyre i pritshëm dhe gradual është:

1. Krijimi i kushteve për përfundimin e investimeve të huaja direkte në këtë segment të ekonomisë;
2. Rritja e punësimit në sektor dhe në industritë që kanë impakt prej sektorit të gazit;
3. Përmirësimi i furnizimit me energji në nivel industrial, shërbimesh dhe rezidencial;
4. Krijimi i kushteve për zhvillim të qëndrueshëm industrial dhe ulje kostosh energjetike në nivel prodhimi “mallrash dhe shërbimesh”;
5. Ulje në përgjithësi e “faturës energjetike” të konsumatorit familjar fundor;
6. Krijimi i kapaciteteve njerëzore në vend në drejtim të para-projektimit, projektimit, menaxhimit të investimeve duke rezultuar në zbatimin efektiv dhe eficient të aktiviteteve përkatëse në industrinë e gazit.

2.10 Bashkëpunimi me Institucionet Ndërkombëtare

Enti Rregullator i Energjisë ka një bashkëpunim të ngushtë me të gjitha Organizatat dhe institucionet ndërkombëtare të cilat kanë të bëjnë me Elektricitetin dhe Gazin Natyror.

Ne jemi anëtarë në SOUTH SOUTH-EAST GAS REGIONAL INITIATIVE(GRI SSE), për studime të përbashkëta në lidhje me tregun e gazit. Aktualisht.

Në kuadër të bashkëpunimit shumë-palësh mes Enteve Rregullatore pjesëmarrëse të MEDREG (Shoqata e Rregullatorëve të Mesdheut) ERE është shumë aktive.

Në planin e veprimeve (Action Plans) për periudhën 2016-2018 në Working Group on Gaz, Z. Maksim Shuli ka drejtuar studimin : “Gas infrastructure map of the Mediterranean” si dhe studimin “Contribution to the setting up of an operational platform for the exchange of information and data on Mediterranean Gas Market”. Gjithashtu, ai është pjesëmarrës në të gjitha studimet e tjera të përbashkëta që janë në planin e veprimeve afat mesëm dhe afat gjatë. <http://www.medreg-regulators.org>

PJESA III: Aktiviteti i Entit Rregullator të Energjisë

3.1 Mbi realizimin e detyrave të ERE-s për vitin 2018. (Rezoluta e Kuvendit)

Në kuadër të zbatimit të detyrave që i ngarkon Ligji nr. 43/2015, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”; Ligji nr. 102/2015, “Për Sektorin e Gazit Natyror” si dhe Ligji nr. 7/2017, “Për rritjen e prodhimit të energjisë nga burimet e rinovueshme” si dhe detyrat që rrjedhin nga rezoluta e Kuvendit të Shqipërisë, ERE ka organizuar punën dhe mobilizimin e stafit për të arritur përmbushjen e të gjitha detyrave të ngarkuara. Në analizë të detyrave rezulton sa vijon:

Në lidhje me rikuperimin e vonesave të krijuara dhe bërjen efektive të ndarjes ligjore dhe funksionale të Operatorit të Shpërndarjes së Energjisë Elektrike nga ai i Furnizimit të Shërbimit Universal sh.a., Furnizuesi i Tregut të Lirë sh.a. dhe Operatori i Sistemit të Shpërndarjes sh.a., bëjmë me dije se:

Në kuadër të reformës në sektorin e Energjisë Elektrike dhe në zbatim të; (i) Ligjit Nr. 43/2015, “Për sektorin e Energjisë Elektrike”, i ndryshuar me atë nr. 7/2018 “Për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin nr. 43/2015, “Për sektorin e Energjisë Elektrike”, (ii) VKM Nr. 519, datë 13.07.2016, “Për miratimin e Modelit të Tregut të Energjisë Elektrike”, si dhe (iii) Urdhrit Nr. 157, datë 12.02.2018, mbi “Krijimin e tre shoqërive të kontrolluara nga Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike”, me qëllim fillimin e çuarjen përpara të procesit të ndarjes, OSHEE sh.a. ka themeluar tre shoqëri si më poshtë:

“Operatori i Sistemit të Shpërndarjes” sh.a. (OSSH sh.a.), “Furnizuesi i Shërbimit Universal” sh.a. (FSHU sh.a.) dhe “Furnizuesi i Tregut të Lirë” sh.a. (FTL sh.a.).

Më tej në zbatim të detyrimeve ligjore, me anë të shkresës Nr. 7818, datë 27.04.2018 “OSHEE” sh.a., ka përcjellë pranë ERE-s dokumentacionin për transferimin/licencimin e shoqërive të kontrolluara FSHU sh.a., FTL sh.a., dhe OSSH sh.a..

Në zbatim të parashikimit të nenit 17, pika 7, Vendimi Nr. 109, datë 29.06.2016 të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, ERE mori vendimet si më poshtë:

Vendimi Nr. 198, datë 03.09.2018, i Bordit të Entit Rregullator të Energjisë “Mbi licencimin e shoqërisë “Furnizuesi i Tregut të Lirë” sh.a., (FTL sh.a.) në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike” Seria: T18, Nr. 422, me afat 5 vjeçar.

Vendimi Nr. 199, datë 03.09.2018, i Bordit të Entit Rregullator të Energjisë “Mbi licencimin e shoqërisë “Furnizuesi i Tregut të Lirë” sh.a., (FTL sh.a.) në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike” Seria: F18, Nr. 423, me afat 5 vjeçar.

Vendimi Nr. 215, datë 11.10.2018, i Bordit të Entit Rregullator të Energjisë “Mbi transferimin e licencës së furnizimit energjisë elektrike me nr. 251, me Seri P14FPP, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s Nr. 97, datë 27.10.2014, e vlefshme deri më datë 27.10.2019 dhe detyrimit të shërbimit universal të furnizimit të energjisë elektrike, të shoqërisë Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike sh.a (OSHEE sh.a.), miratuar me Vendimin e Bordit të ERE-s Nr. 112, datë 08.07.2016, tek shoqëria “Furnizuesi i Shërbimit Universal” sh.a (FSHU sh.a.)”.

Vendimi Nr. 216, datë 11.10.2018, i Bordit të Entit Rregullator të Energjisë “Mbi transferimin e licencës për operimin e sistemit të shpërndarjes së energjisë elektrike, të shoqërisë Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike sh.a. (OSHEE sh.a.), me nr. 250, Seria P14SH, miratuar me Vendimin e Bordit të ERE-s, nr. 96 datë 27.10.2014, tek shoqëria "Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike sh.a. (OSHEE sh.a.), e vlefshme deri me datë 27.10.2044.”

ERE vendosi sa sipërcituar, duke marrë në konsideratë edhe Urdhrin e Asamblesë së Përgjithshme të OSHEE sh.a. me nr. 157 Prot, datë 12.02.2018, me anë të të cilit kjo e fundit, nxorri Urdhrin e Brendshëm Nr. 7224 Prot, datë 20.04.2018 “*Mbi ngritjen e grupit të punës për koordinimin e procesit të transferimit të licencave nga shoqëria “OSHEE” sh.a.*” apo dhënien e licencës për shoqëritë e themeluara nga shoqëria “OSHEE” sh.a..

OSHEE sh.a. dhe tre shoqëritë e krijuara prej saj, panë të nevojshëm krijimin e një kuadri të qartë të përcaktuar përmes akteve ligjore përkatëse në lidhje me strukturën e plotë të funksionimit të Tregut të Energjisë Elektrike.

Përcaktimi sa më lart, do t’u krijonte mundësinë tre shoqërive të kontrolluara për; (i) përcaktimin e saktë të strukturave organizative dhe proceseve të menaxhimit të portofolit të Energjisë Elektrike në përputhje me funksionet dhe veprimtaritë që do të mbulojë çdo operator, që pritet të jetë i referuar te Modeli i ri i Tregut të Energjisë Elektrike që do të përcaktohet/ndryshohet, si dhe miratimi i tyre pranë strukturave vendimmarrëse të OSHEE sh.a.; (ii) Vijimin e hartimit të buxheteve përkatëse për çdo shoqëri; (iii) Aplikimin në ERE i tarifave për secilin operator, duke bërë të mundur reflektimin e të ardhurave të kërkuara për të mbështetur buxhetet e miratuara, apo përmbushjen e detyrimeve të tjera të cilat janë thelbësore për sigurimin e cilësisë së shërbimit të shpërndarjes dhe sigurimin e furnizimit të pandërprerë me energji elektrike.

Në këtë aspekt, referuar garantimit të furnizimit dhe cilësisë së shërbimit, OSHEE sh.a. vërejti që tre ishin elementet për të cilat kërkohej qartësi për detyrimet dhe të drejtat që lindin për Operatorin e Sistemit të Shpërndarjes të Energjisë Elektrike, nga;

- a. kërkesat për rregulloren e cilësisë;
- b. kërkesat për akses në rrjetin e shpërndarjes të burimeve gjeneruese;
- c. sigurimi i aksesit për përdoruesit.

Te tre kërkesat e sipërpërmendura janë të përcaktuara në rregulloren e cilësisë së shërbimit të shpërndarjes, për të cilat OSHEE sh.a. ka aplikuar në ERE lidhur me shtyrjen e afateve dhe kërkesës në mënyrë të përshkallëzuar të kritereve standarde të performancës për zona të ndryshme, bazuar në rivlerësimin e performancës në këto zona gjatë periudhës tranzitore dhe situatës së sektorit të shpërndarjes së energjisë elektrike.

Më tej, një pjesë e efekteve e rëndësishme në cilësinë e shërbimit të shpërndarjes, rrjedh nga lidhja e burimeve gjeneruese në rrjetin shpërndarjes. Në këto zona, rrjeti shpërndarjes është i paplanifikuar për të injektuar energji elektrike nga burime të tjera alternative.

Në bashkëpunim me konsulentët e saj, OSHEE sh.a. propozoi disa ndryshime nënligjore, duke referuar në një model tregu, i cili mund të konsiderohet si një model optimal jo vetëm për OSHEE sh.a., por edhe për operatorët e tjerë të sektorit të energjisë elektrike me qëllimin primar arritjen e qëndrueshmërisë së sektorit dhe daljen nga vështirësitë financiare me të cilat po përballlet aktualisht. OSHEE sh.a. thekson se kjo qasje jo vetëm është në përputhje me Direktivën 72/2009, të

Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë, por siguron në terma afatshkurtër, liberalizimin e tregut, në përputhje me Ligjin 43/2015, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, i ndryshuar.

Sa më sipër shoqëria OSHEE sh.a. me shkresën nr. 21171 Prot., datë 26.11.2018, ka përcjellë në MIE kërkesën për orientim në kuadër të ndarjes së shoqërisë OSHEE sh.a., duke kërkuar marrjen në konsideratë të masave tranzitore të cilat do të ofronin mundësinë për realizimin e veprimeve, përmbushjes së funksioneve që lidhen me hartimin e buxheteve përkatëse për çdo shoqëri, prezantimin e tyre pranë strukturave vendimmarrëse, realizimin e aplikimeve për tarifa pranë ERE-s për çdo operator që zhvillon veprimtari të rregulluar, me qëllim final vënien në jetë të punës së realizuar deri më tani për ndarjen.

Në vijim Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 798/1, datë 19.12.2018, ka përcjellë në ERE për dijeni, orientim në kuadër të ndarjes së shoqërisë OSHEE sh.a..

Në këtë korrespondencë, MIE ndan shqetësimet që lidhen me:

- Përcaktimin e saktë të strukturave organizative dhe proceseve të menaxhimit të portofolit të energjisë elektrike, në përputhje me funksionet dhe veprimtaritë që do të mbulojë çdo operator;
- Rishikimin dhe plotësimin e kuadrit ligjor dhe nënligjor në përputhje me detyrimet për sigurimin e furnizimit pa ndërprerje dhe sipas standarteve të cilësisë ndaj konsumatorëve;
- Ndryshime nënligjore të propozuara duke referuar në një model tregu i cili mund të konsiderohet si një model optimal, jo vetëm për OSHEE sh.a., por edhe për operatorët e tjerë të sektorit të energjisë elektrike, ku objektiv mbetet qëndrueshmëria e sektorit apo përmbushja e detyrimeve të tjera të parashikuara në ligj.

Në vlerësimin paraprak të zgjidhjeve të propozuara, MIE në cilësinë e aksionerit të shoqërisë OSHEE sh.a., gjykon të përshtatshme një periudhë tranzitore prej 12 muaj për bërjen efektive të transferimit të licencave të miratuara nga ERE me vendimet respektive, kohë e nevojshme kjo për nxjerrjen e akteve ligjore dhe nënligjore respektive.

Në vijim OSHEE sh.a. me shkresën nr. 798 Prot., datë 19.12.2018, bazuar në nenin 37 të Ligjit nr. 43/2015, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, i ndryshuar, kërkoi nga ERE përcaktimin e një periudhe tranzitore të transferimit të licencave të miratuara nga ERE sipas propozimit të përcjellë nga MIE.

ERE duke marrë në konsideratë kryesisht konstatimet e OSHEE sh.a mbi bërjen efektive të ndarjes së kompanive, Urdhrin e Brendshëm të saj nr. 7224 Prot, datë 20.04.2018 “Mbi ngritjen e grupit të punës për koordinimin e procesit të transferimit të licencave nga shoqëria “OSHEE sh.a.” si dhe propozimin e MIE në lidhje me përcaktimin e një periudhe tranzitore të transferimit të licencave të miratuara nga ERE, për një periudhë 12 mujore si dhe në zbatim të neneve 16 dhe 37, pika 2, gërmat “c”, “ç”, të Ligjit nr. 43/2015, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, i ndryshuar; neni 113, pika 3 e Ligj nr. 44/2015, “Kodi i Proçedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, si dhe nenit 15 të “Rregullave për Organizimin, Funksionimin dhe Proçedurat e ERE-s,” me vendimin nr. 264, datë 20.12.2018, vendosi:

- Përcaktimin e një periudhe tranzitore prej 12 muaj, për bërjen efektive të transferimit të licencave të operimit të sistemit të shpërndarjes së energjisë elektrike, të shoqërisë Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike sh.a (OSHEE sh.a), tek shoqëria "Operatori i Sistemit të Shpërndarjes" sh.a. (O.S.SH sh.a.); miratuar me vendimin e Bordit të ERE nr. 216, datë 11.10.2018; licencës së furnizimit të energjisë elektrike dhe detyrimit të shërbimit universal të furnizimit të energjisë elektrike, të shoqërisë Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike sh.a. (OSHEE sh.a.), tek shoqëria "Furnizuesi i Shërbimit Universal" sh.a. (FSHU sh.a.) miratuar me vendimin e Bordit të ERE nr. 215, datë 11.10.2018;
- Deri në përfundimin e periudhës tranzitore prej 12 muaj, veprimtaritë e operimit të sistemit të shpërndarjes së energjisë elektrike; furnizimit të energjisë elektrike dhe detyrimit të shërbimit universal të furnizimit të energjisë elektrike, do të vazhdojnë të kryhen nga OSHEE sh.a..

Në lidhje me rritjen e përpjekjeve dhe të bashkëpunimit me insitucionet përkatëse për të mundësuar ngritjen dhe bërjen efektive të bursës së energjisë, bëjmë me dije se:

Me hyrjen në fuqi të Ligji nr. 7/2018 *“Për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin nr. 43/2015, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”*, u vendos mbi ndarjen e plotë të Operatorit të Tregut nga Operatorit i Sistemit të Transmetimit dhe ngritjen si të tillë të Bursës Shqiptare të Energjisë.

Në kuadër të punës me qëllim bërjen efektive të Bursës Shqiptare të Energjisë, si dhe në zbatim të VKM nr. 519/2016 *“Për miratimin e Modelit të Tregut të Energjisë Elektrike”* gjatë vitit 2018, në bashkëpunim me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë dhe nën konsulencën e USAID, janë ngritur 3 grupe pune, tekniko-Operacionale, komerciale dhe ligjor dhe rregullatore, në të cilët ERE ka përfaqësuesit e saj. Gjatë vitit 2018 janë zhvilluar tre mbledhje të përbashkëta ndër-institucionale, ku fillimisht u hartua Plani i Masave të bërjes efektive të Bursës Shqiptare të Energjisë dhe më tej përditësimi i tij. Aktualisht grupet e punës janë njoftuar se nga ana e MIE janë draftuar tashmë edhe VKM *“Për krijimin dhe strukturën e kapitalit të Operatorit të Tregut”* dhe VKM *“Për caktimin e kritereve dhe procedurave të përzgjedhjes së pjesëmarrësve në kapitalin e Operatorit të Tregut.”*

Në mbështetje të nenit 19 të Ligjit nr. 43/2015 *“Për Sektorin e Energjisë Elektrike”* i ndryshuar, si dhe në kuadër të Memorandumit të Bashkëpunimit të 6 vendeve të Ballkanit Perëndimor, mbi Zhvillimin e Tregut Rajonal të Energjisë dhe Vendosijen e një Kuadri Ligjor për Bashkëpunim të mëtejshëm të nënshkruar në Vienë në datën 27.04.2016, Bordi i ERE-s me vendimin nr. 170, datë 03.08.2018, miratoi *“Memorandumin e mirëkuptimit mbi bashkëpunimin e tregjeve ditore të energjisë elektrike mes palëve”*, Enti Rregullator i Energjisë së Shqipërisë (ERE), Zyra e Rregullatorit të Energjisë të Kosovës (ZRRë), Operatori i Sistemit të Transmetimit të Shqipërisë (OST sh.a.), Operatori i Sistemit të Transmetimit të Kosovës (KOSTT sh.a.). Ky memorandum përcakton kushtet e bashkëpunimit midis palëve për mundësinë e krijimit të tregut të përbashkët midis Shqipërisë dhe Kosovës.

ERE gjatë procedurave të miratimit të tarifës së transmetimit të energjisë elektrike i kërkoi informacion OST sh.a. në lidhje me kostot e parashikuara nga kjo e fundit për funksionimin e OT për vitin 2019, kosto të cilat u morën në konsideratë në përcaktimin e tarifës së shërbimit të transmetimit për vitin 2019.

ERE ka filluar procedurën për rishikimin e “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licensave në sektorin e energjisë elektrike”, në të cilën do të integrohet si veprimtari e licencuar edhe operimi i tregut të energjisë elektrike.

Po ashtu gjatë vitit 2018, ERE me vendimin nr. 59, datë 15.03.2018, miratoi kërkesën e OST sh.a. për shtyrjen e afatit të pikës 2 të vendimit të ERE nr. 43 datë 15.03.2017 “Mbi miratimin përfundimtar të certifikimit të operatorit të sistemit të transmetimit të energjisë elektrike OST sh.a. në përputhje me nenin 54, pika 6, të ligjit nr. 43/2015, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike” dhe nenin 9, pika 6, të Direktivës 72/2009 EC mbas marrjes së Opinioneve të Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë. Shtyrje e cila erdhi si rezultat i mosrealizimi në kohë të Ndarjes së Operatorit të Tregut dhe realizimit të ndryshimeve në kuadrin ligjor dhe transferimi i kompetencave tek Ministria e Ekonomisë.

Në lidhje me propozimin për ndryshimet në strukturën e saj organizative për të bërë të mundur sigurimin e kapaciteteve të mjaftueshme dhe ekspertizën e nevojshme për t’u përballur me sfidat e sektorit, bëjmë me dije se:

Neni 9 pika 1 e ligjit nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, i ndryshuar, parashikon qartësisht se ERE është institucioni Rregullator i sektorit të Energjisë Elektrike dhe Gazit në Shqipëri që drejtohet nëpërmjet bordit të Komisionerëve, Bordi përbëhet nga Kryetari dhe katër anëtarë të cilët përzgjidhen nga Kuvendi. Struktura organizative me të cilën kryen veprimtarinë e saj ERE, duke përfshirë edhe bordin me pesë anëtarë, përbëhet nga 32 punonjës. Është për t’u theksuar se, ERE që nga miratimi i vendimit nr. 181, datë 05.05.2008 të Kuvendit, ka ushtruar funksionet mbështetur në strukturën si më poshtë:

(i) Bordi me 5 anëtarë, Këshilltari, Sekretari i Bordit, Personel teknik të organizuar në 4 Drejtori si vijon: (ii) Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut, me 7 punonjës, (iii) Drejtoria Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, me 5 punonjës, (iv) Drejtoria e Çmimeve dhe Tarifave të Energjisë Elektrike, me 5 punonjës dhe (v) Drejtoria e Administrim Financës dhe Burimeve Njerëzore, me 8 punonjës.

Me zhvillimet aktuale të sektorit të Energjisë Elektrike por edhe atij të Gazit Natyror, ERE është gjendur në kushtet e një numri të kufizuar personeli teknik, rreth 13 në total, pa konsideruar stafin e domosdoshëm mbështetës, për të plotësuar kërkesat që i dalin rregullatorit si një ndër aktorët kryesorë të sektorit përballë kërkesave dhe zhvillimeve të një Tregu të Energjisë Elektrike në rritje, dhe krijimit të një Tregu të Gazit Natyror i cili është po ashtu në zhvillim.

Është për t’u vënë në dukje se vetëm pas daljes së Ligjit të ri të Sektorit të Energjisë Elektrike nr. 43/2015, në zbatim të parashikimeve të tij, ERE ka patur për detyrë realizimin e qëllimeve të ngarkuara me ligj brenda afateve të parashikuara në të dhe ka miratuar, ose ka filluar procedurat për miratimin, e rreth 60 akteve rregullatore dhe legjislacion sekondar.

Sa më sipër, ka qënë një sfidë e jashtëzakonshme për stafin por edhe për bordin për sa i përket investimit personal të tyre në shqyrtimin e praktikave të përgatitura nga personeli teknik si dhe vendimmarrjes. Kjo, pa përfshirë një sërë aktesh në funksion të rregullimit të Sektorit e që lidhen me shqyrtimin dhe miratimin e kontratave apo marrëveshjeve të rregulluara me ligj të Operatorëve

të sektorit të energjisë elektrike dhe atyre të gazit natyror, të cilat janë akte që miratohen periodikisht, në disa raste dhe disa herë brenda një viti nga ana e rregullatorit.

Gjithashtu një pjesë të rëndësishme në punën e stafit të ERE-s, kanë zënë praktikën në lidhje me procedurat e licencimeve të shqyrtuara si dhe vendimet e marra në lidhje me to, si në kuptim të licencimit fillestar por gjithashtu edhe në funksion të reflektimit të kërkesave të vetë operatorëve për ndryshime në licencat aktuale.

Puna e ERE, pavarësisht numrit të kufizuar të stafit mbështetës, është fokusuar edhe në monitorimin e Tregut të Energjisë Elektrike, në funksion të vëzhgimit e konstatimit të zbatimit të legjislacionit në fuqi nga operatorët e sektorit.

Përgjatë viteve të fundit, ERE ka patur në mënyrë të vazhdueshme mbështetjen dhe ka bashkëpunuar ngushtë me organizmat ndërkombëtare të tillë si: (i) ERRA– Energy Regulators Regional Association, (ii) Sekretariati i Komunitetit të Energjisë, (iii) NARUC – National Association of Regulatory Utilities (SHBA), (iv) MEDREG– Mediterranean Energy Regulators, (v) E-Control– Energy Control Austria, (vi) ARERA – Enti Regullator i Italisë (vii) CEER shoqata e Regullatorëve të vendeve Europiane, (viii) RAE Enti Regullator i Greqisë etj. dhe ka marrë pjesë në grupet e punës të ngritura nga këto organizma si dhe seminarët e mbajtura nga këto institucione, fakt që ka kërkuar angazhim të stafit të ERE-s,.

Në konkluzion të sa më sipër, dhe duke marrë po ashtu në konsideratë që:

- Sipas parashikimeve të Nenit 10 pika 1 e ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e Energjisë Elektrike” i ndryshuar i cili parashikon se ERE është një person juridik publik, i pavarur nga çdo institucion tjetër publik ose privat.

Bordi dhe personeli teknik i ERE-s:

a) ushtrojnë funksionet e tyre në mënyrë të paanshme dhe transparente;

b) veprojnë në mënyrë të pavarur nga interesat e tregut, nga çdo institucion apo subjekt publik ose privat.

- Neni 11 pika 7 e ligjit nr.43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, ndryshuar, parashikon se: Bordi përcakton strukturën organizative të ERE-s dhe numrin e punonjësve, pagën dhe trajtimet financiare të kryetarit, të anëtarëve të bordit, si dhe të personelit teknik.
- Në mbështetje të nenit 16, nenit 11, pika 7 të Ligjit nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, i ndryshuar, nenit 7 dhe 8 të “Rregullores së Organizimit, funksionimit dhe procedurave të ERE-s”, miratuar me Vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.06.2016,
- Sekretariati i Komunitetit të Energjisë, në mënyrë të herëpashershme dhe të përsëritur i ka kërkuar Bordit të ERE por edhe Ministrisë përgjegjëse për Energjinë, ndërmarrjen e hapave të nevojshëm për të përshtatur kapacitetet teknike dhe stafit të ERE me kërkesat e tregut por edhe praktikën më të mira ndërkombëtare.

- Rezoluta e Kuvendit të Shqipërisë, për vlerësimin e veprimtarisë së Entit Rregullator të Energjisë, për vitin 2017, ka lënë detyrë që: ERE të propozojë ndryshimet në strukturën e saj organizative për të bërë të mundur sigurimin e kapaciteteve të mjaftueshme dhe ekspertizën e nevojshme për t'u përballur me sfidat e sektorit.

Nisur nga sa më sipër;


Bordi i ERE në mbledhjen e tij të datës 02.04.2019, me vendimin nr. 52 vendosi të miratojë strukturën organizative, organogramën e Entit Rregullator të Energjisë, duke u shprehur:

1. Të miratojë strukturën organizative dhe organogramën e Entit Rregullator të Energjisë.
2. Numri maksimal i punonjësve të Entit Rregullator të Energjisë është 52.

Struktura e re organizative reflekton;

- (i) Sfidat që i dalin përpara ERE-s në drejtim të zhvillimeve në Tregun e Energjisë Elektrike, dhe atë të Gazit Natyror jo vetëm në Shqipëri por edhe në kuadër të integritit në tregun rajonal në përputhje me angazhimet që burojnë nga Memorandumi i WB6.
- (ii) Nevojën për hartimin, miratimin dhe rishikimin e akteve nënligjore që mundësojnë implementimin e ligjeve dhe politikës së qeverisë shqiptare në sektorin e energjisë elektrike, gazit natyror dhe burimeve të rinovueshme.
- (iii) Përgjegjësitë e ERE-s në funksion të monitorimit të Tregut të Energjisë Elektrike rritjes së numrit të pjesëmarrësve të tregut gjatë këtyre viteve, rolit të ERE-s në kuadër të mbrojtjes së klientit fundor dhe Transparencës së Tregut duke krijuar njësi të veçanta lidhur me monitorimin e standarteve dhe cilësisë si dhe zgjidhjes së mosmarrëveshjeve.
- (iv) Ecurinë e zhvillimit të tregut të gazit natyror i cili me vënien në operim të projektit të TAP do të kërkonte zhvillimin dhe trajnimin e burimeve njerëzore në Rregullator për të përballuar sfidat në krijimin e këtij tregu në Shqipëri duke krijuar hapësira për krijimin e një tregu rajonal, duke konsideruar këtu edhe pritshmëritë lidhur me investimet në kaudër të projektit Ionian Adriatic Pipeline (IAP).
- (v) Angazhimeve në strukturat rajonale e ndërkombëtare të cilat kërkojnë pjesmarrjen aktive të stafit të Rregullatorit në to.
- (vi) Parashikimet e Ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar dhe aktet e nxjerra në zbatim të tij lidhur me mënyrën e organizimit strukturor të administratës publike.
- (vii) Gjithashtu kjo strukturë organizative vjen edhe si një analizë e praktikave të insitucioneve homologe në vendet dhe organizmat rregullator ku marrim pjesë si anëtarë të përhershëm.

Nr. total i punonjësve 52



Në lidhje me bashkëpunimin me OSHEE sh.a. dhe institucionet përgjegjëse, për marrjen e masave për zgjidhjen e problemit të pronësisë së kabinave elektrike, 51.3 % e të cilave nuk janë në pronësi të OSHEE sh.a., duke krijuar kështu pengesa për të drejtën e ndërhyrjes dhe kryerjen e shpenzimeve financiare nga ana e OSHEE sh.a. në rastet e nevojshme, bëjmë me dije se:

ERE ka dërguar pranë OSHEE sh.a. dhe për dijëni Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë shkresën nr. 578 Prot., datë 04.09.2018, me anë të së cilës i kërkon OSHEE sh.a. propozimet konkrete mbi zgjidhjet e përshtatshme duke përfshirë dhe ndryshimet e nevojshme në kuadrin ligjor. Në një sërë takimesh të zhvilluara në ERE, OSHEE sh.a. ka bërë me dije se është duke punuar për rishikimin e propozimeve të përcjella më herët, me qëllim ndryshimet në legjislacionin në fuqi dhe zgjidhjen përfundimtare të kësaj problematike.

Në lidhje me propozimin për ndryshimet e nevojshme në legjislacion për zgjidhjen e kësaj problematike në të ardhmen, bëjmë me dije se është në diskrecion të OSHEE sh.a. e cila ka patur dhe ka në vijimësi gjithë mbështetjen dhe ekspertizën e ERE-s, për propozimin e ndryshimeve më oportune në legjislacionin në fuqi. Këto ndryshime nëse do të bëhen duhet të reflektohen në aktet ligjore që rregullojnë marrëdhëniet e pronësisë.

Në komunikimet e vazhdueshme me OSHEE sh.a, me qëllim gjetjen e një zgjidhjeje mbi pronësinë e kabinave, ERE ka shprehur rekomandimin për vlerësimin e kujdesshëm të objekteve (kabinave) me efekte minimale në kostot që transferohen tek tarifa e shërbimit të shpërndarjes. Sa më sipër, ERE ka shprehur gatishmërinë e saj dhe mbështetjen për OSHEE sh.a për një zgjidhje optimale.

Sa i përket masave të marra për të bërë të mundur një vlerësim të plotë të humbjeve të OSHEE-së prej pikës së lidhjes së prodhuesve të energjisë, në mënyrë që të kemi një sistem sa më të drejtë dhe të saktë për shlyerjen e detyrimeve financiare përkatëse, bëjmë me dije se:

ERE i ka kërkuar në mënyrë të vazhdueshme OSHEE sh.a. përgatitjen e një studimi/analize të vlerësimit dhe efektit të humbjeve të OSHEE sh.a. prej pikës së lidhjes së prodhuesve të energjisë elektrike dhe zgjidhjet e propozuara. Për këtë qëllim OSHEE sh.a. ka bërë me dije se ka kontraktuar palë të treta për shërbimin “Studimin e vlerësimit të humbjeve të energjisë elektrike në traktin e lidhjes nga njësia gjeneruese deri në pikën e lidhjes me rrjetin e OSHEE sh.a.” dhe do të dërgojë në ERE rezultatin dhe propozimet konkrete sipas termave të referencës, menjëherë pas mbylljes së këtij shërbimi nga ana e kontraktorit.

Bazuar në legjislacionin në fuqi (neni 94, shkronja “e”, e Ligjit “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”) dhe eksperiencave më të mira ndërkombëtare, të punojë për krijimin e mekanizmave të rinj të vlerësimit, të cilët, nga njëra anë, ndikojnë në rritjen e cilësisë së shërbimit dhe nga ana tjetër i shërbejnë mbrojtjes së konsumatorëve, duke i rimbursuar/kompensuar në rastet e mungesës së shërbimit me energji (outage) për tensionin e ulët (TU), sqarojmë se:

Pas korrespondencave të përsëritura nga ana e ERE-s, në përgjigje të tyre, OSHEE sh.a. ka raportuar në lidhje me implementimin e “Rregullores për kriteret standarte të shërbimit të

shpërndarjes së energjisë elektrike”, miratuar me vendimin e ERE-s nr. 181, datë 10.11.2017. Nga ana e OSHEE sh.a. është bërë studimi dhe analiza e plotë e treguesve kryesorë të matjes së cilësisë së shërbimit të energjisë elektrike nga OSHEE sh.a. gjatë viteve 2015 - 2016 - 2017 - 2018. Kjo analizë i referohet treguesve kryesorë të cilësisë SAIDI (Indeksi Mesatar i Kohëzgjatjes së Ndërprerjeve në Sistem), SAIFI (Indeksi Mesatar i Frekuencës së Ndërprerjeve në Sistem) të ndarë sipas zonave urbane dhe rurale. Referuar treguesve të performancës së OSHEE sh.a., konstatuam se rrjeti i shpërndarjes për periudhën 2015-2018 është përmirësuar dukshëm, por numri dhe kohëzgjatja e difekteve në zonat Rurale vazhdon të jetë i lartë në raport me normat e Komunitetit Europian dhe kërkesave të Tregut të Energjisë Elektrike. SAIDI dhe SAIFI për vitin 2018 kanë qënë respektivisht 65.18 min dhe 34.02. Këto vlera të SAIDIT dhe SAIFIT për vitin 2017 kanë qënë respektivisht 35.58 min dhe 74.43.

Ky përmirësim për periudhën 2015-2018 ka ardhur si pasojë e:

Realizimit të investimeve të planifikuara në përputhje me politikat për zhvillimin e sektorit të Energjisë elektrike;

- a) për sigurinë e furnizimit për rastet e situatave normale dhe ato emergjente;
- b) për përmirësimin e sistemit të shpërndarjes për ruajtjen dhe përmirësimin e performancës së rrjetit.

ERE ka miratuar Rregulloren për kriteret standarte të cilësisë së shërbimit të furnizimit dhe performancës së sigurisë së rrjetit të shpërndarjes së energjisë elektrike me vendimin nr. 181, datë 10.11.2017. Në lidhje me këtë rregullore OSHEE sh.a., kërkoi shtyrjen e afateve të përcaktuara në këtë rregullore, duke kërkuar një aplikim të përshkallëzuar për të miratuar nivelin e lejuar të kriterëve standarte të performancës në zona të ndryshme.

ERE në konsultë edhe me MIE, me vendimin nr. 271, datë 21.12.2018, vendosi shtyrjen e afateve për realizimin e parametrave të kërkuar nga *“Kriteret Standarte të Cilësisë së Shërbimit të Shpërndarjes të Energjisë Elektrike”*, për një periudhë 6-mujore me kusht që brenda kësaj periudhe Shoqëria të dorëzojë në ERE një studim të detajuar mbi përshkallëzimin e realizimit të parametrave të kërkuara sipas zonave të sipërcituara.

ERE me vendimin nr. 207, datë 18.12.2017, miratoi *“Rregulloren për kriteret standarte të cilësisë së shërbimit të transmetimit të energjisë elektrike”*.

ERE me vendimin nr. 270, datë 21.12.2018, pasi konstatoi pamundësinë për përmbushjen e detyrimeve që kërkohen nga rregullorja e sipërcituar për shkaqe që nuk varen nga OST sh.a., dhe nuk mund të shmangen pavarësisht vullnetit, përpjekjeve apo kujdesit të OST sh.a., vendosi shtyrjen e afateve të përcaktuara në vendimin nr. 207, datë 18.12.2017 deri në 1 korrik 2019.

Duke marrë në konsideratë siç bën me dije dhe OST sh.a., gjatë procesit të transferimit të aseteve nga OSHEE sh.a. (zbarat e nënstacioneve 110 kV, elementë të cilët rezultonin relativisht të amortizuar sa i përket gjendjes teknike), lindi nevoja për transferimin e të dhënave për këto asete duke bërë që të nevojitej një periudhë tranzitore për implementimin e rregullores së cilësisë së shërbimit nga OST sh.a.

Në lidhje me nxitjen e OSHEE-në për vënien sa më shpejt në punë të sistemit të ri të faturimit, i cili lehtëson në mënyrë të ndjeshme matjen e energjisë dhe krijon mundësi dhe opsione të reja të nevojshme, duke përfshirë edhe matjen periodike disa mujore, si dhe përfshirjen në kontratën tip për vitin 2019 të kësaj mënyre matjeje.

ERE më shkresën nr. 574 Prot., datë 04.09.2019, i është drejtuar OSHEE sh.a duke kërkuar bashkëpunimin e OSHEE sh.a për vënien sa më shpejt në punë të sistemit të ri të faturimit i cili do të lehtësojë në mënyrë të ndjeshme matjen e energjisë elektrike dhe krijon mundësi të reja të nevojshme, duke përfshirë edhe matjen periodike disa mujore, si dhe përfshirjen në kontratën tip për vitin 2019, të kësaj mënyre matje si dhe dërgimin e propozimeve konkrete të shoqëruara me një analizë të kosto – përfitimi të vendosjes së një sistemi të tillë lexim – faturimi. Gjithashtu u kërkuar që OSHEE sh.a të bënte me dije edhe mekanizmat e identifikuar për shmangien e abuzimeve në procesin e leximit dhe faturimit mbi baza disa mujore.

Në lidhje me kushtet e rritjes së ndjeshme të prodhimit nga HEC-et private, të nxisë autoritetet përkatëse të vlerësojnë nevojën e përditësimit të rregullores së shfrytëzimit të digave, bëjmë me dije se:

ERE me shkresën nr. 571 Prot., datë 04.09.2018, i është drejtuar Komitetit Kombëtar të Digave të Mëdha, dhe për dijeni MIE, KESH sh.a, FIAA dhe AREA, duke kërkuar evidentimin e problematikave të konstatuara që lidhen me gjendjen aktuale të digave në vendin tonë, si dhe propozimet përkatëse për ndryshimet e nevojshme në rregulloren e shfrytëzimit të digave.

Në vijim Komiteti Kombëtar i Digave të Mëdha (KKDM) ka përcjellë në ERE shkresën nr. 571/1 Prot., datë 04.10.2018, në të cilën ndër të tjera ka evidentuar nevojën për qëndrimin e shprehur të Autoritetit Kontraktues në zbatimin e kontratave koncesionare dhe përgjegjësitë ligjore që u takojnë pronarëve e shfrytëzuesve të digave në cilatdo periudha, duke qënë se në praktikën e tij KKDM, ka hasur në raste si më poshtë:

Diga, të cilat megjithëse kanë kontratë koncesioni janë projektuar, ndërtuar dhe vënë në shfrytëzim pa u paraqitur për miratim në KKDM. Për më tepër, objekti ka qënë i pajisur me Leje Ndërtimi.

Materialet për projektin e digës ose të veprave që mund të ndikojnë në funksionimin e saj, nuk janë të pasqyruara saktë. Si rrjedhojë mund të ketë paqartësi për vendimmarrjen dhe përgjegjësitë.

Në projektet e përgatitura nga të huaj, ka mungesa në njohjen e kushteve konkrete, veprave të ndërtuara më parë dhe ndikimit nga veprat e reja. Në vijim të sa më sipër, ERE po ashtu me shkresën nr. 571/2, Prot., datë 29.10.2018 i është drejtuar MIE dhe për djeni Komitetit Kombëtar të Digave, duke kërkuar mbështetjen e Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë me qëllim shmangien e situatave të evidentuara nga Komiteti Kombëtar i Digave të Mëdha në shkresën nr. 571/1, datë 04.10.2018.

Ndërkohë ERE me vendimin nr. 239, datë 02.11.2018, ka filluar procedurën për rishikimin e “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licensave në sektorin e energjisë elektrike”, në të cilën do të integrohet si kriter për pajisjen me licencë nga ERE edhe miratimi nga KKDM të projektit të digës si dhe leja e vënies në ngarkesë për herë të parë të digës e objekteve.

Në lidhje me bashkëpunimin me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë për adresimin e mangësive, si dhe për zgjerimin më tej të përgjegjësive dhe kompetencave të ERE-s, në kuadër të implementimit të objektivave dhe parimeve të përcaktuara në Paketën e Tretë të Energjisë, bëjmë me dije se:

ERE duke konsideruar me shumë rëndësi rritjen e pavarësisë së Rregullatorit në ushtrimin e detyrave funksionale në kuadër të ligjeve të sipërcituara me shkresën nr. 568 Prot., datë 04.09.2018, i është drejtuar MIE duke i kërkuar bashkëpunim për adresimin e mangësive si dhe për zgjerimin më tej të përgjegjësive dhe kompetencave të ERE-s, në kuadër të implementimit të objektivave dhe parimeve të përcaktuara në Paketën e Tretë të Energjisë.

këto propozime lidhen me një shtesë në ligjin nr. 152/2013, Për Nëpunësin Civil të Ndryshuar”, Miratimi i këtyre ndryshimeve nga Kuvendi përmbush një nga kushtet kryesore të Implementimit të Paketës Tretë të Energjisë, “Për një Pavarësi Funksionale dhe Financiare të Enteve Rregullator të Energjisë”, bazuar në Direktivën 2009/72/EC të Energjisë Elektrike, neni 35 (4, 5) gërmat a,b dhe Direktiva 2009/73/EC të Gazit Natyror, neni 39 (4,5), pika (a,b), si dhe të ligjit “Për Sektorin e Energjisë”, neni 11, pika 7-të e tij.

Gjithashtu këto propozime për të mundësuar harmonizimin e këtij Ligji me Ligjin e Sektorit të Energjisë Elektrike dhe atë të Gazit Natyror lidhen dhe me disa ndryshime në ligjin nr. 9584, datë 17.07.2006 “Për Pagat, Shpërblimet dhe Strukturat e Institucioneve të Pavarura Kushtetuese dhe të Institucioneve të tjera të Pavarura, të krijuara me ligj”.

Në lidhje me fokusimin në plotësimin e kuadrit ligjor me legjislacionin sekondar, në funksion të vendimeve të Këshillit të Ministrave, në zbatim të ligjit nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, si dhe të ndryshimeve që ky ligj ka pësuar me ligjin nr. 7/2018, bëjmë me dije se:

Përgjatë vitit 2018, ERE ka vijuar procesin e draftimit dhe të miratimit të një sërë aktesh nënligjore, në zbatim të parashikimeve të ligjit 43/2015, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike” i ndryshuar si dhe ligjit 102/2015, “Për Sektorin e Gazit Natyror”.

Ndër to përmendim “Kushtet e përgjithshme të kontratës së shërbimit universal të furnizimit me energji elektrike për klientët”, “Rregullat për përcaktimin e formatit të të dhënave dhe procedurën për aksesin e furnizuesve ndaj të dhënave të operatorit të shpërndarjes së energjisë elektrike”, “Rregullave për kushtet e shërbimit të furnizimit nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit”, dhe “Kushtet kontraktore të furnizimit me energji elektrike”, “Rregulloren për mbrojtjen e informacionit konfidencial, licencën e operimit të Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes së energjisë elektrike”.

Të tjera akte të cilat ERE ka hartuar e miratuar janë ato që lidhen me sektorin e gazit, e në zbatim të ligjit 102/2015, “Për Sektorin e Gazit Natyror”. Gjatë vitit 2018 janë miratuar licencat tip për aktivitetet e shpërndarjes së gazit natyror, transmetimit të gazit natyror, tregtimit të gazit natyror, furnizimit të gazit natyror si dhe “Rregullorja mbi kushtet e përgjithshme të shërbimit të furnizimit me gaz natyror për klientët fundorë”.

Duke marrë në konsideratë detyrimet që lindin nga zbatimi i vendimeve të miratuara nga Grupi i Përhershëm i Nivelit të Lartë PHLG i Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë dhe

anëtarësimin e OST sh.a si anëtare me të drejta të plota në Operatorët e Sistemit Europian të Transmetimit të Energjisë (ENTSO-E), lindi nevoja që të përshtatej një pjesë e akteve ligjore duke përfshirë Kodet dhe Rregulloret sipas legjislacionit të Bashkimit Europian (BE).

Në lidhje me procesin e shqyrtimit dhe miratimit të planit të investimeve të operatorëve të shpërndarjes dhe të transmetimit të energjisë, duke kërkuar nga ana e tyre orientimin e investimeve drejt uljes së kostove dhe identifikimit të pjesëve të sistemit ku ndërhyrja është më e nevojshme për një sistem të integruar në tregun rajonal.

Me vendimin nr. 212, datë 28.12.2017, ERE ka miratuar planin e investimeve për vitin 2017 dhe atë dhjetë vjeçar 2015 – 2025 të zhvillimit të rrjetit të transmetimit të shoqërisë OST sh.a. dhe me vendimet nr. 181 dhe 182, datë 20.08.2018, ERE ka miratuar planin e investimeve të shoqërisë “OSHEE” sh.a, për vitin 2018 dhe atë të zhvillimit të rrjetit të shpërndarjes së energjisë elektrike, për periudhën 5- vjeçare (2018 - 2022).

Ndër të tjera në planin e zhvillimit të OST sh.a në kuadrin e inegrimit në tregun rajonal është parashikuar edhe ndërtimi i linjës së interkonjeksionit Shqipëri – Maqedonia e Veriut dhe zgjerimi i nënstacionit të Komanit në nivel tensioni 400 kV, për të rritur kapacitetet transmetuese në drejtim të Kosovës.

Gjatë procesit të miratimit të planit të investimeve të Operatorit të Sistemit të Transmetimit, ERE ka kontrolluar zbatueshmërinë e Ligjit nr. 43/2015, “*Për sektorin e energjisë elektrike*” i ndryshuar dhe “*Rregulloren për procedurat e paraqitjes dhe miratimit të planit të investimeve nga operatorët e transmetimit dhe shpërndarjes së energjisë elektrike*” miratuar me vendimin nr. 135, datë 06.09.2017, veçanërisht të kërkesës për mbështetjen me analizë kosot - përfitim për çdo projekt të propozuar në planin e investimeve.

ERE ka monitoruar vazhdimisht realizimin e investimeve të Operatorit të Sistemit të Transmetimit duke konstatuar se pavarësisht ndryshimeve të miratuara nga Këshilli Drejtues i OST sh.a investimet e realizuara përkohë me trendet e planit 10 vjeçar të zhvillimit të rrjetit të transmetimit. Sa i përket Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes nga monitorimi rezulton se, ky plan ka pësuar ndryshime të miratuara në fazën e realizimit duke iu përmbajtur qëllimeve të shprehura në Planin 5 vjeçar të Zhvillimit të rrjetit të shpërndarjes.

Shqyrtimi i planit të investimeve kryhet në përputhje me kërkesat e “*Rregullores së procedurave të paraqitjes dhe miratimit të planit të investimeve nga operatorët e transmetimit dhe shpërndarjes së energjisë elektrike*”, miratuar me Vendimin e Bordit të ERE-s nr. 135, datë 06.09.2017.

Në lidhje me bashkëpunimin në vazhdimësi me Komunitetin e Energjisë, Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë dhe Autoritetin e Konkurrencës lidhur me çështje që kanë të bëjnë me kuadrin rregullator në sektorin e energjisë dhe për çështje të tjera të rëndësishme të këtij sektori, bëjmë me dije se:

Gjatë vitit 2018, ERE ka patur bashkëpunim të vazhdueshëm me Sekretariatën e Komunitetit të Energjisë, Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë dhe Autoritetin e Konkurrencës, sa i përket procesit të miratimit të akteve nënligjore rregullatore të sektorit të energjisë elektrike dhe gazit natyror, për të cilat këto institucione kanë shprehur komente dhe sugjerime. Po ashtu me Sekretariatën e Komunitetit të Energjisë gjatë vitit 2018 janë trajtuar edhe problematika të

paraqitura nga subjekti Energji Ashta sh.p.k që kanë të bëjnë me operimin dhe balancimin në funksion të kontratave që lidhen me operimin e kaskadës dhe legjislacionit të zbatueshëm në fuqi. Gjithashtu shoqëria tregtare “GEN-I Tirana” sh.p.k ka paraqitur në ERE disa ankesa lidhur me zbatimin e procedurave të shitblerjes të energjisë elektrike nga KESH sh.a si dhe kontratat me KESH sh.a lidhur me devijimet dhe depozitimet e energjisë. Këto çështje janë aktualisht duke u shqyrtuar nga ERE në konsulencë me Sekretariatit e Komunitetit të Energjisë.

Me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë si dhe Autoritetin e Konkurrencës gjatë vitit 2018 ka bashkëpunuar dhe marrë opinion në lidhje me çështje që kanë të bëjnë me rishikimin e metodologjive të përcaktimit të tarifave dhe çmimeve dhe me vendimmarjet për përcaktimin e tarifave dhe çmimeve të cilat janë reflektuar në vendimet e ERE-s si vijon:

- Vendimi Nr. 97, Datë 23.04.2018 “Mbi miratimin e tarifës së transmetimit të gazit natyror nga shoqëria Albgaz sh.a., për vitin 2018”
- Vendimi 144, date 25.06.2018 “Mbi rishikimin e “metodologjisë së përcaktimit çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga furnizuesi i mundësisë së fundit” miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 201, datë 04.12.2017”
- Vendimi 190, date 30.08.2018 “Mbi shqyrtimin e aplikimit të shoqërisë “OSHEE” sh.a. për tarifën e shërbimit të shpërndarjes së energjisë elektrike sipas nivelit të tensionit dhe lënien në fuqi të çmimeve me pakicë për klientët që shërbehen nga furnizuesi i shërbimit universal për vitin 2018.”
- Vendim Nr. 266, Datë 21.12.2018 “Mbi përcaktimin e tarifës së shërbimit të transmetimit të energjisë elektrike nga shoqëria “OST” sh.a. për vitin 2019”
- Vendim Nr. 268, Datë 21.12.2018 mbi lënien në fuqi të vendimit të bordit të ERE-s nr. 190 datë 30.8.2018 në lidhje me tarifën e përdorimit të rrjetit të shpërndarjes sipas nivelit të tensionit dhe çmimet me pakicë për klientët fundorë që shërbehen nga furnizuesi i shërbimit universal për vitin 2019.

Në lidhje me vijimin e punës për reflektimin në legjislacionin aktual rregullator të ndryshimeve të nevojshme, në përputhje me Paketën e Tretë të Bashkimit Europian në fushën e energjisë, për të berë të mundur krijimin e një tregu konkurrues, eficient, dhe që nxit sigurinë dhe cilësinë e funizimit me energji elektrike në vend, bëjmë me dije se:

ERE gjatë vitit 2018, ka miratuar një sërë aktesh rregullatore në përputhje me Paketën e Tretë të Bashkimit Europian në fushën e energjisë të cilat janë si më poshtë:

- Vendimi i Bordit të ERE nr. 127, datë 04.06.2018; Mbi miratimin e kodit të rrjetit për kërkesat e lidhjes me rrjetin të sistemeve me tension të lartë me rrymë të vazhduar dhe parqet me module të energjisë të lidhur me rrymë të vazhduar (HVDC)
- Vendimi i Bordit të ERE nr. 128, datë 04.06.2018, “Mbi miratimin e Kodit të Rrjetit për Ngarkesën”

- Vendimi i Bordit të ERE nr. 129, datë 04.06.2018, "Mbi miratimin e Kodit të rrjetit mbi kërkesat për lidhjen me rrjetin e gjeneruesve."
- Vendimi i Bordit të ERE nr. 214, datë 11.10.2018, "Mbi miratimin e Kodit të rrjetit mbi rregullat e ndërveprimit dhe shkëmbimit të të dhënave."
- Vendimi i Bordit të ERE nr. 249, datë 11.12.2018, "Mbi miratimin e "propozimi i gjithë OST-ve për një metodologji të ofrimit të të dhënave të gjenerimit dhe ngarkesës, në përputhje me nenin 17 të rregullores së Komisionit të Bashkimit European (BE) 2016/1719 të datës 26 shtator 2016 për krijimin e një Udhëzuesi mbi Alokimin e Kapaciteteve në Avancë".
- Vendimi i Bordit të ERE nr. 250, datë 11.12.2018, "Mbi miratimin e "propozimi i gjithë OST-ve për një metodologji të modelit të përbashkët të rrjetit në përputhje me nenet 67 (1) dhe 70 (1) të Rregullores së Komisionit të Bashkimit European (BE) 2017/1485 të datës 02 gusht 2017 për krijimin e një udhëzuesi mbi operimin e sistemit të transmetimit të energjisë elektrike"
- Vendimi i Bordit të ERE nr. 251, datë 11.12.2018, "Mbi miratimin e disa amendimeve për propozimin e të gjithë OST-ve mbi "Udhëzuesin për Kërkesat Organizative, rolet dhe përgjegjësitë në lidhje me shkëmbimin e të dhënave" (KORP)
- Vendimi i Bordit të ERE nr. 252, datë 11.12.2018, "Mbi miratimin e propozimit të të gjitha OST-ve të Evropës kontinentale dhe nordike për hipotezat dhe një metodologji të analizës së kosto-përfitimit në përputhje me nenin 156 (11) të rregullores së komisionit të bashkimit european (be) 2017 /1485 të datës 2 gusht 2017, që përcakton një udhëzues mbi operimin e sistemit të transmetimit të energjisë elektrike".
- Propozimi i të gjitha OST-ve të Evropës Kontinentale dhe Nordike për hipotezat dhe një metodologji të Analizës së Kosto – Përfitimit në përputhje me Nenin 156 (11) të Rregullores së Komisionit (BE) 2017/1485 të datës 2 gusht 2017, që përcakton një udhëzues mbi operimin e sistemit të transmetimit të energjisë elektrike.
- Propozimi i të gjitha OST-ve mbi Kërkesat Organizative, Rolet dhe Përgjegjësitë (KORP) në lidhje me Shkëmbimin e të Dhënave në përputhje me Nenin 40 (6) të Rregullores së Komisionit (BE) 2017/1485 të datës 2 gusht 2017 Udhëzim për Operimin e Sistemit të Transmetimit të Energjisë.

Pas certifikimit të operatorëve të transmetimit në sektorët respektivë, të monitorojë në mënyrë të vazhdueshme këta operatorë për të siguruar përmbushjen e detyrimeve që burojnë nga statusi i operatorit të certifikuar.

Gjatë vitit 2018, ERE ka marrë vendimet si më poshtë:

- Vendimi nr. 59, datë 15.03.2018, "Mbi miratimin e kërkesës së OST sh.a. për shtyrtjen e afatit të pikës 2 të vendimit të ERE nr. 43 datë 15.03.2017, mbi miratimin përfundimtar të certifikimit të operatorit të sistemit të transmetimit të energjisë elektrike OST sh.a. në përputhje me nenin 54, pika 6, të ligjit nr. 43/2015, "Për Sektorin e Energjisë Elektrike" dhe nenin 9, pika 6, të Direktivës 72/2009 EC mbas marrjes së opinionit të Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë.

Ky vendim konsiston në shtyrjen e afatit të përmbushjes së kushteve të tij, nga ana e OST sh.a.

Në lidhje me plotësimin e kushteve të vendimit të certifikimit të OST sh.a, pas shtyrjes sipërcituar, ERE ka monitoruar procesin e përmbushjes së kushteve duke kërkuar nga OST sh.a të bëjë me dije statusin e përmbushjes së tyre.

OST sh.a ka raportuar duke bërë me dije se kanë mbetur pa plotësuar, kushtet, për të cilët janë paraqitur edhe propozimet përkatëse për zgjidhjen e kushteve të mëposhtme:

- *Ndarja e Operatorit të Tregut. Për realizimin e këtij qëllimi, OST sh.a. duhet të marrë masat paraprake dhe të bashkëpunojë brenda kompetencave të saj për realizimin e detyrimeve ligjore të përcaktuara në ligj, për sigurimin e përmbushjes së detyrimit për ndarjen financiare dhe ligjore të Operatorit të Tregut, siç është parashikuar në nenin 57/2 të Ligjit nr. 43/2015, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, të ndryshuar, në përputhje me Rregullat e Tregut të miratuara nga ERE dhe në përputhje me vendimin e Këshillit të Ministrave për ndarjen e Operatorit të Tregut.*
- *Bashkëpunimin ndër – institucional për realizimin e ndryshimeve në kuadrin ligjor dhe transferimi i kompetencave tek Ministria e Ekonomisë. Për përmbushjen e këtij detyrimi, OST sh.a. do t’i paraqesë ERE-s provat dokumentare që ndryshimet ligjore dhe nënligjore të nevojshme që lidhen me transferimin e kompetencave të Ministrisë së Energjisë dhe Industrisë tek aksionari i OST sh.a., Ministria e Ekonomisë, kanë ndodhur dhe janë efektive.*

ERE për këtë qëllim ka komunikuar edhe me MIE për të kërkuar mbështetjen e kësaj të fundit për qëllime të implementimit e nenit 56 të Ligjit nr. 43/2015, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike” të ndryshuar dhe vendimeve të ERE-s, nr. 43, datë 15.03.2017, dhe nr. 59, datë 15.03.2017, për të siguruar kështu ndarjen e OST sh.a nga Operatori i Tregut dhe ngritjen e Bursës Shqiptare të Energjisë si dhe për hartimin e drafteve të VKM-së “Për Krijimin dhe strukturën e kapitalit të Operatorit të Tregut” dhe VKM “Për caktimin e kritereve dhe procedurave të përzgjedhjes së pjesëmarrësve në kapitalin e Operatorit të Tregut.”

- Vendimi nr. 236, datë 02.11.2018, “Për një ndryshim në vendimin e Bordit të ERE-s, nr. 179, datë 08.11.2017, “Mbi certifikimin e shoqërisë “Operatori i Kombinuar i gazit natyror” Albغاز sh.a.”

Ky vendim konsiston në shtyrjen e afatit të përmbushjes së kushteve të tij, nga ana e Albغاز sh.a, duke qënë se ky i fundit e pati të pamundur ti plotësonte brenda afatit që përcaktonte vendimi nr. 179, datë 08.11.2017.

ERE për këtë qëllim ka komunikuar edhe me MIE për të kërkuar mbështetjen e kësaj të fundit për qëllime plotësimin e kushteve, si më poshtë:

- Pika 2. Brenda 1 muaji nga hyrja në fuqi e këtij vendimi Albغاز sh.a të zëvendësojë përfaqësuesit e MIE tek Këshilli Mbikqyrës i kompanisë me antarë të cilët nuk janë të punësuar tek MIE ose tek kompanitë e prodhimit dhe/ose furnizimit të energjisë elektrike që kontrollohen nga ajo.
- Pika 3. Albغاز të raportojë çdo muaj në ERE procedurën për rregjistrimin e aseteve të transmetimit dhe t’a përfundojë procedurën brenda gjashtë muajve pas miratimit të Vendimit Përfundimtar.

- Pika 4. Paragrafi “si dhe duhet që të hartojë dhe t’i dorëzojë ERE-s, Raportin e përcaktuar sipas Programit të Përputhshmërisë rregullatore jo më vonë se 12 muaj nga miratimi i Vendimit të Certifikimit të Albgaz sh.a., konform përcaktimeve të nenit 21 të Direktivës nr.73/2009 të Komisionit Europian, “Mbi rregullat për tregun e gazit natyror” dhe nenit 47 të ligjit nr. 102/2015, “Për Sektorin e Gazit Natyror” Pika 5. Brenda 12 muajve nga hyrja në fuqi e këtij vendimi, për qëllime të implementimit të rekomandimeve në Opinionin e Sekretariatit, Albgaz sh.a., të paraqesë në ERE dëshmi që tregon garancinë në lidhje me: 5.2 Bashkëpunimin ndërinstitucional për realizimin e ndryshimeve në kuadrin ligjor, Neni 11 dhe 46 (10) i Ligjit nr. 102/2015, “Për Sektorin e Gazit Natyror” dhe transferimi i kompetencave tek Ministria e Ekonomisë. Për përmbushjen e këtij detyrimit, Albgaz sh.a. do të paraqesë ERE provat dokumentare që ndryshimet ligjore dhe nënligjore të nevojshme që lidhen me transferimin e kompetencave të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë tek aksionari i Albgaz sh.a., Ministria e Ekonomisë dhe Financave, kanë ndodhur janë efektive.
- Pika 7. Albgaz sh.a., do të raportojë çdo 3 muaj në tek ERE dhe Sekretariati i Komunitetit të Energjisë në lidhje me përmbushjen e detyrimeve të pikave 2, 3, 4 dhe 5 të këtij vendimi si dhe me ecurinë e procesit të transferimit të kompetencave nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë tek Ministria e Ekonomisë dhe Financave.

Në lidhje me rritjen e përpjekjeve dhe luajtjen e një roli proaktiv për liberalizimin gradual dhe hapjen efektive të tregut të energjisë, për të siguruar shërbime të drejta e të besueshme për klientët dhe që rrisin konkurrencën në tregun e energjisë elektrike, ju bëjmë me dije se:

Gjatë vitit 2018 ka vijuar dalja e klientëve në tregun e hapur të energjisë elektrike. Tashmë përveç atyre të lidhur në nivelin e tensionit 220 kV : 110 kV (gjithësej 17 klientë me konsum vjetor 957 GWh) kanë dalë në treg të hapur edhe ato të lidhur në 35 kV, ku 16 klientë me konsum rreth 15 GWh, marrin vetëm shërbimin e shpërndarjes, ndërsa në cilësinë e klientëve që furnizohen nga FMF numërohen 79 të tillë me konsum 57 GWh.

Në lidhje me shtimin e numrit të implementimit të impianteve fotovoltaike në ndërtesa, të mbikqyrë mbarëvajtjen dhe të bashkëpunojë me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë dhe institucionet e tjera për përgatitjen dhe miratimin e vendimeve përkatëse për zgjidhjen e problemeve, si nga pikëpamja teknologjike, ashtu edhe financiare për energjinë e tepërt të gjeneruar nga këto impiante, bëjmë me dije se:

ERE me shkresën nr. 573 Prot., datë 07.09.2018, i është drejtuar MIE dhe OSHEE sh.a duke i kërkuar bashkëpunim për evidentimin e problemeve teknike dhe financiare që shkaktohen nga implementimi i këtyre impianteve në ndërtesa, për të vijuar më tej me zgjidhjen e nevojshme përfshirë propozimet për nxjerrjen e akteve ligjore e nënligjore.

Në vijim OSHEE sh.a me shkresën nr. 573/1 Prot., datë 06.12.2018, ka përcjellë në ERE pamundësinë për të lidhur në rrjetin e shpërndarjes këtë kategori prodhuesish.

ERE me shkresën nr. 166 Prot., datë 18.02.2019, i drejtohet OSHEE sh.a dhe për dijëni MIE në të cilën i rikujton OSHEE sh.a detyrimin ligjor të përcaktuar në Ligjin nr. 7/2017 “Për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme”, i cili duhet të zbatohet nga OSHEE sh.a duke marrë masa për lidhjen e këtyre impianteve në rrjetin e shpërndarjes së energjisë elektrike.

Në lidhje me vijimin e punës për zhvillimin e tregut të gazit, si një kusht i rëndësishëm për të garantuar sigurinë afatgjatë të furnizimit me gaz natyror dhe diversifikimin e burimeve në vend, bëjmë me dije se:

ERE gjatë këtij viti me vendimin nr. 256, datë 17.12.2018, ka licencuar shoqërinë “Balkgaz” sh.p.k., në veprimtarinë e tregtimit të gazit natyror (shitje me shumicë).

Po ashtu ERE ka miratuar aktet nënligjore rregullatore për sektorin e gazit natyror si më poshtë:

- Vendimi nr. 7, datë 10.01.2018, “Mbi miratimin e licencës tip të aktivitetit të shpërndarjes së gazit natyror.”
- Vendimi nr. 8, datë 10.01.2018, “Mbi miratimin e licencës tip të aktivitetit të transmetimit të gazit natyror”.
- Vendimi nr. 18, datë 10.01.2018, “Mbi miratimin e Rregullores së procedurave të paraqitjes së planit të investimeve nga operatorët e transmetimit dhe shpërndarjes së gazit natyror.”
- Vendimi nr. 23, datë 30.01.2018, “Mbi miratimin e Rregullores për ndryshimin e furnizuesit në sektorin e gazit natyror”.
- Vendimi nr. 24, datë 30.01.2018, “Mbi miratimin e licencës tip të aktivitetit të tregtimit të gazit natyror.”
- Vendim nr. 25, datë 30.01.2018, “Mbi miratimin e licencës tip në aktivitetin e furnizimit të gazit natyror.”
- Vendimi nr. 80, datë 06.04.2018, “Mbi miratimin e rregullave operacionale për furnizuesin e mundësisë së fundit të gazit natyror.”
- Vendimi nr. 81, datë 06.04.2018, “Mbi miratimin e rregullave për sigurimin e aksesit të palëve të treta në sistemin e transmetimit dhe transparencën në sektorin e gazit natyror.”
- Vendimi nr. 161, datë 09.07.2018, “Për miratimin e Rregullores mbi kushtet e përgjithshme të shërbimit të furnizimit me gaz natyror për klientët fundorë”.
- Vendimi nr. 223, datë 16.10.2018, “Mbi miratimin e kërkesave minimale për zyrtarin e përputhshmërisë, kriteret profesionale si dhe kriteret e tjera përzgjedhëse” dhe miratimin paraprak të zyrtarit të përputhshmërisë së OST të gazit natyror.”
- Vendimi nr. 248, datë 11.12.2018, “Mbi miratimin e kontratës nr. 116 datë 20.11.2018 “për shërbimin e transmetimit të gazit natyror të lidhur ndërmjet shoqërisë “Albgaz” sh.a. dhe shoqërisë “Albpetrol” sh.a., për periudhën 01.01.2018 - 31.12.2018.”

Në kuadër të mbrojtjes së konsumatorit, përmes kompetencave që i jep ligji, të kërkojë nga OSHEE-ja respektimin e të drejtave të konsumatorit, përmirësimin e shërbimit të kujdesit për klientin, evidentimin dhe ndëshkimin e sjelljeve arbitrare dhe të papërgjegjshme nga

punonjës të OSHEE-së, si dhe respektimin e afateve për shërbimet përkatëse, të cilat jo rrallë nuk respektohen, duke krijuar vonesa, të cilat lënë vend për abuzim dhe korrupsion.

Lidhur me këtë problematike në ERE janë paraqitur 279 ankesa. Kryesisht objekti i këtyre ankesave ka qenë shkelja e kushteve të kontratës së shërbimit universal të furnizimit me energji elektrike. Në vazhdimësi ERE i ka kërkuar kompanisë OSHEE sh.a, të trajtojnë pa vonesë dhe brenda afateve ligjore të gjitha ankesat e konsumatorëve të energjisë elektrike. Kjo duke i përcaktuar afate për kthimin e përgjigjeve nga ana e kompanisë të trajtimin të ankesave duke kërkuar, zbatimin e detyrimeve që burojnë nga Ligj nr. 43/2015” *Për Sektorin e Energjisë Elektrike*” i ndryshuar si dhe akteve nënligjore në fuqi dhe konkretisht: “Kushteve të përgjithshme të kontratës së shërbimit universal të furnizimit për klientët fundor”. ERE është në proces monitorimi të shqyrtimit të të gjithë rasteve të ankesave ende të pa trajtuara.

Gjithashtu në këtë kuadër, ERE ka filluar dhe vijon monitorimin e veprimtarisë së OSHEE sh.a në lidhje me respektimin e të drejtave të klientëve në zbatim të rregulloreve që ka miratuar ERE për këtë qëllim.

Në kuadër të mbrojtjes së konsumatorit dhe për të bërë të mundur që përdoruesit të mos ndihen të pambrojtur në një treg, i cili akoma nuk është liberalizuar, ERE ka miratuar me vendimin nr. 201, datë 03.09.2018, dhe i ka vendosur si detyrim OSHEE sh.a zbatimin e një plani masash me detyra konkrete.

Ky plan identifikon qartësisht përgjegjësitë e Furnizuesit në kuadër të detyrimit të shërbimit publik të tillë si: E drejta e informimit, aksesit të klientit ndaj shërbimeve, e drejta për të paraqitur ankesë ndaj shërbimit të ofruar, e drejta e zgjedhjes, përfshirë e drejta e zgjedhjes së modaliteteve të pagesave, e drejta e zgjedhjes së furnizuesit, e drejta për t’u informuar për çmimet.

Sa i përket punës me qëllim rritjen e ndërgjegjesimit të klientëve për të drejtat e tyre, që lidhen me shërbimin e furnizimit me energji elektrike, ERE e ka kryer këtë mision nëpërmjet publikimeve në faqen zyrtare të web-it, si dhe në rrjetet sociale.

Të vijojë t’i kushtojë një vëmendje të veçantë kujdesit për mbrojtjen e interesave të klientëve, duke trajtuar jo vetëm ankesat e përcjella për kompetencë në ERE, por duke marrë pjesë në proceset gjyqësore, në të cilat klientët ushtrojnë të drejtën kushtetuese për ankesë ndaj Operatorit të Shpërndarjes.

Në këtë kuadër ERE, ka shqyrtuar administrativisht konform procedurës dhe brenda afateve ligjore, ankesat e paraqitura nga klientët e energjisë elektrike. Sigurisht kjo nuk i ka penguar këta të fundit, që ti drejtohen organeve gjyqësore për të kërkuar të drejtën e tyre, të pretenduar të cënuar nga Shoqëria e furnizimit “OSHEE” sh.a. Në këto kushte ata e kanë gjykuar të arsyeshme që ERE të jetë pjesë e procesit gjyqësorë, në cilësinë e personit të tretë, kur ata kanë thirrur si të paditur në gjykatë, kompaninë OSHEE sh.a.

3.2 Licencimi dhe Monitorimi i Veprimtarive në Tregun e Energjisë Elektrike

3.2.1 Licencimet dhe Kërkesat e Trajtuara gjatë Vitit 2018.

Gjatë vitit 2018, ERE ka kryer një veprimtari të gjërë për licencimin e subjekteve në aktivitetet e ndryshme të sektorit të energjisë elektrike dhe gazit natyror, në zbatim të kuadrit ligjor e nënligjor në fuqi. Ajo që spikati këtë vit ka qënë rritja e numrit të aplikimeve për licencimi në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centralet fotovoltaike.

Për të gjitha aplikimet e paraqitura, është respektuar transparenca e parashikuar në procedurat për licensim, në zbatim të Ligjit nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, të ndryshuar, Ligjit nr.102/2015 “Për Sektorin e Gazit Natyror”, si dhe të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e liçensave në sektorin e energjisë elektrike dhe të gazit natyror“. Në përputhje me kuadrin ligjor të mësipërm janë zbatuar afatet e publikimit në median e shkruar për marrjen e opinionit nga të interesuarit. Gjithashtu çdo aplikim për licensim i është nënshtruar një analize të kujdesshme të rregullshmërisë dhe plotësimit me korrektësi të dokumentacionit ligjor, administrativ, financiar, teknik dhe marrjes së lejeve përkatëse të përdorimit të ujrave apo leje mjedisore, të dhëna nga institucionet e tjera në përputhje me veprimtarinë që subjektet kanë kërkuar të licensohen.

Subjektet e licensuar, në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike për vitin 2018:

SUBJEKTI	PRODHUES ENERGJIE ELEKTRIKE	FUQIA E INSTALUAR
“HEC Llenge” sh.p.k	H/C “Llënga 1” H/C “Llënga 2” H/C “Llënga 3”	1730 kW 300 kW 1500 kW
“Alesio - 2014”sh.p.k	H/C “Kryezi”	1990 kW
“Lucente Koncesionare” sh.p.k	H/C “Spatharë”	1038 kW
“Hydro Seta” sh.p.k	H/C “Seta 1+2” H/C “Seta 3” H/C “Seta 4”	7454 kW 2722 kW 4724 kW
“Favina 1” sh.p.k	H/C “Voskopjë”	1970 kW
“AGE Sunpower” sh.p.k	Centrali fotovoltaiik Topojë (Sheq Marinas)	2000 kW
“Seman Sunpower” sh.p.k	Centrali fotovoltaiik Topojë (Sheq Marinas)	2000 kW
“Malësia Solar 1” sh.p.k	Centrali fotovoltaiik “Lahë e Poshtëme” Shkrel, Koplik, Rrethi Malësi e Madhe, Qarku Shkodër.	2500 kW

“Malësia Solar 2” sh.p.k	Centrali fotovoltaiq “Lahë e Poshtëme” Shkrel, Koplik, Rrethi Malësi e Madhe, Qarku Shkodër.	2500 kW
“Malësia Solar 3” sh.p.k	Centrali fotovoltaiq “Lahë e Poshtëme” Shkrel, Koplik, Rrethi Malësi e Madhe, Qarku Shkodër.	2500 kW
“OSOJA Energy” sh.p.k	Centrali fotovoltaiq Seman-1 Sheq Marinas Fier.	2000 kW
“Seman2Sun” sh.p.k	Centrali Fotovoltaiq Seman – 2, Sheq Marinas, Fier	2000 kW
“Caushi Energy” sh.p.k	H/C Qafzezë”	400 kW
“SONNE” sh.p.k	Centrali Fotovoltaiq, Topojë	1998 kW
“AED Solar” sh.p.k	Centrali fotovoltaiq Topojë	1998 kW
“Domi - Tec” sh.p.k	H/C “Plepi”	2285 kW
“Blac Energy” sh.p.k	H/C “Blac”	1300 kW
“Ediani” sh.p.k	H/C “Shëngjon 1” H/C “Shëngjon 2” H/C “Shëngjon 3”	651 kW 356 kW 341 kW
“Alesio - 2014” sh.p.k	H/C “Fushë Arrëz”	1990 kW
DERBI – E	H/C “Antena”	1105 kW
“AEE” sh.p.k	Centrali Fotovoltaiq “Plug”	2000 kW
“OSOJA HPP” sh.p.k	H/C “Osoja”	1952 kW
“BE-IS Energy”	H/C “Kalivar 1” H/C “Kalivar 2” H/C “Kalivar 3” H/C “Kalivar 4”	1475 kW 1526 kW 3321 kW 275 kW

- Nga Bordi i ERE-s gjatë vitit 2018 është miratuar modifikimi i licencës së prodhimit të energjisë elektrike të shoqërisë “Hidropower Elektrik” sh.p.k., me numër. 130, Seria PV11K, miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE nr. 59, datë 22.06.2011, për prodhimin e energjisë elektrike nga HEC-et “SLABINJE 2A” me fuqi 2 MW, “SLABINJE 2B” me fuqi 1600 kW, “SLABINJE 2C” me fuqi 1800 kW, “SLABINJE 2D” me fuqi 5000 kW dhe “SLABINJE 2E” me fuqi 3400 kW, duke miratuar emërtimet dhe fuqitë e mëposhtme:
 - Hec “Sllabinja 2B”, fuqi të instaluar 1800 kW;
 - Hec “Sllabinja 2C” me fuqi të instaluar 3400 kW;

- Hec “Sllabinja 2D&2D/I”(fuqia e instaluar N/1.= 4885 kW dhe N/2. =1200 kW);
 - Hec “Sllabinja 2E” me fuqi të instaluar 3800 kW;

Dhe fuqi totale të instaluar N= 15085 kW.
- Po ashtu u miratua modifikimi i licencës nr. 181, Seria PV12K e subjektit “ÇAUSHI ENERGJI” sh.p.k, për prodhimin e energjisë elektrike nga Hec “Qafëzezë”, me fuqi të instaluar 400 KW, të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr. 122 datë 29.08.2012, me kushtin që brenda 3 muajve nga marrja dijani e këtij vendimi, të depozitohet në ERE lejen mjedisore dhe lejen e shfrytëzimit të ujrave, të lëshuara nga institucionet kompetente për fuqinë e instaluar 1450 kW. Duke qënë se kushti nuk u plotësua nga subjekti, Bordi i ERE me vendimin nr. 218, datë 11.10.2018, vendosi për:
 1. *Shfuqizimin e Vendimit të Bordit të ERE-s nr. 133, datë 07.06.2018, “Mbi kërkesën e shoqërisë “Çaushi - Energji” sh.p.k. për modifikimin e licencës së “Prodhimit të energjisë elektrike” nr. 181, Seria PV12K, të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 122, datë 29.08.2012”.*
 2. *Refuzimin e kërkesës së shoqërisë “Çaushi Energji” sh.p.k për modifikimin e licencës së Prodhimit të energjisë elektrike me nr. 181, Seria PV12K, të miratuar me Vendimin e Bordit të ERE-s Nr. 122, datë 29.08.2012.*
- Bordi i ERE-s gjatë vitit 2018, në mbështetje të nenit 16; nenit 19, gërma “d”; nenit 37, pika 2, gërma “ç” dhe nenit 44, të Ligjit nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, i ndryshuar; nenit 2 dhe nenit 4 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 244, datë 30.03.2016 i ndryshuar, “Kushtet për vendosjen e detyrimit të shërbimit publik, që do të zbatohen ndaj të licencuarve në sektorin e energjisë elektrike, të cilët ushtrojnë aktivitetin e prodhimit, transmetimit, shpërndarjes dhe furnizimit me energji elektrike”; nenit 4, pika 1, gërma “c”; nenit 5, pika 1, gërma “c”; nenit 13; nenit 17, pikat 1, 2, 4 dhe 5 të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në Sektorin e Energjisë Elektrike”, të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.06.2016, si dhe nenit 15 të “Rregullores së Organizimit, Funkcionimit dhe Procedurave të ERE-s”, miratuar me Vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.06.2016, ka vendosur transferimin e licencës së furnizimit të energjisë elektrike me nr. 251 me Seri P14FPP miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 97, datë 27.10.2014, e vlefshme deri më datë 27.10.2019 dhe detyrimit të shërbimit universal të furnizimit të energjisë elektrike, të shoqërisë Operatori i Shpërndarjes së Energjisë elektrike sh.a. (OSHEE sh.a.), miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 112, datë 08.07.2016 tek shoqëria "Furnizuesi i shërbimit universal“ sh.a. (FSHU)
- Bordi i ERE-s në mbështetje të nenit 16, nenit 37, pika 2 gërma “c”, si dhe nenit 44 të Ligjit nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike” i ndryshuar, nenit 4, pika 1, gërma “c”; nenit 5, pika 1 gërma “c”; nenit 13 dhe nenit 17, pikat 1, 2, 4 dhe 5, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me Vendimin e Bordit të ERE-s, nr. 109, datë 29.06.2016, si dhe nenit 15 të “Rregullave të Organizimit, Funkcionimit dhe Procedurave të ERE-s”, miratuar me Vendimin e Bordit të ERE nr. 96, datë 17.06.2016, vendosi transferimin e licencës së Operimit të Sistemit të Shpërndarjes së Energjisë

Elektrike, të shoqërisë “Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike” sh.a.(OSHEE sh.a.), me nr. 250, Seria P14SH, miratuar me Vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr. 96, datë 27.10.2014, tek shoqëria "Operatori i Sistemit të Shpërndarjes" sh.a. (O.S.SH sh.a.) e vlefshme deri më datë 27.10.2044.

Të licensuarit në veprimtarinë e Tregimit të Energjisë Elektrike gjatë 2018:

Nr.	SUBJEKTI	AKTIVITETI I LICENSUAR	DATA E VENDIMIT TË BORDIT
1	“Wind Power Albania” sh.p.k	Tregëtim	Vendimi Nr. 58, datë 12.03.2018
2.	“Smart Watt” sh.p.k	Tregëtim	Vendimi Nr. 72, datë 26.03.2018
3.	“DON - UCD” shpk	Tregëtim	Vendimi Nr. 158, datë 09.07.2018
4.	“ReNRGY Trading Group” sh.p.k	Tregëtim	Vendimi Nr. 163, datë 19.07.2018
5.	“Uradrin” sh.p.k	Tregëtim	Vendimi Nr. 172, datë 03.08.2018
6.	“FLT” sh.a	Tregëtim	Vendimi Nr. 198, datë 03.09.2018
7.	“AEE” sh.p.k	Tregëtim	Vendimi nr. 210, datë 27.09.2018
8.	“ENER TRADE” sh.p.k	Tregëtim	Vendimi Nr. 226, datë 26.10.2018

- Heqja e licencës nr. 124, Seria T11P, shoqërisë “Hec-Dunicë” sh.p.k, për tregtimin të energjisë elektrike, miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr. 28, datë 10.03.2011. Heqja e licencës u bë me kërkesë të subjektit duke qënë në kushtet e paaftësisë për të vazhduar veprimtarinë.
- Shfuqizimi i vendimin nr. 8, datë 04.02.2009, të Bordit të Komisionerëve të ERE “Për licencimin e shoqërisë “ENPOWER ALBANIA” sh.p.k, për kryerjen e aktivitetit të tregimit të energjisë elektrike”, i ndryshuar, pasi u konstatuan shkelje të kushteve të licencës nga ana e subjektit.
- Heqja e licencës nr. 255, Seria T14, shoqërisë “EFT ALBANIA” sh.p.k, për tregtimin të energjisë elektrike, miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr. 108, datë 14.11.2014. Heqja e licencës u bë me kërkesë të subjektit në kuadër të një riorganizimi brenda grupit të kompanive të EFT Group.
- Modifikimi i licencës së shoqërisë “Energia Gas and Power Albania” sh.p.k, në veprimtarinë e tregimit të energjisë elektrike me nr. 258, Seria T14, të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr. 133, datë 24.12.2014. Me këtë modifikim ka ndryshuar emri i subjektit dhe emri tregtar si më poshtë:
 - Emri i ri i subjektit bëhet: “Energia Gas and Power Albania”
 - Emri i ri tregtar bëhet: “Energia Gas and Power Albania”
- Modifikimi i licencës së shoqërisë “GEN – I Tirana” sh.p.k me nr. 74, Seria T08P, në veprimtarinë e tregimit të energjisë elektrike, për një afat 5 vjeçar.
- Heqja e licencës nr. 278, Seria T15, shoqërisë “ROBERTO OIL” sh.p.k, për tregtimin e energjisë elektrike, miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr. 49, datë 17.04.2015. Heqja e licencës u bë me kërkesë të subjektit për arsye të mos ushtrimit të veprimtarisë.

Subjektet e licensuar në aktivitetin e Furnizimit të Energjisë Elektrike, gjatë vitit 2018 :

Nr.	SUBJEKTI	AKTIVITETI I LICENSUAR	DATA E VENDIMIT TE BORDIT
1	“Energji Ashta” shpk	Furnizim	Vendimi Nr. 26, Datë 30.01.2018

2.	“Wind Power Albania” shpk	Furnizim	Vendimi Nr. 126, Datë 04.06.2018
3.	“FTL” sh.a	Furnizim	Vendimi Nr. 199, Datë 03.09.2018
4.	“DON - UCD” sh.p.k	Furnizim	Vendimi Nr. 219, Datë 11.10.2018
5.	“ENER TRADE” sh.p.k	Furnizim	Vendimi Nr. 227, Datë 26.10.2018
6.	“ReNRGY Trading Group” sh.p.k	Furnizim	Vendimi Nr. 245, Datë 26.11.2018
7.			

- Heqja e licencës së shoqërisë “EFT Albania” sh.p.k me nr. 256 Seria FK14, miratuar me Vendimin e Bordit të ERE nr. 109, datë 14.11.2014. Heqja e licencës u bë me kërkesë të subjektit në kuadër të një riorganizimi brenda grupit të kompanive të EFT Group.
- Modifikimi i licencës së shoqërisë “Energia Gas and Power Albania” sh.p.k, në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike me nr. 322, Seria F15, të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr. 159, datë 28.12.2015. Me këtë modifikim ka ndryshuar emri i subjektit dhe emri tregtar si më poshtë:
 - Emri i ri i subjektit bëhet: “Energia Gas and Power Albania”
 - Emri i ri tregtar bëhet: “Energia Gas and Power Albania”
- Modifikimi i licencës së shoqërisë “GEN – I Tirana” sh.p.k me nr. 73, Seria FK08, në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike, për një afat 5 vjeçar.
- Transferimi i licencës së Furnizimit të Energjisë Elektrike me nr. 251, Seria P14FPP, miratuar me Vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr. 97 date 27.10.2014, e vlefshme deri më datë 27.10.2019, dhe Detyrimit të shërbimit universal të furnizimit të energjisë elektrike, të shoqërisë “Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike” sh.a. (OSHEE sh.a), miratuar me Vendimin e Bordit të ERE-s nr. 112, datë 08.07.2016, tek shoqëria "Furnizuesi i Shërbimit Universal“ sh.a. (FSHU sh.a).
- Heqja e licencës nr. 279, Seria FK15, shoqërisë “ROBERTO OIL” sh.p.k, për furnizimin e energjisë elektrike, miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr. 50, datë 14.11.2015. Heqja e licencës u bë me kërkesë të subjektit për arsye të mos ushtrimit të veprimtarisë.

Subjektet e licensuar në aktivitetet e Gazit natyror për vitin 2018

Nr.	SUBJEKTI	AKTIVITETI	DATA E VENDIMIT TE BORDIT
1	“Balkgaz” sh.p.k	Tregëtim	Vendimi Nr. 256, datë 17.12.2018

Për të gjithë subjektet e licensuar nga ERE, mbahet dhe arshivohet regjistri për secilin aktivitet, me të dhënat e nevojshme për subjektin dhe llojin e licensës, të cilat pasqyrohen të përditesuara në faqen e internetit të ERE dhe mund të konsultohen nga çdo palë e interesuar.

3.3 Monitorimi i Veprimtarive në Tregun e Energjisë Elektrike

3.3.1 Monitorimi i Tregut të Energjisë Elektrike.

Edhe gjatë vitit 2018 ka vazhduar e njëjta strukturë monitorimi bazuar në përmbushjen e detyrave funksionale të strukturave organizative të ERE-s si dhe në bashkëpunimin ndërsektorial lidhur me problematika të diktuar nga situatat e krijuara.

Në zbatim të Ligjit nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, neni 7, neni 20, gërma ç), d), f) dhe g), neni 22, neni 58, pika 9, neni 62, pika 4 si dhe neni 72, gërma dh); Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr. 244, datë 30.03.2016 “Për miratimin e kushteve për vendosjen e detyrimit të shërbimit publik, që do të zbatohen ndaj të licensuarve në sektorin e energjisë elektrike, të cilët ushtrojnë aktivitetin e prodhimit, transmetimit, shpërndarjes dhe furnizimit me energji elektrike”, neni 13; si dhe kushtet e licensave të lëshuara nga ERE, shërbimet e operatorëve të licensuar nga ERE janë objekt i monitorimit në lidhje me respektimin e detyrimeve ligjore si dhe zbatimin e rregullave, vendimeve dhe urdhërave të ERE-s.

Monitorimet janë kryer bazuar në Ligjin Nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”; në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 244, datë 30.03.2016 i ndryshuar, në VKM Nr.519 datë 13.07. 2016, në Rregullat e Tregut, si dhe në rregulloret përkatëse mbi bazën e të cilave veprojnë pjesëmarrësit e tregut.

- Mbledhja dhe përpunimi i rezultateve periodike (muajore) dhe informacioneve.
- Përpunimi i rezultateve të marra nga operatorët apo të konstatuara nga monitorimet në terren
- Identifikimi i çështjeve për monitorim në terren.
- Monitorim për zbatimin e rregulloreve
- Kryerja e monitorimeve në terren dhe analizimi i tyre.

Për sa i përket monitorimit periodik të nivelit të realizimit të treguesve nga operatorët, janë mbledhur e përpunuar treguesit e planifikuar duke shfrytëzuar informacionet periodike të pjesëmarrësve të tregut të energjisë elektrike. Tashmë është kthyer në rutinë muajore mbledhja e përpunimi i indikatorëve të domosdoshëm që ndihmojnë të gjitha strukturat për të gjykuar lidhur me ecurinë, problematikat dhe trendet e zhvillimit në këtë sektor.

Janë paraqitur në mënyrë të përmbledhur shumica e të dhënave të përpunuara duke dhënë edhe mundësinë e krahasimit me vitet paraardhëse.

Mbetet e nevojshme përgatitja e vënia në funksionim e një Platforme elektronike të gjithë sektorit e cila do të detyrojë pjesëmarrësit në tregun e energjisë për të plotësuar të gjitha detyrimet që rrjedhin nga Direktivat dhe Rregulloret e KE-së si dhe Ligjet 43/2015 dhe 102/2015, njëkohësisht do të shërbejë të gjithë të interesuarve për marrjen në kohë reale të informacioneve të nevojshme.

Nga analizimi i rezultateve dhe përpunimi i problematikave e informacioneve të marra, nga strukturat drejtuese të ERE-s, është gjykuar sipas rastit të zhvillohen verifikime, analiza, seanca dëgjimore dhe monitorime në terren.

Rezultatet e këtyre aktiviteteve i kane shërbyer strukturave përkatëse për një vendimmarrje sa më të drejtë.

Grupet e monitorimeve specifike janë organizuar me pjesëmarrje nga drejtori e sektorë të tjerë me qëllim sigurimin e specialistëve të nevojshëm në procesin e monitorimit .

Është analizuar situata e raportimeve periodike të të licensuarve ku konstatohen mangësi nga ana e tyre në respektimin e detyrimit për raportim periodik.

Përfaqësues të Drejtorive të ERE-s janë anëtarë të grupeve të punës së organizmave ndërkombëtare sipas urdhrave e Udhëzimeve të Kryetarit të ERE-s duke informuar rast pas rasti për zhvillimet.

Plotësimi me informacionin e kërkuar të institucioneve e organizatave të ndryshme bashkëpunuese me ERE-n, si dhe pjesëmarrja në takime, ka qënë objekt pune specifike e ERE-s.

Në mënyrë që të rritet transparenca në tregun e energjisë elektrike, me Vendimin e ERE-s Nr. 118, Datë 27.07.2017 u miratuan “Rregullat për publikimin e të dhënave bazë të tregut të energjisë elektrike”, ndërkohë publikimi i të dhënave kryesore katërmujore për funksionimin e tregut të energjisë elektrike publikohen rregullisht në faqen e internetit të ERE-s sipas parashikimeve të Ligjit nr.43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”. Për të siguruar zbatimin e parashikimeve ligjore dhe nënligjore të detyrimeve që lidhen me transparençën në tregun e energjisë ERE ka monitoruar periodikisht faqet e internetit të operatorëve kryesorë në tregun e energjisë, ku rezultojn se këto detyrime zbatohen kryesisht.

3.3.2 Monitorime Specifike nga informacionet periodike të OSHEE sh.a

Në tabelën e mëposhtme paraqiten rezultatet e treguesve të vazhdimësisë së furnizimit me energji të klientëve të OSHEE sh.a gjatë vitit 2018.

TREGUESIT E VAZHDIESHMERISE SE FURNIZIMIT ME ENERGIJ E LEKTRIKE NE TENSION TE LARTE E TE MESEM GJATE VITIT 2018																							
		SHKAKU I NDERPRERJES				Numri i Konsumatoreve te lidhur			Nderprerje te Planifikuara				Nderprerje te PaPlanifikuara				SAIFI	SAIDI	CAIDI	N1	D1		
		Nderprerje e Planifikuar	Force Majeure	Pergjegjesi e pakete te treta	Pergjegjesi e OSHEE	GJITHSEJ	ZONE URBANE	ZONE RUKALE	Nr. Konsumatoreve te prekur GJITHSEJ	Nr. Konsumatoreve te prekur Zone URBANE	Nr. Konsumatoreve te prekur Zone RUKALE	Nr konsumatorësh X Kohe	KOHEZGJATJA (ore)	Nr. Konsumatoreve te prekur GJITHSEJ	Nr. Konsumatoreve te prekur Zone URBANE	Nr. Konsumatoreve te prekur Zone RUKALE						Nr konsumatorësh X Kohe	KOHEZGJATJA (ore)
Janar	Total TL	75	16	2	65	1,215,818	682,435	533,383	207,900	49,196	158,704	476,358	148	499,421	104,929	394,492	1,062,557	193	0.58	1.27	2.18	0.41	0.87
	Tot TM	186	457	130	1,729	1,215,818	682,435	533,383	181,101	33,256	142,654	399,962	431	2,605,916	528,329	2,077,587	5,639,181	7,537	2.29	4.97	2.17	2.14	4.64
Shkurt	Total TL	59	41	27	114	1,215,818	682,435	533,383	181,286	39,166	142,120	444,516	140	432,065	111,712	320,353	872,023	275	0.50	1.08	2.15	0.36	0.72
	Tot TM	189	698	150	2,506	1,215,818	682,435	533,383	205,921	37,230	1,803	452,501	463	3,335,149	757,654	5,043	7,216,476	13,399	2.91	6.31	2.17	2.74	5.94
Mars	Total TL	83	54	54	219	1,215,818	682,435	533,383	194,788	44,050	150,738	457,639	193	833,096	228,173	604,923	1,102,213	360	0.85	1.28	1.52	0.69	0.91
	Tot TM	208	1,161	182	2,795	1,215,818	682,435	533,383	224,625	55,907	168,718	444,160	492	4,022,998	739,706	3,278,727	8,975,923	14,713	3.40	7.75	2.28	3.31	7.38
Prill	Total TL	114	6	23	108	1,215,818	682,435	533,383	421,032	171,515	249,517	1,153,638	315	385,225	107,387	277,838	588,095	137	0.66	1.43	2.16	0.32	0.48
	Tot TM	411	214	169	1,339	1,215,818	682,435	533,383	390,423	93,459	296,964	820,653	997	1,894,616	470,482	1,424,134	2,760,168	4,633	1.88	2.95	1.57	1.56	2.27
Maj	Total TL	132	20	9	84	1,215,818	682,435	533,383	426,096	117,582	308,514	1,139,344	338	328,753	74,668	254,085	676,297	226	0.62	1.49	2.41	0.27	0.56
	Tot TM	392	508	155	1,962	1,215,818	682,435	533,383	398,200	96,993	301,207	783,877	895	2,691,989	666,054	2,025,935	4,240,180	7,677	2.54	4.13	1.63	2.21	3.49
Qershor	Total TL	73	20	25	67	1,293,433	743,287	550,146	238,450	58,237	180,213	629,414	182	401,107	166,891	234,216	686,447	184	0.49	1.02	2.06	0.31	0.53
	Tot TM	248	508	160	2,112	1,293,433	743,287	550,146	243,765	40,605	203,160	479,079	565	3,032,627	739,045	2,616,054	4,414,032	7,638	2.53	3.78	1.49	2.34	3.41
Korrik	Total TL	67	25	0	77	1,293,433	743,287	550,146	200,191	63,473	136,718	541,803	210	574,273	227,980	346,293	676,619	218	0.60	0.94	1.57	0.44	0.52
	Tot TM	313	402	135	1,786	1,293,433	743,287	550,146	314,971	51,184	265,454	767,680	805	2,336,647	513,836	1,821,370	3,936,484	6,089	2.05	3.64	1.77	1.81	3.04
Gusht	Total TL	35	12	4	135	1,293,433	743,287	550,146	136,740	18,867	117,873	205,950	63	365,188	82,332	282,942	581,566	260	0.39	0.61	1.57	0.28	0.45
	Tot TM	212	481	114	1,830	1,293,433	743,287	550,146	229,679	57,424	172,255	485,578	511	2,618,092	524,820	2,093,262	3,894,707	5,735	2.20	3.39	1.54	2.02	3.01
Shtator	Total TL	119	8	2	45	1,293,433	743,287	550,146	339,606	79,030	260,576	1,048,630	350	232,705	115,424	117,281	298,541	123	0.44	1.04	2.35	0.18	0.23
	Tot TM	310	287	137	1,694	1,293,433	743,287	550,146	323,282	119,123	210,044	667,440	756	2,174,438	464,289	1,706,549	4,338,251	6,386	1.93	3.87	2.00	1.68	3.35
Tetor	Total TL	158	9	13	57	1,293,433	743,287	550,146	544,652	191,645	353,007	1,398,604	465	266,738	70,555	196,183	768,297	162	0.63	1.68	2.67	0.21	0.59
	Tot TM	426	270	160	2,045	1,293,433	743,287	550,146	444,035	124,793	319,242	1,135,458	1,127	2,591,528	645,408	1,946,220	4,950,078	6,650	2.35	4.70	2.00	2.00	3.83
Nentor	Total TL	84	25	12	88	1,293,433	743,287	550,146	283,265	77,928	205,337	750,150	268	404,304	105,162	299,142	595,328	223	0.53	1.04	1.96	0.31	0.46
	Tot TM	263	296	149	2,394	1,293,433	743,287	550,146	242,896	53,107	191,776	577,280	847	2,645,822	543,864	2,278,031	4,734,061	6,449	2.23	4.11	1.84	2.05	3.66
Dhjetor	Total TL	47	0	16	120	1,293,433	743,287	550,146	211,133	62,984	148,149	471,982	106	434,930	177,069	257,861	1,094,557	348	0.50	1.21	2.42	0.34	0.85
	Tot TM	299	151	122	1,518	1,293,433	743,287	550,146	343,433	87,250	256,183	556,769	648	1,972,892	535,585	1,437,314	3,912,113	4,836	1.79	3.46	1.93	1.53	3.02
2018	Total TL	1,046	236	187	1,179	1,293,433	743,287	550,146	3,385,139	973,673	2,411,466	8,718,027	2,779	5,157,805	1,572,282	3,585,609	9,002,539	2,710	6.60	13.70	2.07	3.99	6.96
	Tot TM	3,457	5,433	1,763	23,710	1,293,433	743,287	550,146	3,542,331	850,331	2,529,460	7,570,437	8,536	31,922,714	7,129,072	22,710,226	59,011,653	91,743	27.42	51.48	1.88	24.68	45.62
TM+T		4,503	5,669	1,950	24,889	1,293,433	743,287	550,146	6,927,470	1,824,004	4,940,926	16,288,465	11,315	37,080,519	8,701,354	26,295,835	68,014,192	94,453	34.02	65.18	1.92	28.67	52.58

SAIFI =	NUMRI TOT I KLIENTEVE TE PREKUR		SAIDI =	KOHA TOT E NDERPRERJEVE		CAIDI =	KOHA TOT E NDERPRERJEVE	
	NUMRI TOT I KLIENTEVE			NUMRI TOT I KLIENTEVE			NUMRI I KLIENTEVE TE NDERPRERE	

3.3.3 Monitorime Specifike nga informacionet periodike të OST sh.a.

Alokimi i kapaciteteve ne interkonjeksione

Në tabelën e mëposhtme paraqiten alokimet e kapaciteteve të interkonjeksionit sipas kufijve dhe periodicitetit të tyre.

Tabela me te dhenat e Alokimit te ATC 2018																									
Ankandi	Periodha	Shqiperi - Mali Zi						Shqiperi - Greqi						Shqiperi - Kosove											
		ATC e ofruar ne Ankand		ATC e shitur ne Ankand		Cmimi Ankandit		ATC e ofruar ne Ankand		ATC e shitur ne Ankand		Cmimi Ankandit		ATC e ofruar ne Ankand		ATC e shitur ne Ankand		Cmimi Ankandit							
		Export	Import	Export	Import	Export	Import	Export	Import	Export	Import	Export	Import	Export	Import	Export	Import	Export	Import						
		[MW]	[MW]	[MW]	[MW]	[Euro/MWh]	[Euro/MWh]	[MW]	[MW]	[MW]	[MW]	[Euro/MWh]	[Euro/MWh]	[MW]	[MW]	[MW]	[MW]	[Euro/MWh]	[Euro/MWh]						
Janar	1.01.2018-31.01.2018	150.5	125	150.5	125	0.14	0.99	50	50	50	50	3.37	1.25	125	125	125	125	0.21	0.37						
Shkurt	1.02.2018-28.02.2018	125.5	125	125.5	124	0.14	0.27	50	50	50	50	7.16	0.18	125	125	125	125	0.12	0.1						
Mars	1.03.2018-25.03.2018	150.5	150	150	149	0.71	0.07	50	60	50	60	9.1	0.04	125	125	125	125	0.66	0.05						
	26.03.2018-31.03.2018	100.5		100.5	0.93																				
Prill	1.04.2018-22.04.2018	100.5	125	100.5	124.5	2.09	0.09	50	50	50	49	6.54	0.05	105	105	105	105	1.18	0.04						
	26.04.2018-30.04.2018																	105	105	105	105	0.8	0.04		
Maj	1.05.2018-6.05.2018	100.5	100	100.5	100	0.87	0.19	50	50	50	48.5	10.87	0.03	105	105	105	105	1.15	0.07						
	7.05.2017-7.05.2018	25.5	25	25.5	25	10.55	0.33																		
	8.05.2018-11.05.2018	75.5	100	75.5	100	1.2	0.19																		
	12.05.2018-31.05.2018	100.5		100.5	0.87																				
Qershor	1.06.2018-30.06.2018	100.5	125	100.5	125	0.87	0.09	50	50	50	50	13.55	0.3	75	105	75	105	1.03	0.05						
Korrik	1.07.2018-31.07.2018	100.5	125	100.5	125	0.5	0.56	50	50	50	50	5.52	2.38	105	105	105	105	0.19	0.47						
Gusht	1.08.2018-31.08.2018	100.5	125	100.5	124.5	0.19	0.25	50	50	50	50	7.24	0.73	105	105	105	105	0.08	0.15						
Shtator	1.09.2018-2.09.2018							50	50	50	50	5.37	1.12	105	105	105	105	0.1	0.11						
	3.09.2018-7.09.2018																		75	75	75	75	0.14	0.34	
	8.09.2018-30.09.2018																			105	105	105	105	0.2	0.16
	1.09.2018-12.09.2018	100.5	125	100.5	125	0.13	0.12																		
	13.09.2018-14.09.2018	25.5	25	25.5	25	0.44	1.4																		
	15.09.2018-30.09.2018	100.5	125	100.5	125	0.13	0.12																		
Tetor	1.10.2018-7.10.2018	100.5	125	100	125	0.17	0.2	0	0	0	0	5.88	4.12	125	125	112	125	0	0.04						
	50							50	50	49.5	5.88	4.12													
Nentor	1.11.2018-30.11.2018	100.5	125	100.5	125	0.03	1.47	50	50	50	50	4.89	5.11	125	125	125	125	0.09	0.88						
Dhjetor	1.12.2018-31.12.2018	125.5	125	125.5	125	0.06	2.22	50	50	49.5	50	5.27	3.33	125	125	125	125	0.07	1.78						

Siç shihet, në shumicën e rasteve ka patur konxhestion në alokimin e kapaciteteve në të dy krahët import/eksport.

Për alokimin e kapaciteteve në interkonjeksione, gjatë vitit 2018 janë ndjekur procedurat sipas rregullave të miratuara nga ERE me Vendim Nr. 140 datë 22.11.2013 të ndryshuar “Rregullorja mbi alokimin e kapacitetit në interkonjeksione” për kufirin Shqipëri - Kosovë dhe “Rregullores të ankandit të zyrës së koordinuar të ankandeve për Europën Juglindore (SEE CAO)” versioni 1.4, miratuar me Vendimin Nr. 167, datë 18.10.2016 për kufinjtë Shqipëri-Mal i Zi dhe Shqipëri-Greqi.

- Ankandet e kapaciteteve në interkonjeksion janë zhvilluar në përputhje me afatet dhe procedurat e përcaktuara, në rregulloret apo vendimet përkatëse të ERE-s.
- Vlen të theksojmë se nuk ka pasur asnjë ankimim të Pjesëmarrësve të Tregut, pjesëmarrës në ankand, për afatet, procedurat, procesin e zhvillimit të ankandit, procesin e vlerësimit të ofertave, përcaktimit të fituesve dhe çmimeve të ankandit, komunikimit dhe publikimit të njoftimit të ankandit dhe rezultateve të tyre.

- Duke vlerësuar se implementimi i Tregut të energjisë është edhe një proces bashkëpunimi dhe i vlerësimit të ndërsjellë ndërmjet OT dhe Pjesëmarrësve të Tregut, sipas rolit përkatës të tyre në tregun e energjisë, OT vijon kontaktet, takimet dhe konsultimet e herë pas herëshme me Pjesëmarrësit e Tregut.

Disbalancat

Në zbatim të Rregullave të Tregut dhe Rregullave të Përkohshme për Mekanizmin Balancues të Energjisë Elektrike (Rregullat për Mekanizmin Balancues) për sa i përket trajtimit të çështjes së tregut balancues, mbi bazën e të dhënave orare të marra nga sistemi i matjeve i OST-së, janë bërë llogaritjet e disbalancave për secilin pjesëmarrës tregu të cilët janë përgjegjës për disbalancimin, në bazë orare.

Çdo 10 ditë janë informuar nga OST sh.a Pjesëmarrësit e Tregut për disbalancat e kryera. Janë vlerësuar disbalancat e palëve në bazë mujore, të cilat më pas u janë faturuar pjesëmarrësve të tregut.

Penalizimet për devijimet gjatë vitit 2018 që kanë shkaktuar Pjesëmarrësit e Tregut të cilët janë përgjegjës për disbalancimin, në MWh, përllogariten dhe faturohen sipas Rregullave të Tregut të miratuara me vendimet përkatëse të Bordit të ERE-s.




Figure 57 Disbalancat totale për vitin 2018 (MWh)

Siç shihet vlera e disbalancave pozitive më e lartë, është shënuar në muajin mars, ndërsa vlera e disbalancave negative më e lartë është shënuar në muajin shtator.

Tabela e Faturave te detyrimet midis Furnizuesve te Kualifikuar dhe OST Sha per vitin 2018

DISBALANCAT																																
VITI 2018	Nga	GSA	OST	GEN-I	OST	OSHEE-I	OST	NOA	OST			GRUP KURUM	OST	ASHTA	OST	Ayen AS Energji	OST	AYEN Trading	OST	AYEN-nev	DEVOLL	OST		KESH si BRP	OST	KESH si FSHN	OST	OST	OST	AES	OST	
	Per	OST	GSA	OST	GEN-I	OST	OSHEE	OST	NOA			OST	GRUP KURUM	OST	ASHTA	OST	AYEN AS Energji	OST	AYEN Trading	OST	AYEN-nev	DEVOLL	OST		KESH si BRP	OST	KESH si FSHN	OST	OST+	OST	AES	
		MWh	MWh	MWh	MWh	MWh	MWh	MWh	MWh	MWh	MWh	MWh	MWh	MWh	MWh	MWh	MWh	MWh	MWh	MWh	MWh	MWh	MWh	MWh	MWh	MWh	MWh	MWh	MWh	MWh	MWh	MWh
Janar		329	1,923	277	174	5,849	28,126					325	462	1,073	812			185	632	839	28		794	0	26,123	7,427	2,711	788	1,756	251		
Shkurt		386	647	223	303	13,349	21,553					804	833	451	259			386	467	22	71		683	0	16,119	9,202	4,931	1,008	1,809	504		
Mars		780	1,582	657	703	12,884	34,331					1,312	902	248	304			1,002	295	418	70		222	9	22,509	15,490	3,894	1,116	651	809		
Prill		814	621	83	441	2,292	22,094		4			756	1,196	360	253			584	208	120	60		20	50	29,410	6,522	1,483	1,951	872	645		
Maj		722	1,306	202	235	6,011	11,511					794	1,290	578	384			781	342	15	45		63	18	11,206	5,217	1,065	3,628	748	472		
Qershor		965	889	104	209	3,395	16,581					764	1,339	565	520	734	189	57	0	34	1,050		67	10	18,471	3,585	1,381	1,942	561	597		
Korrik		737	1,121			4,205	11,735					555	1,548	430	365	454	140	282	133	25	34		75	9	12,111	4,202	1,588	485	594	636		
Gusht		925	1,404			2,111	16,587					1,136	2,087	529	442	319	125	192	306	16	19		107	0	18,840	2,417	944	1,708	538	337		
Shtator		433	2,954			5,156	9,043					854	1,051	497	452	88	7	206	268	13	23		74	5	10,011	4,238	1,194	795	676	525		
Tetor		937	1,277			25,051	2,373					1,272	476	751	800	293	233	26		14	373		64	40	2,874	23,090	2,852	192	782	476		
Nentor		741	1,139			7,091	17,046					1,358	732	1,090	935	872	502			15	15		88	26	12,865	8,299	2,537	347	1,220	304		
Dhjetor		880	1,501			10,592	20,664					1,063	579	714	837	1,297	401			13	22		157	5	18,971	10,730	1,736	815	845	266		
SHUMA		8,650	16,364	1,545	2,065	97,987	211,644	0	4	0	0	10,990	12,495	0	7,283	6,363	4,056	1,597	3,702	2,652	0	1,544	1,809	0	2,414	172	199,511	100,418	26,317	14,776	11,053	5,821

DISBALANCAT				VITI 2018	Nga	Aktivizim Rezerve ne Ulje nga KESH sh.a.	OST sh.a.	
VITI 2018		DISBALANC A NEGATIVE	DISBALANC A POZITIVE			OST sh.a.		Aktivizim Rezerve ne Rritje nga KESH sh.a.
		MWh	MWh					MWh
Janar		40,261	40,624	Janar		26,123	7,427	
Shkurt		39,163	34,845	Shkurt		16,119	9,202	
Mars		44,576	55,612	Mars		22,509	15,490	
Prill		36,794	34,044	Prill		29,410	6,522	
Maj		22,185	24,448	Maj		11,206	5,217	
Qershor		27,098	26,911	Qershor		18,471	3,585	
Korrik		21,056	20,408	Korrik		12,111	4,202	
Gusht		25,657	25,433	Gusht		18,840	2,417	
Shtator		19,202	19,360	Shtator		10,011	4,238	
Tetor		34,914	29,331	Tetor		2,874	23,090	
Nentor		27,877	29,345	Nentor		12,865	8,299	
Dhjetor		36,267	35,821	Dhjetor		18,971	10,730	
SHUMA		375,051	376,182	SHUMA		199,511	100,418	

Regjistri Pjesëmarrësve Aktivë në Tregun e Energjisë Elektrike gjatë vitit 2018

Regjistri Pjesëmarrësve të Tregut 2018 (31 Dhjetor 2018) (aktiv)		PRODHUES			P
		TREGTUES			T
		FURNIZUES			F
		FURNIZUES I SHËRBIMIT UNIVERSAL			FSHU
		SHPERNDARJE			SH
Nr	Emri i Subjektit	EIC Code	nr MPT	data e regjistrimit	Roli në TEE
1	Albanian Energy Supplier	54X-AEG-02-1603G	58	26.05.2015	T; F
2	AXPO Albania	23X--150330-AA-K	3	20.01.2011	T; F
3	Ayen AS Energji	23X--150416-A-N	47	17.12.2014	P; T; F
4	Ayen Energy Trading	23X--140426-AY-W	40	04.05.2014	T; F
5	Danske Commodities Albania	23X--121120DCALG	21	30.10.2012	T; F
6	Devoll Hydropower	23X--150409-DHP5	62	11.06.2015	T; F
7	EMIKEL	54X-E-SHPK-16044	56	15.04.2015	T
8	Energija doo Veternik	54X-EDOOV-15-020	68	15.12.2015	T; F
9	Energji Ashta	54X-HECASHA-059	20	25.05.2012	P
10	Energy Supply-AL	34X-0000000017-C	24	15.05.2013	T; F
11	Erdat Lura	54X-HEC-LURA-069	32	17.09.2013	P
12	GEN-I Tirana	23X---120709GEN0	4	31.01.2011	T; F
13	Gjo-Spa Power	54X-HEC-LAPAJ075	33	17.09.2013	P
14	Green Energy Trading Albania	23X--150702GE--3	65	01.07.2015	T
15	Grupi Sistemeve Automatike	22XGSA-----N	16	09.05.2011	T; F
16	Korporata Elektroenergjitike Shqiptare	23X--130918APC-M	12	25.04.2011	P; T
17	KURUM International	23X--131115KI--1	35	17.12.2013	P; T; F
18	Alb Energy Market	54X-ALBEM---11Y	74	07.07.2017	T, F
19	NOA Energy Trade	23X--150630-NE-6	52	10.03.2015	T; F
20	Operatori Shperndarjes Energjise Elektrike	23X--130503--CS-2	7	25.04.2011	SH; FSHU
21	Stravaj Energy	54X-STRAVAJ-E086	38	25.04.2014	P; T
22	WENERG	54X-WENERG---10E	64	10.06.2015	P
23	YLLIAD	29XYLLIAD-AL--W	6	03.03.2011	T
24	Energy Market Albania	54X-ENMARKETAL99	71	23.03.2017	T
25	Grid Energy	54X-GRID-ENERGYR	72	05.04.2017	T; F
26	GAEA-Energjia Alternative e Gjelber	54X-GAEA11-1501R	66	07.12.2015	T; F
27	Energy Financing Team Tirana	54X-EFT-TIRANA-V	76	24.08.2017	T; F
29	Alpiq Energy Albania	23X--141204AEA-T	10	29.04.2011	T; F
30	Le Trading Albania	23X--150309-LT-Y	49	16.02.2015	T
31	Energy to Energy	54X-EN-TO-EN-13F	77	13.10.2017	T
32	DON-UCD	54X-DON-UCD--15T	80	17.07.2018	T;F
33	URADRIN	54X-100ID101218J	81	10.08.2018	T
34	Energia Gas and Power Albania shpk	23x-150309-LT-Y	82	22.10.2018	T; F
35	RENRGY Trading Group	54X-10IRN102618R	85	12.11.2018	T
36	Ener Trade shpk	54X-10 IET091118	86	21.12.2018	T; F
Burimi OST sha					

Figure 58 Pjesëmarrësit e Tregut gjatë vitit 2018

Në tabelën në vijim paraqiten monitorimet tematike të kryera gjatë vitit 2018 nga ERE.

Monitorime Tematike gjatë vitit 2018		
Urdhëri i Monitorimit	Objekti i Monitorimit	Shoqëria
Urdhër Nr. 14, datë 1.02.2018	Analizimin e planit të përditësuar të investimeve për vitin 2018 dhe planin e zhvillimit të rrjetit të shpërndarjes për 5 vitet e ardhëshme të shoqërisë OSHEE sha.	OSHEE sha
Urdhër Nr. 32, datë 28.03.2018	Për shqyrtimin dhe analizimin e planit 10 vjeçar të zhvillimit të (2018-2028) të shoqërisë ALBGAS sha.	ALBGAS sha
Urdhër Nr. 48, datë 11.07.2018	Monitorimin e operimit të prodhuesve të energjisë elektrike dhe lidhjet me rrjetin e shpërndarjes së energjisë elektrike.	OSHEE sha; Hydro Power Plnt of Korca shpk; Gjoka Konstruksion & Energji shpk; Xhengo Energji

		shpk;Favina 1 shpk;The Blue Star shpk; Strelca Energy shpk.
Urdhër Nr. 51, datë 31.08.2018	Monitorimin e shoqërisë KESH sha lidhur me ankesën e shoqërisë GEN-I Tirana shpk mbi zbatimin e procedurave të shitblerjes së energjisë elektrike të kryera nga KESH sha për periudhën 2017-mars 2018.	KESH sha
Urdhër Nr. 52, datë 04.09.2018	Për monitorimin e shoqërive të licencuara nga ERE në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike	Shoqëritë e licencuara nga ERE në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike (sipas HEC-eve përkatëse)
Urdhër Nr. 61, datë 06.11.2018	Mbi monitorimin e ecuresë së zbatimit të planit të investimeve për vitin 2017 dhe periudhën janar – tetor 2018	OST sha
Urdhër Nr. 70, datë 23.11.2018	Për monitorimin e veprimtarisë së OST sha gjatë periudhës janar – tetor 2018	OST sha
Urdhër Nr. 73, datë 26.11.2018	Për monitorimin e veprimtarive të OSSH sha;FSHU sha për periudhën janar – nëntor 2018.	OSHEE sh.a.
Urdhër Nr. 75, datë 06.12.2018	Për monitorimin e realizimit të OPEX për vitin 2017 dhe 2018 të shoqërisë OST sha.	OST sha
Urdhër Nr. 76, datë 06.12.2018	Lidhur me kërkesën e shoqërisë GEN-I Tirana shpk për zgjerimin e hetimit në lidhje me kontratat ekskluzive të KESH sha për vitet 2017 dhe 2018.	KESH sha

3.4 Aktiviteti i ERE-s në fushën e rregullimit të tarifave dhe çmimeve të Energjisë Elektrike dhe Gazit Natyror

Bazuar në Ligjin nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, i ndryshuar, përkatësisht në nenet 19, 20, 79 dhe 83, Ligjin 102/2015 “Për Sektorin e Gazit Natyror” përkatësisht nenet 16,17,75 dhe 92, si dhe ne Ligjin 7/2017 “Për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme” Neni 10, ERE është autoriteti përgjegjës për përcaktimin e tarifave dhe çmimeve për veprimtaritë e rregulluara dhe ato që kanë detyrimin e shërbimit publik në sektorin e energjisë, bazuar në metodologjitë respektive në fuqi.

Në zbatim të këtij detyrimi ligjor, veprimtaritë kryesore të ERE-s gjatë vitit 2018 kanë qënë:

- Shqyrtimi i aplikimeve për tarifatat dhe çmimet nga ana e të licencuarve në sektorin e energjisë elektrike dhe të gazit natyror për:
 - Aktivitetin e transmetimit të energjisë elektrike;
 - Aktivitetin e shpërndarjes të energjisë elektrike;
 - Aktivitetin e furnizimit të shërbimit universal të energjisë elektrike;
 - Aktivitetin e transmetimit dhe shpërndarjes së gazit natyror;
 - Aktivitetin e furnizimit të mundësisë së fundit të energjisë elektrike;
 - Aktivitetin e gjenerimit të energjisë elektrike nga prodhuesit me përparësi sipas parashikimeve të Ligjit 7/2017
- Amendimi i metodologjisë për llogaritjen çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit, miratuar me vendimit nr. 144, datë 25.06.2018.

Në lidhje me shqyrtimin e tarifave dhe çmimeve për vitin 2018:

- Lidhur me aplikimin e shoqërisë OSHEE sh.a., , duhet vënë në dukje se ai është bazuar mbi parashikime të treguesve të vitit 2017 pasi ky nuk ishte mbyllur ende. Më tej, ky aplikim është përditësuar pasi viti ushtrimor u mbyll, ku të dhënat e dërguara nga aplikuesi, si dhe çështjet e trajtuara gjatë seancave dëgjimore dhe teknike gjatë muajve janar–mars 2018, kanë shërbyer për të reflektuar një analizë më të saktë të të ardhurave të kërkuara nga shoqëria OSHEE sh.a., për mbulimin e aktivitetit të licencuar për vitin 2018. Analiza e aplikimit dhe e dokumentacionit shtesë të dërguar në kuadër të kërkesave të ERE-s, si dhe çështjeve të diskutuara gjatë seancave dëgjimore janë bazuar në të dhënat e pasqyrave financiare, bilancit energjetik faktik dhe treguesve të tjerë tekniko-ekonomikë të shoqërisë OSHEE sh.a. për periudhën paraardhëse.

- Për qëllime të analizës së të ardhurave të kërkuara të shoqërisë për ushtrimin e aktivitetit të licencuar janë analizuar të gjithë zërat që lidhen me:

- Shpenzimet operative, për vitet 2015, 2016, 2017 dhe 2018. OPEX është analizuar duke iu referuar pasqyrave financiare (PF) të viteve respektive, deklaramit të bërë nga shoqëria në aplikimin e vitit 2018 dhe analizën konform metodologjisë së shpërndarjes dhe objektivit të humbjeve të energjisë elektrike në rrjet sipas nivelit të lejuar në vendimin e ERE-s nr. 148 datë 26.12.2014. Nga kjo analizë vërehet se OPEX-i i realizuar sipas PF-së së vitit 2015, në përgjithësi për të gjithë zërat rezultojnë në ulje kundrejt atij të miratuar nga ERE, duke përjashtuar gjokat e penalitetet. Sa u takon viteve 2016 dhe 2017, nisur nga fakti se periudha rregullatore është një vit, OPEX-et e pranuar nga ana jonë, janë ato të shpenzimeve të realizuara në fakt për vitin 2016 dhe 2017, por duke përjashtuar si jo të arsyeshme njohjen e shpenzimeve për panalitete dhe gjoka. OPEX paraqitet në rritje, kryesisht në zërat: Paga, mirëmbajtje dhe shpenzime të tjera. Nga analiza e të ardhurave të kërkuara për vitin 2018, OPEX-et e pranuar nga ERE janë ato të shpenzimeve të realizuara në fakt për vitin 2017, të indeksuara me inflacionin, si dhe kostot shtesë të parashikuara nga shoqëria. Zëri “Shpenzime për personelin”, për vitin 2018, kundrejt 2014-ës rezulton me një rritje të konsiderueshme, por nga deklaramet e kompanisë sqarohet se këto vlera janë miratuar dhe nga Këshilli Mbikëqyrës dhe lidhen kryesisht me ristrukturimin e skemës organizative të shoqërisë, si dhe planin e masave në kuadrin e ndërhyrjes dhe të aksionit për uljen e humbjeve dhe rritjen e arkëtimeve. Shoqëria deklaroi që paga e përputhur me shpërblimin, sipas vlerës së tregut, do të rrisë përgjegjshmërinë në punë, si dhe performancën e shoqërisë. Në lidhje me këtë zë për vitin 2018 pranohet rritja vetëm për efekt indeksimi. Zëri mirëmbajtje është kërkuar, gjithashtu, me rritje kundrejt atij të rezultuar për vitin 2017. Kryesisht, vërehet se shpenzimet për riparime në Rrjetin e Shpërndarjes përbëjnë pjesën kryesore të këtij zëri. Meqenëse të ardhurat për të mbuluar zërat e tjerë të OPEX-it për vitin 2018 janë rreth 3% më të larta se viti 2017, sipas PF-së pa përfshirë gjokat dhe penalitetet, vlerësohen si të arsyeshme kostot e kërkuara nga Shoqëria.

- Kosto e energjisë elektrike për mbulimin e humbjeve: Kjo kosto, si pjesë e shpenzimeve operative, përbëhet nga kostot e blerjes së energjisë elektrike në treg të parregulluar, si dhe nga kostot e transmetimit të këtyre humbjeve, të cilat rezultojnë më të larta nga ato të miratuara, në kuadër të vendimit nr. 146, datë 26.12.2014, të Bordit të ERE-s. Sipas VKM-së nr. 171, datë 25.2.2015, “Për miratimin e planit të rimëkëmbjes financiare të sektorit të energjisë elektrike”, këto kosto rezultojnë më të larta se sa nivelet e këtyre treguesve që përcakton ky vendim. Vërehet se në uljen e shpenzimeve të blerjes së energjisë elektrike për mbulimin e humbjeve, krahasuar me ato të miratuara për vitet

respektive, ka ndikuar edhe faktori çmimi i tregut, i cili ka pësuar ulje ndaj atij të parashikuar për vitet 2015 dhe 2016. Nga ana tjetër, kostoja e humbjeve për vitin 2017 dhe 2018, është ndikuar edhe nga çmimi më i lartë i blerjes së energjisë elektrike nga prodhuesit me përparësi dhe HEC “Ashta”. Humbjet totale faktike në rrjet për vitet 2015, 2016 dhe 2017 rezultojnë me përmirësim, por përsëri ato janë më të larta se targetet e përcaktuar nga VKM-ja nr. 171, datë 25.2.2015.

Efekti nga kjo kosto e tepërt përtej asaj të lejuar, ka impakt në të ardhurat e kërkuara për aktivitetin e shpërndarjes së energjisë elektrike.

- Në lidhje me kostot kapitale, CAPEX, vlerat e RAB-it, të llogaritur nga ERE nuk përputhen me ato të paraqitura nga shoqëria në aplikimin e saj për vitin 2018. Mbi bazën e treguesve të shpjeguar në mënyrë të detajuar në relacionin e këtij vendimi dhe nisur nga vlera e RAB-it të pranuar nga ERE dhe ai i kërkuar nga shoqëria rezulton me diferencë dhe është e kuptueshme që edhe kthimi mbi RAB, i llogaritur do të jetë i ndryshëm. Për vitin 2017, vlera e RAB-it e llogaritur nga ERE është shumë më e vogël se ajo e paraqitur nga shoqëria për vitin 2017 në aplikimin e saj për vitin 2018. Kjo është vazhdim i diferencave të paraqitura nga shoqëria për asetet deri në fund të vitit 2011, problem ky i trajtuar në analizën për të ardhurat e kërkuara të rishikuar për vitin 2015. Vlera e RAB-it për vitin 2017 reflekton investimet e reja të vitit 2015 dhe 2016 të marrë nga pasqyrat financiare, si dhe 1/2 e vlerës së aseteve të shtuara/investimeve të realizuara për vitin 2017, duke e konsideruar si vlerë të aseteve të vëna në operim për këtë periudhë. Kjo shifër rezulton nga pasqyrat financiare të vitit 2017. Vlera e RAB-it për vitin 2018 reflekton investimet e reja të vitit 2017 marrë nga pasqyrat financiare të kësaj periudhe.

- Të ardhurat e tjera si të ardhurat për lidhjet e reja dhe energjinë reaktive, të konsideruara të zbritshme për shoqërinë, janë ato të rezultuara në PF dhe të përditësuara sipas aplikimit.

- Energji e livruar në Rrjetin e Shpërndarjes, për vitet 2015, 2016, 2017 dhe rezulton në sasi të 4,459 gwh, për vitin 2015, 4,605 gwh për vitin 2016, 4,782 gwh për vitin 2017 dhe për vitin 2018 është pranuar sasia e energjisë së livruar prej 4,803 GWh.

- Nga raportimi i strukturës së shitjes për vitet 2015,2016 dhe 2017 rezulton që çmimi mesatar i realizuar nga shitja është më i lartë nga ai miratuar prej 10.7 lekë/kWh, duke rezultuar me të ardhura shtesë për shoqërinë. Këto diferenca vlerësohen të përdoren si rezervë për mbulimin e kapitalit negativ të trashëguar që nga viti 2014, duke i mundësuar shoqërisë aftësinë për likuidimin e detyrimeve, si dhe mbulimin e kostove të blerjes së energjisë elektrike për mbulimin e humbjeve mbi target.

- Përlllogaritja e tarifave të aktivitetit të shpërndarjes sipas nivelit të tensionit

Shoqëria ka kërkuar tarifën e aksesit për nivel tensioni për vitin 2018 si më poshtë:

- Për vitin 2018, - 5.16 lekë;
- tension i mesëm -2.36 lekë;
- tension i mesëm (20–6 kV) – 3.81 lekë;
- tension i ulët (0.4 kV) – 5.51 lekë.

-Për përlllogaritjet e këtyre tarifave, shoqëria shprehet se është bazuar në koeficientet e alokimit të shpenzimeve që marrin parasysh sasinë e energjisë elektrike të shitur sipas strukturës së shitjeve, strukturën e aseteve sipas niveleve të tensionit dhe humbjet teknike të energjisë elektrike sipas niveleve të tensionit. Koeficientët e llogaritur mbi bazë të peshës specifike të shitjes së energjisë

elektrike në nivel tensioni, OSHEE sh.a. i ka përdorur për alokimin e shpenzimeve kapitale dhe të ardhurave nga lidhjet e reja dhe energjia reaktive. Për alokimin e shpenzimeve operative, shpenzimeve për mbulimin e humbjeve të energjisë elektrike, shoqëria ka përdorur koeficientët e ponderuar që marrin parasysh peshat specifike të energjisë elektrike të shitur dhe humbjet teknike.

- Konsiderojmë jokorrekte praktikën për alokimin e kostove kapitale, duke përdorur thjesht peshat specifike të konsumit të energjisë elektrike në atë nivel tensioni, pa marrë në konsideratë vlerat e aseteve për nivelet përkatëse të tensionit, si dhe faktin që asetet në nivele më të larta tensioni shërbejnë edhe për furnizimin e klientëve të lidhur në tensionet më të ulëta. Kostoja e përllogaritur për blerjen e humbjeve në Rrjetin e Shpërndarjes nuk është llogaritur në zbatim të përcaktimeve të VKM-së nr. 171, datë 25.2.2015, si dhe të VKM-së nr. 244, datë 30.3.2016. Kështu që, llogaritjet tona reflektojnë këto diferenca në të ardhurat e kërkuara, të cilat në përfundim rezultojnë me një tarifë prej 4,85 nga 5,14 lekë, e kërkuar nga shoqëria OSHEE sh.a.

- Për të mundësuar përllogaritjet në mënyrë që tarifat e aksesit të pasqyrojnë kostot e arsyeshme të shërbimit në atë nivel tensioni, iu kërkuar shoqërisë vlerat e aseteve për çdo nivel tensioni, apo minimalisht shtesat e reja të aseteve për çdo nivel tensioni për periudhën 2014–2017. Për shkak se shoqëria nuk ka paraqitur informacion në plotësim të kësaj kërkesë, kemi vënë në përdorim të vetmin informacion që trashëgojmë në lidhje me vlerat e aseteve për nivel tensioni, pra ato të datës 31.5.2014.

- Për shpërndarjen e kostos së humbjeve është konsideruar, gjithashtu:

a) Studimi i paraqitur nga shoqëria në lidhje me “Humbjet e energjisë elektrike aktive në rrjetat 35 kV për vitin 2017”;

b) Studimi i paraqitur në aplikimin për tarifat e vitit 2017 në lidhje me humbjet në rrjetat e TM-së:

- Në llogaritjen e koeficientëve për alokimin e kostos së humbjeve është përdorur arsyetimi se një pjesë e humbjeve të shkaktuara në nivelet e mësipërme të tensionit i takojnë konsumit të energjisë elektrike në tensionet në vijim. Për këtë qëllim janë shfrytëzuar raportet e konsumit të energjisë elektrike në çdo nivel tensioni ndaj totalit të energjisë elektrike. Vlerësimet tona, bazohen në të dhënat e paraqitura nga shoqëria, dhe në vetvete mbartin pasiguri në shpërndarjen e kostove sipas nivelit të tensionit, ashtu siç deklarohet në aplikim.

- Për sa trajtohet në relacionin argumentues të këtij vendimi, vërehet se të ardhurat totale nga aktiviteti i shpërndarjes dhe i furnizimit me pakicë rezultojnë më të larta se ato të lejuara për periudhën 2015–2017, kjo për faktin se në llogaritjet tona nuk janë përfshirë kostot totale të blerjes së energjisë elektrike për mbulimin e humbjeve në Rrjetin e Shpërndarjes, përtej targetit të përcaktuar në VKM-në nr. 171, datë 25.2.2015, vlerë kjo e konsiderueshme për shoqërinë dhe që në të njëjtën kohë do të kërkonte financime shtesë nga pronari shtet ose në të kundërt kjo vlerë duhet të mbulohet nga klientët që shërbehen nga FSHU-ja.

Bordi i ERE-s, me vendimin Nr. 190, datë 30.08.2018 vendosi:

1. Lënien në fuqi të Vendimit Nr.52, datë 06.04.2017 “Mbi lënien në fuqi të Vendimit nr. 190 datë 22.12.2016, të Bordit të ERE-s” për tarifat e shërbimit të shpërndarjes si vijon:

- Tarifa e shërbimit të shpërndarjes në nivelin e tensionit 35 kV 1.5 Lekë/kWh
 - Tarifa e shërbimit të shpërndarjes në nivelin e tensionit 20 kV 3.9 Lekë/kWh
 - Tarifa mesatare e shërbimit të shpërndarjes 4.79 Lekë/kWh
2. Rishikimin e të ardhurave të kërkuara të Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes në periudhat pasardhëse për vlerësimin e të ardhurave të kërkuara për vitin 2018.
 3. Lënien në fuqi për vitin 2018, të pikave 3, 4 dhe 5 të Vendimit të Bordit të ERE-s, nr.211, datë 28.12.2017 “Mbi fillimin e procedurës për shqyrtimin e aplikimit të OSHEE sh.a., për tarifat e shërbimit të shpërndarjes së energjisë elektrike sipas nivelit të tensionit dhe lënies në fuqi të çmimeve me pakicë për klientët që shërbehen nga furnizuesi i shërbimit universal për vitin 2018”.

3.4.2. Çmimet e shitjes së energjisë elektrike nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit për vitin 2018

Gjatë vitit 2018, në zbatim të nenin 87, pika 4 të Ligjit 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, i ndryshuar si dhe “Metodologjisë së përcaktimit të çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit”, miratuar me Vendimin nr. 201, datë 04.12.2017 Enti Rregullator i Energjisë përcaktoi çmimin e shitjes së energjisë elektrike të furnizimit nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit (FMF) për klientët e lidhur në nivelin e tensionit 35 kV për çdo muaj të vitit 2018.

Nisur nga problematikat e vërejtura në aplikimin e “Metodologjisë së përcaktimit të çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit” në muajt e parë të vitit 2018, veçanërisht në përcaktimin nga OSHEE sh.a. të shpenzimeve administrative për aktivitetin e FMF dhe të kostove për disbalancat për klientët e FMF si dhe nga fakti që, në disa raste llogaritjet rezultuan në çmime më të ulta se çmimi i klienteve të FSHU në tensionin respektive sipas Vendimit nr. 148, datë 26.12.2014 të Bordit të ERE, duke mos dhënë sinjale nxitëse për daljen e këtyre klientëve në tregun e parregulluar, Bordi i ERE-s me Vendimin nr. 144, datë 25.06.2018 miratoi rishikimin e “Metodologjisë së përcaktimit të çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga furnizuesi i mundësisë së fundit” miratuar me Vendimin e Bordit të ERE-s nr. 201, datë 04.12.2017, me ndryshimet si vijon:

- Ndryshimi i Formulës përlllogaritëse të përcaktimit të çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga furnizuesi i mundësisë së fundit, duke shtuar elemente të tillë si CA që përfaqëson kostot administrative për çdo kWh të furnizuar dhe Pr që përfaqëson kthim për riskun e propozuar në masën 3%.
- Nenit 8 të Metodologjisë i shtohet pika 2 me përmbajtjen si vijon: *Në çdo rast ky çmim nuk do të jetë më i ulët se çmimi i shitjes me pakicë të klientët që furnizohen në atë nivel tensioni sipas Vendimit të Bordit të ERE-s Nr.148, datë 26.12.2014.*

Formula përlllogaritëse e çmimit të shitjes së energjisë elektrike për klientët e FMF në zbatim të nenit 8 të metodologjisë së rishikuar paraqitet në vijim:

$$\text{ÇFMFt} = \text{CBEt} + \text{Pr} * \text{CBEt} + \text{TRrTSHt} + \text{CA}$$

Ku:

CBEt - çmimi maksimal i blerjes së energjisë elektrike për periudhën e furnizimit nga Tregu i parregulluar ose blerja nga prodhuesit me përparësi;

Pr - Kthimi për riskun i përcaktuar në përqindje për vitin (në masën 3% për dy vitet e para);

TRrTSHt -Tarifa e përdorimit të rrjetit të transmetimit dhe të shpërndarjes për periudhën relevante;

Ndryshimet në metodologji ju nënshtruan një procesi konsultativ me OSHEE sh.a..

Mbas rishikimit të Metodologjisë, gjatë procesit të shqyrtimit të aplikimeve të OSHEE sh.a. për çmimet mujore të shitjes së energjisë elektrike tek klientët e FMF u vërejt se shoqëria nuk ka mundur të përcaktojë kostot e disbalancave të shkaktuara nga këta klientë.

Në vijim paraqiten çmimet e shitjes së energjisë elektrike të furnizimit nga FMF për vitin 2018 sipas vendimeve respektive të Bordit të ERE si dhe çmimet maksimale të blerjes së energjisë elektrike për mbulimin e kërkesës së këtij grupi konsumatorësh:

Viti 2018	Vendimi	Cmimi i shitjes i miratuar nga ERE (lek/kWh)	Çmimi maksimal i blerjes se energjise nga OSHEE sh.a. (Euro/MWh)
Janar	Nr.66, Datë 26.03.2018	11.60	64.00
Shkurt		9.50	44.97
Mars	Nr. 67, Datë 26.03.2018	9.50	37.75
Prill	Nr. 92, Datë 20.04.2018	9.50	31.79
Maj	Nr. 116, Datë 21.05.2018	9.50	33.75
Qershor	Nr. 146, Datë 25.06.2018	9.82	54.50
Korrik	Nr. 176, Datë 03.08.2018	12.86	68.05
Gusht	Nr. 204, Datë 13.09.2018	12.86	68.16
Shtator	Nr. 213, Datë 27.09.2018	12.86	67.72
Tetor	Nr. 234, Datë 02.11.2018	16.00	92.80
Nentor	Nr. 254, Datë 11.12.2018	16.00	93.24
Dhjetor	Nr. 7, Datë 17.01.2019	15.22	76.60

Figure 59 çmimet e shitjes së energjisë elektrike të furnizimit nga FMF për vitin 2018 (Burimi: ERE)

Nga raportet periodike të OSHEE sh.a. rezultoi se energjia elektrike e shitur për klientët e FMF gjatë vitit 2018 ishte 60 GWh me një vlerë të faturuar prej 726 milion lekë, nga ku rezultoi një çmim mesatar i shitjes prej 12,07 lekë/kWh. Çmimet e miratuara përgjate vitit 2018 do nxisin këta konsumatorë të kalojnë në treg të parregulluar duke e gjetur vetë furnizuesin.

3.4.3 Shtyrja e afatit të tarifës së përkohshme të transmetimit të gazit natyror nga shoqëria “ALBGAZ” sh.a., miratuar me Vendimin e Bordit të ERE-s nr. 90, datë 07.06.2017.

Shoqëria Albgaz sh.a. me shkresën nr. 85/1 datë 03.01.2018 depozitoi në ERE aplikimin për përcaktimin e tarifës së shërbimit të transmetimit të gazit natyror.

Gjithashtu, Shoqëria Albgaz sh.a. paraqiti në ERE kërkesën për shtyrjen e afatit të kontratës së transmetimit të gazit natyror, mes shoqërisë Albgaz sh.a. dhe shoqërisë Albpetrol sh.a. me shkresat

me nr. 55/1 Prot. i Albgaz, datë 05.07.2017 dhe nr. 4608 Prot. i Albpetrol, datë 06.07.2017. Kjo kërkesë vinte si rrjedhojë e shterimit të fuqisë juridike të kontratës së nënshkruar dhe miratuar me vendimin e Bordit të ERE nr. 199, datë 24.11.2017.

Bordi i ERE me vendimin nr. 90, datë 07.06.2017, miratoi tarifën e përkohshme të transmetimit të gazit natyror nga shoqëria “ALBGAZ” sh.a. prej 25 Lekë/m³, për periudhën 05.01.2017 – 20.09.2017.

Për arsye se :

- Proçesi i miratimit i tarifës përfundimtare të shërbimit të transmetimit kërkonte kryerjen e një sërë konsultimesh e seancash dëgjimore me palët e interesit, te cilat kërkonin kohë.
- Kishte përfunduar (datë 31.12.2017) fuqia juridike e vendimit nr. 155, datë 28.09.2017 të Bordit të ERE, me të cilin është vendosur mbi lënien në fuqi të vendimit të Bordit të ERE-s nr. 90, datë 07.06.2017 “Mbi miratimin e tarifës së përkohshme të transmetimit të gazit natyror nga shoqëria “Albgaz” sh.a. për periudhën 05.01.2017–20.09.2017” deri në 31.12.2017.
- Shoqëria Albgaz sh.a. nuk mund të ushtronte aktivitetin e saj pa një tarifë për shërbimin e transmetimit dhe pa një kontratë të ligjshme.
- Në datë 05.01.2018 kishte përfunduar afati i kontratës së transmetimit të gazit natyror mes shoqërisë Albgaz sh.a. dhe shoqërisë Albpetrol sh.a.
- Me përcaktimin e një tarife përfundimtare për aktivitetin e transmetimit të gazit natyror, shoqëria Albgaz sh.a., duhej të hartonte një kontratë të re për shërbimin e transmetimit të gazit natyror, e cila të reflektonte parashikimet e legjislacionit në fuqi, si dhe tarifën përfundimtare.

Bordi i ERE-s me vendimin Nr. 14, Datë 10.01.2018 vendosi:

1. Lënien në fuqi të vendimit të Bordit të ERE-s nr. 90, datë 07.06.2017 “Mbi miratimin e tarifës së përkohshme të transmetimit të gazit natyror nga shoqëria “Albgaz” sh.a. deri në datë 31.03.2018.

3.4.4 Miratimi i tarifës së transmetimit të gazit natyror nga shoqëria Albgaz sh.a. për vitin 2018.

Shoqëria ALBGAZ sh.a. me shkresën nr. 85/1 Prot., datë 03.01.2018, paraqiti ne ERE kërkesën për miratimin e tarifës së Transmetimit të Gazit Natyror për vitin 2018.

ERE me vendimin nr. 14 datë 10.01.2018 shtyu deri në datë 31.03.2018 afatin e lënies në fuqi të tarifës së përkohshme të transmetimit të gazit natyror nga shoqëria “ALBGAZ” sh.a. periudhën 05.01.2017 – 20.09.2017”, të miratuar me vendimin nr. 90, datë 07.06.2017, dhe i ndryshuar me Vendimin nr. 155, datë 28.09.2017.

ERE pas marrjes së vendimit nr. 20, datë 19.01.2018 “Mbi fillimin e procedurës për miratimin e tarifës së transmetimit të gazit natyror nga shoqëria ALBGAZ sh.a, për vitin 2018”, ndoqi hapat sipas procedurave të parashikuara në “Rregulloren për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”

Mbështetur në analizën e dokumentacionit të plotësuar përgjatë etapave procedurale të ndjekura, Bordi i ERE-s me Vendimin Nr. 97, datë 23.04.2018 miratoi tarifën e transmetimit të gazit natyror nga shoqëria Albgaz sh.a, për vitin 2018 prej 28 lekë/m³ ose 2.6457 lekë/kWh.

Vendimi nr. 14, i Bordit të ERE.-s, datë 10.01.2018, "Mbi shtyrjen e afatit të tarifës së përkohshme të transmetimit të gazit natyror nga shoqëria "Albgaz" sh.a. miratuar me Vendimin e Bordi të ERE.-s, nr. 90, datë 07.06.2017 si dhe kontratës së transmetimit të gazit natyror të lidhur mes Albpetrol Sh.a dhe Albgaz sh.a" la në fuqi deri në 31.03.2018 tarifën e përkohshme të transmetimit të gazit natyror prej 25 Lekë/m³. Ndërkohë, vendimi nr Nr. 97, datë 23.04.2018 miratoi një tarifë prej 28 lekë/m³. Midis tarifës së përkohshme të transmetimit dhe tarifës përfundimtare të transmetimit të gazit natyror nga shoqëria Albgaz sh.a, për vitin 2018 kishte një diferencë prej 3 lekë/m³.

Në mbështetje të Nenit 17, gërma "e" e Ligjit Nr.102/2015 "Për Sektorin e Gazit Natyror", i cili parashikon se kur tarifat e miratuara rezultojnë të ndryshme nga ato të përkohshme, ERE vendos masat e përshtatshme kompensuese, Bordi i ERE, me vendimi Nr. 179, datë 20.08.2018 vendosi:

1. Pika 1 e Vendimit Nr. 97, datë 23.04.2018 " Mbi miratimin e tarifës së transmetimit të gazit natyror nga shoqëria Albgaz sh.a., për vitin 2018" të Bordit të ERE-s , ishte "Miratimin e tarifës së transmetimit të gazit natyror nga shoqëria Albgaz sh.a, për vitin 2018 prej 28 lekë/m³ ose 2.6457 lekë/kWh" dhe bëhet "Miratimin e tarifës së transmetimit të gazit natyror nga shoqëria Albgaz sh.a, për vitin 2018 prej 28 lekë/m³ ose 2.6457 lekë/kWh, duke filluar nga data 01.01.2018"

3.4.5 Fillimi i procedurave për përcaktimin e çmimit të blerjes së energjisë elektrike të prodhuar nga burimet e vogla të rinovueshme nga dielli me fuqi të instaluar deri 2MW dhe era me fuqi të instaluar deri në 3MW për vitin 2018

Në mbështetje të nenit 10 pika 2 dhe 16 të Ligjit nr. 43/2015, "Për Sektorin e Energjisë Elektrike", i ndryshuar, nenit 10, pika 3 të Ligjit nr. 7/2017 "P r nxitjen e p rdorimit t energjis nga burimet e rinovueshme" ERE ka detyrimin e përcaktimit të çmimit të blerjes së energjisë elektrike të prodhuar nga burimet e vogla të rinovueshme nga dielli dhe era me fuqi të instaluar respektivisht 2 MW dhe 3MW.

VKM nr.369, datë 26.04.2017, "Për miratimin e metodologjisë për përcaktimin e çmimit të blerjes së energjisë elektrike të prodhuar nga burimet e vogla të rinovueshme nga dielli dhe era", në pikën 2 të tij, ngarkon ERE-n me miratimin e çmimit të blerjes së energjisë elektrike të prodhuar nga burimet e vogla të rinovueshme nga dielli dhe era, në përputhje me çmimin e mesatarizuar, sipas parashikimeve të kësaj metodologjie.

Pika 2 e Vendimit Nr. 120 datë 27.07.2017 të Bordit të ERE-s i cili miratoi çmimet për prodhuesit e vegjël nga dielli dhe era për vitin 2017 përcakton se "Duke filluar nga viti 2018, për investimet në vijim, ERE, në bazë të grumbullimit të të dhënave, përsa i përket kostove reale të investimit, nëse rezultojnë të ndryshme nga parashikimet e VKM nr. 369 datë 26.4.2017, "Për miratimin e metodologjisë për përcaktimin e çmimit të blerjes së energjisë elektrike të prodhuar nga burimet e vogla të rinovueshme nga dielli dhe era", t'i propozojë MEI-t për përmirësimin dhe rishikimin e VKM".

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i ERE-s, me Vendimin Nr. 205, Datë 13.09.2018 vendosi:

Fillimin e procedurave për përcaktimin e çmimit të blerjes së energjisë elektrike të prodhuar nga burimet e vogla të rinovueshme nga dielli me fuqi të instaluar deri 2 MW dhe era me fuqi të instaluar deri 3MW për vitin 2018.

Përgjatë këtij procesi, dhe në zbatim të pikës 2 të vendimit Nr. 120 datë 27.07.2017, u mor në shqyrtim dokumentacioni i depozituar nga shoqëritë që aplikuan për licencat e prodhimit nga impiantet e diellit me fuqi të instaluar deri 2 MW dhe erës me fuqi të instaluar deri 3 MW të cilët kishin marrë aprovimin nga MIE gjatë vitit 2017. Informacioni i grumbulluar nga ERE duhej të ballfaqohej me vlerat faktike për investimet e realizuara për të cilat nuk pati informacion.

Për sa më lart, dhe për shkak të mungesës së informacionit të nevojshëm në lidhje me lejet e miratuara përgjatë vitit 2018 nga MIE për impiantet nga teknologjitë e diellit me fuqi të instaluar deri në 2 MW dhe erës deri 3 MW, procesi i miratimit të çmimeve të shitjes së energjisë elektrike për këta impiante për vitin 2018 u shty për periudhën në vazhdim. Kjo në funksion të marrjes së një vendimi sa më të drejtë, të bazuar në një analizë të plotë dhe të mbështetur në të dhëna reale.

Në lidhje me shqyrtimin e tarifave dhe çmimeve për vitin 2019:

- i. Lënia në fuqi e vendimit të Bordit të ERE-s nr. 190 datë 30.8.2018 në lidhje me tarifën e përdorimit të rrjetit të shpërndarjes sipas nivelit të tensionit dhe çmimet me pakicë për klientët fundorë që shërbehen nga furnizuesi i shërbimit universal për vitin 2019.**

Neni 85 i Ligjit nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, i ndryshuar, përcakton se, ERE miraton çmime të rregulluara vetëm për kategori të caktuara të klienteve fundorë që furnizohen sipas shërbimit të furnizimit universal dhe këto çmime të miratuara rishikohen mbi baza vjetore.

Shoqëritë “OSSH” sh.a. dhe “FSHU” sh.a. nuk paraqiten pranë ERE-s aplikimet përkatëse në përputhje me “Metodologjinë e llogaritjes së tarifave të Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes së Energjisë Elektrike” miratuar me Vendimin e Bordit të ERE-s nr 180, datë 10.11.2017 dhe “Metodologjisë së përcaktimit të çmimeve për shitjen e energjisë elektrike me pakicë tek klientët fundorë që furnizohen nga Furnizuesi i Shërbimit Universal”, të miratuar me Vendimin e Bordit të ERE-s nr. 189. datë 23.11.2017.

Neni 21 i “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s” përcakton se i licencuari në sektorin e energjisë elektrike dhe të gazit natyror, duhet të paraqesë në ERE jo me vonë se data 1 Shtator e vitit aktual, një kërkesë me shkrim të shoqëruar me të gjithë informacionin e kërkuar sipas rregullores dhe metodologjive përkatëse.

Me qëllim që shoqëria “OSSH” sh.a. dhe shoqëria “FSHU” sh.a. të operojnë në mënyrë normale në periudhën rregullatore në vijim, është e domosdoshme që ato të faturojnë energjinë me çmime të miratuara nga ERE.

Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 798/1 prot., datë 19.12.2018, përcolli problematikat e ndarjes së shoqërisë “OSHEE” sh.a., ku ndër të cilat më kryesoret që kishin lidhje me përcaktimin e tarifave u renditën:

- Në zbatim të procesit të nisur të ndarjes së shoqërisë ishte e nevojshme të vijohej me ndryshimet nënligjore duke iu referuar një modeli tregu i cili do të ishte optimal jo vetëm për shoqërinë “OSHEE” sh.a. por edhe për operatorët e tjerë të energjisë.
- Nevojitej të përcaktohej operatori i energjive të rinovueshme jashtë shoqërisë “OSHEE” sh.a..
- T’i jepej zgjidhje problematikës së akomodimit në treg të sasisë së energjisë elektrike nga burimet e rinovueshme (RES), që rezulton përtej nevojave për mbulimin e humbjeve në rrjetin e shpërndarjes të Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes.
- Në vijim të etapave të mësipërme, nevojitej përcaktimi i buxheteve për dy shoqëritë: “OSSH” sh.a. dhe “FSHU” sh.a., gjë që do të mundësonte vlerësimin e të ardhurave të nevojshme për aktivitetet e rregulluara.

Në vijim OSHEE sh.a. me shkresën e datës 20.12.2018 paraqiti në ERE, kërkesën për mosndryshimin e tarifave të Shërbimit të Shpërndarjes dhe Çmimeve të Shitjes së Energjisë Elektrike për vitin 2019. Kjo kërkesë argumentohej me rezultatet paraprake pozitive të vitit 2018 dhe mbështetej në vlerësimin se shoqëritë do të mund të ushtrojnë aktivitetet e shpërndarjes dhe shitjes me pakicë të energjisë elektrike në kushte normale operimi, nisur nga vlerësimi i situatës ekonomiko financiare sipas raportimeve të bëra përgjatë vitit 2018.

Sikurse rezultoi nga Pasqyrat financiare paraprake për vitin 2018 OSHEE sh.a. për të tretin vit radhazi pati një rezultat financiar pozitiv ndërkohë që vazhdonte reduktimi i kapitalit negativ të shoqërisë. Gjatë vitit 2018 kapitali negativ u reduktua me rreth 11% krahasuar me vitin 2017 sikurse paraqitur në grafikun në vijim:




Figure 60 Ecuria e kapitalit te vet OSHEE sh.a

Për gjithë sa më sipër Bordi i ERE me Vendimin Nr. 268, Datë 21.12.2018 vendosi:

1. Të lërë në fuqi pikën 1 dhe pikën 3 të Vendimin e Bordit të ERE-s nr. 190, datë 30.08.2018, “Mbi shqyrtimin e aplikimit të shoqërisë “OSHEE” sh.a. për tarifat e shërbimit të shpërndarjes së energjisë elektrike sipas nivelit të tensionit dhe lënien në fuqi të çmimeve me pakicë për klientët që shërbehen nga Furnizuesi i Shërbimit Universal për vitin 2018” sipas tabelës më poshtë:

TIPI I AKTIVITETIT	NR. I VENDIMIT	TARIFAT E MIRATUARA
Tarifa e shërbimit të shpërndarjes në nivelin e tensionit 35 kV	Nr. 52, Datë 06.04.2017	1.5 Lekë/Kwh
Tarifa e shërbimit të shpërndarjes në nivelin e tensionit 20 kV	Nr. 52, Datë 06.04.2017	3.9 Lekë/Kwh
Tarifa mesatare e shërbimit të shpërndarjes	Nr. 52, Datë 06.04.2017	4.79 Lekë/Kwh
Çmimi i shitjes për Klientët në 20 kV *	Nr. 52, Datë 06.04.2017	11 Lekë/Kwh Në Pik 12.65 Lekë/Kwh
Çmimi i shitjes për Klientët në 10/6 kV *	Nr. 52, Datë 06.04.2017	11 Lekë/Kwh Në Pik 12.65 Lekë/Kwh
* Miratim i përkohshëm për klientët që nuk arrijnë të sigurojnë furnizues në treg për shkak të pamundësisë objektive të operimeve të sistemit në përputhje me VKM nr. 449, datë 15.06.2016, furnizimi si mundësi e fundit i këtyre klientëve kryhet në të njëjtat kushte me shërbimin universal të furnizimit me çmimet si më lart		
Çmimi i shitjes për Konsumatorët e lidhur në TM dhe me matës në TU	Nr. 52, Datë 06.04.2017	12.4 Lekë/Kwh Në Pik 14.3 Lekë/Kwh
Çmimet e shitjes me pakicë për klientët fundor	Nr. 52, Datë 06.04.2017	*Çmimet paraqiten në tabelën më poshtë
TARIFAT E SHËRBIMEVE TË SHITJES ME PAKICË TË ENERGJISË ELEKTRIKE PËR KLIENTËT FUNDOR		
Niveli i tensionit	Çmimi (Lekë/kWh)	Çmimi pik (Lekë/kWh)
Furra buke dhe prodhim mielli në 10/6 kV	7.1	8.17
Klientë në 0.4 kV	14	16.1
Furra buke dhe prodhim mielli në 0.4 kV	7.6	8.74
Familjarë	9.5	
Tarifa për konsumin e energjisë elektrike në ambientet e përbashkëta (ndricim shkalle, pompe, ashensor)	9.5	
Tarifë fikse e shërbimit për leximin "zero" (Lekë/Muaj)		200
*Çmimi i energjisë reaktive është sa 15% e çmimit të energjisë aktive		
*Orari pik gjatë të cilit do të aplikohet tarifa për energjinë e konsumuar në pik është :		
Për periudhën 1 Nëntor - 31 Mars nga ora 18:00 deri në 22:00		
Për periudhën 1 Prill - 31 Tetor nga ora 19:00 deri në 23:00		

Figure 61 Tabela e Tarifave dhe çmimeve për vitin 2019

2. Nëse do të rezultojë se do të ketë efekte në të ardhurat e kërkuara të shoqërisë “OSHEE” sh.a. do të bëhet përditësimi dhe kompensimi i tyre sipas përcaktimeve të nenit 20, pika “c” e Ligjit nr.43/2015, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, i ndryshuar.

Nga analiza e Pasqyrave Financiare paraprake për vitin 2018 të OSHEE sh.a. konstatohet se shoqëria ka patur një rezultat financiar pozitiv prej 5,4 miliard lekë, rezultat i cili do të ndikojë në përmirësimin e mëtejshëm të kapitalit negativ, shlyerjen e detyrimeve ndaj palëve të treta si dhe në kryerjen e investimeve në rrjetin e shpërndarjes.

Gjithashtu, KESH sh.a. dhe OST sh.a., në bazë të pasqyrave financiare paraprake të vitit 2018, kanë patur rezultat financiar pozitiv. Për tu theksuar është rezultati mjaft pozitiv i KESH sh.a. i cili realizoi një fitim prej rreth 10 miliard lekë.....

Në vijim paraqiten të ardhurat e realizuara nga të tre aktorët kryesore të sistemit elektroenergjetik shqiptar: KESH sh.a., OST sh.a. dhe OSHEE sh.a. për periudhën 2015-2018 si dhe ato të miratuara nga ERE për vitin 2015:

Të ardhurat e Kërkuara/Realizuara per shoqërite KESHsh.a., OST sh.a. OSHEE sh.a. (mln/lekë)	Miratuuar nga ERE për vitin 2015	Realizuar per vitin 2015 Pasqyrat Financiare Viti 2015	Realizuar per vitin 2016 Pasqyrat Financiare Viti 2016	Realizuar per vitin 2017 Pasqyrat Financiare Viti 2017	Realizuar per vitin 2018 Pasqyrat Financiare Viti 2018
KESH sh.a.	13573	19661	17273	11214	18464
OST sh.a.	4094	6347	5816	5967	6808
OSSHEE sh.a.	48641	59634	62023	60432	56171

Figure 62 Të ardhurat e realizuara KESH, OST dhe OSHEE për periudhën 2015-2017 Burimi (KESH,OST dhe OSHEE sh.a)

ii. Tarifa e shërbimit të transmetimit të energjisë elektrike nga OST sh.a. për vitin 2019

Shoqëria “OST” sh.a., paraqiti aplikimin për tarifën e shërbimit të transmetimit të energjisë elektrike për vitin 2019 me shkresën nr. 6879 Prot, datë. 04.10.2018.

ERE me Vendimin e Bordit nr. 224, datë 26.10.2018 vendosi mbi fillimin e procedurave për miratimin e tarifës së shërbimit të transmetimit të energjisë elektrike për vitin 2019.

Në zbatim të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, përgjatë procesit të shqyrtimit të kërkesës së OST sh.a. u kryen veprimet e nevojshme procedurale për të siguruar transparencën nëpërmjet publikimeve dhe seancave dëgjimore si dhe marrjen e opinioneve nga palët e interesuara.

ERE në kuadër të shqyrtimit të këtij aplikimi zhvilloi një monitorim pranë kësaj shoqërie në lidhje me shpenzimet operative të realizuara për vitet 2017 dhe 2018.

ERE bazuar në:

- Metodologjinë e llogaritjes së tarifës së transmetimit të energjisë elektrike, të miratuuar me Vendimin Nr. 180, datë 08.11.2017 të Bordit të ERE-s;
- Analizën e pasqyrave financiare të OST për vitin 2017 dhe atyre paraprake për vitin 2018 si dhe të informacionit të paraqitur në aplikim e më pas informacionit shtesë të dërguar nga Shoqëria në përgjigje të kërkesave të ERE-s;
- Argumentave të OST sh.a. të parashtruara në seancën teknike;
- Rezultatet paraprake të monitorimit në lidhje me shpenzimet operative për vitet 2017-2018;
- Opinioneve të parashtruara nga palët e interesit,

Kreu saktësime, verifikime dhe përlllogaritje lidhur me:

- Shpenzimet operative,
- Bazën e Rregulluar e Aseteve bazuar në Metodologjinë e llogaritjes së tarifave të transmetimit të energjisë elektrike dhe në vijimësi të praktikave të mëparshme.
- Korrigjimin në zbritje të të ardhurave e realizuara më tepër për vitin 2018.

Në përfundim, totali i të ardhurave të kërkuara për vitin 2019 u miratua në vlerën 5,378 milion lekë, për të mundësuar lëvizimin e energjisë elektrike në rrjetin e transmetimit prej 7,158 GWh.

Në përfundim, Bordi i ERE-s me Vendimin Nr. 266, datë 21.12.2018 miratoi tarifën e shërbimit të transmetimit të energjisë elektrike prej 0,75 Lekë/kWh për vitin 2019.

iii. Prodhuesit me përparësi të energjisë elektrike dhe impakti i tyre

Prodhimi i energjisë elektrike nga prodhuesit me përparësi të energjisë elektrike (HEC-et me fuqi deri në 15 MW) në vitin 2018, për shkak të kushteve shumë të favorshme hidrike pati një rritje të konsiderueshme prej rreth 61% krahasuar me vitin paraardhës. Futja në operim e 11 centraleve të rinj me fuqi totale të instaluar prej 38.3 MW dhe me një prodhim prej 18.966 GWh, ndikoi gjithashtu në këtë prodhim të rritur.

Grafikët në vijim paraqesin ecurinë e energjisë së prodhuar dhe të ardhurat e realizuara në vite nga shitja e energjisë elektrike për prodhuesit me përparësi dhe HEC Ashta duke sjellë në vëmendje një rritje të prodhimit nga kjo kategori për vitin 2018..




Figure 63 Ecuria e prodhimit nga prodhuesi me Përparësi & Hec Ashta (MWh) (Burimi OSHEE sh.a)




Figure 64 Të ardhurat nga prodhuesit me përparësi (Burimi OSHEE sh.a)

Prodhimi i energjisë elektrike ishte rreth 60% më i lartë në krahasim me vitin 2017 . Ky prodhim i lartë ndikoi në rritjen e të ardhurave nga shitja e energjisë për prodhuesit me përparësi të cilat ishin 80% më të larta krahasuar me vitin 2017. Në rritjen e të ardhurave për prodhuesit me përparësi ndikoi edhe çmimi i blerjes të energjisë së prodhuar nga këta gjenerues për vitin 2018 i cili ishte 15% më i lartë se ai i vitit 2017.

Grafiku në vijim paraqet ecurinë e çmimeve të miratura për prodhuesit e energjisë elektrike nga hidrocentralet për periudhën 2004-2019:




Figure 65 Ecuria e çmimeve të miratuara për Prodhuesit me Përparësi

Tendenca në rritje e prodhimit të energjisë elektrike nga prodhuesit me përparësi ku përveç shtimit të kapaciteteve prodhuese të impianteve hidro, duke filluar që nga viti 2019 e në vazhdim do të fillojnë prodhimin edhe impiantet nga burime të tjera të rinovueshme si fotovoltaike dhe eolike si dhe pjesa e biodegradueshme e mbetjeve të ngurta që shfrytëzojnë mbeturinat industriale, urbane dhe rurale të cilat tashmë kanë marrë miratimin nga MIE, ndikon në rritjen edhe më tej të peshës specifike që zë prodhimin nga prodhuesit me përparësi, ndaj konsumit total të energjisë elektrike. Në vitin 2018 energjia elektrike e prodhuar nga Prodhuesit me Përparësi deri 15 MW dhe HEC-Ashta zinte rreth 22% të konsumit kombëtar vjetor të energjisë elektrike.

Grafiku në vijim paraqet ecurinë e peshës specifike të prodhimit nga prodhuesit me përparësi kundrejt konsumit total:




Figure 66 Pësha specifike e prodhimit të prodhuesve me përparësi nga konsumi total (Burimi OST sh.a. OSHEE sh.a. ERE)

OSHEE sh.a., në zbatim të VKM Nr.244, datë 30.03.2016 “Për miratimin e kushteve për vendosjen e Detyrimit të Shërbimit Publik”, të ndryshuar ka detyrimin për blerjen e energjisë së prodhuar nga prodhuesit me përparësi. Rritja e mëtejshme e prodhimit nga këta prodhues për shkak të shtimit të kapaciteteve prodhuese jo vetëm nga teknologjia hidro, por edhe nga teknologjitë e tjera të burimeve të rinovueshme, ndikon ndjeshëm në koston për blerjen e energjisë elektrike nga OSHEE sh.a..

Shpenzimet e OSHEE sh.a. për blerjen e energjisë elektrike nga prodhuesit me përparësi dhe Hec-Ashta në vitin 2018 përbënin rreth 50.2% të shpenzimeve totale për blerjen e energjisë elektrike nga 22.5% që ishin në periudhën paraardhëse.

U konstatua se sasia e blerë nga OSHEE sh.a. nga këta prodhues (1,696 GWh) me një çmim mesatar prej 66,37 Euro/MWh, i tejkaloi nevojat për mbulimin e humbjeve prej 1,538 GWh sikurse parashikuar në VKM 244 datë 30.03.2016. Diferenca prej 158 GWh ka kaluar për mbulimin e kërkesës për Klientet e Furnizimit Universal.

Ky fakt përforcon nevojën e rregullimeve ligjore për t’i dhënë zgjidhje problematikës së akomodimit në treg të sasisë së energjisë elektrike nga burimet e rinovueshme (RES), që rezulton përtej nevojave për mbulimin e humbjeve në rrjetin e shpërndarjes të Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes.

Grafiket në vijim paraqesin strukturën e shpenzimeve të OSHEE sh.a. për blerjen e energjisë elektrike për vitin 2018 dhe 2017:




Figure 67 Struktura e shpenzimeve për blerjen e energjisë elektrike nga OSHEE për vitin 2018 (Burimi OSHEE sh.a.,ERE)

Siç rezulton edhe nga të dhënat e mbledhura, përgjatë vitit 2018 pjesa më e madhe e energjisë është blerë nga PPE dhe evidentohet një ulje e sasisë së blerë në treg të parregulluar krahasuar me atë të blerë në vitin 2017 në tregun e parregulluar.




Figure 68 Struktura e shpenzimeve për blerjen e energjisë elektrike nga OSHEE për vitin 2017

Shpenzimet për blerje energjie nga OSHEE sh.a. për vitin 2018 ishin 19% më të ulëta nga ato të vitit parardhës.

Ndërkohë u vërejt ulje e shpenzimeve për blerjen e energjisë në tregun e parregulluar nga 64.5 % në 25% të totalit të shpenzimeve. Kjo erdhi kryesisht për shkak të prodhimit të bollshëm nga impiantet hidrike si KESH sh.a., Hec Ashta dhe prodhuesit me përparësi si rezultat i prurjeve hidrike të larta, kryesisht në gjysmën e parë të vitit. Ndërsa çmimi i blerjes së energjisë elektrike në tregun e parregulluar ishte 73,79 EUR/MWh ose rreth 11% më i lartë nga ai i vitit 2017, ndërkohë që çmimi mesatar i blerjes së energjisë nga prodhuesit me përparësi rezultoi 66,37 Euro/MWh.

iv. Mbi lënien në fuqi të vendimit të Bordit të ERE-s nr. 19, datë 19.01.2018 mbi çmimin vjetor të blerjes së energjisë elektrike, që do t'u paguhet prodhuesve ekzistues me përparësi të energjisë elektrike për vitin 2018.

VKM Nr. 687, datë 22.11.2017 miratoi “Metodologjinë e përcaktimit të çmimit vjetor të blerjes së energjisë elektrike që do t'u paguhet prodhuesve ekzistues me përparësi”. Sipas kësaj metodologjie çmimi vjetor i blerjes së energjisë elektrike përcaktohet nga: çmimi mesatar vjetor i tregut të ditës në avancë (HUPX/DAM) i energjisë elektrike në profilin në bandë i vitit përkatës të bursës hungareze (HUPX) të energjisë elektrike në euro cent/kWh, një koeficient bonus për promovimin e burimeve të rinovueshme në masën 1.3 dhe norma mesatare e këmbimit në euro/lekë për vitin e fundit.

VKM Nr. 687, datë 22.11.2017 përcaktoi gjithashtu edhe kufijtë maksimal dhe minimal të çmimit të blerjes së energjisë elektrike nga prodhuesit ekzistues me përparësi të cilët janë: jo më i ulët se çmimi i miratuar nga ERE për vitin 2016 dhe jo më i lartë se 15% e çmimit të miratuar nga ERE për vitin 2016.

Nga të dhënat paraprake të publikuara në faqen e internetit të Bursës së Energjisë së Hungarisë rezultoi një çmim mesatar vjetor i tregut të ditës në avancë (HUPX/DAM) të energjisë elektrike në profiling bandë për vitin 2018 prej 49.65 Euro/MWh.

Nga të dhënat e publikuara për periudhen Janar – Nëntor 2018 nga Banka e Shqipërisë mbi kursin e këmbimit, rezultoi se kursi mesatar i këmbimit ishte 127.96 lekë/euro.

Sipas metodologjisë së sipërcituar, për sa kohë që nuk është mbyllur viti ushtrimor 2018, ERE nuk ka mundësinë e axhustimit/korrigjimit të komponentëve të formulës së paraqitur më sipër.

Bordi i ERE-s me vendimin nr. 19 datë 19.01.2018 “Mbi çmimin vjetor të blerjes së energjisë elektrike, që do t’u paguhet prodhuesve ekzistues me përparësi për vitin 2018”, miratoi çmimin 8.5652 lekë/kWh.

Për sa më sipër Bordit të ERE-s me Vendimin Nr. 267, Datë 21.12.2018 vendosi të lërë në fuqi Vendimin nr. 19 datë 19.01.2018, “Mbi çmimin vjetor të blerjes së energjisë elektrike, që do t’u paguhet prodhuesve ekzistues me përparësi për vitin 2018” deri në publikimin e raportit vjetor nga HUPEX.

v. Çmimi i blerjes së energjisë elektrike nga prodhuesit ekzistues me përparësi për vitin 2019

Në zbatim të “Metodologjisë së përcaktimit të çmimit vjetor të blerjes së energjisë elektrike që do t’u paguhet prodhuesve ekzistues me përparësi” të miratuar me VKM Nr. 687, datë 22.11.2017, ERE përcaktoi çmimin përkatës menjëherë pas publikimit të raportit vjetor të Bursës së Energjisë së Hungarisë (HUPX) për vitin 2018.

Nga të dhënat e raportit vjetor të Bursës së Energjisë së Hungarisë (HUPX) çmimi mesatar vjetor i tregut të ditës në avancë (HUPX/DAM) të energjisë elektrike në profiling bandë (baseload) për vitin 2018 rezultoi në vlerën 51 Euro/MWh.

Nga të dhënat e publikuara nga Banka e Shqipërisë mbi kursin e këmbimit Lekë/EUR për çdo ditë të vitit 2018, rezultoi që kursi mesatar i këmbimit për vitin 2018 të jetë vlerën 127.575 Lekë/EUR. ERE rezervon të drejtën që të axhustojë llogaritjet e bëra në rast se kursi i këmbimit Lekë/EUR që publikohet në Raportin Vjetor 2018 të Bankës së Shqipërisë (gjatë muajve në vazhdim) ndryshon nga ai i konsideruar në llogaritje.

Çmimi prej 8.4582 Lekë/kWh i cili rezultoi nga zbatimi i formulës përlllogaritëse të cituar në metodologji, ndodhej brenda kufijve minimal e maksimal të përcaktuar në paragrafet 2.ç dhe 2.d, të VKM-së Nr. 667, datë 22.11.2017.

Përsa më sipër, Bordi i ERE-s, me Vendimin Nr. 8, datë 17.01.2019 miratoi çmimin vjetor prej 8.4582 Lekë Lekë/kWh që do t’u paguhet prodhuesve ekzistues me përparësi për vitin 2019.

vi. Lënia në fuqi deri në 31.03.2019 e Vendimit të Bordit të ERE-s Nr. 97, datë 23.4.2018 “Mbi miratimin e tarifës së transmetimit të gazit natyror nga shoqëria “ALBGAS” sh.a për vitin 2018.

Bordi i ERE-s me Vendimin nr. 97, datë 23.04.2018 “Mbi miratimin e tarifës së transmetimit të gazit natyror nga shoqëria “ALBGAZ” sh.a për vitin 2018 vendosi miratimin e tarifës të transmetimit të gazit natyror për shoqërinë “ALBGAZ” sh.a.për periudhën 01.01.2018 – 31.12.2018.

Shoqëria “ALBGAZ” sh.a.nuk paraqiti aplikim për rishikimin e tarifës së transmetimit për periudhën pasardhëse rregullore të vitit 2019, në përputhje me “Metodologjinë për llogaritjen e tarifave të përdorimit të rrjetit të transmetimit dhe shpërndarjes së gazit natyror”.


Shoqëria “ALBGAZ” sh.a akoma nuk kishte paraqitur aplikimin për planin e investimeve për vitin 2019. Mungesa e vlerës së investimeve për vitin 2019, si komponent i rëndësishëm i llogaritjes së tarifës bënte të pamundur llogaritjen e të ardhurave të kërkuara dhe përcaktimin e tarifës së transmetimit të gazit natyror për vitin 2019.

ERE, e konsideron tarifën e aktivitetit të transmetimit të domosdoshme për ushtrimin e aktivitetit nga Shoqëria “ALBGAZ” sh.a. aktivitet i cili ushtrohet konform Ligjit nr. 102/2015, “Për Sektorin e Gazit Natyror”, si dhe direktivave të Bashkimit Europian. Aksesin në rrjet për përdoruesit e sistemit të transmetimit duhet të jetë i garantuar dhe kjo shoqëri duhet t’i ofrojë shërbimet e saj me tarifa të rregulluara nga ERE.

Në këto kushte Bordi i ERE, me Vendimin Nr. 269, Datë 21.12.2018, vendosi për shtyrjen deri më datë 31.03.2019 të fuqisë juridike të Vendimit të Bordit të ERE-s nr. 97, datë 23.04.2018 “Mbi miratimin e tarifës së transmetimit të gazit natyror nga shoqëria “ALBGAZ” sh.a, për vitin 2018”, i ndryshuar deri më datë 31.03.2019.

vii. Tarifat dhe çmimet e miratuara ndër vite

Në tabelën dhe grafikun në vijim janë paraqitur çmimet e energjisë elektrike të miratuara ndër vite nga ERE në zbatim të legjislacionit në fuqi në momentin e vendimmarrjes:



Tipi i Aktivitetit (leke/kWh)	2008	2009	2010	2011	2012	2013	2014	2015	2016	2017	2018	2019
Prodhimi	0.78	0.78	0.4	0.63	1	1	1	1.45	1.45	1.45		
Hec-et egzistuese deri në 15 MW	6.5	6.5	7.4	7.57	7.77	7.53	7.53	7.636	7.448	7.448	8.5652	8.4582
Hec-et e reja deri në 15 MW	9.37	9.37	6	6.89	9.3	9.73	7.95	7.636	7.448	7.448	8.5652	8.4582
Impiantet fotovoltaike 2MW											13.42	
Impiantet Eolike MW										10.201		
Furnizuesi Publik me shumicë	1.61	1.61	2.03	1.48	2.2	2.2	2.2	3	3			
Transmetimi	0.5	0.5	0.6	0.6	0.65	0.65	0.65	0.65	0.65	0.65	0.75	0.75
Tarifa mesatare e Shpërndarjes	5.7	5.7	5.7	6.3	5	5	5	4.79	4.79	4.79	4.79	4.79
Çmimi Mesatar për Klientet e Shërbimit Universal	8.45	8.45	9.53	9.53	9.53	9.53	9.53	10.7	10.7	10.7	10.7	10.7
Tarifa e shërbimit të shpërndarjes në nivelin 35 kV								1.5	1.5	1.5	1.5	1.5
Tarifa e shërbimit të shpërndarjes në nivelin 20/10/6 kV										3.9	3.9	3.9

Figure 69 Çmimet e miratuara nga ERE për periudhën 2008-2019 (Burimi ERE- Çmimi mesatar perlllogaritët mbi bazën e mesatares aritmetike të të dhënave)

Grafiku pasqyron ndryshimet e ndodhura në çmimet dhe tarifat e miratuara nga ERE për shkak të reflektimit të ndryshimeve që solli Ligji Nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, i ndryshuar, në strukturën e tregut shqiptar të energjisë elektrike.

Duke filluar nga viti 2015 vijon të aplikohet tarifa e shërbimit të shpërndarjes për nivelin e tensionit 35 kV prej 1,5 lekë/kWh dhe që prej 01.01.2017 tarifa e shërbimit të shpërndarjes për nivelin e tensionit 20 kV prej 3,9 lekë/kWh.

Kurba e tarifës së shitjes me shumicë të energjisë elektrike nga KESH sh.a. në funksion të shërbimit të furnizimit me shumicë ndërpritet në vitin 2016 për shkak se ky funksion i kaloi furnizuesit të shërbimit universal. KESH sh.a., në zbatim të ligjit 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, i ndryshuar, i cili imponon liberalizim të segmenteve të prodhimit dhe furnizimit të energjisë elektrike, dhe të VKM Nr. 244 datë 30.03.2016, ‘Për miratimin e kushteve për vendosjen e detyrimit të shërbimit publik, që do të zbatohen ndaj të licencuarve në sektorin e energjisë elektrike, të cilët ushtrojnë aktivitetin e prodhimit, transmetimit, shpërndarjes dhe furnizimit me energji elektrike”, te ndryshuar, shiti energji tek Furnizuesi i Shërbimit Universal për mbulimin e kërkesës së klientëve fundorë dhe tek operatori i sistemit të shpërndarjes për mbulimin e humbjeve me çmime të parregulluara nga ERE.

Për rrjedhim grafiku i çmimit të prodhimit për KESH sh.a. (i miratuar nga ERE) ndërpritet në vitin 2017. KESH sh.a. shiti gjatë vitit 2018 rreth 3,844 GWh energji elektrike për mbulimin e kërkesës së Furnizuesit të Shërbimit Universal me çmimin 1.5 lekë /kWh të miratuar nga Asambleja e Përgjithshme e KESH sh.a. në zbatim të pikës 2 të nenit 5 të VKM Nr. 244, datë 30.03.2016. Gjithashtu, të KESH sh.a. në zbatim të pikës 4 të nenit 5 të VKM Nr. 244 shiti 145 GWh energji elektrike për mbulimin e humbjeve në rrjetin e shpërndarjes me një çmim mesatar prej 6.95 lekë/kWh.

Grafiku në vijim paraqet ecurinë e çmimeve mesatare të realizuara të energjisë elektrike në tërësi si dhe për klientë familjarë dhe jofamiljarë:




Figure 70 Çmimi mesatar i realizuar (Burimi ERE, OSHEE sh.a.)

Çmimi mesatar për klientët fundorë, për vitin 2018 rezultoi nga përlogaritjet në masën 11,15 lekë/kWh për shkak të realizimit të një strukture të shitjes.

Tabela në vijim paraqet realizimin e çmimeve për kategori të ndryshme të klientëve në nivelet përkatëse të tensionit krahasuar me miratimin për vitin 2018:

Kategoria e Klienteve	Çmimi i miratuar		Çmimi i realizuar	
	Aktive	Në Pik	Aktive	Në Pik
Klientë në 20/10/6 kV	11.00	12.65	10.99	12.65
Furra buke dhe prodhim mielli në 20/10/6 kV	7.10	8.17	7.60	8.74
Klientë në 20/10/6 kV matur ne TU kabinë me nje ak	12.40	14.30	12.37	14.24
Klientë në 20/10/6 kV matur ne TU (Kabinë me shur	14.00	16.10	13.91	16.10
Klientë në 0.4 kV	14.00	16.10	13.98	16.10
Furra buke dhe prodhim mielli në 0.4 Kv	7.60	8.74	7.55	7.86
Objekte fetare	9.50	10.93	9.50	10.93
Familjarë	9.50		9.50	
Ambjente te Perbashketa	9.50		9.50	
Çmimi mesatar 2018	10.70		11.15	

Figure 71 Çmimi i realizuar për kategoritë e klientëve (Burimi ERE, OSHEE)

Çmimi faktik prej 7.60 lekë/kWh për kategorinë “Furra buke e prodhim mielli” për nivelin e tensionit 20/10/6 kV rezultoi më i lartë se ai i miratuar 7.10 lekë/kWh për shkak të aplikimit nga ana e OSHEE sh.a. të tarifës 7.6 lekë/kWh për ata klientë të kësaj kategorie që lidhjen e kanë në tension te mesëm ndërsa matjen e kanë në tension të ulët.

viii. Tarifat e Energjisë Elektrike në Vendet e Rajonit, për vitin 2018

Baza e të dhënave e Shoqatës Rajonale të Rregullatorëve të Energjisë (ERRA) për tarifat e energjisë është burimi kryesor i të dhënave zyrtare të energjisë elektrike në vendet e Evropës Qendrore / Lindore.

Në grafikun e mëposhtëm janë paraqitur tarifat e energjisë elektrike në Euro cent/kWh dhe lekë/kWh para taksimit (TVSH-së) për konsumatorët jo familjarë në vitin 2018. Çmimi mesatar i energjisë elektrike për konsumatorët jo familjarë për vendet e rajonit është 11.47 lekë/kWh.




Figure 72 Çmimet e energjisë elektrike të konsumatorëve familjar në vendet e rajonit sipas raportimit më të fundit të ERA për vitin 2018

(Burimi ERA)

Në grafikun e mëposhtëm janë paraqitur tarifat e energjisë elektrike në Euro cent/kWh dhe lekë/kWh para taksimit (TVSH-së) për konsumatorët familjarë. Çmimi mesatar i energjisë elektrike për konsumatorët familjarë për vendet e rajonit është 11.00 lekë/kWh. Shihet që çmimet për Shqipërinë, paraqiten pothuajse në të njëjtën renditje për të ruajtur stabilitetin e të ardhurave për shoqërinë, me qëllim rikuperimin e kapitalit negativ, të trashëguar, të kësaj shoqërie.




Figure 73 Çmimet e energjisë elektrike të konsumatorëve jo-familjar në vendet e rajonit sipas raportimit më të fundit të ERA për vitin 2018

(Burimi ERA)

3.5 Aktiviteti i ERE-s në Zhvillimin e Legjislacionit Sekondar dhe Ndryshimet e tjera Ligjore të Ndodhura gjatë vitit 2018

Një pjesë e rëndësishme e aktivitetit të ERE-s, dhe veçanërisht Drejtorisë juridike është hartimi i legjislacionit sekondar që përbën edhe kuadrin rregullator në Sektorin e Energjisë Elektrike dhe atë të gazit natyror. Ky kuadër është plotësuar nga ERE në një pjesë të konsiderueshme dhe aktualisht janë ende në proces përpunimi nga ERE disa akte me mjaft rëndësi në zbatim të Ligjit nr. 43/2015, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike” që gjatë vitit 2018 ka pësuar ndryshime, por edhe ligjit 102/2015 Për sektorin e gazit.

Hartimi dhe rishikimi në disa raste i kuadrin ligjor të miratuar më herët e që është konstatuar se ka patur nevojë për ndërhyrje, është bërë në çdo rast duke patur prioritet parimin e transparencës. ERE ka ndërmarrë hapat e nevojshëm për tu krijuar palëve të treta mundësi njohje me përmbajtjen e dokumentave, mundësinë konsultimit dhe dëgjimit të palëve të interesuara nëpërmjet dërgimit të opinioneve apo komenteve të ndryshme apo edhe nëpërmjet zhvillimit të seancave dëgjimore me prezencën e palëve që kanë shfaqur interes për dokumentat në proces përpunimi nga ERE. Çdo dokument i cili ka hyrë në procesin e draftimit apo edhe të rishikimit, është publikuar në faqen zyrtare të ERE për ti siguruar mundësi aksesit në vendimmarrje kujtdo që thërret interes në këto praktika. Në finalizim të këtyre proceseve të konsultimit publik dhe me palët e interesit, ERE është shprehur me vendimmarrje të cilat shprehin jo vetëm plotësimin e parashikimeve ligjore por edhe qëndrimin praktik të palëve të interesit. Mbledhjet vendimmarrëse janë të hapura për publikun.

Gjatë vitit 2018, ERE shënon disa vendimmarrje të rëndësishme në lidhje me shqyrtimin e akteve nënligjore të sektorit të energjisë elektrike dhe gazit natyror në kuadër të përshtatjes së tyre me Ligjin “Për Sektorin e Energjisë Elektrike nr. 43/2015 dhe atë për Gazin Natyror.

Më poshtë po listojmë disa nga vendimmarrjet e rëndësishme që lidhen me hartimin e këtyre akteve spjeguar më sipër :

Vendim Nr. 103, Datë 30.04.2018 Mbi miratimin e programit të pajtueshmërisë së OST sh.a. Shoqëria OST sh.a. me shkresën nr. 962 Prot., datë 31.01.2018 i është drejtuar ERE me kërkesën për miratimin e Programit të Pajtueshmërisë së OST sh.a. Kjo kërkesë vjen në zbatim të vendimit të ERE nr. 43, datë 15.03.2017 si dhe Vendimit të Këshillit Mbikqyrës të OST sh.a. i cili me vendimin nr. 2, datë 21.01.2018, ka miratuar Programin e Pajtueshmërisë së OST sh.a. Me vendimin e Bordit të ERE nr. 43, datë 15.03.2017 është vendosur “*Mbi miratimin përfundimtar të certifikimit të operatorit të sistemit të transmetimit të energjisë elektrike OST sh.a.*” në përputhje me nenin 54, pika 6, të Ligjit nr. 43/2015, “*Për Sektorin e Energjisë Elektrike*” dhe nenin 9, pika 6, të Direktivës 72/2009 EC mbas marrjes së opinionit të Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë. Ky vendim është marrë në përputhje me nenet 3, pika 8; 16; 54 dhe 58, pikat 1, 2, 3, 6 dhe 7, të Ligjit nr. 43/2015, “*Për Sektorin e Energjisë Elektrike*”; Vendimit të Këshillit Ministerial nr. D/2011/02/MC-EnC; Traktatit të Komunitetit të Energjisë, të ratifikuar me Ligjin nr. 9501, datë 03.04.2006, si dhe neneve 6, 8, 9 pika 1, neneve 10, 11, 12 dhe 14 të “*Rregullave për certifikimin e operatorit të sistemit të transmetimit të energjisë elektrike*”, miratuar me vendimin nr. 154, datë 11.12.2015, të Bordit të ERE-s. Në faqen 75 të këtij vendimi Bordi i ERE është shprehur: *Kërkesa për Zyrtarin e pajtueshmërisë dhe programin e pajtueshmërisë duhet të realizohet në përputhje me neni 21 të Direktivës së Energjisë Elektrike dhe duhet të përfshijnë të drejta të gjera që lidhen me*

vendimet e investimeve, dhe në veçanti detyrimin që të raportojë në ERE dhe të publikojë në faqen e internetit një raport në lidhje me marrëdhëniet midis të dy organeve publike që kontrollojnë OST dhe KESH / OSHEE. Programi i Pajtueshmërisë duhet t'i dorëzohet autoritetit rregullator ERE, jo më vonë se 6 muaj pas caktimit të Zyrtarit të Pajtueshmërisë. Ndërkohë që Zyrtari i Pajtueshmërisë duhet të caktohet jo më vonë se 3 muaj pas miratimit të Vendimit final të Certifikimi. Në përmbushje të kushteve dhe afateve të parashikuara në legjislacionin në fuqi si dhe në vendimin e ERE sipërcituar, Bordi u shpreh për miratimin e programit të pajtueshmërisë së OST sh.a.

Të tjera vendimmarrje të Bordit të ERE të cilat kanë qënë në fokus të punës së Drejtorisë juridike dhe drejtorive teknike të ERE kanë qënë ato që lidhen me shtyrjen e afateve apo ndërhyrje në kuadrin rregullues të miratuar më herët e që kanë ardhur si përgjigje e kërkesave të depozituara në ERE për përmirësimin e punës dhe operimit të aktivitetit nga të licencuarit.

Vendim Nr. 14, Datë 10.01.2018 mbi shtyrjen e afatit të tarifës së përkohshme të transmetimit të gazit natyror nga shoqëria “ALBGAZ” sh.a., miratuar me Vendimin e Bordit të ERE-s Nr. 90, Datë 07.06.2017 si dhe kontratës së transmetimit të gazit natyror të lidhur mes ALBPETROL sh.a. dhe ALBGAZ sh.a.

ERE me vendimin, nr. 90, datë 07.06.2017, ka miratuar tarifën e përkohshme të transmetimit të gazit natyror nga shoqëria “ALBGAZ” sh.a. për periudhën 05.01.2017 – 20.09.2017”, i ndryshuar me Vendimin nr. 155, datë 28.09.2017 dhe me Vendimin nr. 14 datë 10.01.2018. Në vijim, me qëllim që të mos pengohet ushtrimi i aktivitetit nga ky subjekt. Një parashikim i tillë gjen mbështetje në kuadrin ligjor në fuqi, e konkretisht ligjin 102/2015 Për sektorin e gazit natyror. Kjo tarifë e përkohëshme ka qëndruar në fuqi, me anë të vendimmarrjeve të herëpashërëshme të ERE, deri në plotësimin e kushteve të parashikuara në legjislacionin në fuqi, hartimin e legjislacionit sekondar të nevojshëm si dhe përmbushjen e kushteve të kërkuara ndaj AlbgaZ sh.a., kur me vendimin Nr. 97, Datë 23.04.2018 Bordi i ERE është shprehur për miratimin e tarifës së transmetimit të gazit natyror nga shoqëria albgaZ sh.a., për vitin 2018.

Vendimin Nr. 19, Datë 19.01.2018 Mbi çmimin vjetor të blerjes së energjisë elektrike, që do t'u paguhet prodhuesve ekzistues me përparësi të energjisë elektrike për vitin 2018

Me vendimin sa më sipër, mbështetur në Metodologjinë e përcaktimit të çmimit vjetor të blerjes së energjisë elektrike që do t'u paguhet prodhuesve ekzistues me përparësi për llogaritjen e këtij çmimi si dhe kritereve të tjera që referon ligji, është përcaktuar se Çmimi vjetor i blerjes së energjisë elektrike, që do t'u paguhet prodhuesve ekzistues me përparësi për vitin 2018, do të jetë 8.5652 Lekë/kWh. Në vijim me vendimin Nr. 267, Datë 21.12.2018 mbi lënien në fuqi të vendimit të bordit të ERE-s nr. 19, datë 19.01.2018; “Mbi çmimin vjetor të blerjes së energjisë elektrike, që do t'u paguhet prodhuesve ekzistues me përparësi të energjisë elektrike për vitin 2018” është vendosur që, *Të lërë në fuqi Vendimin nr. 19 datë 19.01.2018, “Mbi çmimin vjetor të blerjes së energjisë elektrike, që do t'u paguhet prodhuesve ekzistues me përparësi për vitin 2018” deri në publikimin e raportit vjetor nga HUPEX.*

Vendim Nr. 22, Datë 30.01.2018 Mbi ankimin e shoqërisë “OST” sh.a. në lidhje me Vendimin e bordit të ERE NR.210, Datë 28.12.2017 “Për miratimin e tarifës së shërbimit të transmetimit të energjisë elektrike nga OST sh.a për vitin 2018”.

Vendim Nr. 110, Datë 14.05.2018 mbi zgjidhjen e mosmarrëveshjes ndërmjet KESH sh.a dhe OST sh.a, lidhur me korrigjimet e faturave për shërbimin e balancimit sipas parashikimeve të akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi dhe përlllogaritjeve nga OST sh.a të rakorduara dhe të pranuara nga palët përgjegjëse për periudhën 1 korrik 2016 – 31 dhjetor 2017.

Vendim Nr. 148, Datë 28.06.2018 Mbi kërkesën e OSHEE sh.a. për kontestimin e Vendimit Nr. 110, Datë, 14.05.2018, të Bordit të ERE, lidhur me korrigjimin e faturave për shërbimin e balancimit sipas parashikimeve të akteve ligjore dhe nën ligjore në fuqi dhe përlllogaritjeve nga OST sh.a, të rakorduara dhe të pranuara nga palët përgjegjëse për periudhën 1 korrik 2016-31 dhjetor 2017".

Vendim Nr. 131, Datë 07.06.2018 Mbi kërkesën e KESH sh.a. për rishikimin e Vendimit të Bordit të ERE Nr. 98 Datë, 30.04.2016, Mbi miratimin e kontratës për shit-blerjen e sasisë së tepërt të energjisë elektrike që rezulton pas përmbushjes së kërkesës së klientëve që përfitojnë nga shërbimi universal, me qëllim mbulimin e humbjeve në rrjetin e shpërndarjes për periudhën kohore 01.01.2018-31.12.2018.

Vendim Nr. 59, Datë 15.03.2018 Mbi miratimin e kërkesës së OST sh.a. për shtyrjen e afatit të pikës 2 të Vendimit të ERE Nr. 43 Datë 15.03.2017 Mbi miratimin përfundimtar të certifikimit të operatorit të sistemit të transmetimit të energjisë elektrike OST sh.a. në përputhje me nenin 54, pika 6, të Ligjit Nr. 43/2015, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike” dhe nenin 9, pika 6, të direktivës 72/2009 EC mbas marrjes së opinionit të Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë.

Bordi i ERE me vendimin nr. 43 Datë 15.03.2017 ka vendosur mbi miratimin përfundimtar të certifikimit të operatorit të sistemit të transmetimit të energjisë elektrike OST sh.a. në përputhje me nenin 54, pika 6, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike” dhe nenin 9, pika 6, të direktivës 72/2009 EC. Për shkak të rrethanave të cilat siç spjeguar nuk varen nga vullneti i OST sh.a për të zbatuar parashikimet e vendimit të ERE nr. 43, datë 15.03.2017, “OST i është drejtuar ERE me kërkesën për shtyrjen me 1 vit të afatit të përmbushjes të kushteve të parashikuara në pikën 2 të vendimit të ERE nr. 43 datë 15.03.2017. • Kërkesa e OST sh.a është depozituar në ERE përpara përfundimit të afatit, dhe u konstatua se plotësonte për shqyrtim, ndaj në të tillë rrethana Bordi i ERE me vendimin **Nr. 59, Datë 15.03.2018, vendosi** Të miratojë kërkesën e OST sh.a për shtyrjen e afatit të zbatimit të pikës 2 të vendimit të ERE nr. 43 Datë 15.03.2017, “Mbi miratimin përfundimtar të certifikimit të Operatorit të Sistemit të Transmetimit të energjisë elektrike OST sh.a. në përputhje me nenin 54, pika 6, të Ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike” dhe nenin 9, pika 6, të Direktivës 72/2009 EC mbas marrjes së opinionit të Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë, deri në datën 15.03.2019.

Vendim Nr. 75, Datë 26.03.2018 Mbi detyrimin e shoqërisë OSHEE “Kontratës tip për shitblerje të energjisë elektrike ndërmjet OSHEE sh.a dhe prodhuesve me përparësi të energjisë elektrike” të miratuar me Vendimin Nr. 101, Datë 23.06.2016 të Bordit të ERE-s, i ndryshuar me Vendimin Nr. 147, Datë 30.09.2016 të Bordit të ERE-s.

Bordi i ERE me vendimin nr. 101, datë 23.06.2016 ka vendosur për miratimin e disa ndryshimeve në modelin e kontratës së shitblerjes së energjisë elektrike ndërmjet KESH sh.a. (FPSH) dhe prodhuesve të vegjël të energjisë (PVE) miratuar me vendimin nr. 80 datë 23.10.2009, të ndryshuar. Në zbatim të parashikimit të nenit 6, pika 10 të “Kontratës Noteriale” të nënshkruar nga Ministria

e Infrastrukturës dhe Energjisë dhe Prodhuesit me Përparësi të energjisë elektrike, detyrohet që “OSHEE” sh.a brenda datës 28 Janar 2018 të nënshkruajë kontratën e shitblerjes së energjisë elektrike me Prodhuesin me Përparësi të energjisë elektrike. Shoqëria OSHEE sh.a ka kërkuar nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë dhe Enti Rregullator i Energjisë udhëzim dhe orientim lidhje me këtë situatë si dhe hapat që duhet të ndërmerret Shoqëria “OSHEE” sh.a. ERE në cilësinë e rregullatorit ka detyrimin të garantojë mbarëvajtjen normale të kësaj kontrate midis OSHEE sh.a dhe Prodhuesve me përparësi të energjisë elektrike. Si e tillë për të mos penguar punën e OSHEE dhe PPE-ve në zbatimin e kësaj kontrate, lindi nevoja e nënshkrimit të saj nga palët sipas afateve të vendosura në kontratën/autorizim, me mbajtësin e miratimit përfundimtar nga Ministria përgjegjëse për ndërtimin e impianteve nga burimet e rinovueshme. Për sa më sipër ERE vendosi mbi këtë rrethanë përjashtimore që, Shoqëria OSHEE sh.a të nënshkruajë brenda afateve të vendosura në kontratë/autorizim, me mbajtësin e miratimit përfundimtar nga Ministria përgjegjëse për ndërtimin e impianteve nga burimet e rinovueshme, Kontratën Tip të shitblerjes së energjisë elektrike të miratuar nga ERE me Vendimin nr. 101, datë 23.06.2016.

Vendim Nr. 127, datë 04.06.2018 “Mbi miratimin e Kodit të rrjetit për kërkesat e lidhjes me rrjetin të sistemeve me tension të lartë me rrymë të vazhduar dhe parqet me module të energjisë të lidhur me rrymë të vazhduar (HVDC)”; **Nr. 128, datë 04.06.2018 “Mbi miratimin e Kodit të rrjetit për ngarkesën”;** **Nr. 129, datë 04.06.2018 “Mbi miratimin e Kodit të rrjetit mbi kërkesat për lidhjen me rrjetin e gjeneruesve”.**

Vendimet e mësipërm vijnë si rezultat i faktit se Shqipëria është anëtare e Sekretariatit të Energjisë që nga data 01.07.2006. Këto Kode mbështeten në Rregulloren e (BE) nr. 714/2009, të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit Evropës, në kërkesat e Rregullores së Komisionit (KE) 2016/1447 të datës 26 Gusht 2016 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit Evropës, në Vendimet nr. 2018/03 – 04 – 05/PHLG-EnC, datë 12.01.2018 të Grupit të Përhershëm të Nivelit të Lartë të Komunitetit të Energjisë si dhe parashikimet e Ligjit nr. 43/2015, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, i ndryshuar, certifikimin e operatorit të sistemit të transmetimit të energjisë elektrike OST sh.a.

Po ashtu duke pasur parasysh se operatori i sistemit të transmetimit të energjisë elektrike OST sh.a është anëtar me të drejta të plota e ENTSO-E dhe sipas Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë, ky Kod duhet të transpozohet pa ndryshuar tekstin apo strukturën e tij, dispozitat e këtyre Kodeve prevalojnë ndaj Kodit të Transmetimit miratuar me Vendimin nr. 186, datë 10.11.2017, të Bordit të ERE dhe çdo akti tjetër rregullator të sektorit të energjisë.

Vendim Nr. 161, datë 09.07.2018 Për miratimin e “Rregullores mbi kushtet e përgjithshme të shërbimit të furnizimit me gaz natyror për klientët fundorë”.

Kjo Rregullore është hartuar dhe miratuar si kërkesë e nenit 16, të Ligjit 102/2015” Për Sektorin e Gazit Natyror”, në pikën 10 të të cilit përcaktohet si përgjegjësi e ERE-s, miratimi i kushteve të përgjithshme të furnizimit, duke përfshirë këtu edhe hartimin në mënyrë transparente të të drejtave dhe detyrimeve kontraktuale të përgjithshme.

Vendim Nr. 168, Datë 19. 07.2018 “Mbi miratimin e ndryshimeve të propozuara nga TAP AG në metodologjinë e tarifave të TAP AG të miratuar me Vendimin e ERE-s nr.127 datë 7.11.2013”.

Ndryshimet e miratuara janë në përputhje me parimet e përmendura në “Opinionin Përfundimtar të Përbashkët të Rregullatorëve të Energjisë mbi Aplikimin e TAP AG për Përrjashtim të Autoritetit për Energjinë Elektrike dhe Gazin (Itali), Entit Rregullator të Energjisë (Shqipëri) dhe Autoritetit Rregullator të Greqisë”, miratuar me Vendimin e Komisionit European (C(2013)2949”. Në veçanti ato kanë për qëllim të

përmirësojnë saktësinë dhe transparencën e metodologjisë së tarifave dhe nuk paraqesin pengesa të panevojshme për procesin e parashikuar të rezervimit afatshkurtër të kapacitetit; - Aprovimi i këtyre ndryshimeve në Kodin e Tarifave është konsultuar me rregullatorët e Greqisë dhe Italisë, përaktësisht RAE dhe ARERA, - Metodologjia e Tarifave e amenduar, do të propozohet nga TAP AG te përdoruesit e saj potencialë në momentin e ofertës së produkteve të kapaciteteve dhe për këtë arsye, është e nevojshme të mbahen të rezervuara në Anekset B dhe C në këtë vendim.

Vendim Nr. 170, datë 03.08.2018 Mbi miratimin e Memorandumit të Mirëkuptimit mbi bashkëpunimin e tregjeve ditore të energjisë elektrike mes palëve, Enti Rregullator i Energjisë së Shqipërisë (ERE), Zyra e Rregullatorit të Energjisë të Kosovës (ZRRë), OST sh.a, KOST sh.a.

Memorandumi ka si qëllim të lehtësojë harmonizimin e tregjeve të energjisë elektrike të Shqipërisë dhe Kosovës, përsa i përket lehtësimit të procedurave të bashkëveprimit të këtyre tregjeve. Ky Memorandum është draftuar në kuadër të projektit për bashkimin e tregjeve të energjisë elektrike Shqipëri – Kosovë nga Sekretariati i Komunitetit të Energjisë.

Nëpërmjet këtij Memorandumi, palët zotohen të implementojnë projektin nga Programi i iniciativës së 6 vendeve të Ballkanit Perëndimor (Western Balkan 6; WB6), për integrimin e tregut ditor të energjisë elektrike për të cilin bashkërisht janë përgjegjëse. Objektivi i projektit është implementimi i tregut ditor të energjisë elektrike në Shqipëri dhe Kosovë në mënyrë efektive.

Autoritetet rregullatore, ZRRë dhe ERE, zotohen që të vazhdojnë bashkërisht punën për lehtësimin dhe koordinimin e mbikëqyrjes rregullatore, zhvillimin e deklaratave të përbashkëta, dhe udhëheqjen në marrjen e vendimeve të përbashkëta për implementimin e kësaj iniciative.

Vendim Nr. 183, Datë 20.08.2018 Mbi miratimin e licencës së operimit të Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes së energjisë elektrike.

Për miratimin e këtij dokumenti, ERE ka marrë në konsideratë të gjithë rekomandimet e palëve të interesit që shprehën opinionin e tyre, çka ndihmoi në përmirësimin e këtij drafti, pa rënë ndesh me sa parashikuar në legjislacionin në fuqi për kushtet e licencës së operimit të sistemit të shpërndarjes.

Vendimet Nr. 188, datë 20.08.2018; Nr. 249, datë 11.12.2018; Nr. 250, datë 11.12.2018; Nr. 251, datë 11.12.2018; Nr. 252, datë 11.12.2018; Nr. 253, datë 11.12.2018,

kanë miratuar Propozime të të gjithë OST-ve në përputhje me Rregulloret e Komisionit Evropian që lidhen me metodologji të modelit të përbashkët të rrjetit, metodologji të ofrimit të të dhënave të gjenerimit dhe ngarkesës, metodologji të analizës së kosto-përfitimit si dhe Udhëzuesit përkatës mbi alokimin e kapaciteteve në avancë, mbi operimin e sistemit të transmetimit të energjisë elektrike si dhe amendimet përkatëse.

Vendim Nr. 200, datë 03.09.2018 Mbi miratimin e disa ndryshimeve në “Rregullat për alokimin e kapaciteteve të interkoneksionit”.

Ndryshimet e miratuara kanë qëllim dhënien e aksesit tregtarëve dhe furnizuesve të energjisë elektrike, të regjistruar në një shtet tjetër anëtar të Traktatit të Komunitetit të Energjisë, për të pasur të drejtë të marrin pjesë në tregun e energjisë elektrike, bazuar në parimet e reciprocitetit dhe në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Vendim Nr.214, Datë 11.10.2018 Mbi miratimin e kodit të rrjetit mbi rregullat e ndërveprimit dhe shkëmbimit të të dhënave. (Sektori i Gazit Natyror)

Ky Kod është miratuar nisur nga fakti që Shqipëria është anëtare e Komunitetit të Energjisë që nga data 01.07.2006 dhe si e tillë duhet të mbajë në konsideratë parashikimet e Rregullores së (BE) nr. 715/2009, të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit Evropës; kërkesat e Rregullores së Komisionit (KE) 2015/703, të datës 30 prill 2015; Vendimin nr. 2018/02/PHLG.EnC, datë 12.01.2018 të Grupit të Përhershëm të Nivelit të Lartë të Komunitetit të Energjisë, me të cilin është miratuar Kodi i Rrjetit mbi Rregullat e Ndërveprimit dhe Shkëmbimit të të Dhënave. Në përshtatjen e Kodit të Rrjetit mbi Rregullat e Ndërveprimit dhe Shkëmbimit të të Dhënave, janë mbajtur në konsideratë parashikimet e Ligjit nr. 102/2015, “Për Sektorin e Gazit Natyror”, licencimi i shoqërisë “ALBGAZ” sh.a. në aktivitetin e Transmetimit të Gazit Natyror; licencimi i shoqërisë “ALBGAZ” sh.a. në aktivitetin e Shpërndarjes së Gazit Natyror si dhe Certifikimi Përfundimtar i Operatorit të Kombinuar të Gazit Natyror “ALBGAZ” sh.a.

Me Vendimet Nr. 198, datë 03.09.2018 dhe Nr. 199, datë 03.09.2018, ERE ka licencuar në veprimtarinë e tregtimit dhe furnizimit të energjisë elektrike, shoqërinë Furnizuesi i Tregut të Lirë sh.a (FTL sh.a).

Po ashtu me Vendimet Nr. 215, datë 11.10.2018 dhe Nr. 216, datë 11.10.2018 ka transferuar licencat e furnizimit të energjisë elektrike dhe të operimit të sistemit të shpërndarjes, OSHEE sha. përkatësisht tek Furnizuesi i Shërbimit Universal sh.a (FSHU sh.a) dhe Operatori i Sistemit të Shpërndarjes sh.a (OSSH sh.a).

Shoqëritë “FTL” sh.a, “FSHU” sh.a dhe OSSH sh.a, janë themeluar si shoqëri të kontrolluara, në zbatim të Ligjit nr 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, i ndryshuar, Ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, i ndryshuar dhe Urdhërit të Asamblesë së Përgjithshme Nr. 157 Prot, datë 12.02.2018 të shoqërisë “Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike, “OSHEE” sh.a, në cilësinë e Aksionerit themelues dhe shoqërisë mëmë.

Vendim Nr. 247 , Datë 11.12.2018 Mbi miratimin e “Rregullave për kushtet e shërbimit të furnizimit nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit, dhe kushtet kontraktore të furnizimit me energji elektrike”.

Këto rregulla kanë për qëllim të përcaktojnë mënyrën e operimit nga FMF (Furnizuesi i Mundësisë së Fundit) në lidhje me përmbushjen e detyrimeve të parashikuara në ligj për veprimet që do të ndiqen me qëllim sigurimin e shërbimit nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit si dhe kushtet kontraktore për shërbimin e furnizimit me energji elektrike, nga FMF. Këto rregulla/kushte janë hartuar në mbështetje të:

- Ligjit Nr.43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, i ndryshuar, neni 86 dhe neni 87, pika 3.
- Ligjit Nr. 9902 datë 17.04.2008, “Për mbrojtjen e konsumatorëve”, i ndryshuar.
- Ligjit Nr. 9887 datë 10.03.2008, “Për mbrojtjen e të dhënave personale” i ndryshuar.

Vendim Nr. 246, datë 11.12.2018 Mbi miratimin e “Rregullores mbi kushtet specifike për ndërprerjen e furnizimit me energji elektrike të klientëve në nevojë”

Ndër risitë e reja të Ligjit Nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike” i ndryshuar, ishte dhe përcaktimi me dispozita të veçanta i “ *Klientëve në Nevojë* “ si dhe detyrimin e furnizuesit të Shërbimit Universal të Furnizimit për të furnizuar *klientët në nevojë* sipas nenit 84, pika 1, gërma d. Bazuar në autoritetin që i është dhënë në përputhje me përcaktimet e nenit 96 të Ligjit Nr. 43/2015

sipas të cilit : *Furnizuesi, që furnizon me energji elektrike klientin në nevojë, mund të ndërpresë shërbimin, bazuar në kushtet specifike për këtë kategori klientësh, të miratuara nga ERE, kjo e fundit hartoi draft Rregulloren “Për përcaktimin e kushteve për ndërperjen e furnizimit me energji elektrike të klientëve në nevojë”.*

Drafti i këtyre Rregullore është përgatitur në mbështetje të parashikimeve të ligjit të sipërcituar dhe duke mbajtur në konsideratë se: Vendi ynë ka ratifikuar *“Traktatin e Komunitetit të Energjisë”* nga i cili buron detyrimi që vendet komunitare duhet të sigurojnë nëpërmjet legjislacionit të brendshëm implementimin e kërkesave të *Paketës së Tretë të Energjisë*.

Në kuadër të kësaj pakete, kërkohet mbrojtja e konsumatorit përmes një tregu që të nxisë konkurrencën dhe të ulë pengesat për hyrjen e furnizuesve të rinj dhe palët e tjera të treta. Mbrojtje të veçantë i dedikon kjo paketë sa i takon “klientëve në nevojë” ndër të tjera edhe vendosjes së kriterëve të ndërperjes së shërbimit të furnizimit për këtë kategori konsumatorësh.

Ligji organik Nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike” i ndryshuar, gjithashtu në nenin 84, pika 2, gërma d, ka përcaktuar detyrimin e furnizuesin e shërbimit universal të furnizimit që *“të furnizojë klientët në nevojë, duke respektuar kushtet e përcaktuara në nenin 96 të këtij ligji”*. Në nenin 95 “klientët në nevojë” të Ligjit Nr. 43/2015, përcaktohet se Ministria Përgjegjëse për Çështjet Sociale, në bashkëpunim me Ministrinë Përgjegjëse për Energjinë, Ministrinë e Financave, dhe në konsultim me ERE-n, dhe grupet e interesit, harton kriteret, procedurat për përfitimin e statusit të klientit në nevojë dhe mënyrën e trajtimit të tyre, të cilat miratohen me Vendim të Këshillit të Ministrave.

Kjo rregullore, përsa më sipër cituar reflekton edhe detyrimet e vendosura në Direktivën 2009/72/EC dhe Direktivën 2009/73/EC, sipas të cilës:

Shtetet Anëtare do të marrin masat e duhura për të mbrojtur konsumatorët fundorë, dhe në veçanti, do të sigurojë që ka mbrojtje më specifike dhe më adequate të konsumatorëve në nevojë (vulnerable customer).

Në këtë kontekst, çdo shtet anëtar përcakton konceptin e “konsumatorëve në nevojë”, që mund t’i referohen varfërisë energjetike dhe ndër të tjera, me fokus në ndalimin e ndërprerjes së energjisë elektrike (gazit) tek këta konsumatorë në kohë kritike.

Me qëllimin për një vendimmarrje të drejtë dhe transparente Draft Rregullorja u është dërguar të gjitha palëve dhe grupeve të interesit për të shfaqur komentet dhe sugjerimet e tyre, të cilat janë marrë në konsideratë nga ERE gjatë miratimit të *“Rregullores mbi kushtet specifike për ndërprerjen e furnizimit me energji elektrike të klientëve në nevojë”*.

Akte për të cilat ERE është në proces konsultimi me USAID dhe ENC janë:

- Rregullorja për mënyrën e përzgjidhjes, emërimit, ngritjes në detyrë dhe largimit nga detyra te personelit teknik.
- Rregulla për përcaktimin e kostove nga përdoruesit në lidhje me kushtet e veçanta të pikës së lidhjes.
- Sistemi i njësuar dhe standard i llogarive për të gjithë të licencuarit që veprojnë në tregun të energjisë elektrike.

- Kushtet teknike për instalimin e një burimi dytësor të furnizimit me energji elektrike për klientët që kërkojnë këtë shërbim, përfshirë edhe kushtet që duhet të përmbushë burimi dytësor, me qëllim që të parandalohen çrregullimet në rrjet.
- Kodi i shpërndarjes.

3.6 Proçeset gjyqësore në të cilat ERE ka qënë palë gjatë vitit 2018

3.6.1 ERE në Cilësinë e Palës së Paditur në proçeset gjyqësore.

ERE ka qënë palë e paditur në 4 proçese gjyqësore përgjatë vitit 2018.

1. Proçesi gjyqësor në Gjykatën Administrative Tiranë, çështja nr. 4701/279, me palë: Padihtëse Shoqëria Tregtare “Star NRG” sh.p.k.; e Paditur: ERE; Person i Tretë: OSHEE sh.a., Anastas Riska; me Objekt: Konstatimin e pavlefshmërisë absolute dhe të paligjshmërisë të Vendimt nr. 117, datë 27.07.2017, të Bordit të ERE. Gjykata Administrative Tiranë me vendimin e datës 18.03.2019, ka vendosur rrëzimin e padisë.
2. Në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë është kundërshtuar nga “OSHEE”, Vendimi Nr.110, datë 14.05.2018 të Bordit të Komisionerëve të ERE “*Mbi zgjidhjen e mosmarrëveshjes ndërmjet “KESH” Sh.A dhe “OST” Sh.A, lidhur me korrigjimet e faturave për shërbimin e balancimit sipas parashikimeve të akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi dhe përlllogaritjeve nga “OST” Sh.A të rakorduara dhe të pranuar nga palë përgjegjëse për periudhën 1 korrik 2016 – 31 dhjetor 2017*”, në çështjen me palë ndërgjyqëse si më poshtë: Padihtës: OSHEE sh.a, I paditur: Enti Rregullator i Energjisë (ERE) Persona të tretë, KESH sh.a dhe OST sh.a Objekt: Kundërshtim i Vendimit Nr.110, datë 14.05.2018 të Bordit të Komisionerëve të ERE. Marrja e masës së sigurimit të padisë, për pezullimin e zbatimit të Vendimit të ERE. Në përfundim të gjykimit të kërkesë padisë të OSHEE, Gjykata Administrative të Shkallës së Parë Tiranë me Vendimin Nr. 3851, datë 29.10.2018, ka vendosur rrëzimin e kërkesë padisë.
3. Proçesi gjyqësor në Gjykatën Administrative Tiranë, çështja nr. 3160/31162-03374-80, me palë: Padihtëse Shoqëria “OSHEE” sh.a.; e Paditur: ERE; Person i Tretë: Shoqëria “OST” sh.a.; me Objekt: Kundërshtim dhe anulim të Vendimt nr. 102, datë 19.07.2012, të Bordit të ERE. Gjykata Administrative Tiranë me vendimin nr. 2879, datë 20.07.2018, vendosi rrëzimin e padisë.
4. Proçesi gjyqësor në Gjykatën Administrative Tiranë, çështja nr. 2432, me palë: Padihtëse Shoqëria “Dardania Energji” sh.p.k.; e Paditur: ERE, Soqëria “Dosku Energji” shp.k., MIE, Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, KESH sh.a., OSHEE sh.a.; me Objekt: Konstatimin pjesërisht të pavlefshëm të Vendimt nr. 67, datë 27.07.2011, të Bordit të ERE. Gjykata Administrative Tiranë me vendimin nr. 3477, datë 08.10.2018, vendosi rrëzimin e padisë.
5. Proçesi gjyqësor në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë Tiranë, çështja nr. 14033 Akti, me palë: Padihtëse Shoqëria “Dardania Energji” sh.p.k.; e Paditur: ERE, Soqëria “Dosku Energji” shp.k., MIE, Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, KESH sh.a., OSHEE sh.a.; me Objekt: Pavlefshmëri akti. Gjykimi i kësaj çështjeje ka vazhduar edhe përgjatë

vitet 2019. Pala paditëse ka hequr dorë nga padia. Pritet zbardhja e vendimit të Gjykatës së Rrethit Tiranë dhe vënia në dispozicion e këtij vendimi.

3.6.2 ERE në Cilësinë e Palës së Tretë në proceset gjyqësore në kuadër zbatimit të kompetencave ligjore.

ERE është thërritur në cilësinë e personit të tretë me të cilin palët paditëse kanë të përbashkët çështjen që kanë paraqitur ne gjykatë. Janë 14 procese gjyqësore në të cilat ERE është thërritur për të ndihmuar palët ndërgjygjëse dhe gjykatën në zgjidhjen e konflikteve të cilat në të gjitha rastet janë shqyrtuar më herët administrativisht pranë sektorit për mbrojtjen e konsumatorit në ERE. 10 procese kanë përfunduar gjykimin pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, dhe janë në proces shqyrtimi në Gjykatën e Apelit, ndërsa për 3 procese të tjera vazhdon procesi gjyqësor pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor -Tiranë. Një proces është pezulluar nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

3.7 Zhvillimi i seancave Dëgjimore në ERE

Për vitin 2018 shënohen 26 seanca degjimore teknike dhe joteknike, të organizuara nga ERE nga të cilat 20 seanca në kuadër të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve midis operatorëve të licencuar në sektorin e energjisë elektrike dhe gazit natyror, dhe 6 seanca diskutimesh me palët e interesuara në kuadër të rishikimit të akteve nënligjore në zbatim të ligjit nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë”.

3.8 Veprimtaria e ERE-s në fushën e Mbrojtjes së Konsumatorit.

Autoriteti dhe përgjegjësia e ERE-s në drejtim të zbatimit të masave më efektive për garantimin e mbrojtjes së klienteve të energjisë elektrike, zë një vend të veçantë në veprimtarinë e saj në funksion të Ligjit Nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike” i ndryshuar. Veprimtaria e Sektorit të Mbrojtjes së Konsumatorit mbështetet kryesisht në parimet kryesore që konsistojnë në:

- Trajtimin dhe zgjidhjen e të gjitha ankesat dhe konfliktet direkte që lindin në marrëdhëniet midis furnizuesit të energjisë elektrike dhe konsumatorëve/klientëve, duke pasur si qëllim:
- Mbrojtjen e interesave të konsumatorëve/klienteve në aspektin individual.
- Mbrojtjen e interesave të konsumatorëve/klientëve në tërësi nga abuzimet e aktorëve dominant në tregun e energjisë elektrike.
- Trajtim të barabartë dhe jodiskriminues të të gjithë klienteve përmes procedurave ligjore e transparente.
- Monitorimin dhe kontrollin e shërbimeve që ofron i licensuari ndaj konsumatorëve të energjisë elektrike.
- Sigurimin e një shërbimi të furnizimit me energji elektrike të pa ndërprerë dhe brenda standardeve të cilësisë së shërbimit.

Prioriteti i ERE-s në zgjidhjen e mosmarrëveshjeve ndërmjet klientëve të energjisë elektrike dhe të licencuarve, vazhdon të mbetet ndër veprimtaritë kryesore të saj që vijnë si detyrim i zbatimit të parashikimeve të nenit 24 të Ligjit Nr.43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike” i ndryshuar dhe nenit 98 të Ligjit Nr. 102/2015 “Për Sektorin e Gazit Natyror”.

Edhe gjatë vitit 2018 ka vijuar veprimtaria e ERE-s në drejtim të mbrojtjes së konsumatorit, me hartimin e miratimin e akteve nënligjore në zbatim të Ligjit Nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”i ndryshuar; Ligjit Nr. 102/2015 “Për Sektorin e Gazit Natyror”, si dhe monitorimit të zbatimit nga “Kushtet e Përgjithshme të Kontratës së Shërbimit Universal të Furnizimit me Energji Elektrike për Klientët Fundorë” të akteve nënligjore të tilla si dhe “Rregullore për Kriteret Standarde të Cilësisë së Shërbimit të Furnizimit dhe Performancës së Sigurisë së Rrjetit të Shpërndarjes së Energjisë Elektrike” të miratuar me vendimin e ERE-s Nr.181, datë 10.11.2017 (etj).

Një hap i rëndësishëm në tutelimin e interesave të konsumatorit ka qënë edhe miratimi i “Planit të masave për operatorin e shpërndarjes së energjisë elektrike. “OSHEE” sha, për respektimin e të drejtave të klientëve të furnizimit me energji elektrike

Kuvendi i Shqipërisë në Rezolutën e datës 09.07.2018 për vlerësimin e veprimtarisë së Entit Rregullator të Energjisë ka rekomanduar ndër të tjera dhe se ERE, në kuadër të mbrojtjes së konsumatorit përmes kompetencave që i jep Ligji të kërkojë nga “OSHEE” sh.a, respektimin e të drejtave të konsumatorit, përmirësimin e shërbimit të kujdesit për klientin, evidentimin dhe ndëshkimin e sjelljeve arbitrare dhe të papërgjegjshme nga punonjës të “OSHEE”sh.a, si dhe respektimin e afateve për shërbimet përkatëse të cilat jo rrallë nuk respektohen duke krijuar vonesa të cilat lënë vend për abuzim dhe korrupsion. Në kuadër të mbrojtjes së konsumatorit dhe për të bërë të mundur që përdoruesit të mos ndjehen të pambrojtur në një treg i cili akoma nuk është liberalizuar, ERE të hartojë një plan masash me detyra konkrete për “OSHEE”sh.a, lidhur me problematikat kryesore sa i takon respektimit të të drejtave të konsumatorit dhe të informojë Kuvendin mbi realizimin e këtyre masave nga “OSHEE”sh.a, mbi baza periodike gjatë vitit. Të rrisë përpjekjet e “OSHEE” sh.a, në ndërgjegjësimin e konsumatorëve për të drejtat e tyre që lidhen me shërbimin e furnizimit me energji elektrike, përmes publikimeve në faqen online të institucionit, si dhe mjeteve të tjera të komunikimit. Shërbimi i furnizimit me energji elektrike realizohet si një shërbimi i rregulluar çka përfshin “Kontrata të Rregulluara”, Rregulla dhe standarde të cilësisë së shërbimit të miratuara nga ERE. Këto akte rregullojnë marrëdhëniet në veprimtarinë e furnizimit për klientet tariforë dhe gjithashtu synojnë të mbajnë në konsideratë ekuilibrimin sa më të mirë të të drejtave dhe detyrimeve të palëve në këtë marrëdhënie kontraktore. Në këtë kuadër, Ligji Nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike” i ndryshuar, përcakton në mënyrë të qartë veprimtarinë e furnizimit të klienteve fundorë dhe atributin e ERE –s, për të miratuar dhe monitoruar “Kushtet e përgjithshme të shërbimit universal të furnizimit si detyrim i shërbimit publik”. Ligji Nr. 43/2015 ”Për Sektorin e Energjisë Elektrike” i ndryshuar, përcakton detyrime më specifike për furnizuesin e ngarkuar me detyrimin e shërbimit universal të furnizimit si detyrim i shërbimit publik si dhe të drejta e detyrime të qarta për klientët fundorë.

Në këto kushte dhe për sa rekomanduar nga Kuvendi në Rezolutën e sipërcituar, ERE e vlerësoi të nevojshme hartimi i një plani masash për “OSHEE”sh.a, për respektimin e të drejtave të konsumatorëve të furnizimit me energji elektrike me qëllim garantimin dhe mbrojtjen e interesave të klientëve fundorë, si një detyrim i cili buron nga Ligji Nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike” i ndryshuar. ERE me Vendimin e Bordit Nr. 201, datë 03.09.2018 miratoi “Planin e masave për Operatorin e Shpërndarjes së Energjisë Elektrike (OSHEE) sh.a, për respektimin e të drejtave të klientëve të furnizimit me energji elektrike “ .

Plani i masave, identifikon qartësisht përgjegjësitë e Furnizuesit në kuadër të detyrimit të shërbimit publik të tillë si: E drejta e informimit, aksesit të konsumtarit ndaj shërbimeve, e drejta për të paraqitur ankesë ndaj shërbimit të ofruar, e drejta e zgjedhjes, përfshirë dhe të drejtën e zgjedhjes së modaliteteve të pagesave, e drejta e zgjedhjes së furnizuesit, e drejta për t'u informuar për çmimet.

ERE do të monitorojë punën e Furnizuesit të Shërbimit Universal kundrejt standardeve të vendosura në aktet rregullatore dhe në përpunime me detyrat sipas këtij plani masash.

Në vijim të detyrave që i ngarkohen nga ligji, ERE ka analizuar të dhënat lidhur me numrin e ankesave të klientëve të paraqitura gjatë vitit 2018 dhe ka evidentuar se ky numër është shumë më i vogël në krahasim me vitin 2017. Për vitin 2017, në ERE janë paraqitur dhe trajtuar 564 ankesa për energjinë elektrike, ndërkohë që gjatë vitit 2018 janë paraqitur dhe trajtuar 279 ankesa. Përveç ankesave të paraqitura, Sektori i Mbrojtjes së Konsumatorit në zbatim të përgjegjësisë dhe objektivave të tij ka ofruar asistencë dhe në dhënien e informacionit, shpjegimeve dhe konsultimeve verbale ndërmjet faqes zyrtare të ERE-s www.ere.gov.al për të gjithë klientët e energjisë elektrike. Objekti i ankesave të paraqitura ka konsistuar në shkeljen e kushteve të përgjithshme të “Kontratës së Shërbimit Universal të Furnizimit me Energji Elektrike për Klientet Fundorë”, të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s Nr. 15, datë 10.01.2018 në të cilat përcaktohen detyrimet reciproke të palëve në kontratë.

ERE në referencë të Ligjit Nr.43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike” i ndryshuar dhe akteve nënligjore, si: “Kontratës së Shërbimit Universal të Furnizimit me Energji Elektrike për Klientët Fundorë”; “Rregullores për Trajtimin e Ankesave të Paraqitura nga Klientët dhe për Zgjidhjen e Mosmarrëveshjeve midis të Licencuarve në Sektorin e Energjisë Elektrike dhe të Gazit Natyror” dhe “Rregullave për Organizimin, Funkionimin dhe Proçedurat e ERE-s, ka trajtuar dhe analizuar ankesat e klientëve të energjisë elektrike duke ia përcjellë shoqërisë “OSHEE” sh.a, së bashku me udhëzimet përkatëse.

Ne tabelën e mëposhtme jepen ankesat totale sipas problematikave të trajtuara nga ana e OSHEE sh.a. dhe ato të cilat janë adresuar duke dhënë zgjidhje.

Te paraqitura:		Te zgjidhura:	
Nr.Ceshtjeve	2018 Total	Nr.Ceshtjeve	2018 Total
KATEGORIA		KATEGORIA	1
Faturimi	40,793	Faturimi	4,336 41,762
Kreditimi	2,482	Kreditimi	2,110 3,792
Cilesi Sherbimi	4,910	Cilesi Sherbimi	687 5,069
Depozitime Zyrtar Qendrore	116	Depozitime Zyrtar Qe	10 121
Komunikime Pale te 3ta	543	Komunikime Pale te	354 1,019
Ndryshime Kontrate	49,938	Ndryshime Kontrate	6,068 45,724
Lidhjet e reja	54,294	Lidhjet e reja	3,603 46,968
Grand Total	153,076	Grand Total	17,168 144,455

Figure 74 Ankesat totale sipas problematikave të trajtuara nga ana e OSHEE sh.a.

Në tabelën më poshtë jepen të detajuara sipas objektit ankesat e trajtuara nga ERE gjatë 2018.

Ankesat e trajtuara nga ERE gjatë vitit 2018									
OBJEKTI	ENERGJI E PAMATUR	FATURIM AFORFE	MBIFATURIM	FATURIM FIKTIV	KONTRATE FIKTIVE	MATJE JASHT KUSHTEVE TEKNIKE	VLERE REFERUESE	TE NDRYSHME	TOTALI
JANAR	10	2	7	0	0	6	6	14	45
SHKURT	6	1	7	1	0	1	1	16	33
MARS	5	1	10	0	3	1	1	9	30
PRILL	10	1	5	0	4	3	2	8	33
MAJ	3	1	6	0	3	2	0	4	19
QERSHOR	4	2	4	1	1	2	1	4	19
KORRIK	3	2	4	1	2	1	0	7	20
GUSHT	3	0	5	0	0	1	1	8	18
SHTATOR	3	0	5	0	0	1	1	7	17
TETOR	2	0	5	0	0	0	1	5	13
NENTOR	2	0	3	1	0	1	1	7	15
DHJETOR	3	0	4	0	1	1	0	8	17
Tot 2018	54	10	65	4	14	20	15	97	279

Figure 75 Ankesat e trajtuara nga ERE gjatë 2018

Gjatë periudhës Janar – Dhjetor 2018, janë trajtuar nga ERE në total rreth 279 ankesa. Nga të dhënat e administruara konstatohet se ankesat me objekt “mbifaturim” zënë vendin kryesor në trajtimin e ankesave, të ndjekura nga ankesat me objekt “energji e pamatur” dhe “matje jashtë kushteve teknike”.

Nga analizimi i tabelës së mësipërme konstatohet sipas objektit të ankesës, raporti midis ankesave totale dhe atyre që kanë përgjigje nga Shoqëria rezulton si në vijim;

- 54 ankesa për “energji të pamatur”, prej të cilave janë marrë masa për anulimin e 6 prej tyre;
- 65 ankesa për “mbifaturim” të energjisë elektrike, prej të cilave janë marrë masa për anulimin e 2 prej tyre;
- 10 ankesa për “faturim aforfe” të energjisë elektrike, prej të cilave janë marrë masa për anulimin e 3 prej tyre;
- 20 ankesa për “ matje jashte kushteve teknike”;
- 15 ankesa për vlerë rreferuese dhe;
- 14 ankesa për kontratat fiktive, për të cilat nuk ka patur sistemim nga ana e shoqërisë “OSHEE” sha.

Theksojmë faktin se, pavarësisht mënyrës së zgjidhjes të gjitha ankesave të dërgura nga ERE, Shoqëria e furnizimit “OSHEE” sh.a, i është përgjigjur shkresërisht.

Vlen të theksojmë faktin se janë evidentuar gjithashtu dhe ankesat me objekt kryesisht të: refuzimit të së drejtës për “lidhje të re” në sistemin e shpërndarjes; ankesat për kreditim të pagesave të energjisë elektrike; ndryshim tarifimi; kolaudim matësi.

Në mënyrë grafike ky informacion jepet në Figurën më poshtë.




Figure 76 Ankesat e trajtuara nga ERE gjatë vitit 2018

3.8.1 Ankesat për mbifaturimin e energjisë elektrike.

Nga analiza e treguesve statistikorë konstatohet se spektrin më të madh të ankesave e zënë ankesat me objekt “mbifaturimin” e energjisë elektrike, të rregjistruara në ERE për vitin 2018 janë 65 ankesa, ose rreth 23% e totalit të ankesave. Këto ankesa janë shkaktuar nga problematika të ndryshme si: mosrakordimi i gjendjes së hedhur në sistemin e faturimit me gjendjen reale të matësit, gabime nga ana e faturuesve, vonesa në hedhjen e të dhënave të matësive të rinj në sistem. Për të gjitha këto ankesa, ERE ka kërkuar nga shoqëria “OSHEE” sh.a, verifikimin e praktikave dhe procedurave lidhur me faturimet e kryera së bashku me korrigjimet përkatëse që duhen realizuar në zbatim të afateve të përcaktuara për trajtimin e ankesave. Nga ana e shoqërisë “OSHEE” sh.a, nga 65 ankesa për “mbifaturim” të energjisë elektrike, janë marrë masa për të sistemuar vetëm 2 prej tyre.

3.8.2 Ankesat për “Energji të pamatur”.

Ankesa për “energji të pamatur”, zënë vendin e dytë në totalin e ankesave të trajtuara me rreth 54 ankesa ose 19 % e totalit të ankesave. Vihet re se këto ankesa janë të mbartura dhe përfshijnë

faturime të energjisë elektrike, të cilat kanë ardhur si pasojë e kontrolleve të ushtruara nga shoqëria “CEZ Shpërndarje“ sh.a, përgjatë periudhës 2011-2013, ku vihet re se në shumicën e rasteve të paraqitura, procesverbalet e mbajtura për konstatimin e ndërhyrjeve të paautorizuara në sistemin e matjes janë kryer jo në prezencën e klientit, në bokse kolektive të matësive të energjisë elektrike si dhe raste ku është lëshuar më shumë se një faturë, brenda 1 viti, që përmban “energji të pamatur”.

Sikurse evidetohet pavarësisht trajtimit të një pjese të konsiderueshme të këtyre faturimeve nga shoqëria “OSHEE“ sh.a, vijon të ketë ende ankesa të pazgjidhura lidhur me këtë problematikë.

Sikurse dhe në vitet më parë, është për tu theksuar faktin se edhe gjatë vitit 2018, konstatohen ende ankesa nga klient të energjisë elektrike, të cilët edhe pse periudha e faturimit të tyre nën emërtimin “dëm ekonomik“ dhe “energji e pamatur“, sipas procesverbaleve të mbajtur është bërë në periudhën Tetor 2008 - Prill 2011, këto faturime nuk janë anuluar nga Shoqëria “OSHEE”sh.a (si rezultat i zbatimit të Vendimit Nr. 90 të Bordit të ERE-s, datë 15.11.2010). Lidhur me zbatimin e këtij vendimi, ERE ia ka parashtruar këtë problematike ish shoqërisë “CEZ Shpërndarje” sh.a, disa herë ku ka evidentuar ankesat e klienteve të energjisë elektrike të cilët janë faturuar me faturimin nën emërtimin “energji e pamatur” dhe “dëm ekonomik” dhe ka kërkuar anulimin e mënjëhershëm të këtyre faturimeve.

3.8.3 Ankesat për “faturim aforfe”.

Edhe gjatë vitit 2018 konstatohet ankesat për “faturim aforfe” të energjisë elektrike të trajtuara nga ERE. Janë paraqitur dhe trajtuar rreth 10 raste ose gati 4% e totalit të ankesave. Lidhur me këto problematika ERE, i ka trajtuar me shkresa përcjellëse ku ka kërkuar verifikimin rast pas rasti nga ana e kompanisë “OSHEE” sh.a. Problematike vazhdojnë të mbeten ende faturimet aforfe të energjisë elektrike për periudhën 2007 – 2015, lidhur me sasinë e energjisë elektrike të faturuar aforfe të përcaktuara në Vendimet e Bordit të ERE-s si dhe me afatin final të aplikimit të këtij faturimi bazuar në Vendimin e Bordit të ERE-s Nr.104, datë 22.12.2009 “*Për përcaktimin e kohëzgjatjes për faturimin aforfe për klientët familjarë pa matës të energjisë elektrike*”. Ka patur ankesa nga klientë, të cilët edhe pse kanë qënë të pajisur me matës të energjisë elektrike, përsëri janë faturuar aforfe në kundërshtim me Vendimin e Bordit të ERE –s Nr. 146, datë 24.12.2013 “*Mbi kërkesën e kompanisë “Cez-Shpërndarje” sh.a, në administrim të përkohshëm, për vendosjen e faturimit aforfe*”. Gjithashtu për klientët familjare me matës të dëmtuar dhe jashtë kushtit teknik, Vendimi Nr. 146, datë 24.12.2013 i Bordit të ERE-s, pika 2 e tij, përcakton qartë që “*për konsumatorët me matës të dëmtuar dhe jashtë kushtit teknik faturimi aforfe sipas tabelës bashkëlidhur këtij vendimi aplikohet për një periudhë jo më shumë se 2 (dy) muaj*”.

3.8.4 Faturimi i energjisë elektrike për “matje jashtë kushteve teknike”.

Gjate vitit 2018 janë evidentuar një numër relativisht jo i madh i ankesave me objekt “matjet jashtë kushteve teknike”, në krahasim me vitin 2017 ku ishin rreth 30 ankesa ose 5% e totalit. Gjatë 2018 konstatohen rreth 20 ankesa ose 7% e totalit. Ky faturim është bërë në rastet e evidentimit të matësive të energjisë elektrike, jashtë klasës së saktësisë në matje ose për shkak të dëmtimit të tyre. Faturimi i tyre është bërë bazuar në procesverbalet e mbajtur nga ana e shoqërive të autorizuara për verifikimin e saktësisë së matësive të energjisë elektrike ashtu siç përcaktohet në pikën IV.9 të “Kodit të Matjes”. Megjithatë, duhet vënë në dukje se mos zëvendësimi i këtyre matësive në afat

ka sjellë ngarkimin e klienteve me energji të faturuar për “matje jashtë kushteve teknike”, në kundërshtim me “Kontratën për Furnizimin me Energji Elektrike për Klientët Familjarë dhe Jofamiljarë”, neni 8, pika 2, ku përcaktohet se “*nëse Furnizuesi nuk respekton afatin 30 ditor për vendosjen e matësit të rregullt, atëherë përgjegjësia është e Furnizuesit dhe faturimi për ditët pa matje tej këtij afati, do të jetë zero*”.

3.8.5 Ankesat mbi “kontratat fiktive” dhe “faturim fiktiv”.

Gjatë vitit 2018 lidhur me kontratat fiktive konstatohen në total rreth 18 ankesa për të cilat nuk ka pasur sistemime nga ana e shoqërisë “OSHEE” sh.a. Nga këto ankesa janë për faturim fiktiv rreth 4 ankesa ose 2% e totalit të ankesave dhe 14 ankesa për kontrata fiktive ose 5% e totalit, të ankesave që klientët e energjisë elektrike kanë bërë ndaj shoqërisë “OSHEE” sh.a. Këto ankesa lidhen kryesisht me kontrata të furnizimit me energji elektrike të dubluara me kontratat origjinale të klientëve, me kontrata të hapura në mënyrë të njëanshme pa marrëveshje mes palëve, kontrata provizore të hapura gjatë viteve të mëparshme, faturime fiktive për kontrata të cilat janë të shkëputura nga rrjeti i furnizimit me energji elektrike ose për objekte të cilat nuk ekzistojnë më, apo nuk kanë ekzistuar asnjëherë. Duhet përmendur se problemet kryesore lidhur me kontratat dhe faturimin fiktiv vijnë nga zonat me ndërtime informale, objektet e të cilave kanë qenë ose janë në proces legalizimi nga ana e ALUIZNI-t.

Këto ankesa i janë përcjellë kompanisë por për shkak të keq menaxhimit të arkivave gjatë periudhës 2010-2013 e më parë nuk gjendet dokumentacion për zgjidhje përfundimtare të problematikës. Kjo e konstatuar nga përgjigjet e ardhur nga “OSHEE” sh.a.

3.8.6 Ankesa “të ndryshme”.

Në grupin e ankesave të klasifikuara “të ndryshme” janë futur ankesat me objekt: refuzimin e të drejtës për “lidhje të re” në sistemin e shpërndarjes; ankesat për kreditim të pagesave të energjisë elektrike; ndryshim tarifimi; kolaudim matësi, ndërprejen e energjisë elektrike në menyrë të mënjëhershme, kryqëzim matësi të energjisë elektrike, faturimin e ambjenteve të përbashkëta, etj. Në grupin e ankesave të ndryshme konstatohen rreth 95 ankesa të cilat zënë 35% të totalit të ankesave. Lidhur me këto problematika ERE, i ka trajtuar duke dërguar shkresa përcjellese kompanisë “OSHEE” sh.a, ku ka kërkuar verifikimin rast pas rasti të problematikave.

3.8.7 Ankesa për “vlera referuese” .

Në ndryshim nga 2017 ku numri i ankesave për “vlerë referuese”, ka qënë 43 ankesa ose 7% e totalit, gjatë vitit 2018 ky numër është ulur në 15 ankesa ose 5% e totali.

Kjo problematikë e ankesave mbi “vlerat referuese“, u konstatua në muajin Gusht 2016 e po vijon. Ligji Nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike” i ndryshuar, në nenin 76 te tij, ka përcaktuar ndër të tjera, në pikat 3 dhe 4 të tij se:

Në rast se të dhënat e matjes janë përkohësisht të padisponueshme ose të paarrtshme për një periudhë më të gjatë se 1 muaj, operatorët e rrjetit llogarisin vlera reference zëvendësuese, bazuar

në metodologjinë e miratuar nga ERE. Periudha e zbatimit të vlerave referuese nuk mund të zgjasë më shumë se 3 muaj.

Në kuptim të sa më sipër parashtruar, vërehet se ligji i atribuon ERE-s, përcaktimin e metodologjisë së llogaritjes së vlerave referuese të matjes së energjisë elektrike, në rastet kur konstatohet se të dhënat e matjes janë përkohësisht të padisponueshme ose të pa arritshme për një periudhë më të gjatë se 1 muaj, duke përcaktuar gjithashtu se vlerat referuese që do të përdoren nga Shoqëria nuk mund të jenë për një kohë më të gjatë se 3 muaj.

Në këto kushte, bazuar në nenet 16 dhe 76 të ligjit Nr.43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike” i ndryshuar; në nenin 113 të Kodit të Proçedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë, miratuar me Ligjin Nr. 44/2015, nenin 15 të “Rregullores për Organizimin, Funksionimin dhe Proçedurat e ERE-s” miratuar me Vendimin Nr. 96, datë 17.06.2016, Bordi i ERE me Vendimin e tij Nr.104, datë 23.06.2016 vendosi:

Shfuqizimin e vendimeve të ERE-s Nr. 49, datë 21.10.2004, “Për miratimin e mënyrës së faturimit të energjisë elektrike për abonentët familjarë dhe jofamiljarë me matësa jashtë kushtit teknik” dhe Nr. 146, datë 24.12.2013 “Mbi kërkesen e CEZ shpërndarje sh.a në administrim të përkohshëm për vendosjen e faturimit aforfe” dhe të çdo vendimi që bie në kundërshtim me këtë vendim”

Në rastet kur Furnizuesi konstaton se të dhënat e matjes janë përkohësisht të padisponueshme ose të paarritshme për një periudhë më të gjatë se një muaj (matësi është i dëmtuar apo jashtë kushtit teknik) e bën faturimin duke u bazuar në mesataren mujore të faturimit me matje të 3 muajve respektiv të vitit të mëparshëm. Periudha e faturimit sipas këtyre vlerave referuese nuk mund të zgjasë me shumë se tre muaj.

Lidhur me zbatimin e këtij vendimi nga ana e kompanisë “OSHEE” sh.a, ERE konstatoi një sërë ankesash të ardhur nga klientë të energjisë elektrike, të cilët ankimonin faturat e vendosura nën zërin “faturim me vlerë referuese” .

ERE ia ka parashtruar këtë problematikë kompanisë “OSHEE” sh.a, ku ka evidentuar ankesat e disa klientë të energjisë elektrike të cilët ishin faturuar për muajin Gusht 2016 e në vijim dhe gjatë vitit 2018, nën zërin “konsum aktiv vlerë referuese” dhe ka kërkuar nga “OSHEE” sh.a: verifikimin e praktikës dhe proçedurës së ndjekur për faturimin e këtyre klientëve të energjisë elektrike dhe anulimin e çdo mbifaturimi të bërë në kundërshtim me legjislacionin në fuqi. Nga ana e kompanisë “OSHEE” sh.a, nuk kemi asnjë përgjigje lidhur me trajtimin e këtyre ankesave të paraqitura nga klientët e energjisë elektrike.

Përgjigje të ardhura nga “OSHEE” sh.a, gjatë vitit 2018.

Gjatë vitit 2018 janë trajtuar nga Shoqëria “OSHEE” sh.a, rreth 217 ankesa të klientëve për të cilat ERE ka kërkuar zgjidhjen e tyre.

Në analizë të përgjigjeve të ardhura në ERE vërehet se janë:

- 158 përgjigje të ardhura nga “OSHEE” sh.a, gjatë 2018 për ankesa të dërguara për verifikim dhe trajtim gjatë vitit 2018;

- 59 përgjigje të ardhura nga “OSHEE” sh.a gjatë 2018, që i përkasin ankesave të dërguara për verifikim dhe trajtim gjatë vitit 2017;

Nga përgjigjet e ankesave të trajtuara gjatë vitit 2018:

- rreth 43 prej këtyre përgjigjeve kanë patur si objekt anulimin e faturave të ankimuara, ose janë marrë parasysh rekomandimet e ERE-s, nga të cilat del që klienti ankimues, ka pasur të drejtë.
- 113 prej tyre kanë patur si objekt kthim përgjigje lidhur me ankesat e klientëve të energjisë elektrike ka qënë në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi ose ankesa e paraqitur nga klienti ka rezultuar e pabazë.
- ndërsa 61 prej tyre kanë patur si objekt përgjigje, mungesën e dokumentacionit nga ana e shoqërisë “OSHEE” sh.a, për të gjykuar mbi ankesat e paraqitura në ERE. Kjo problematikë është trajtuar në ERE disa herë, me anë të zhvillimit të seancave dëgjimore me praninë e palëve të interesuara, me qëllim për të bërë të mundur marrjen e një informacioni apo dokumentacioni shtesë nga vetë klienti, dhe për të gjetur mënyrën e zgjidhjes së ankesës.

Në mënyrë grafike këto të dhëna paraqiten në Figurën më poshtë:

Përgjigjet e OSHEE gjatë vitit 2018 lidhur me ankesat e dërguara nga ERE




Figure 77 Përgjigjet e OSHEE gjatë vitit 2018 lidhur me ankesat e dërguara nga ERE

3.9 Komunikime me Pjesëtarët e Tregut.

Komunikimi me pjesëtarët e tregut të energjisë elektrike është një ndër prioritetet e ERE-s, që burojnë nga legjislacioni bazë i sektorit të energjisë elektrike. Në këtë këndvështrim me qëllim ekuilibrimin e interesave të shtetit, të konsumatorëve dhe investitorëve ERE, ka vendosur një bashkëpunim me pjesëtarët e tregut në sektorin e energjisë elektrike për një koordinim sa më të mirë dhe transparent të tregut të energjisë. Konsultimet dhe takimet me operatorët e tregut të energjisë elektrike, përpunimi dhe dhënia në kohë e informacionit të kërkuar nga subjektet e interesuara lidhur me çështjet e tregut të energjisë elektrike, legjislacionit dhe zbatimit të detyrimeve që burojnë prej tij.

3.10 Informacioni në Faqen Zyrtare të Internetit.

Ashtu sikurse dhe vitet më parë dhe gjatë vitit 2018 ka vijuar puna intesive për përditesimin e faqes zyrtare të internetit të ERE-s, duke ofruar një pasqyrë sa më të plotë e më të saktë të informacioneve dhe shërbimeve të ofruara. Një nga prioritet kryesor ka qënë dhe mbetet azhurnimi sistematik i faqes së Internetit, duke u ofruar të gjithë të interesuarve një informacion të përditësuar mbi legjislacionin primar dhe sekondar në sektorin e energjisë, të gjitha vendimmarrjet e ERE, publikimi i akteve nënligjore të miratura dhe ato për të cilat është filluar procedura e miratimit dhe priten komentet nga palët e treta; regjistrin e të licensuarëve, kushtet e licencimit. Informacion të detajuar për klientët e energjisë elektrike, mbi kontratat e furnizimit me energji elektrike, broshurë informuese mbi të drejtat dhe detyrimet respektive të palëve në tregun energjetik. Gjithashtu në faqen zyrtare vazhdon të sigurohet aksesimi dhe plotësimi online i formularit të ankesave nga të gjithë të interesuarit dhe baza e të dhënave e ankesave të trajtuara në ERE dhe përgjigjet e kompanisë “OSHEE” sh.a, të pasqyruara në mënyrë të detajuar.

Gjithashtu, përgjatë vitit 2018, faqja e internetit të ERE-s ka vazhduar të ofrojë informacione mbi legjislacionin primar dhe sekondar në sektor, mbledhjet e Bordit të Komisionerëve, vendimet përkatëse si dhe për veprimtaritë e ERE-s në nivel kombëtar dhe rajonal. Ka vazhduar puna me intensitet për përkthimin në gjuhën Angleze dhe publikimin në faqen zyrtare të ERE-s të të gjitha vendimeve të Bordit si dhe çdo informacion tjetër, i cili lidhet me veprimtarinë e ERE-s.

3.11 Marrëdhëniet Ndërkombëtare.

Prioritet i ERE-s është investimi për një përfaqësim sa më dinjitoz të vendit dhe Rregullatorit në aktivitetet rajonale dhe ndërkombëtare, duke patur si qëllim përputhjen dhe harmonizimin e praktikave të saj me praktikat e vendeve të BE-së. Qëllimi i pjesëmarrjes në aktivitetet ndërkombëtare është konsideruar nga ERE si një ndër elementet kryesore që i shërben forcimit institucional, rritjes së njohurive dhe eksperiencës së stafit të saj. Kjo është një ndër arsyet për të cilat mund të përmendim aktivitetin dhe rolin e ERE-s në anëtarësimin dhe pjesëmarrjen aktive në organizatat ndërkombëtare, në organizimin e konferencave ndërkombëtare, në bashkëpunimin me institucionet e tjera për organizimin e aktiviteteve ndërkombëtare, workshopeve apo takimeve multilaterale dhe bilaterale.

Për vitin 2018, ERE ka punuar me një intensitet të lartë për realizimin e bashkëpunimeve sa me frytdhënëse në dobi të sektorit të energjisë të vendit. Duke vendosur këto priorite, ERE ka punuar në intensifikimin e marrëdhënieve multilaterale me organizatat ndërkombëtare si Sekretariati i Energjisë së Vjenës ECRB, MEDREG, ERRA, USAID, NARUC, IGU, Florence School of Regulation etj. Por në forcimin e rolit të ERE-s dhe harmonizimin e kuadrit Rregullator, janë mbajtur gjithashtu marrëdhënie bilaterale me institucione të tjera Rregullatore simotra, duke realizuar takime të përbashkëta dhe duke marrë pjesë në mënyrë aktive në konferencat dhe aktivitetet ndërkombëtare të lidhura me sektorin. Gjatë vitit 2018 ERE i ka kushtuar një rëndësi të veçantë pjesëmarrjes në workshope, takime dhe aktivitete të tjera ndërkombëtare. Interesi i institucionit tonë në këto aktivitete ka qënë i lartë për t'u njohur me eksperiencat perëndimore dhe zhvillimet e fundit në sektorin energjetik duke marrë pjesë në këto aktivitete ndërkombëtare.

3.11.1 Pjesëmarrja Aktive si Anëtare.

- ERE është anëtare me të drejta të plota në Shoqatën e Enteve Rregullatore të Vendeve të Evropës Juglindore dhe Euro-Azisë (ERRA), duke realizuar një pjesëmarrje të rregullt në takimet e Asamblesë së Përgjithshme të Kryetarëve të ERRA-s, në konferencën e përvitshme të Investimeve të ERRA-s takimet e Komiteteve të përhershme të ERRA-s, atij të Licencimit e Monitorimit dhe atij të Tarifave e Çmimeve që zhvillohen në vendet anëtare të ERRA-s.
- ERE është anëtare e Shoqatës së Rregullatorëve të vendeve të Mesdheut (MEDREG) për energjinë elektrike dhe gjatë vitit 2018. Në Asamblenë e Përgjithshme të MEDREG të zhvilluar në Nëntor 2018, Kryetari i ERE, z. Petrit Ahmeti u zgjodh zv/President i MEDREG për një periudhë 2-vjeçare 2018 – 2020, duke forcuar rolin dhe ndikimin e Entit Rregullator pranë këtij organizmi. Gjithashtu, anëtari i Bordit të ERE, z. Maksim Shuli ka mbajtur postin e nënkryetarit të grupit të punës së Gazit të MEDREG. Kjo tregon angazhimin e ERE-s në arenën ndërkombëtare dhe siguron një përfaqësim për tu shënuar të vendit.
- Gjithashtu, stafi i ERE-s ka marrë pjesë në mënyrë aktive në takimet e grupeve të punës për konsumatorin, energjitë e rinovueshme, çështjet e gazit, të grupit të punës së elektricitetit duke qënë dhe draftues i materialeve të grupeve të punës.
- Për vitin 2018 ERE ka mbajtur një bashkëpunim të frytshëm me USAID dhe NARUC në projektin e përbashkët, të përkrahur nga USAID dhe NARUC në lidhje me hartimin e kodeve të rrjetit të transmetimit dhe shpërndarjes së gazit si dhe në hartimin e legjislacionit sekondar në përputhje me paketën e tretë legjislative.

Gjithashtu, ERE ka marrë pjesë në projektin e USAID & NARUC lidhur me hartimin e planeve 10-vjeçare të zhvillimit të rrjeteve të transmetimit në Europën Juglindore si dhe workshop-in e organizuar lidhur me çështjet e sigurisë kibernetike.

Me mbështetjen e NARUC dhe USAID, ERE ka marrë pjesë edhe në Projektin “Mjetet e krahasimit të çmimeve dhe komunikimi me konsumatorët”, i cili ka për qëllim implementimin e një mjeti për krahasimin e çmimeve të energjisë elektrike në tregjet e hapura me pakicë, duke bërë të mundur vlerësimin e impaktit që jep mundësia e klientit për të ndryshuar Furnizuesin. Gjithashtu, ky projekt tregon dhe eksperiencën e NARUC në pritjen dhe trajtimin e ankesave të konsumatorëve të energjisë elektrike.

- ERE në kuadër të Traktatit të Komunitetit të Energjisë gjatë vitit 2018 ka marrë pjesë në Forumin e Athinës, Forumin e Gazit në Ljubjanë dhe aktivitetet e Komunitetit të Energjisë të organizuara nga Sekretariati i Vjenës.

Gjatë vitit 2018, ERE ka marrë pjesë në takimet e Bordit Rregullator të Komunitetit të Energjisë duke dhënë një kontribut të çmuar lidhur mbi opinionin e kërkuar nga Sekretariati i Komunitetit të Energjisë për certifikimin e Operatorit të Sistemit të Transmetimit të Kosovës KOSTT. Enti Rregullator i Energjisë ka bërë të qartë se është i domosdoshëm certifikimi i KOSTT në kuadër të hapjes dhe krijimit të një tregu rajonal të energjisë elektrike.

Gjithashtu ERE ka marrë pjesë në aktivitete duke bashkëpunuar në mënyrë intensive me Sekretariatit të Energjisë së Vjenës, duke u konsultuar për vendimet kryesore dhe duke kërkuar opinion për çështjet delikate. Gjithashtu dhe draft vendimet e marra prej nesh si dhe draft rregulloret e hartuara nga ana jonë i janë dërguar për konsultim Sekretariatit të Vjenës ose janë realizuar takime me to për të patur një kuptim sa më të mirë të çështjes, si dhe jemi ndihmuar nga Sekretariati i Vjenës në draftimin e akteve sekondare në kuadër të ligjeve të reja. ERE ka ndjekur në mënyrë të rregullt dhe aktive takimet e Grupeve të Punës të ECRB për çështjet e

konsumatorëve, të energjisë dhe tregut rajonal të saj, burimeve të rinovueshme, statistikave, elektricitetit, efijensës, sigurisë së furnizimit, REMIT, gazit natyror, platforma e gazit. Për realizimin e një pune sa më të mirë dhe arritjen e rezultateve të larta, ERE ka zhvilluar takime të përbashkëta me Sekretariatit e Vjenës për sa i përket implementimit të paketës së tretë legjislativë në kuadër të legjislacionin sekondar i cili ka qënë në proces draftimi dhe miratimi nga Bordi, si dhe për sa i përket implementimit të Kodeve të Rrjetit, miratimi i të cilave vjen si detyrim që rrjedh nga Traktati i Komunitetit të Energjisë dhe ENTSO-E.

- ERE gjithashtu është anëtare e Komitetit Drejtues dhe grupeve të punës për implementimin e Tregut Rajonal të Ditës në Avancë në Ballkanin Perëndimor.

Vlen të theksohet që ERE ka marrë pjesë edhe në seminarët e organizuara nga ana e Sekretariatit për sigurinë e furnizimit, tarifën e transmetimit, energjitë e rinovueshme, efijencën, infrastrukturën e rrjeteve të energjisë elektrike dhe të gazit dhe licensimin e TAP si dhe workshopet për statistikën. Përfaqësuesit e Sekretariatit të Vjenës e kanë përkrahur në mënyrë aktive ERE-n për zgjidhjen e problemeve të hasura gjatë vitit. Institucioni jonë është munduar të përfitoj sa më shumë nga këto aktivitete dhe nga eksperiencën e rregullatorëve perëndimor, për harmonizimin e legjislacionit, praktikave dhe procedurave me qëllim krijimin e një tregu të përbashkët rajonal të energjisë, transparent, konkurrues, jo diskriminues dhe me akses të barabartë për të gjithë pjesëmarrësit.

ERE po ashtu ka marrë pjesë në projektin “Smartnet”, i zhvilluar me mbështetjen e shkollës rregullatore të Firences, në Samitin Europian të strategjive dhe sistemeve të energjisë si dhe në Samitin dhe Ekspozitën ndërkombëtare “Hydropower Balkans 2018”.

3.11.2 Marrëdhëniet Bilaterale të ERE-s.

Marrëdhëniet bilaterale të ERE-s për vitin 2018 kanë pasur si qëllim të forcojnë kapacitetin institucional të saj dhe vendosjen e bashkëpunimeve sa më të suksesshme në dobi dhe përmirësim të sektorit energjistik të vendit. ERE ka punuar në drejtim të bashkëpunimit bilateral bazuar në marrëveshjet bilaterale, ku mund të përmendim takimet e ndërsjella me qëllim shkëmbimin e eksperiencës për paketën e tretë legjislativë në sektorin e energjisë elektrike dhe gazit natyror. Gjatë vitit 2018 janë intensifikuar në mënyrë të mëtijshme dhe marrëdhëniet bilaterale me Rregullatorin Italian (ARERA) si dhe atë Grek (RAE). Ky bashkëpunim ka bërë të mundur realizimin në kohë të vendimeve të përbashkëta të tre rregullatorëve në lidhje me projektin TAP si dhe licensimin e TAP-AG në aktivitetin e transmetimit të gazit natyror.

Gjithashtu, gjatë këtij viti ERE ka mbajtur një bashkëpunim aktiv me institucionet rregullatore të rajonit e më gjerë, ku mund të përmendim Rregullatorin e Kosovës, me të cilin po punohet për bashkimin e tregjeve të energjisë Shqipëri – Kosovë dhe gjatë vitit 2018 është nënshkruar Memorandumi i Mirëkuptimit mbi bashkëpunimin e tregjeve ditore të energjisë elektrike mes palëve, që përfaqësohen nga Autoritetet rregullatore dhe OST-të përkatëse.

Një tjetër iniciativë rajonale është ndërmarrë gjatë vitit 2018, me mbështetjen e CEI (Central European Initiative) dhe të rregullatorit Italian ARERA, duke startuar Projekti KEP (Know-How Exchange Program) “Suporti i CEI për forcimin e autoriteteve rregullatore të energjisë në Ballkanin Perëndimor”, i cili ka si objekt shtrirjen e praktikave të njohurive për iniciativat e bashkimit të tregjeve të energjisë ndërmjet anëtarëve të BE në vendet e Ballkanit Perëndimor.

Në këtë projekt marrin pjesë Italia, e cila ka rolin e udhëheqësit të këtij projekti, Shqipëria, Mali i Zi dhe Serbia.

Në fund të vitit 2018, u mbyll me sukses faza e parë e këtij projekti, për të vijuar me fazën e dytë e cila do të startojë në fillim të vitit 2019. Po ashtu, janë zhvilluar takime mes anëtarëve të Bordit të ERE-s dhe atyre të rregullatorit Italian, me të cilët është diskutuar për rritjen dhe forcimin e bashkëpunimit institucional mes rregullatorëve.

PJESA IV: Administrimi i Burimeve Financiare dhe Burimeve Njerëzore të ERE-s

Burimet Njerëzore të ERE

Edhe për vitin 2018 përsa i takon fushës së Burimeve Njerëzore është zbatuar me përpikmëri Ligji nr. 9367 datë 07.04.2005” Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike” i ndryshuar me ligjin nr.86/2012 date 18.09.2012, i ndryshuar me Ligjin nr.44/2014 datë 24.04.2014 dhe Ligjit nr. 9049, datë 10.04.2003 “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publik” i ndryshuar me ligjin nr.85/2012 datë 18.09.2012, ligjin nr.45, datë 24.04.2014 si dhe ligjin nr.42/2017 datë 06.04.2017.

Janë plotësuar deklaratat e interesave private periodike/vjetore nga zyrtarët që janë subjekt i këtij detyrimi, sipas afateve kohore të parashikuara nga ligji.

Gjithashtu është mbajtur komunikimi i rregullt me ILDKPKI në zbatim të njoftimeve të dërguara prej këtij institucioni.

ERE ushtron përgjegjësitë e saj në zbatim të Ligjit Nr.43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike” dhe ligjit Nr. 102/2015 “Për Sektorin e Gazit Natyror”, përmes organit vendimmarrës të Bordit të ERE-s, i cili ndihmohet në punën e tij nga një staf teknik, staf mbështetës dhe specialistë të jashtëm. Në zbatim të Vendimit nr. 181, datë 05.05.2008 të Kuvendit të Shqipërisë për miratimin e strukturës dhe organikës është zbatuar me përpikmëri Ligji Nr. 9584 datë 11.07.2006, ”Për pagat shpërblimet dhe strukturat e institucioneve kushtetuese dhe të institucioneve të tjera të pavarura të krijuara me ligj”, si dhe Vendimi nr. 187, datë 8.03.2017 ”Për miratimin e strukturës dhe te niveleve të pagave të nëpunësve civil/nëpunësve, zëvendësministrit dhe nëpunësve të kabineteve, në Kryeministri, aparatet e ministrive të linjës, administratën e Presidentit, Kuvendit, Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, Gjykatën e Lartë, Prokurorinë e Përgjithshme, disa institucione të pavarura, institucionet në varësi të Kryeministrit, institucionet në varësi të ministrive të linjës dhe administratën e Prefektit” si dhe Vendimin nr. 202, datë 15.03.2017 “ Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 717, datë 23.06.2009 të këshillit të ministrave “Për pagat e punonjësve mbështetës të institucioneve buxhetore dhe të nëpunësve të disa institucioneve buxhetore “ të ndryshuar.

Në vijim të Ligjit nr. 43/2015, datë 30.4.2015 “Për sektorin e energjisë elektrike” i ndryshuar, për përzgjedhjen, emërimin dhe promovimin në detyrë të personelit është zbatuar ligji nr. 152/2013, datë 30.05.2013 “Për nëpunësin civil” si dhe të gjithë aktet nënligjore të dala në funksion të zbatimit të Ligjit.

Struktura dhe organograma e me të cilën ka ushtruar aktivitetin e saj ERE përgjatë vitit 2018 nuk ka reflektuar përshtatjen e saj me zhvillimet e tregut të energjisë dhe përgjegjësitë e ERE me të cilat është ngarkuar nga legjislaconi në fuqi i sektorit të energjisë. Për këtë qëllim struktura e re e ERE bazohet në një ndarje të qartë, me kapacitetet e nevojshme, me qëllim përmbushjen e detyrave që lidhen me fushat e rregullimit nga ERE të tilla si :

Mbrojtja e Konsumatorit,

Zhvillimi i Akteve Nënligjore,

Zhvillimit të Tregut të Gazit natyror

Monitorimi i Tregut, Standarteve të Cilësisë,

Vendosja e Tarifave dhe Çmimeve në Segmentet e Rregulluara të Tregut,

Licensimi, Modifikimi, Rinovimi, dhënia e Autorizimeve për operimet në aktivitetet e identifikuara në ligjet respektive,

Marrëdhënia instiucionale brenda dhe jashtë vendit

Planifikimi e Hartimit të Buxhetit

Zhvillimit të Burimeve Njerëzore,

4.1 Administrimi i Burimeve Financiare të ERE-s

Në fushën e administrimit dhe financës janë zbatuar me korrektësi aktet ligjore dhe nënligjore përkatëse për administrimin e financave të ERE-s, përfshirë ligji nr. 43/2015, datë 30.4.2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, i ndryshuar, ligji nr. 9643, datë 20.11.2006 për “ Prokurimet Publike”, i ndryshuar, Ligji nr. 9228, datë 29.4.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, si dhe Urdhërit nr.64 datë 22.7.2014 “Për shpalljen e standarteve kombëtare të kontabilitetit të përmirësuara dhe zbatimin e detyrueshëm të tyre”.

Në të gjitha rastet janë zbatuar procedurat dhe afatet kohore në lidhje me kryerjen e prokurimeve të fondeve publike, në përputhje me ligjin e prokurimeve dhe akteve të tjera nën ligjore. Janë kryer procedurat e prokurimeve në kuadër të blerjeve apo shërbimeve të vogla (si pjesë e Komisionit të blerjeve Vogla) në zbatim të legjislacionit të prokurimeve elektronike për fondet publike.

Gjithashtu, ka vijuar inventarizimi i aseteve që ERE ka në administrim. Për sa i takon fondeve monetare, ato sigurohen në përputhje me ligjet respektive të sektorit të energjisë elektrike dhe atij të gazit natyror, dhe përbëhen nga pagesat e aplikimeve për licencime/modifikime/rinovime dhe nga pagesat e rregullimit që ERE ka vendosur për të licencuarit.

Shpenzimet e kryera nga ERE, reflektojnë nevojën e ERE për realizimin e përgjegjësi të ngarkuara nga ligji si dhe përmbushjes së detyrimit ligjor për të siguruar një punë normale të institucionit, si edhe më parë kanë konsistuar në përmbushjen e nevojave më të domosdoshme që ka pasur ERE gjatë vitit, në zbatim të buxhetit për vitin 2018 të miratuar. Ndër zërat kryesorë të shpenzimeve të ERE mund të përmendim:

Pagat e personelit, kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, tatimet mbi të ardhurat, për të cilat institucioni ynë ka shlyer të gjitha detyrimet dhe nga sistemi elektronik “ Detyrimet në kohë reale “ nuk rezulton debitor apo me gjoba.

Publikimet për informim të opinionit publik janë realizuar në zbatim të Ligjit nr. 43/2015, datë 30.4.2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike” dhe nr.102/2015 ‘Për Sektorin e Gazit Natyror’.

Pagesat për shlyerjet e detyrimeve të shërbimeve si ujë, energji elektrike, telefon për të cilat institucioni ynë gjithashtu nuk është debitor, shpenzime për shërbime të domosdoshme për mbarëvajtjen e punës si dhe amortizimi i aktiveve të qëndrueshme të trupëzuara etj.

Detyrimet e taksave për Bashkinë e Rrethit Tiranë rezultojnë zero (0).

Pagesat me qëllim përmbushjen e angazhimeve në cilësinë e vendit anëtar në një sërë organizatash të rëndësishme ndërkombëtare të sektorit të energjisë të tillë si MEDREG, ERRA, IGU,

Edhe për vitin 2018 veprimtaria ekonomiko-financiare e ERE-s në zbatim të parashikimeve të nenit 17 të ligjit nr.43/2015, është audituar nga një grup ekspertësh kontabël të regjistruar dhe të liçensuar për këtë aktivitet bazuar në ligjin nr. 10091, datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar”. Në vijim të këtij paragrafi paraqitet raporti përkatës i ekspertit kontabël.

Shtojca 1 Pasqyrat Financiare

Emertimi dhe Forma ligjore:

NIPT –i:

Adresa e Selise:

Enti Rregullator i Energjise, Ent Publik

K51717024I

**Bul.Bajram Curri, Rr.Viktor Eftimiu,
Tirane**

Data e krijimit:

15.10.1995

PASQYRAT FINANCIARE

(Ne zbatim te Standartit Kombetar te Kontabilitetit Nr 2
dhe Ligjit Nr. 9228, date 29.04.2004 “Per Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare”)

VITI 2018

Pasqyrat Financiare jane individuale

Pasqyrat Financiare jane te shprehura ne Lek

Pasqyrat Financiare nuk jane te rrumbullakosura

Periudha Kontabel e Pasqyrave Financiare nga 01.01.2018-31.12.2018

Data e mbylljes se Pasqyrave Financiare 30.03.2019

RAPORTI I AUDITUESIT TE PAVARUR**Kryetarit te Entit Regullator te Energjise,****Z. Petrit AHMETI****Opinioni**

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të **Entit Regullator te Energjise**, të cilat përfshijnë pasqyrën e pozicionit financiar me datën 31 Dhjetor 2018, pasqyrën e të ardhurave gjithpërfshirëse, pasqyrën e ndryshimeve në kapital dhe pasqyrën e flukseve të parasë për vitin që mbyllet me këtë datë, si edhe shënimet për pasqyrat financiare, përfshirë një përmbledhje të politikave kontabël më të rëndësishme.

Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare bashkëlidhur paraqesin drejt, në të gjitha aspektet materiale, pozicionin financiar të **Entit Regullator te Energjise** me datën 31 Dhjetor 2018, dhe performancën financiare dhe flukset e parasë për vitin që mbyllet në këtë datë, në përputhje me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit.

Baza për Opinionin

Ne e kryem auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA-të). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar në mënyrë më të detajuar në seksionin e raportit ku jepen *Përgjegjësitë e Audituesit për Pasqyrat Financiare*. Ne jemi të pavarur nga Shoqëria në përputhje me kërkesat etike që janë të zbatueshme për auditimin e pasqyrave financiare, dhe kemi përmbushur përgjegjësitë e tjera etike në përputhje me këto kërkesa. Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë një bazë për opinionin tonë.

Përgjegjësitë e Drejtimit dhe të Personave të Ngarkuar me Qeverisjen në lidhje me Pasqyrat Financiare

Drejtimi është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare në përputhje me SKK-të, dhe për ato kontrole të brendshme që drejtimi i gjykon të nevojshme për të bërë të mundur përgatitjen e pasqyrave financiare që nuk përmbajnë anomali materiale, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit.

2

Në përgatitjen e pasqyrave financiare, drejtimi është përgjegjës për të vlerësuar aftësinë e Entit për të vazhduar në vijimësi, duke dhënë informacion, nëse është e zbatueshme, për çështjet që kanë të bëjnë me vijimësinë dhe duke përdorur parimin kontabël të vijimësisë.
Ata që janë të ngarkuar me drejtimin janë përgjegjës për mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Shoqërisë.

Përgjegjësitë e Audituesit për Auditimin e Pasqyrave Financiare

Objektivat tona janë që të arrijmë një siguri të arësyeshme lidhur me faktin nëse pasqyrat financiare në tërësi nuk kanë anomali materiale, për shkak të mashtrimit apo gabimit, dhe të lëshojmë një raport auditimi që përfshin opinionin tonë. Siguria e arësyeshme është një siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci që një auditim i kryer sipas SNA-ve do të identifikojë gjithmonë një anomali materiale kur ajo ekziston.
Anomalitë mund të vijnë si rezultat i gabimit ose i mashtrimit dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose të marra së bashku, pritet që në mënyrë të arësyeshme të influencojnë vendimet ekonomike të përdoruesve, të marra bazuar në këto pasqyra financiare.

Auditues Ligjore te Pavarur

Ludmilla Paluka



Rr.H. Hidri, Ndriçesa nr 2, Zyra 9,
Tirane
Nr.kontakti 069 20 36 339.

Eneida Rahmani



Rr.Ali Demi Nr.16 Tirane
Nr.kontakti 068 20 51 151

Tirane, me 30 Mars 2019

Raporti i Auditimit eshte i vlefshem vetem per pasqyrat financiare bashkelidhur tij.

3

ENTI RREGULLATOR I ENERGJISE PASQYRAT FINANCIARE

2018

Enti Rregullator i Energjise

Pasqyra e Pozicionit financiar

AKTIVE	Shenime	31 dhjetor 2018	31 dhjetor 2017
Aktivët monetare	4	32,711,968	17,836,051
Investime		-	-
Të drejta të arkëtueshme		-	-
<i>Nga aktiviteti i shfrytëzimi</i>		56,714,047	38,912,370
<i>Debitore të tjera</i>		-	-
<i>Te tjera</i>		52,604	-
Totali i të drejtave të arkëtueshme	5	56,766,651	38,912,370
Inventarët		-	-
<i>Lende e pare dhe materiale</i>		3,273,055	3,241,963
<i>Parapajime për inventar</i>		-	-
Totali i inventarit	6	3,273,055	3,241,963
Shpenzime të shtyra		-	-
Të arkëtueshme nga të ardhurat e konstatuara		-	-
Totali i aktiveve afatshkurtra		92,751,675	59,990,384
Aktive financiare		-	-
Aktivët materiale		-	-
<i>Ndertesat</i>		-	-
<i>Makinori e pajisje</i>		-	-
<i>Mjete transporti</i>		11,603,844	14,504,806
<i>Pajisje zyresh</i>		2,061,244	2,576,556
<i>Te tjera pajisje dhe informrike</i>		5,001,154	6,621,540
Totali i aktiveve materiale	7	18,666,243	23,702,902
Aktivët biologjike		-	-
Aktive jo materiale:		-	-
Aktive tatimore të shtyra		-	-
Kapitali i nënshkruar i papaguar		-	-
Total Aktive		111,417,919	83,693,287

Kryetari

Petrit Ahmeti



Hartuesi i pasqyrave

Afordita Bushi

Shënimet shprehen nga faqja 6 deri ne faqen 16 jane pjese perberese e pasqyrave financiare.

ENTI RREGULLATOR I ENERGJISE PASQYRAT FINANCIARE

2018

Enti Rregullator i Energjisë

Pasqyra e Pozicionit financiar

PASIV	Skenime	31 dhjetor 2018	31 dhjetor 2017
Detyrime afatshkurtra:			
<i>Të pagueshme për aktivitetin e shfrytëzimit</i>		63,279	-
<i>Të pagueshme ndaj përonjëseve dhe sigurimeve shoqërore/shëndetësore</i>		1,309,865	1,294,951
<i>Të pagueshme për detyrimet tatumore</i>		2,009,065	1,609,353
<i>Të pagueshme të tjera</i>		142,125	76,475
Shuma detyrime afatshkurtra	8	3,614,334	2,980,779
Të pagueshme për shpenzime të konstatuara		-	-
Të ardhura të shtyra		18,815,169	8,853,910
Provizione		-	-
Total detyrime afatshkurtra		22,460,503	11,834,689
Detyrime afatgjata:			
Të pagueshme për shpenzime të konstatuara		-	-
Të ardhura të shtyra		-	-
Provizione		-	-
Detyrime tatumore të shtyra		-	-
Të pagueshme të tjera		-	-
Total detyrime afatgjata	9	-	-
Total detyrime		22,460,503	11,834,689
Kapitali dhe Rezervat			
<i>Fondet e ERE</i>		71,858,598	93,541,317
<i>Rritje/Renie fondë gjate vitit</i>		17,098,818	(21,682,710)
<i>Fitim / Humbje e Vitit</i>		-	-
Total kapitali aksionar	10	88,957,416	71,858,598
Totali i kapitalit dhe i detyrimeve		111,417,919	83,693,287

Kryetari

Hartuesi i pasqyrave

Petrit Ahmeti

Aferdita Bushi



2 | Shënime shpjeguese nga faja 5 deri në faqen 16 janë pjesë përbërëse e pasqyrave financiare

ENTI RREGULLATOR I ENERGJISE PASQYRAT FINANCIARE

2018

Enti Rregullator i Energjise

<u>Pasqyra e performances</u>	Shenime	31 dhjetor 2018	31 dhjetor 2017
Të ardhura nga pagesat e Operatoreve	11	143,468,002	98,779,757
Të ardhura nga licencimet 2018		10,129,781	10,765,250
Të ardhura nga Organizma mbulim shpenzimesh		3,409,230	1,279,341
Lënda e parë dhe materiale të konsumueshme	12	-	-
<i>Lënda e parë dhe materiale të konsumueshme</i>			
<i>Të tjera sipërzimë</i>			
Shpenzime të personelit	13	(103,698,499)	(97,077,944)
<i>Paga dhe shpërbllime</i>		(95,088,001)	(83,897,228)
<i>Shpenzime të sigurimeve shoqërore/shëndetësore</i>		(8,610,498)	(3,180,716)
Zhvlerësimi i aktiveve afatgjata materiale		-	-
Shpenzime konsumi dhe amortizimi	14	(5,071,658)	(4,579,269)
Shpenzime të tjera shfrytëzimi	15	(31,011,088)	(30,741,121)
Të ardhura të tjera		-	-
Zhvlerësimi i aktiveve dhe investimeve financiare		-	-
Shpenzime financiare	16	(126,949)	(108,734)
<i>Shpenzime për interesa</i>		(76,552)	(108,734)
<i>Shpenzime të tjera financiare</i>		-	-
<i>Futme/humbje nga kurset e këmbimit</i>		(50,411)	-
<i>Të ardhura të tjera</i>		14	-
<i>Gjaba dhe interesa</i>		-	-
<i>Pjesë e fitimit/humbjes nga pjesëmarrjet</i>		-	-
Rritja/Rënia neto e fondeve	17	17,098,818	(21,682,719)

Kryetari

Haruesi i pasqyrave

Petril Ahmeti

Aferdita Bushi



3 | Shënimet shpjeguese në faja 6 deri në faqen 15 janë njëzë të përbërësve të pasqyrave financiare

ENTI RREGULLATOR I ENERGIJES PASQYRAT FINANCIARE

2018

Enti Rregullator i Energjise

Pasqyra e Fluksit të Mjeteve Monetare	(metoda indirekte)	
	31 dhjetor 2018	31 dhjetor 2017
Fluksi i Mjeteve Monetare nga/(përdorur në) aktivitetin e shfrytëzimit		
<i>Rritja/Rënia neto e fondeve</i>	17,098,818	(14,498,370)
<i>Sipenzime konsumi dhe amortizimi</i>	5,071,658	4,579,269
<i>Sipenzime të shlyra</i>	-	-
<i>Fluksi i mjeteve monetare të përfshirë në aktivitetet investuese:</i>	-	-
<i>Fitim nga shitja e aktiveve afatgjata materiale</i>	-	-
<i>Ndryshimet në aktivet dhe detyrimet e shfrytëzimit:</i>	-	-
<i>Rënie/(ritje) në të drejtat e arkëtueshme dhe të tjera</i>	(17,854,281)	34,081,183
<i>Rënie/(ritje) në inventarë</i>	(31,092)	607,419
<i>Rritje/(rënie) në detyrimet e pagueshme</i>	10,625,814	(11,202)
<i>Rritje/(rënie) në detyrimet afatgjata</i>	-	-
<i>Tanim fitimi i paguar</i>	-	-
Mjete monetare neto nga/(përdorur në) aktivitetin e shfrytëzimit	14,910,918	24,758,299
Fluksi i Mjeteve Monetare nga/(përdorur në) aktivitetin e investimit	-	-
<i>Pagesa për blerjen e aktiveve afatgjata materiale</i>	(35,000)	(15,090,000)
<i>Arketime nga shitja e aktiveve afatgjata materiale</i>	-	-
<i>Dividentë të arkëtuar</i>	-	-
Mjete monetare neto nga/(përdorur në) aktivitetin e investimit	(35,000)	(15,090,000)
Fluksi i Mjeteve Monetare nga/(përdorur në) aktivitetin e financimit	-	-
Mjete monetare neto nga aktivitetin e financimit	-	-
Rritje/(rënie) neto në mjete monetare	14,875,918	9,668,299
Mjete monetare dhe ekuivalentë të mjeteve monetare më 1 janar	17,836,051	8,167,752
Mjete monetare dhe ekuivalentë të mjeteve monetare më 31 dhjetor	32,711,968	17,836,051

Kryetari

Petrit Ahmeti



Hartuesi i pasqyrave

Aferdita Bushi

4 Sheqimet shprehëse të bllokimit deri në fazon 16 janë pjesë përbërëse e pasqyrave financiare

SHENIMET SHPJEGUESE

1. Informacion i përgjithshëm

Shoqëria «Enti Rregullator i Energjise» është Ent Publik i pavaruar me NIPT K517170241, i cili është krijuar në datë 15.10.1995 sipas Ligjit Nr. 7963 Datë 17.07.1995. Objekti i Ligjit rregullon marrëdhëniet në veprimtaritë e prodhimit, transportimit, shpërndarjes dhe furnizimit me energji elektrike, si dhe vendos rregullat e këtij tregu. Kryetar i Entit Rregullator të Energjise është z. Petrit Ahmeti.

2. Bazat e përgatitjes së pasqyrave financiare**2.1. Deklarata e pajtueshmërisë**

Pasqyrat financiare janë përgatitur në përputhje me Standartet Kombëtare të Kontabilitetit të përmirësuara (SKK) dhe ligjin nr.9228, datë 29 prill 2004 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare".

Në bazë të urdhrit nr.64 datë 22.7.2014 "Për shpalljen e standardeve kombëtare të kontabilitetit të përmirësuara dhe zbatimin e detyrueshëm të tyre", Ministria e financave vendosi të bëjë të detyrueshme zbatimin e Standardeve Kombëtare të Kontabilitetit të përmirësuara duke filluar nga 1 janar 2015.

ERE është Ent Publik-jo fitim prures që funksionon me të ardhurat nga operatorët e licencuar prej saj. Është vendosur të paraqesë Pasqyrat Financiare sipas SKK 2, pasi pjesa më e madhe e operatorëve të energjise në treg punojnë me këto format pasqyrash financiare.

2.2. Bazat e matjes

Pasqyrat financiare janë përgatitur bazuar në koston historike.

2.3. Biznesi në vijimësi

Pasqyrat financiare të Shoqërisë përgatiten mbi supozimin e biznesit në vijimësi, i cili merr parasysh se Shoqëria do të vazhdojë ekzistencën e aktivitetit të saj për një të ardhme të parashikuar.

2.4. Monedha funksionale dhe e paraqitjes

Këto pasqyra financiare janë paraqitur në Lek, e cila është dhe monedha funksionale e Shoqërisë.

2.5. Vlerësime dhe gjykime

Paraqitja e pasqyrave financiare kërkon që manaxhimi i shoqërisë të kryejë vlerësime dhe supozime që ndikojnë shumë në raportuar të aktiveve, detyrimeve dhe aktiveve e detyrimeve të kushëzuar në datën e pasqyrës së pozicionit financiar, si dhe të ardhurave dhe shpenzimeve të krijuara në periudhën kontabël. Vlerësimet dhe gjykimet rishikohen vazhdimisht dhe bazohen në eksperiencën e mëparshme dhe faktorë të tjerë duke përfshirë pritshmëritë për ngjarjet e ardhshme të cilat besohen të jenë të arsyeshme në rrethanat aktuale. Në disa raste manaxhimi mbështetet në mendimet e ekspertëve të pavarur. Manaxhimi kryen vlerësime dhe gjykime në lidhje me të ardhmen. Vlerësimet kontabël që rezultojnë sipas përkatizimit, jo gjithmonë do të barazohen me rezultatet aktuale. Vlerësimet dhe supozimet që kanë risk të rëndësishëm për të shkaktuar korigjime (ajhustime) materiale, të vlerave të mbartura të aktiveve dhe detyrimeve janë përshkruar më poshtë:

5 | *Shenimet shpjeguese nga faqja 6 deri në faqen 16 janë pjesë përbërëse e pasqyrave financiare.*

2.5.1. Zhvlerësimi i llogarive të arkëtueshme

Zhvlerësimi i llogarive të arkëtueshme bazohet në humbjet e vlerësuara të cilat rezultojnë nga pa mundësia e konsumatorëve për të paguar detyrimet e tyre. Këto vlerësime bazohen në moshën e llogarive të arkëtueshme dhe eksperiencën e mëparshme në regjistrimin, vlerësimin e aftësisë paguese të konsumatorëve, si dhe ndryshimet e fundit dhe të pritshme të termave të pagesës së konsumatorëve. Manaxhimi vlerëson në fund të çdo periudhe në rast se ka nevojë për zhvlerësimin e llogarive të arkëtueshme.

2.5.2. Provizionet

Provizionet në përgjithësi kërkojnë një nivel të lartë gjykimi, veçanërisht në rastet e konflikteve gjyqësore. Shoqëria vlerëson mundësinë e krijimit të një detyrimi aktual si rrjedhojë e një ngjarje të shkuar, në rast se mundësia e ndodhjes vlerësohet të jetë më shumë se 50%, në të tilla raste shoqëria provizionon vlerën e detyrimit të cila mund të matet me besueshmëri. Për shkak të nivelit të lartë të pasigurisë, në disa raste mund të ndodhë që vlerësimi mund të mos jetë në të njëjtën linjë me rezultatin e çështjes. Manaxhimi vlerëson në fund të çdo periudhe në rast se ka nevojë për krijimin e provizioneve.

2.6. Krahasueshmëria e informacionit kontabël

Siç paraqitet në Standardin Kombëtar të Kontabilitetit të përmirësuar nr.1, në rastet e një ndryshimi në paraqitjen e pasqyrave financiare si pasojë e kërkesave të një standardi të ri, një përmirësimi në standard apo një ndryshimi në ligjin për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare⁶, informacioni krahasues duhet të riparaqitet për të korresponduar me paraqitjen e re, përveç rasteve kur riparaqitja e informacionit krahasues nuk mund të vlerësohet në mënyrë të besueshme. Informacioni krahasues për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017 siç kërkohet nga Standardet Kombëtare të Kontabilitetit të përmirësuara.

3. Politikat Kontabël

Politikat kontabël të mëposhme janë aplikuar në mënyrë konsistente në të gjitha periudhat e paraqitura në pasqyrat financiare.

3.1 Transaksionet në monedhë të huaj

Transaksionet në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale dhe regjistrohen me kursin e këmbimit në datën e transaksionit. Aktivët dhe detyrimet monetare në monedhë të huaj në datën e raportimit konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit në datën e bilancit. Fitimi ose humbja nga këmbimi në zëra monetarë është diferenca që vjen nga këmbimi i një numri të caktuar njësisish të një monedhe të huaj në monedhën funksionale me kurse të ndryshme këmbimi në datat e këmbimit. Të drejtat dhe detyrimet jo-monetare në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës së kryerjes së transaksionit ndërsa ato që maten me vlerë të drejtë rikëmbehen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës kur është përcaktuar vlera e drejtë. Diferencat që rezultojnë nga kurset e këmbimit kalojnë në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Kursi i këmbimit i monedhave të huaja më 31 dhjetor 2018 dhe 2017 është detajuar si më poshtë:

⁶ Shënimet shpjeguese nga faja 6 deri në faqen 16 janë pjesë përbërëse e pasqyrave financiare

Kursi i këmbimit	Viti 2018	Viti 2017
Euro/LEK	123.42	132.95
USD/LEK	107.82	111.10

3.2 Instrumentat financiarë

Instrumentat financiarë jo-derivativë përbëhen nga llogari të arkëtueshme, mjete monetare, hua të marra dhe të dhëna dhe llogari të pagueshme. Instrumentat financiarë jo-derivativë njihen fillimisht me vlerën e drejtë plus çdo kosto transaksioni që lidhet me to, përveç siç përshkruhet më poshtë. Për instrumentat e mbajtur me vlerë të drejtë nepërmjet fitim/humbjes, kostot e transaksionit kalojnë në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Në vijim të njohjes fillestare instrumentat financiarë jo-derivativë maten siç përshkruhet më poshtë. Një instrument financiar njihet nëse Shoqëria bëhet palë në kushtet kontraktuale të instrumentit. Aktivët financiarë regjistrohen kur skadojnë të drejtat kontraktuale të shoqërisë mbi fluksit e parasë së aktivitetit financiar ose kur shoqëria transferon aktivin financiar tek një palë e tretë pa mbajtur kontrollin ose gjithë risqet dhe përfitimet rielbesore të aktivitetit. Blerjet dhe shitjet normale të aktiveve financiare kontabilizohen në datën e transaksionit, që është data në të cilën shoqëria angazhohet të blejë apo të shesë aktivin. Detyrimet financiare regjistrohen nëse detyrimet kontraktuale të shoqërisë skadojnë, shfuqizohen ose anulohen.

✓ Mjetet monetare

Mjetet monetare përfshijnë arkën, llogaritë njëjeshë dhe depozitat në të parë me bankat. Për qëllimin e pasqyrës së fluksit të parasë, mjetet monetare përfshijnë depozita me afat me një maturim prej tre muajsh ose më pak që nga data e fillimit.

✓ Llogari të arkëtueshme

Llogaritë e arkëtueshme njihen fillimisht me vlerën e drejtë dhe më pas me kosto të amortizuar duke zbritur humbjen nga zhvlerësimi. Provizioni për zhvlerësimin e aktiveve të arkëtueshme llogaritet kur ka të dhëna se shoqëria nuk do të jetë në gjendje të mbledhë të gjitha detyrimet. Vështrësitë financiare të debitorit, mundësia që debitori të falimentojë ose riorganizimi i tij financiar konsiderohen tregues që llogaritë e arkëtueshme të zhvlerësohen. Shuma e provizionit llogaritet si diferencë midis vlerës së mbetur dhe vlerës aktuale të fluksive të ardhshme të parashikuara të parasë të skontuara me normën efektive të interesit.

✓ Llogari të pagueshme

Llogaritë e pagueshme paraqiten me vlerën e tyre të drejtë dhe më pas me kosto të amortizuar, duke përdorur metodën e interesit efektiv.

✓ Hua të marra dhe të dhëna

Huatë e marra dhe të dhëna njihen fillimisht dhe mbahen në vazhdim me vlerën e tregut, pa përfshirë koston e transaksioneve. Pas njohjes fillestare, huatë e marra dhe të dhëna paraqiten me kosto të amortizuar duke njohur në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve çdo diferencë midis koston dhe vlerës së pagueshme nominale përgjatë periudhës së huamarrjes duke u bazuar (si regull) në interesin efektiv. Interesat e njohura në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve janë përlogaritur mbi bazën e interesit nominal.

✓ Vlera e drejtë

Vlerat e drejta të përllogaritura të mjeteve monetare dhe ekuivalentëve të tyre: të kërkesave për t'u arkëtuar, detyrimeve për t'u paguar dhe huave, përafrohen me vlerat e tyre kontabël.

✓ Të tjera

Instrumenta të tjerë jo-derivativë maten me kosto të amortizuar sipas metodës së interesit efektiv, duke zbritur çdo humbje nga zhvlerësimi.

✓ Kapitali themeltar

Kapitali themeltar njihet me vlerën nominale.

✓ Zhvlerësimi i aktiveve financiare

Një aktiv financiar konsiderohet i zhvlerësuar nëse ka të dhëna objektive që tregojnë se një apo disa ngjarje kanë efekte negative në flukse të ardhshme që parashikohen të burojnë nga aktivi.

Një zhvlerësim në lidhje me aktivin financiar, të matur me kosto të amortizuar, llogaritet si diferencë midis vlerës së mbetur dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të parashikuara të parasë të skontuara me normën efektive të interesit.

Aktivitet financiare të rëndësishme testohen për zhvlerësim në mënyrë individuale. Aktivitet të tjera financiare vlerësohen në mënyrë të grupuar, në grupe që kanë karakteristika të ngjashme të riskut kreditor. Të gjitha humbjet nga zhvlerësimi njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Një humbje nga zhvlerësimi rimerret nëse rimarrja mund të lidhet objektivisht me një ngjarje të ndodhur pas njohjes së humbjes nga zhvlerësimi. Për aktivitet financiare të matur me kosto të amortizuar, rimarrja njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

3.3 Inventarët

Inventarët regjistrohen në kontabilitet me kosto. Kosto e marrjes përfshin të gjitha shpenzimet e kryera për ta sjellë inventarin në vendin dhe kushtet ekzistuese. Në rastin e prodhimit të produkteve në kosto përfshihet edhe pjesa respektive e shpenzimeve të përgjithshme duke u llogaritur mbi kapacitetet normale prodhuese. Kosto e inventarit llogaritet duke përdorur metodën e mesatares së ponderuar.

Gjendjet e inventarit janë të vlerësuara në bilanc me koston e tyre historike, duke e konsideruar këtë vlerësim, si vlerën më të ulët midis koston dhe vlerës neto të realizueshme.

3.4 Aktive afatgjata materiale

i. Njohja dhe matja

Të gjitha aktivitet afatgjata materiale paraqiten me kosto duke zbritur zhvlerësimin dhe amortizimin e akumuluar. Kostoja përfshin shpenzime të cilat lidhen drejtpërdrejt me blerjen e aktivitet. Kostoja e aktiveve të vetëndërtuara përfshin koston e materialeve dhe punës direkte, çdo kosto tjetër të lidhur drejtpërdrejt me sjelljen e aktivitet në gjendje pune për qëllimin e synuar të përdorimit, si dhe koston e çmontimit, heqjes së pjesëve dhe sjelljes në gjendjen e mëparshme të vendndodhjes së aktivitet. Shpenzimet kapitale të aktiveve të bëra gjatë ndërtimit kapitalizohen në "Ndërtim në proces" dhe transferohen në kategorinë përkatëse të aktivitet kur përfundon ndërtimi tij, nga kur aplikohet amortizimi përkatës sipas kategorisë. Në rastet kur pjesë të një aktivitet afatgjatë material kanë jetëgjatësi të ndryshme, ato kontabilizohen si zëra të ndryshëm të aktiveve afatgjata materiale.

Fitimet dhe humbjet nga shitjet, apo nxjerrjet jashtë përdorimit përcaktohen duke krahasuar vlerën e shijes me vlerën e mbetur dhe këto përfshihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

ii. Kostot e mëpasshme

Kostoja e zëvendësimit të një pjese të një zëri të aktiveve afatgjata materiale njihet në vlerën kontabël të tij zëri nëse është e mundshme që shoqëria do të realizojë përfitime të ardhshme ekonomike nga përdorimi i pjesës zëvendësuese dhe kostoja e pjesës mund të matet në mënyrë të besueshme. Kostot e shërbimeve të zakonshme të aktiveve afatgjata materiale njihen si shpenzime kur ato ndodhin.

iii. Amortizimi

Amortizimi i aktiveve llogaritet duke përdorur metodën e vlerës së mbetur të amortizimit mbi jetën e vlerësuar të çdo pjese të aktivitetit afatgjatë material duke filluar nga dita e parë e muajit që pasen muajin e blerjes. Aktivitetet e marra me qira amortizohen duke marrë për bazë periudhën më të shkurtër midis periudhës së qirasë dhe jetës së dobishme të aktivitetit.

Jetëgjatësia e vlerësuar për vitin 2018 dhe 2017 është si më poshtë:

Kategoria e aktiveve	Metoda e Amortizimit	Norma e Amortizimit
Mobilje për zyrën	Vlera e mbetur	20 %
Pajisje informatike	Vlera e mbetur	25 %
Të tjera	Vlera e mbetur	20%

iv. Çregjistrimi

Një zëri i aktiveve afatgjata materiale çregjistrohet kur ai nxirret jashtë përdorimit apo atëherë kur nuk priten më përfitime ekonomike të ardhshme nga përdorimi apo nxjerrja e tij jashtë përdorimit. Fitimet dhe humbjet në rastin e nxjerrjes jashtë përdorimit të aktiveve afatgjata materiale, përcaktohen sipas shumës së tyre të mbetur dhe merren parasysh në nxjerrjen e rezultetit operativ të vitit.

3.5 Të ardhurat

Të ardhurat njihen atëherë kur është e mundshme që njësi ekonomike do të ketë përfitime ekonomike në të ardhmen dhe këto përfitime mund të maten me besueshmëri. Të ardhurat maten me vlerën e drejtë të arkëtuar ose të arkëtueshme që merr parasysh shumën e çfarëdo zbrilje tregtare, zbriljet për shlyerje të menjëhershme dhe zbriljet e bëra për sasi (vëllim) të blerë.

3.6 Të ardhurat e tjera të shfrytëzimit

Të ardhurat e tjera të shfrytëzimit paraqesin të ardhurat që përfitohen jo rregullisht gjatë rrjedhës normale të veprimtarisë ekonomike duke përfshirë, fitim/humbjet nga shitja e aktiveve afatgjata materiale dhe jomateriale, fitim/humbjet nga rivlerësimet e aktiveve afatgjate të investuara dhe fitim/humbjet që vijnë nga ndryshimi i kursit të këmbimit përveç diferencave të këmbimit që lidhen me veprimtaritë financiare dhe investuese.

3.7 Qiratë

Qirantarrjet klasifikohen si financiare ose operative që në fillimin e qirasë. Qiratë financiare njihen si aktive dhe detyrime financiare në shkallën më të ulët të vlerës së drejtë të aktivitetit dhe

vlerës aktuale të minimumit të pagesave të qirasë në datën e blerjes. Kostot financiare regjistrohen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve nën termin e qirasë me normat e zbatueshme të interesit mbi balancën e mbetur të detyrimeve.

3.8 Të ardhurat dhe shpenzimet financiare

Të ardhurat financiare përfshijnë të ardhura interesi nga llogaritë bankare dhe fitime nga kursi i këmbimit që njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Të ardhurat nga interesi njihen mbi bazën e të drejtave të konstatuara duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Shpenzimet financiare përfshijnë shpenzime interesi mbi huamarrjet dhe humbjet nga kursi i këmbimit, ndryshimet në vlerën e drejtë të aktiveve financiare të mbajtura me vlerë të drejtë nëpërmjet llogarisë fitim/humbje dhe humbjet nga zhvlerësimi i aktiveve financiare. Kostot e huamarrjes njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve me metodën e interesit efektiv.

3.9 Fondet për pensione

Shoqëria paguan kontributet ndaj sigurimeve shoqërore e shëndetësore të detyrueshme, që sigurojnë përfitimet për pensione të punonjësve në përputhje me legjislacionin shqiptar. Autoritetet Fiskale janë përgjegjëse për përcaktimin e kufirit minimal ligjor të vendosur për pensionet në juridiksionin përkatës sipas një plani kontributësh pensioni të përcaktuar.

3.10 Transaksionet me palët e lidhura

Palët e lidhura përcaktohen kur një palë kontrollohet nga pala tjetër, ose ka ndikim të rëndësishëm në vendimet e biznesit apo vendimet financiare të palës tjetër. Për qëllime të paraqitjes së pasqyrave financiare, drejtimi i shoqërisë dhe manaxhimi konsiderohen si palë të lidhura.

3.11 Provizionet

Një provizion njihet nëse, si rezultat i një ngjarjeje të shkuar, Shoqëria ka një detyrim ligjor apo konstruktiv, i cili mund të vlerësohet në mënyrë të besueshme dhe do të kërkojë në të ardhmen flukse dalëse parash për shlyerjen e tij. Provizionet përcaktohen duke skontuar flukset e pritshme të ardhshme të parasë me një normë skontimi para tatimit që pasqyron vlerësimet aktuale të tregut për vlerën në kohë të parasë dhe për risqet që lidhen me detyrimin në fjalë. Provizionet rishikohen në çdo datë raportimi dhe nëse nuk ka më gjasa për daljen e ndonjë fluksi parash për shlyerjen e detyrimit, provizionet rimerren.

3.12 Aktivët dhe detyrimet e kushtëzuara

Detyrimet e kushtëzuara nuk njihen në pasqyrat financiare. Ato paraqiten në shënime të pasqyrave financiare për sa kohë që mundësia për një dalje të bujmeve që përfshijnë përfitime ekonomike është e largët. Një aktiv i kushtëzuar nuk paraqitet në pasqyrat financiare por paraqitet në shënime për sa kohë ekziston mundësia e hyrjes së përfitimeve ekonomike. Shuma e humbjeve të kushtëzuara njihet si provizion, nëse është e mundshme që ngjarjet e ardhshme të konfirmojnë që një detyrim ka lindur në datën e pozicionit financiar dhe mund të bëhet një vlerësim i arsyeshëm i shumës së humbjes.

ENTI RREGULLATOR I ENERGJISE PASQYRAT FINANCIARE

2018

Bilanci Kontabel, Aktivët**4. Aktivët monetare**

Aktivët monetare janë në shumën 32.711.968 lek të pasqyruara në tabelën e mëposhtme:

Nr	Likuiditete	Viti 2018	Viti 2017
1	Depozita në banke	32.711.968	17.836.051
2	Para në arkë	0	0
	Totali	32.711.968	17.836.051

Depozitat në banke në monedhë të huaj janë të konvertura me kursin e datës 31.12.2018, diferencat nga kursi i këmbimit janë të pasqyruara në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

5. Të drejta të arkëtueshme

Paraqitet shuma e të drejtave të arkëtueshme deri më 31.12.2018, prej 56,766,651 leke, si më poshtë:

Nr	Të drejta të arkëtueshme	Viti 2018	Viti 2017
1	Nga aktiviteti i shfrytëzimit	56.714.047	38.912.370
1	Debitore të tjerë	52.604	
	Shuma	56.766.651	38.912.370

6. Inventarët

Në këtë post paraqitet më 31.12.2018 inventari i materialeve në shumën 3,273,055 leke, si më poshtë:

Nr	Inventarët	Viti 2018	Viti 2017
1	Lëndë e parë dhe materiale	3,273,055	3,241,963
	Parapajime për inventar		
	Shuma	3,273,055	3,241,963

Gjendja e materialeve është vlerësuar me koston e blerjes. Gjate vitit 2018 nuk është ndryshuar mënyra e mbajtjes së inventarit e cila vazhdon të jetë me kosto mesatare.

7. Aktive materiale

Aktivet afat gjatë materiale janë të paraqitura me koston e blerjes minus amortizimin e vitit. Vlera kontabel e tyre është 18.666,243 leke, sipas tabelës së mëposhtme:

Nr	Aktive afatgjatë materiale	Viti 2018	Viti 2017
1	Mjete transporti	11,603,844	14,504,806
2	Pajisje informatike dhe zyre	7,062,399	9,198,096
	Totali	18,666,243	23,702,902

11 | Shënimet shpjeguese nga faja 5 deri në faqen 16 janë pjesë përbërëse e pasqyrave financiare

ENTI RREGULLATOR I ENERGJISE PASQYRAT FINANCIARE

2018

Sì politike kontabel per kontabilizimin dhe shpjegimin e AAM-ve, shoqëria ka zgjedhur modelin e koston (SKK-5). Vleresimi fillestar ne momentin e hyrjes eshte bere me kosto dhe ne daten e mbylljes se bilancit paraqiten me koston e tyre minus zhvleresimin e akumuluar dhe ndonje humbje nga renia e vleres. Drejtimi nuk ka llogaritur renie te vleres per vitin e mbyllur me 31 Dhjetor 2018 dhe 31 Dhjetor 2017.

Bilanci Kontabel, Pasivet**8. Detyrime afatshkurtra**

Detyrime: afatshkurtra te shoqerise me 31.12.2018 paraqiten ne shumeti 3,614,334 leke, si me poshte :

Nr	Detyrime afatshkurtra:	Viti 2018	Viti 2017
1	Të pagueshme për aktivitetin e shfrytëzimit	63,279	
2	Të pagueshme ndaj punonjësve		
3	Të pagueshme ndaj sigurimeve	1,399,865	1,294,951
4	Të pagueshme ndaj TAP	2,009,065	1,609,353
5	Të tjera të pagueshme	142,125	76,475
	Shuma	3,614,334	2,980,779

9. Te ardhura te shtyra

Te ardhura te paguara ne avance nga Operatoret e licensuar me 31.12.2018 me rreje shume prej 18,846,169 leke e detajuar si me poshte vijon:

Nr	Te ardhura te shtyra	Viti 2018	Viti 2017
1	Te ardhura nga mbi pagesa KESH	6,193,588	7,184,349
2	Te ardhura nga mbi pagesa Gurshpall	16,516	
3	Te ardhura nga mbi pagesa Termo-Vlore		20,000
4	Te ardhura nga mbi pagesa OST	12,636,065	1,649,561
	Shuma	18,846,169	8,853,910

10. Fondet e ERE

Fondet paraqitet si me poshte:

Nr	Fonde te ERE	Viti 2018	Viti 2017
1	Fonde te mbartura	71,858,598	93,541,317
2	Rrije/Renie foresh gjate vitit ushtrimor	17,098,818	(21,682,719)
	Totali	88,957,416	71,858,598

Gjate vitit 2018 ERE ka rritur fondet e saj ne perdorim me shumen prej 17,098,818 leke, kjo rrejedhoje e mosrealizimit buxhetor te investimeve per vitin 2018.

Totali i Fondeve te ERE-s eshte 88,957,416 leke,

ENTI RREGULLATOR I ENERGJISE PASQYRAT FINANCIARE

2018

Pasqyra e performances**11. Te ardhura nga operatorët e licensuar**

Te ardhurat e realizuara nga operatorët e licensuar, e llogaritur ne baze te metodologjise se tarifimit ne baze te te ardhurave te tyre per vitin 2018 jane 157,007,013 leke.

Nr	Te ardhurat	Viti 2018	Viti 2017
1	Te ardhura nga pagesat e Operatoreve	145,468,002	98,779,757
2	Te ardhura nga Organizma mbulim shpenzimesh	3,409,229,87	1,279,341
3	Te ardhura nga licensimet 2018	10,129,781	10,765,250
	Shuma	157,007,013	110,824,348

12. Shpenzime te personelit

Shpenzimet e personelit per paga e sigurime ne shumen 103,698,499 leke jane te detajuara si me poshte:

Nr	Kosto e Punes	Viti 2018	Viti 2017
1	Shpenzime per paga	95,088,001	88,897,228
2	Sigurime shoqerore dhe shendetesore	8,610,498	8,180,716
	Shuma	103,698,499	97,077,944

13. Shpenzime Konsumi dhe Amortizimi

Jane llogaritur shpenzimet per amortizimin e asetëve sipas normave ligjore fiskale ne fuqi ne shumen 5,071,658 lek. Drejtimi nuk ka zbatuar norma te ndryshme nga ato fiskale.

Nr	Emertimi	Viti 2018	Viti 2017
1	Amortizimi i aktiveve	5,071,658	4,579,269
	Shuma	5,071,658	4,579,269

14. Shpenzime te tjera te aktivitetit

Shpenzime e tjera te aktivitetit paraqiten ne shumen **31,011,088** leke, me nje strukture si vijon:

Nr	Emertimi i shpenzimit	Viti 2018	Viti 2017
1	Shpenzime te tjera	2,889,757	3,713,378
2	Sherbime te ndryshme nga te tretet	4,490,595	2,180,025
3	Shpenzime tje energji	448,289	409,048
4	Mirembajtje automjete e tasa te lidhura me te	761,562	1,146,076
5	Publikime ne media	1,494,850	1,519,200
6	Udhetime dieta J.vend, kaotizacion	17,896,221	20,574,656
7	Poste telefon etj	1,039,860	1,183,738
8	Taksa dhe tarifa vendore	15,069	15,000
9	Trajtime profesionale	1,874,885	
10	Te tjera	100,000	
	Shuma	31,011,088	30,741,121

15. Shpenzime financiare

Shpenzimet financiare per vitin 2018 paraqiten ne shumen 126.949 lëke te detajuara si vijon:

Nr	Emertimi	Viti 2018	Viti 2017
1	Sherbime bankare	76,552	58,101
2	Humbje kursi kembimit	50,494	52,019
3	Rezultat nga kursi kembimit	-83	-1,387
4	Te tjera	-14	
	Shuma	126,949	108,733

Angazhime dhe pasiguri

Çështje gjyqësore

Gjatë aktivitetit të saj të zakonshëm, Shoqëria mund të përfshihet në pretendime apo veprime të ndryshme ligjore nga palë të treta. Bazuar në opinionin e drejtuesve të Shoqërisë, konkluzioni përfundimtar në lidhje me këto çështje nuk do të ketë efekte negative në pozicionin financiar të Shoqërisë ose ndryshime në aktivitetet e saj. Me 31 Dhjetor 2018 Shoqëria ERE për çështjet gjyqësore të hapura kundrejt saj apo nga ajo, nuk ka efekte që mund të kërkojnë rregullime të këtyre pasqyrave financiare.

16. Ngjarje pas datës së Bilancit

Nuk ka asnjë ngjarje pas datës së bilancit e cila kërkon rregullime apo shpjegime në këto pasqyra financiare.

Administratori

Hartuesi i pasqyrave

Petrit AHMETI

Aferdita BUSHI



Shtojca 2 Raport i Audituesve Ligjorë për Performancën e ERE-s

RAPORT I AUDITUESVE LIGJORE

AUDITIM PERFORMANCE PËR ENTIN REGULLATOR TË ENERGJISË

Tiranë, më 19.04.2019

Permbajtja

- Çështjet Kryesore të Auditimit
- Përgjegjësitë e Drejtimit dhe të Personave të Ngarkuar me kryerjen e detyrave funksionale
- Përgjegjësitë e Audituesit
- Të dhëna të përgjithshme mbi Entin Regullator të Energjisë
- Organigrama e ERE-s.
- Drejtoria e licensimit dhe monitorimit të tregut
 - Licensimi
 - Monitorimi
 - Sektori i monitorimit të të licensuarve.
 - Sektori i monitorimit të tregut
- Drejtoria e Tarifave dhe Çmimeve
 - Sektori i strukturës së tarifave dhe çmimeve
 - Sektori i analizës së kostove dhe çmimeve
- Drejtoria e Burimeve Njerëzore, Administrimit, Financës dhe Mardhënieve me Jashtë
 - Sektori i financës dhe protokoll arkivës
 - Sektori i mardhënieve me jashte dhe specialisti i IT-së
- Drejtoria Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit
 - Sektori i Mbrojtjes së Konsumatorit dhe Marrëdhënieve me Publikun

Drejtuar:

**Kryetarit të ERE-s z. Petrit Ahmeti,
Anëtareve të Bordit,
të Entit Regullator të Energjisë Tiranë**

Bazuar në Standartin Nderkombëtar të Angazhimeve të Dhenies së Sigurisë 3000 (SNAS), Ne jemi angazhuar në dhenien e sigurisë për performancën e Entit Regullator të Energjisë në kuptimin e një vlerësimi objektiv, profesional e të pavarur, mbi shkallën e ndjekjes dhe zbatimit prej saj të Ligjit nr.43/2015 “Per sektorin e energjisë elektrike” dhe Ligjin nr.102/2015, “Per sektorin e gazit natyror” si dhe akte të tjera ligjore dhe nënligjore në të cilin përfshihet aktiviteti i saj.

Çështjet Kryesore të Auditimit

Çështje Kryesore të Auditimit janë ato çështje që, në gjykimin tonë profesional, kanë qënë më të rëndësishmet në auditimin e performances për vitin ushtrimor 2018. Si të tilla, Ne do të rendisnim:

- Zbatueshmëria e dy Ligjeve Kryesore, Ligjit nr.43/2015 “Per sektorin e energjisë elektrike” dhe Ligjin nr.102/2015 “Per sektorin e gazit natyror”,
- Hartimi dhe zbatimi i Rregulloreve funksionale dhe procedurale,
- Gjykimi i audituesve të pavarur mbi problematikat e konstatuara.

Përgjegjësitë e Drejtimit dhe të Personave të Ngarkuar me kryerjen e detyrave funksionale

Drejtimi dhe personat e përfshirë në këtë angazhim janë përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të informacioneve të dhena që nuk përmbajnë anomali materiale, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit.

Përgjegjësitë e Audituesit

Objektivat tona janë që të arrijmë një siguri lidhur me faktin nëse strukturat funksionale të ERE-s, zbatojnë dhe kryejnë detyrat e percaktuara nga Legjislacioni dhe Rregulloret perkatese. Siguria e arësyeshme është një siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci që një auditim i kryer sipas SNA-ve do të identifikojë gjithmonë një anomali materiale kur ajo ekziston. Anomali të mund të vijnë si rezultat i gabimit ose i mashtrimit dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose të marra së bashku, pritet që në mënyrë të arësyeshme të influencojnë vendimet e përdoruesve.

Auditimi është kryer në bazë të Letres së angazhimit dhe programit të auditimit të pranuar dhe firmosur nga Kryetari i ERE-s.

Të dhena të përgjithshme mbi Entin Rregullator të Energjisë dhe risite e vitit 2018

ERE është Person Juridik Publik dhe Autoriteti i vetem rregullator në Shqipëri në sektorin e energjisë elektrike dhe të gazit natyror. ERE është krijuar në vitin 1995 dhe sot funksionon sipas Ligjit nr.43/2015, "Per sektorin e energjise elektrike" i ndryshuar dhe Ligjit nr.102/2015, "Per sektorin e gazit natyror". ERE është regjistruar pranë Drejtorisë Rajonale Tatimore të rrethit të Tiranës me NIPT K517170241.

Bazuar në Ligjin nr.43/2015, "Per sektorin e energjise elektrike" i ndryshuar nën 9, pika 1, nën 10 pika 1-ligjin nr.102/2015 "Per sektorin e gazit natyror" nën 13; *percaktohet*:

ERE ka si mision të saj të garantojë dhe të zhvillojë një treg energjie të bazuar mbi objektivitetin e transparencës duke u mbështetur në parimet e konkurrencës së lire; të sigurojë vazhdimësinë dhe cilësinë e furnizimit të energjisë për klientet; të mbrojë interesat e konsumatorëve; të mbrojë mjedisin nëpërmjet ushtrimit të autoritetit në fushën e licensimit dhe të monitorimit të subjekteve që ushtrojnë aktivitete në sektorin e energjisë apo të gazit. ERE është institucioni përgjegjës për vendosjen e tarifave të energjisë elektrike për të gjitha veprimtaritë e rregulluara, që kryhen nga të licensuarit në sektorin e energjisë elektrike.

ERE kryhen funksionet e saj nëpërmjet Bordit të Komisionerëve, personelit teknik dhe personelit mbështetës. Bordi përbehet nga Kryetari dhe katër anëtarë, të cilët emrohen nga Kuvendi me një mandat prej 5 vjetësh, me të drejtë riemrimi për një mandat të dytë radhazi.

Kryetari i ERE-së është administrator ekzekutiv i ERE-së dhe është përgjegjës për administrimin e Entit, për drejtimin e mbledhjeve të Bordit dhe për publikimin e vendimeve.

ERE jo me vonë së fundi i tremujorit të parë të çdo viti paraqet pranë Kuvendit të Shqipërisë një raport vjetor për gjendjen në sektorin e energjisë elektrike dhe të gazit, të veprimtarisë së ERE-së përfshirë dhe veprimtarinë e saj financiare.

ERE është një institucion publik, jo fitimprurës, por në të njëjtën kohë nuk është institucion buxhetor që financohet nga buxheti i shtetit. Burimet e saj të financimit janë tarifave të licensimit në sektorin e energjisë elektrike dhe të gazit, si dhe të ardhurat nga operatorët e licensuar të llogaritura prej saj në bazë të një metodologjie të hartuar e miratuar nga Bordi.

Edhe gjatë vitit 2018 Enti Rregullator i Energjisë ka patur një bashkëpunim të ngushtë me të gjitha Organizatat dhe institucionet ndërkombëtare të cilat kanë të bëjnë me Elektricitetin dhe Gazin Natyror.

ERE bashkëpunon me ECRB (Energy Community Regulatory Board) dhe ACER (Agency for the Cooperation of Energy Regulators), që të dyja këto institucione janë pranë Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë në Vienë. E-Control (EnC), pranë Energy Community në Vienë.

ERE është anëtare dhe bashkëpunon ngushtë me IGU (International Gas Union) ku merr pjesë në të gjitha takimet që organizohen si për Gazin Natyror, ashtu dhe për Gazin Natyror të Lëngëzuar (LNG), dhe Gazin Natyror të Kompresuar (CNP).

ERE është anëtare në South, South-East Gas Regional Initiative, për studime të përbashkëta në lidhje me tregun e gazit.

ERE është shumë aktive në kuadër të bashkëpunimit shumë-palësh mes Enteve Rregullatore pjesëmarrëse të MEDREG (Shoqata e Rregullatorëve të Mesdheut).

Një bashkëpunim i gjatë dhe frytdhënës është ai me USAID, për hartimin e Ligjeve, Rregulloreve dhe Metodologjive të nevojshme në sektorin e energjitikës e të gazit.

Gjatë vitit 2018, Ligji nr.43/2015, "Per sektorin e energjisë elektrike" pesoi ndryshime ne shtese te disa neneve. Keshtu Neni 57, Operimi i Tregut, Neni 1 u shtua per ti dhene vend hapesires Ligjore per funksionimin e Operatorit te Tregut e cila do te jete **Bursa Shqiptare e Energjise**. Në kuadër të punës me qëllim bërjen efektive të Bursës Shqiptare të Energjisë, si dhe në zbatim të VKM nr. 519/2016 "Për miratimin e Modelit të Tregut të Energjisë Elektrike" pjesë e së cilës do të jetë edhe Operatori i Tregut të Kosovës gjatë vitit 2018, në bashkëpunim me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë dhe nën konsulencën e USAID, u hartua Plani i Masave të bërjes efektive të Bursës Shqiptare të Energjisë.

Gjithashtu në Nenin 86, Furnizuesi i mundësisë së fundit, është shtuar Neni 6 i cili përcakton detyrimin ligjor për lidhjen e një kontrate midis klientit fundor që furnizohet nga furnizuesi i mundësisë së fundit dhe që në kuptim të nenit 109, të këtij ligji, del për herë të parë në treg të liberalizuar. Lidhur me keto shtesa, ERE ka vijuar procesin e hartimit dhe të miratimit të një sërë aktesh nënligjore të cilat janë përmendur në aktivitetin e drejtorise perkatese.

Viti 2018, ka përsheptuar procedurën për ndarjen ligjore dhe funksionale të Operatorit të Shpërndarjes së Energjisë Elektrike nga ai i Furnizimit të Shërbimit Universal nga (FSHU), Furnizuesi i Tregut të Lirë nga (FTL) dhe Operatori i Sistemit të Shpërndarjes nga (OSSH).

Gjatë vitit 2018, ERE në mënyrë aktive dhe dinamike bashkëpunon në vazhdimësi me Komunitetin e Energjisë, MIE dhe Autoritetin e Konkurrencës lidhur me çështje që kanë të bëjnë me kuadrin rregullator në sektorin e energjisë dhe për çështje të tjera të rëndësishme të këtij sektori, për sa i përket procesit të miratimit të akteve nënligjore rregullatore të sektorit të energjisë elektrike dhe gazit natyror, rishikimin e metodologjive të përcaktimit të tarifave dhe çmimeve dhe me vendimarrjet për përcaktimin e tyre.

ERE është në fazën e konsultimit, duke u mbështetur në praktikën më të mirë ndërkombëtare si dhe në konsulencën me USAID për hartimin e një strukture të re organizative të ERE-s, e cila do të sigurojë kapacitete dhe ekspertizë të nevojshme për të përmbushur zhvillimet dinamike të tregut të energjisë.


Në Ligjin nr.43/2015, "Per sektorin e energjisë elektrike", nenet 9-25, në Ligjin 102/2015 "Per sektorin e gazit natyror" neni 15-21; janë përcaktuar ndër të tjera: Objektivat e përgjithshme të ERE-s, Përgjegjësitë, Të drejtat, Parimet e vendosjes së tarifave për operim dhe shërbimet në rrjet, Monitorimi nga ERE, Regjimin rregullator për çështjet nderkufitare, Zgjidhjen e mosmarrveshjeve dhe Raportimi i ERE-s.

ERE, për funksionimin e saj mbështetet në Rregulloren për organizimin dhe funksionimin e brendshëm të saj, miratuar me Vendimin e Bordit të ERE-s Nr. 141, datë 24.12.2008 dhe ndryshuar me vendimin Nr. 80, dt. 24.08.2011, rregullore të hartuara para daljes së ligjeve 43/2015 dhe 102/2015 si edhe Rregulloren për Organizimin, Funksionimin dhe Procedurat e ERE-s, miratuar me Vendimin e Bordit të ERE-s Nr. 96, datë 17.06.2016.

Në keto kushte është e domosdoshme hartimi i një rregulloreje të brendshme që të bazohet në risite e ligjeve dhe propozimet për strukturën e re organizative dhe funksionale.

Ne, u njohem me një material të gjere mbi zbatimin dhe mbi respektimin e procedurave sipas Ligjeve dhe ketyre Rregulloreve per funksionimin e ERE-s. Ne po japim një informacion mbi detyrat funksionale me të rëndësishme të ketyre drejtorive të cilat ne i kemi ndjekur nga pikpamja e përpulshmerise dhe respektimit procedural bazuar ne Rregulloret e mesiperme per funksionimin e ERE-s.

Organigrama e ERE-s paraqitet:



Auditues Ligjor: Ludmilla Paluka license nr. 161
 Aida Maloku license nr.55

➤ Drejtoria e licensimit dhe monitorimit të tregut

Perbehet nga tre sektore:

1. Sektori i licensimit, pergjegjes, specialist,
2. Sektori i monitorimit te te licensuarve, pergjegjes, specialist dhe,
3. Sektori i monitorimit te tregut, pergjegjes, specialist.

❖ Licensimi

Ne baze te ligjit 43/2015 "Për sektorin e energjisë elektrike." Seksioni II "Licensimi"neni 37, percaktohen llojet e licensave qe ERE leshon per:

- prodhimin e energjisë elektrike,
- operimin e sistemit të transmetimit të energjisë elektrike,
- operimin e sistemit të shpërndarjes të energjisë elektrike,
- furnizimin e energjisë elektrike,
- tregtimin e energjisë elektrike,
- operimin e tregut të energjisë elektrike.

Ne baze te ligjit 102/2015 "Për sektorin e gazit natyror" Seksioni II "Licensimi"neni 22, percaktohen llojet e licensave qe ERE leshon per:

- transmetim të gazit natyror;
- shpërndarje të gazit natyror;
- furnizim të gazit natyror;
- tregtim të gazit natyror;
- operim në hapësirat e depozitimit të gazit natyror;
- operim në impiantet e GNL-së;
- funksionimin e operatorit të tregut të gazit natyror.

Per secilen veprimtari, licencat lëshohen të veçanta edhe në rastin kur i jepen të njëjtës shoqëri. Sipas nenit 38 te ligjit 43/2015 "Për sektorin e energjisë elektrike" si edhe nenit 23 te ligjit 102/2015 "Për sektorin e gazit natyror" ERE përcakton kushtet që duhet të përmbushen për marrjen e çdo licence, duke marrë në konsideratë: afatin e vlefshmërisë së licencës, i cili për veprimtaritë e prodhimit, transmetimit dhe shpërndarjes nuk mund të jetë më shumë se 30 vjet, vendndodhjet dhe zonat, në të cilat do të kryhen veprimtaritë e licencuara, sigurinë operative dhe qëndrueshmërinë e objekteve, pajisjeve apo rrjetit, në përputhje me rregullat teknike, kërkesat lidhur me sigurinë kombëtare, mbrojtjen e jetës, pasurisë, shëndetit të qytetarëve, rendin publik, kërkesat financiare, mbrojtjen e mjedisit, nxitjen e një tregu konkurrues të energjisë elektrike etj. ERE miraton rregulloren për procedurat dhe afatet për dhënie, modifikimin, transferimin ose heqjen e licensave, pagesat e aplikimeve për licencë, si dhe informacionin që duhet paraqitur në kërkesën për aplikim për çdo licencë. ERE merr vendim për dhënie ose jo të një licence prodhimi të energjisë elektrike, brenda 60 ditëve nga data e aplikimit dhe brenda 30 ditëve nga data e aplikimit për licencat e tjera, përveç rastit kur mund të vendosë zgjatjen e afatit për marrjen e vendimit, në përputhje me rregulloren për organizimin dhe funksionimin e ERE-s. Gjatë marrjes së vendimit, ERE merr në shqyrtim dhe vlerëson vërejtjet ose kundërshtimet e arsyeshme e të bazuara, të paraqitura nga institucionet publike apo palët e tjera të interesuara, në lidhje me kërkesën për licencë, duke arsyetuar në vendim pranimin ose jo të tyre.

ERE ka hartuar dhe miratuar me vendim të bordit nr. 109, datë 29.06.2016 “Rregulloren për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licensave në sektorin e energjisë elektrike dhe gazit natyror”. ERE ka zbatuar me korrektesi afatet e publikimit në median e shkruar të Vendimeve të Bordit të ERE-s për fillimin e procedurës për të bërë të mundur që palët e interesit të shprehin komente lidhur me fillimin e një procedure licensimi.

Gjate vitit 2018 janë licensuar në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike 23 licenca nga të cilat 10 janë centrale fotovoltaike, 8 licenca në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, 6 licenca në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike dhe 1 në veprimtarinë e tregtimit të gazit natyror.

Rinovim license. Me perfundimin e afateve të licensave të marra subjektet aplikojnë pranë ERES për rinovimin e licenses.

Gjate 2018 bordi ka marrë 2 vendime për fillimin e procedurës për rinovimin e licenses dhe ka marrë 2 vendime për rinovim të licensave, të dyja vendimet për rinovim i perkasin të njejtës shoqëri Gen-1 Tirana.

ERE refuzon dhënien e një licence nëse në baze të nenit 41 të ligjit 43/2015 dhe nenit 26 të ligjit 102/2015 aplikuesi nuk përmbush ndonjë nga kushtet e përcaktuara në nenin 38 të këtij ligji, është në proces falimentimi ose likuidimi, aplikuesit i është revokuar ose hequr licenca dhe nuk ka përfunduar periudha, brenda së cilës është i ndaluar riaplikimi për licencë.

Gjate 2018 ERE ka marrë 5 vendime për mosfillim të procedurës së licensimit.

ERE heq një licencë në baze të nenit 42 të ligjit 43/2015 dhe nenit 27 të ligjit 102/2015 kur i licencuari nuk përmbush më kushtet thelbësore të licencës së dhënë, shkel dispozitat ligjore për mbrojtjen e mjedisit gjatë kryerjes së veprimtarisë së tij, rrezikon jetën, shëndetin dhe pasurinë e qytetarëve, nuk kryen pagesat e rregullimit të vendosura nga ERE, siç përcaktohet nga nenit 17 të ligjit 43/2015 dhe nenit 14 të ligjit 102/2015, bëhet financiarisht i paafte ose kërkon shpalljen e falimentimit, me kërkesë të të licencuarit, ka pushuar së kryeri funksionet e caktuara sipas licencës. Për heqjen e licenses njoftohet me shkrim i licencuari për fillimin e procedurave për heqjen e licencës, në njoftim shprehen qartësisht arsyet për heqjen e saj.

Gjate 2018 ERE ka marrë 6 vendime për heqje license, 4 në veprimtarinë e tregtimit të energjisë dhe 2 në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike.

Modifikimi i kushteve të një licence ERE mund të modifikojë licencën në përputhje me nenin 43 të ligjit 43/2015 dhe nenit 28 të ligjit 102/2015, me iniciativën e vet, në bazë të një vendimi gjyqësor të formës së prerë, kur ndryshojnë kushtet e kontratës koncesionare ose me kërkesën e të licencuarit. ERE merr në konsideratë ndikimet e pritshme që modifikimet e iniciuara apo të propozuara sjellin ndaj detyrimeve që i licencuari ka në përputhje me këto ligje dhe kushtet e licencës së tij. Përpara miratimit të modifikimit të një licence, ERE publikon modifikimet e propozuara dhe shqyrton vërejtjet ose ankesat e mundshme, të paraqitura nga palët e interesuara lidhur me këtë proces.

Gjate vitit 2018 bordi i ERE-s ka marrë 5 vendime për miratim të modifikimit të licensave, 1 në fushën e prodhimit të energjisë elektrike, 2 në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike dhe 2 në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike.

Transferimi i licencës ose asetëve. Transferimi i licencës ose asetëve të të licencuarit, që shërbejnë për kryerjen e veprimtarive të licencuara, bëhet me miratimin paraprak të ERE-s, bazuar në rregulloren e miratuar prej saj miratuar me vendimin nr. 119, date 21.07.2016 të

bordit "Rregullore për procedurat e transferimit të aseteve nga të licencuarit". Miratimi i ERE-s sipas rregullores të përcaktuar në pikën 2 të këtij neni, nuk është i nevojshëm në rastet e transferimit të aseteve me vlerë minimale, apo aseteve që nuk lidhen ngushtësisht me veprimtarinë e licencuar. Gjate këtij ushtrimi janë marre 3 vendime për transferim license, të trija nga shoqëria OSHEE tek shoqëria FSHU, OSSH, FTL, po kështu janë marre 2 vendime për fillim procedure për shqyrtim të kërkesave të shoqërive për lenien peng të aseteve dhe 4 vendime mbi miratimin e kërkesave për lenien peng të tyre, ka marre nje vendim për refuzim kerkese për lenien peng të aseteve dhe nje vendim për ndryshim ortaku.

Gjithashtu çdo aplikim për licencim i është nënshtruar një analize të kujdesshme të rregullshmërisë dhe plotësisht me korrektësi të dokumentacionit ligjor, administrativ, financiar, teknik dhe marrjes së lejeve përkatëse të përdorimit të ujërave apo leje mjedisore, të dhëna nga institucionet e tjera në përputhje me aktivitetin që subjektet kanë kërkuar të licensohen.

Për të gjithë subjektet e licensuar nga ERE, mbahen dhe arkivohen regjistra të veçantë për secilin aktivitet, me të dhënat e nevojshme për subjektin dhe llojin e licensës, të cilat pasqyrohen të përditesuara në portalin e ERE-s dhe mund të konsultohen nga çdo palë e interesuar. Licensat kane nje numer rendor progresiv si edhe nje seri dhe kod te veçante sipas fushave te licenses.

Licensat e dhena gjate 2018 jane:

Subjektet e licencuar, në aktivitetin e prodhimit të energjisë

Prodhim energjie nga burime hidrike

Subjekti	Prodhues energjie elektrike	fuqi e instaluar
"HEC Llënge" sh.p.k	H/C "Llënga 1"	1730 kW
	H/C "Llënga 2"	300 kW
	H/C "Llënga 3"	1500 kW
"Alesio - 2014" sh.p.k	H/C "Kryezi"	1990 kW
"Lucente Koncesionare" sh.p.k	H/C "Spatharë"	1038 kW
"Hydro Seta" sh.p.k	H/C "Seta 1+2"	7454 kW
		2722 kW
	H/C "Seta 3"	4724 kW
	H/C "Seta 4"	
"Favina 1" sh.p.k	H/C "Voskopojë"	1970 kW
"Caushi Energy" sh.p.k	H/C Qafzeze"	400 kW
"Domi - Tec" sh.p.k	H/C "Plepi"	2285 kW
"Blac Energy" sh.p.k	H/C "Blac"	1300 kW
"Edlani" sh.p.k	H/C "Shëngjon 1"	651 kW
	H/C "Shëngjon 2"	356 kW
	H/C "Shëngjon 3"	341 kW
"Alesio - 2014" sh.p.k	H/C "Fushë Arrëz"	1990 kW
DERBI – E	H/C "Antena"	1105 kW
"OSOJA HPP" sh.p.k	H/C "Osoja"	1952 kW
"BE-IS Energy"	H/C "Kallivar 1"	1475 kW
	H/C "Kallivar 2"	1526 kW
	H/C "Kallivar 3"	3321 kW
	H/C "Kallivar 4"	275 kW

Auditues Ligjor: Ludmilla Paluka
Aida Maloku

license nr. 161
license nr.55

9

Prodhim i energjise elektrike nepermjet centraleve fotovoltaik

Subjekti	Prodhues energjie elektrike	fuqi e instaluar
"AGE Sunpower" sh.p.k	Centrali fotovoltaik Topojë (Sheq Marinas)	2000 kW
"Seman Sunpower" sh.p.k	Centrali fotovoltaik Topojë (Sheq Marinas)	2000 kW
"Malësia Solar 1" sh.p.k	Centrali fotovoltaik "Labë e Poshtëme" Shkrel, Koplík, Rrethi Malësi e Madhe, Qarku Shkodër.	2500 kW
"Malësia Solar 2" sh.p.k	Centrali fotovoltaik "Labë e Poshtëme" Shkrel, Koplík, Rrethi Malësi e Madhe, Qarku Shkodër.	2500 kW
"Malësia Solar 3" sh.p.k	Centrali fotovoltaik "Labë e Poshtëme" Shkrel, Koplík, Rrethi Malësi e Madhe, Qarku Shkodër.	2500 kW
"OSOJA Energy" sh.p.k	Centrali fotovoltaik Seman-1 Sheq Marinas Fier.	2000 kW
"Seman2Sun" sh.p.k	Centrali Fotovoltaik Seman – 2, Sheq Marinas, Fier	2000 kW
"SONNE" sh.p.k	Centrali Fotovoltaik, Topojë	1998 kW
"AED Solar" sh.p.k	Centrali fotovoltaik Topojë	1998 kW
"AEE" sh.p.k	Centrali Fotovoltaik "Plug"	2000 kW

Vendime te tjera te marra nga ERE per modifikim dhe transferim license ne veprimtarine e prodhimit.

- Nga Bordi i ERE-s gjatë vitit 2018 ka miratuar modifikimin e licencës së prodhimit të energjisë elektrike të shoqërisë "Hidropower Elektrik" shpk duke miratuar emertimet dhe fuqite perkatese.
- Bordi i ERE-s ka miratuar transferimin e licencës së furnizimit te energjisë elektrike nga Operatori i Shpërndarjes së Energjisë elektrike sha tek shoqëria "Furnizuesi i shërbimit universal" sha (FSHU).
- Bordi i ERE-s ka miratuar transferimin e licencës per operimin e sistemit të shpërndarjes së energjisë elektrike, të shoqërisë "OSHEE sha" tek shoqëria "OSSH" sha.

Të licensuarit në veprimtarinë e Tregëtimit të Energjisë Elektrike gjatë 2018:

Subjekti	Aktiv. licensuar	Nr. Vendimit, data
"Wind Power Albania" shpk	Tregëtim	Vendimi Nr. 58, date 12.03.2018
"Smart Watt" shpk	Tregëtim	Vendimi Nr. 72, date 26.03.2018
"DON-UCD" shpk	Tregëtim	Vendimi Nr. 158, date 09.07.2018
"ReNRGY Trading Group" shpk	Tregëtim	Vendimi Nr. 163, date 19.07.2018
"Uradrin" shpk	Tregëtim	Vendimi Nr. 172, date 03.08.2018
"FLT" sha	Tregëtim	Vendimi Nr. 198, date 03.09.2018
"AEE" shpk	Tregëtim	Vendimi nr. 210, date 27.09.2018
"ENER TRADE" shpk	Tregëtim	Vendimi Nr. 226, date 26.10.2018

Vendime te tjera te marra nga ERE per modifikim dhe heqje license ne veprimtarine e tregëtimit te energjise.

- Heqja e licencës për tregëtimin të energjisë elektrike, shoqërisë "Hec-Dunicë" shpk, me kërkesë të subjektit.

Auditues Ligjor: Ludmilla Paluka license nr. 161
Aida Maloku license nr.55

10

- Heqja e licencës për shoqërisë “ENPOWER ALBANIA” shpk, për kryerjen e aktivitetit të tregtimit të energjisë elektrike”, i ndryshuar, për shkelje të kushteve të licencës nga ana e subjektit.
- Heqja e licencës shoqërisë “EFT ALBANIA” shpk, për tregtimin të energjisë elektrike, me kërkesë të subjektit në kuadër të një riorganizimi brenda grupit të kompanive të EFT Group.
- Modifikimi i licencës së shoqërisë “Energia Gas and Power Albania” shpk, në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, për ndryshim emri.
- Modifikimi i licencës së shoqërisë “GEN-I Tirana” shpk në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, për një afat 5 vjeçar.
- Heqja e licencës shoqërisë “ROBERTO OIL” shpk, për tregtimin e energjisë elektrike, me kërkesë të subjektit për mos ushtrim aktiviteti.

Subjektet e licensuar në aktivitetin e Furnizimit të energjisë elektrike, gjatë vitit 2018:

Subjekti	Aktiv. licensuar	Nr.vendimit, data
“Energji Ashta” shpk	Furnizim	Vendimi Nr. 26, Datë 30.01.2018
“Wind Power Albania” shpk	Furnizim	Vendimi Nr. 126, Datë 04.06.2018
“FTL” sha	Furnizim	Vendimi Nr. 199, Datë 03.09.2018
“DON-UCD” shpk	Furnizim	Vendimi Nr. 219, Datë 11.10.2018
“ENER TRADE” shpk	Furnizim	Vendimi Nr. 227, Datë 26.10.2018
“ReNRGY Trading Group” shpk	Furnizim	Vendimi Nr. 243, Datë 26.11.2018

Vendime të tjera të marra nga ERE për modifikim, heqje dhe transferim license në veprimtarinë e furnizimit të energjisë.

- Heqja e licencës së shoqërisë “EFT Albania” shpk me kërkesë të subjektit në kuadër të një riorganizimi brenda grupit të kompanive të EFT Group.
- Modifikim i licencës së shoqërisë “Energia Gas and Power Albania” shpk, në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike, modifikimi ka ndodhur për arsye të ndryshimit të emrit.
- Modifikimi i licencës së shoqërisë “GEN-I Tirana” shpk në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike, për një afat 5 vjeçar.
- Transferimi i licencës së Furnizimit të Energjisë Elektrike nga “Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike” sha (OSHEE sh.a), tek shoqëria “Furnizuesi i Shërbimit Universal” sha (FSHU sha).
- Heqja e licencës shoqërisë “ROBERTO OIL” shpk, për furnizimin e energjisë elektrike, e cila u bë me kërkesë të subjektit për arsye të mos ushtrimit të veprimtarisë.

Subjektet e licensuar në aktivitetet e Gazit natyror për vitin 2018

Subjekti	Aktiviteti	Nr.vendimit, data
“Balkgaz” shpk	Tregëtim	Vendimi Nr. 256, datë 17.12.2018

❖ Monitorimi

Monitorimi kryhet nga dy sektore ai i monitorimit te te licensuarve dhe sektori i monitorimit te tregut.

Në zbatim të Ligjit Nr. 43/2015 "Për Sektorin e Energjisë Elektrike", neni 22, të Ligjit Nr. 102/2015 "Për Sektorin e gazit natyror" neni 87.; Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr. 244, datë 30.03.2016 "Për miratimin e kushteve për vendosjen e detyrimit të shërbimit publik, që do të zbatohen ndaj të licensuarve në sektorin e energjisë elektrike, të cilët ushtrojnë aktivitetin e prodhimit, transmetimit, shpërndarjes dhe furnizimit me energji elektrike", si dhe kushtet e licensave të lëshuara nga ERE, shërbimet e operatorëve të licensuar nga ERE janë objekt i monitorimit në lidhje me respektimin e detyrimeve ligjore.

Monitorimet janë kryhen bazuar në plane tematike paraprake dhe organizuar në mënyrë të tillë që të monitorohen në vazhdimësi rezultatet e pjesëmarrësve të tregut të energjisë elektrike. Procesi i monitorimit kryhet duke ndjekur periodikisht hapat e mëposhtme.

- Mbledhja dhe përpunimi i rezultateve periodike (muajore) dhe informacioneve.
- Përpunimi i rezultateve dhe përcaktimi i vlerave të indikatorëve të performancës.
- Diskutimi i problematikave në mbledhjet periodike të Bordit të ERE.
- Identifikimi i çështjeve për monitorim në terren.
- Monitorim per zbatimin e rregulloreve.
- Kryerja e monitorimeve në terren dhe analiza e tyre.
- Propozimi i qëndrimit dhe rekomandimeve të ERE-s lidhur me konstatimet nga monitorimet.

Sektori i monitorimit te te licensuarve.

Për monitorimin e shoqërive të licencuara nga ERE në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike (Urdhër Nr. 52, datë 04.09.2018) me objekt:

- Verifikimi i kapacitetit të instaluar faktik krahasuar me kapacitetin e instaluar dhënë në licencën përkatëse; Regjistrimet e llogarive të të Licencuarit; Parametrat teknikë dhe zbatimi i kushteve, në përputhje me standartet e parashikuara në Kodin e Shpërndarjes dhe Transmetimit sipas rastit; Format e raportimit në përputhje me detyrimet në zbatim të akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi;-Prodhimi vjetor i ndarë në muaj; -Fuqia e mundëshme, duke përfshirë periudhat kohore të disponibilitetit të çdo njësie gjeneruese e kombinuar kjo me planin dhe kohën për daljen nga puna; -Fuqia Aktive dhe Reaktive e çdo njësie gjeneruese; -Pjesëmarrja e tyre në pik dhe në pjesë të veçanta të mbulimit të ngarkesës,
- Cilësia e prodhimit dhe detaje të marra për përmirësimin e cilësisë së tij.
- Detaje mbi çdo ndryshim të bërë në asetet e prodhimit, përfshirë detaje të çdo elementi që është zgjeruar, nxjerrë jashtë përdorimit ose zëvendësuar gjatë operimit;
- Kushtet dhe tarifat e lidhjes së prodhuesve.

Gjatë vitit 2018 janë kryer rreth 40 monitorime në objektet e licencuara në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike (kryesisht hidrocentrale) për zbatimin e kushteve të licensave, ku u konstatuan që tre hidrocentrale kishin kapacitet të instaluar përtej kufirit të lejuar në kushtet e licensës, për të cilat ka vazhduar procedurat dhe jane kryer seancat dëgjimore me institucionet përkatëse per rregullimin e situates.

Sektori i monitorimit te tregut

a) Eshte monitoruar plani i investimeve te OST sha për vitin 2017 dhe periudhën Janar-Tetor 2018. (Urdheri nr.61, date 6.11.2018).

Ne lidhje me investimet e vitit 2017:

- Nga 33 zëra investimesh të miratuara nga ERE me fond të parashikuar prej 2 183 846 979 lekë, janë lidhur kontrata e janë kryer pagesa për 12 zëra investimesh duke realizuar vlerën 957 337 509 lekë. Gjithashtu janë lidhur kontrata e kryer pagesa për 2 zëra që nuk bënin pjesë në investimet e miratuara të vitit 2017 por të miratuara me vendim të Bordit Mbikqyrës, me një vlerë 64 866 925 lekë. Gjithsej vlera e realizuar për vitin 2017 është 1 022 204 434 lekë nga 1 348 083 090 lekë që është vlera e kontratave për këto zëra investimesh.
- Vërehet mos realizim i parashikimeve i shkaktuar nga mos rakordimi mes strukturave të OST sha. Për 11 zëra investimesh gjatë vitit 2017 është mundësuar vetë procedura deri në lidhjen e kontratës. Për 8 zëra investimesh të miratuara nuk është arritur të lidhet kontratë pasi kryesisht këto investime është menduar të shtyhen në kohë.

Ne lidhje me investimet Janar-Tetor 2018:

- ERE nuk ka miratuar Planin e Investimeve të OST sha pasi nga ana e OST sha nuk është paraqitur kërkesa për miratimin e planit të Investimeve për Vitin 2018. OST sha për realizimin e investimeve është bazuar në planin 10 vjeçar 2015-2025 të miratuar dhe në vendimet e Këshillit Mbikqyrës të miratuara përgjatë vitit 2017 dhe 2018.
- Për vitin 2018 janë planifikuar 41 zëra investimi me fond të parashikuar prej 4 375 053 881 lekë. Duke qënë se disa nga investimet shtrihen në më shumë se një vit, fondi i parashikuar për investimeve vetëm për vitin 2018 është parashikuar 1 792 900 000 lekë. Nga 41 zëra investimesh, për 15 zëra evidentohet se akoma nuk është lidhur kontratë realizimi dhe vlera e këtyre investimeve për vitin 2018 llogaritet afërsisht 317 422 560 lekë. Për 26 zëra investimet ose janë realizuar ose janë në proces realizimi. Vlera e realizuar deri në tetor 2018 është 1 140 108 741 lekë ose 77.27 % e vlerës së parashikuar për vitin 2018 për këto zëra.

ERE ka monitoruar vazhdimisht realizimin e investimeve të Operatorit të Sistemit të Transmetimit duke konstatuar se pavarësisht ndryshimeve të miratuara nga Këshilli Drejtues i OST sha investimet e realizuara përkojnë me trendet e planit 10 vjeçar të zhvillimit të rrjetit të transmetimit.

b) Me kërkesen e shoqërisë GEN-I Tirana shpk ka nisur monitorimi per kontratat e KESH sha për vitet 2017 dhe 2018. (Urdhër Nr. 76, datë 06.12.2018) ku u konstatuan se: Kontrata e lidhur më dt. 11.03.2013 ndërmjet KESH sha dhe GSA shpk "Për furnizimin e energjisë shtesë dhe energjisë së devijimeve" dhe, Kontrata e lidhur më dt. 27.07.2016 ndërmjet KESH sha dhe EFT AG "Kontratë për Depozitimin e Energjisë" nuk i përmbahej kontrates tip të miratuar nga ana e ERE-s.

Bordi i ERE me vendimin nr. 131/2016 "Mbi ndërprerjen e procedurës së shpallur nga shoqëria KESH sha "Ftesë për shprehje interesi për marrëveshjen kuadër për depozitimin e energjisë elektrike" ka vendosur që:-KESH sha të ndërpresë menjëherë çdo veprim të mëtejshëm për finalizimin e procedurës së shpallur "Ftesë për shprehje interesi për marrëveshjen kuadër për depozitimin e energjisë elektrike".

c) Për sa i përket monitorimit periodik të indikatorëve të sistemit elektro-energjitik, janë mbledhur e përpunuar treguesit e planifikuar duke shfrytëzuar informacionet periodike të pjesëmarrësve të tregut të energjisë. Janë paraqitur në mënyrë të përmbledhur shumica e të dhënave të përpunuara duke dhënë edhe mundësinë e krahasimit me vitet paraardhëse.

Një set i plotë me indikatorët kryesorë të sistemit publikohet në faqen e internetit të ERE-s edhe 4-mujor si detyrim i ligjit Nr. 43/2015 dhe që i shërben të gjithë të interesuarve si dhe rrit transparencën për zhvillimet në sektorin elektro-energjitik.

Nga analiza e rezultateve dhe përpunimi i problematikave e informacioneve të marra, nga strukturat drejtuese të ERE-s, është gjykuar sipas rastit të zhvillohen verifikime, analiza, seanca dëgjimore dhe monitorime në terren. Rezultatet e këtyre aktivitetëve i kanë shërbyer strukturave përkatëse për një vendim marrje sa më të drejtë.

Grupet e monitorimeve specifike janë organizuar me pjesëmarrje nga drejtori e sektorë të tjerë me qëllim sigurimin e specialistëve të nevojshëm në procesin e monitorimit por edhe për faktin se numri i specialistëve që punojnë në Drejtorinë e Liçensimit dhe Monitorimit të Tregut është i vogël. Specialistët e Drejtorisë së Liçensimit dhe Monitorimit të Tregut gjithashtu janë angazhuar në grupe pune të ndryshme për të dhënë kontributin e tyre në trajtimin e problematikave të strukturave të tjera të ERE-s. Theksojmë përfshirjen në përgatitjen e draft akteve nënligjore të ERE-s dhe në dhënien e mendimeve për akte jashtë ERE-s.

Është analizuar situata e raportimeve periodike të të licencuarve ku konstatohen **mangesi** nga ana e tyre në respektimin e detyrimit për raportim periodik. Edhe gjatë vitit 2018 do të vazhdojë puna për ndjekjen periodikisht të raportimeve periodike dhe reflektimin e mangesive të konstatuara, është përgatitur një regjister për këto qëllim.

Përfaqesues të Drejtorisë së Liçensimit dhe Monitorimit të Tregut janë anëtarë të grupeve të punës në organizmat ndërkombetare sipas urdherave e Udhëzimeve të Kryetarit të ERE-s duke informuar rast pas rasti për zhvillimet.

Studimi i materialeve dhe zhvillimeve të reja në sektorin energjitik kryhet vazdimisht dhe konsiderohet si detyrim në punën e përditshme të specialistëve të drejtorisë.

Monitorimet Tematike gjatë vitit 2018

Monitorime Tematike gjatë vitit 2018		
Urdhëri / Monitorimi	Objekti / Monitorimi	Kompania
Urdhër Nr. 14, datë 1.02.2018	Analizimi e planit të pendësuar të investimeve për vitin 2018 dhe planin e zhvillimit të rejtës të shpërndarjes për 5 vitet e ardhshme të shoqërisë OSHEE sh.a.	OSHEE sh.a
Urdhër Nr. 32, datë 28.03.2018	Për shqyrtimin dhe analizimin e planit 10 vjeçar të zhvillimit të (2018-2028) të shoqërisë ALBGAS sh.a.	ALBGAS sh.a
Urdhër Nr. 48, datë 11.07.2018	Monitorimin e operimit të prodhuesve të energjisë elektrike dhe lidhjet me rejtin e shpërndarjes së energjisë elektrike.	OSHEE sh.a; Hydro Power Plant of Korca shpk; Gjoka Konstruktion & Energji shpk; Xhengo Energji shpk; Favina I shpk; The Blue Star shpk; Strelca Energy shpk.
Urdhër Nr. 51, datë 31.08.2018	Monitorimin e shoqërisë KESH sh.a lidhur me ankesën e shoqërisë GEN-J Tirana shpk mbi zbatimin e procedurave të shfrytëzimit të energjisë elektrike të kryera nga KESH sh.a për periudhën 2017-mars 2018.	KESH sh.a
Urdhër Nr. 52, datë 04.09.2018	Për monitorimin e shoqërive të licencuara nga ERE në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike	Shoqëritë e licencuara nga ERE në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike (sipas HEC-ëve përkatëse)
Urdhër Nr. 61, datë 06.11.2018	Mbi monitorimin e ecursit së zbatimit të planit të investimeve për vitin 2017 dhe periudhën janar – tetor 2018.	OST sh.a
Urdhër Nr. 70, datë 23.11.2018	Për monitorimin e veprimtarisë së OST sh.a gjatë periudhës janar-tetor 2018.	OST sh.a

Auditues Ligjor: Ludmilla Paluka license nr. 161
Aida Maloku license nr.55

14

Urdhër Nr. 73, datë 26.11.2018	Për monitorimin e veprimtarive të OSSH-së; FSHU-së për periudhën janar-mëntor 2018.	OSHEE-së.
Urdhër Nr. 75, datë 06.12.2018	Për monitorimin e realizimit të OPEX për vitin 2017 dhe 2018 të shoqërisë OST-së.	OST-së.
Urdhër Nr. 76, datë 06.12.2018	Lidhur me kërkesën e shoqërisë GEN-I Tiranë shpk për zgjerimin e heimit në lidhje me kontratat ekskluzive të KESH-së për vitet 2017 dhe 2018.	KESH-së.

➤ Drejtoria e Tarifave dhe Çmimeve

Kjo Drejtori perbehet nga dy sektore:

1. Sektori i Struktues së Tarifave dhe Çmimeve, përgjegjës, specialist dhe,
2. Sektori i Analizes së Kostove dhe Çmimeve, përgjegjës, specialist.

Bazuar në Ligjet Nr 43/2015 "Për Sektorin e Energjisë Elektrike", Ligjin Nr.102/2015, "Për sektorin e gazit natyror" dhe Ligjin 7/2017 "Për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme"; Drejtoria e Tarifave dhe Çmimeve funksionon sipas parimeve të përcaktuara në rregulloren për organizimin dhe funksionimin e brendshëm të ERE-s, miratuar me Vendimin e Bordit të ERE-s Nr. 141, datë 24.12.2008 dhe ndryshuar me vendimin Nr. 80 dt. 24 .08. 2011; si dhe Rregulloren për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s, miratuar me Vendim Bordi Nr.96, datë 17.06.2016.Keshtu ajo gjate aktivitetit vjetor realizon keto momente kryesore:

1. Në përputhje me pikën 1 të nenit 16 të Rregullores, Drejtoria e tarifave dhe Çmimeve, dhe në vecanti Sektori i Struktues së Tarifave dhe të Çmimeve, bazuar në metodologjinë e vleresimit të kostos dhe miratimit të çmimeve, vlereson mjaftueshmerine e tarifave për sigurimin e shërbimit dhe furnizimit me energji e gaz duke i mbajtur vlerat e tarifave në nivelin e mbulimit të kostove dhe të siguroje vazhdimin normal të veprtarisë. Në përputhje me pikën 2 të nenit 16 të Rregullores, Drejtoria e tarifave dhe Çmimeve, dhe në vecanti Sektori i Analizes, ka shqyrtuar programet e investimeve të të licënuarve, Pasqyrat Financiare të Operatoreve të energjisë si material mbështetës në përgatitjen e relacioneve për tarifën dhe çmimet.
2. Kjo Drejtori, në përmbushje të përgjegjësiqe që i ngarkon ligji 43/2015 "Për Sektorin e Energjisë Elektrike" në mënyrë të vecantë referuar nenit 17 pika 4, ligjit 102/2015 Për Sektorin e gazit natyror" neni 14, ERE përcakton, propozon dhe çon për miratim pagesën rregullatore që arketohet prej të licënuarve në përputhje me rregulloren përkatëse. Si rrjedhojë, është llogaritur sipas metodikes se percaktimit te pagesave rregullatore bazuar ne te ardhurat vjetore për të licënuarit në sektorin e energjisë elektrike, e cila është miratuar me Vendimin Nr. 263, dt. 19.12.2018 të Bordit të ERE-s.

Drejtorja e çmimeve dhe tarifave është përgjegjëse për zhvillimin e metodologjisë së tarifave dhe mbledhjen dhe analizen e të dhenave e të informacioneve për propozime të arsyeshme nga operatorët e tregut të energjisë në lidhje me strukturon dhe nivelin e tarifave.

Ashtu si dhe në vitet e mëparshme edhe gjate vitit 2018, nga kjo Drejtori është synuar që nepermjet tarifave dhe çmimeve të propozuara prej saj dhe të miratuara nga Bordi i ERE, tu jape Operatoreve mundësi të mbulimit të kostove dhe ti beje të interesuar për përdorimin e të ardhurave për investime të reja në zhvillim të ecurisë së aktivitetit.

Gjate vitit 2018 ne bashkepunim me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë si dhe Autoritetin e Konkurrencë dhe duke marrë opinion ne lidhje me çështje që kanë të bëjnë me rishikimin e metodologjive të percaktimit të tarifave dhe çmimeve dhe me vendimmarjet për percaktimin e tarifave dhe çmimeve të cilat janë reflektuar në vendimet e ERE-s si vijon:

Auditues Ligjor: Ludmilla Paluka license nr. 161
Aida Maloku license nr.55

15

- Vendimi Nr. 97, Datë 23.04.2018 “Mbi miratimin e tarifës së transmetimit të gazit natyror nga shoqëria Albgaz sha, për vitin 2018”
- Vendimi 144, date 25.06.2018 “Mbi rishikimin e “metodologjisë së përcaktimit çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga furnizuesi i mundësisë së fundit” miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 201, datë 04.12.2017”
- Vendimi 168, datë 19.07.2018 “Mbi për miratimin e ndryshimeve të propozuara nga TAP AG në metodologjinë e tarifave të TAP AG, të miratuar me vendimin e ERE-s nr. 127, datë 7.11.2013
- Vendimi 190, date 30.08.2018 “Mbi shqyrtimin e aplikimit të shoqërisë “OSHEE” sh.a. për tarifën e shërbimit të shpërndarjes së energjisë elektrike sipas nivelit të tensionit dhe lënien në fuqi të çmimeve me pakicë për klientët që shërbehen nga furnizuesi i shërbimit universal për vitin 2018”.
- Vendimi Nr. 266, Datë 21.12.2018 “Mbi përcaktimin e tarifës së shërbimit të transmetimit të energjisë elektrike nga shoqëria “OST” sha për vitin 2019”
- Vendimi Nr. 268, Datë 21.12.2018 mbi lënien në fuqi të vendimit të Bordit të ERE-s nr. 190 datë 30.8.2018 në lidhje me tarifën e përdorimit të rrjetit të shpërndarjes sipas nivelit të tensionit dhe çmimet me pakicë për për klientët fundorë që shërbehen nga furnizuesi i shërbimit universal për vitin 2019.

❖ *Mbi procedurat për aplikimin dhe miratimin e tarifave dhe të çmimeve*

Bazuar në Rregulloren për funksionimin dhe procedurat e ERE-s, miratuar me Vendim Bordi Nr.96, dt.17.06.2016, Neni 21- Procedura e aplikimeve për përcaktimin e tarifave e çmimeve, pika 1; kerkohet nga të licensuarit në sektorin e energjisë dhe të gazit të paraqesin propozimet për përcaktimin e tarifave dhe të çmimeve jo me vonë se data 1 Shtator e vitit aktual.

Po kjo Rregullore, Neni-22, përcakton se ERE do të shpallë vendimet mbi përcaktimin/rishikimin e tarifave dhe çmimeve brenda dates 15 dhjetor të vitit që është paraqitur aplikimi.

Në zbatim të detyrimit ligjor, veprimtaritë e kesaj Drejtorie gjatë vitit 2018 kanë qënë:

1. Shqyrtimi i aplikimeve për tarifën dhe çmimet nga ana e të licensuarve në sektorin e energjisë elektrike dhe të gazit natyror për:
 - Aktivitetin e gjenerimit të energjisë elektrike,
 - Aktivitetin e transmetimit të energjisë elektrike,
 - Aktivitetin e shpërndarjes të energjisë elektrike,
 - Aktivitetin furnizimit të shërbimit universal të energjisë elektrike,
 - Aktivitetin e transmetimit dhe shpërndarjes së gazit natyror,
 - Aktivitetin e furnizimit të mundësisë së fundit të energjisë elektrike.
2. Amendimi i metodologjisë për llogaritjen çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit, miratuar me vendimit nr. 144, datë 25.06.2018.

Gjate procesit të shqyrtimit të aplikimeve kjo Drejtori analizon situatën energjitike në vend duke pasur parasysh orientimet e qeverisë për sektorin, situatën ekonomiko-financiare të Operatoreve kryesore në tregun energjistik dhe atë të gazit dhe relaton pranë Bordit deri në vendimtarjen që finalizohet me tarifën dhe çmimet sipas struktures së tregut të energjisë.

Mbi procedurat per miratimin e tarifave te sherbimit te shperndarjes se energjise elektrike sipas nivelit te tensionit

Gjate misionit ne u njohem me Relacionin e pergatitur nga kjo Drejtori dhe ne bashkepunim: *Mbi analizën e realizimit të të ardhurave për aktivitetet e shperndarjes dhe furnizimit me pakicë të energjisë elektrike për periudhën 2015-2018 dhe lënien në fuqi të tarifave të përdorimit të rrjetit të shperndarjes për nivele tensioni.*

Me anë të Vendimit Nr. 211, datë 28.12.2017, Bordi i ERE-s vendosi "Fillimin e procedurave për shqyrtimin e aplikimit të OSHEE sha për tarifën e shërbimit të shpërndarjes së energjisë elektrike sipas nivelit të tensionit dhe lënien në fuqi të çmimeve me pakicë për klientët që shërbehen nga furnizuesi i shërbimit universal për vitin 2018".

Aplikimi i OSHEE sha nepermjet shkresës nr. 26933 Prot, dt.14.12.2017, u bë ne pergjigje te kerkeses per informacion nga ana e ERE-s me shkresat nr. 699 date 30.10.2017 dhe nr. 699/1 date 11.12.2017 ne lidhje me realizimin e treguesve teknik, ekonomik e financiare per vitin 2017 dhe parashikimin e tyre per vitin 2018.

Ne zbatim te "Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s" miratuar me Vendimin Nr. 96, datë 17.06.2016 të Bordit të ERE-s, pergjate procesit te shqyrtimit te ketij aplikimi jane kryer nje sere veprimesh procedurale per te konkluduar për tarifën e shërbimit të shpërndarjes së energjisë elektrike sipas nivelit të tensionit për vitin 2018.

Ne u njohem gjate misionit me nje sere shkresash ndermjet ERE-s, OSHEE dhe MIE ne ndjekje dhe zbatim te procedurave te percaktuara ne Legjislacion dhe rregulloret me synim percaktimin mbi baza shkencore te tarifave te shërbimit të shpërndarjes së energjisë elektrike sipas nivelit të tensionit.

Në këto kushte per ERE-n rezultoi e nevojshme të rishikohen këto tarifa mbi bazën e të ardhurave të realizuara për periudhat paraardhëse, gjë e cila synon ti shërbejë një analize sa më realiste në përcaktimin e tarifave të drejta për periudhën në vijim.

Bordi i ERE-s, me vendimin Nr. 190, datë 30.08.2018 vendosi:

1. Lënien në fuqi të Vendimit Nr.52, datë 06.04.2017 "Mbi lënien në fuqi të Vendimit nr. 190 datë 22.12.2016, të Bordit të ERE-s" për tarifën e shërbimit të shpërndarjes si vijon:
 - Tarifa e shërbimit të shpërndarjes në nivelin e tensionit 35 kV 1.5 Lekë/kWh
 - Tarifa e shërbimit të shpërndarjes në nivelin e tensionit 20 kV 3.9 Lekë/kWh
 - Tarifa mesatare e shërbimit të shpërndarjes 4.79 Lekë/kWh
2. Rishikimin e të ardhurave të kërkuara të Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes në periudhat pasardhëse për vlerësimin e të ardhurave të kërkuara për vitin 2018.
3. Lënien në fuqi për vitin 2018, të pikave 3, 4 dhe 5 të Vendimit të Bordit te ERE-s, nr.211, datë 28.12.2017 "Mbi fillimin e procedurës për shqyrtimin e aplikimit të OSHEE sha, për tarifën e shërbimit të shpërndarjes së energjisë elektrike sipas nivelit të tensionit dhe lënies në fuqi të çmimeve me pakicë për klientët që shërbehen nga furnizuesi i shërbimit universal për vitin 2018".

Mbi procedurat per miratimin e çmimeve te shitjes se energjise elektrike nga Furnizuesi i Mundesise se Fundit.

ERE me miratimin e Vendimit nr. 201, datë 04.12.2017 dhe rishikuar me Vendimin 144, datë 25.06.2018 të Bordit të ERE-s, përcaktoi çmimin e shitjes së energjisë elektrike të furnizimit nga

Furnizuesi i Mundësisë së Fundit (FMF) për klientët e lidhur në nivelin e tensionit 35 kV për çdo muaj të vitit 2018.

Gjatë vitit 2018 u evidentuan një sërë problematikash në llogaritjen e çmimi të Furnizuesit të Mundësisë së Fundit si mungesa e evidentimit nga OSHEE sha e shpenzimeve operative dhe kostove për disbalancat e shkaktuara për këtë kategori klientësh. Ne keto kushte u pa e nevojshme rishikimi i "Metodologjisë së përcaktimit çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga furnizuesi i mundësisë së fundit" miratuar me Vendimin e Bordit të ERE-s nr. 201, datë 04.12.2017 me ane të Vendimit nr. 144, datë 25.06.2018. Ndryshimi i metodologjisë në përcaktimin e çmimit konsistoi në marjen parasysh të kostove administrative dhe kthimin e riskut.

ERE vendosi që çmimi prej 9.5 lekë/kWh për klientët e FSHU të lidhur në 35 kV sipas Vendimit Nr.148 datë 26.12.2014, të përfaqësojë një kufi dysheme për përcaktimin e çmimit të klienteve të FMF, në rastet kur nga përlogaritjet sipas formulës së Metodologjisë së përcaktimit të çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga FMF rezulton një vlerë më e ulët se 9.5 lekë/kWh. Ndryshimet në metodologji ju nënshtruan një procesi konsultativ me OSHEE sha.

I gjithë ky proces është zhvilluar konform Legjislacionit dhe rregulloreve për procedurat e ERE-s.

Mbi procedurat për miratimin e tarifës së transmetimit të gazit natyror

Bordi i ERE me vendimin nr. 178, datë 08.11.2017, ka miratuar Metodologjinë e llogaritjes së tarifave të rrjetit të transmetimit dhe shpërndarjes së gazit natyror, në zbatim të së cilës miratohet tarifa përfundimtare e transmetimit të gazit natyror.

Gjate misionit në u njohem me procedurat për zbatimin e kesaj tarife, e cila për shkak të mbarimit të afatit të kontratës së transmetimit të gazit midis Shoqërive Albetrol sha dhe Albgaz sha me 05.01.2018, u kerkua dhe miratua nga Bordi i ERE-s vendimi nr. 14, datë 10.01.2018 i cili vendosi:

1. Lëniën në fuqi të vendimit të Bordit të ERE-s nr. 90, datë 07.06.2017 "Mbi miratimin e tarifës së përkohshme të transmetimit të gazit natyror nga shoqëria "Albgaz" sha, deri në datë 31.03.2018.
2. Miratimin e kërkesës së shoqërisë Albgaz sha, për ndryshimin e nenit 4 të kontratës së shërbimit të transmetimit të gazit natyror ndërmjet shoqërisë Albgaz sha dhe Albetrol sha me nr. 55/l Prot. i Albgaz, datë 05.07.2017 dhe nr. 4608 Prot. i Albetrol, datë 06.07.2017, miratuar me vendimin e Bordit të ERE nr. 199, Datë 24.11.2017 duke shtyre afatin e kësaj kontrate deri në 31.03.2018.

ERE ndoqi hapat proceduriale për përcaktimin e tarifave të transmetimit të gazit, nëpërmjet publikimeve në media, seancave degjimore midis paleve të interesuara, analizave të treguesve teknik dhe ekonomik me shoqërinë Albgaz sha, etj dhe konkludoi: Bordi i ERE me Vendimin Nr. 97, datë 23.04.2018 miratoi tarifën e transmetimit të gazit natyror nga shoqëria Albgaz sha, për vitin 2018 prej 28 lekë/m³ ose 2.6457 lekë/kWh.

Shoqëria Albgaz sha kerkoi interpretim të zbatimit të tarifës së re, pasi me vendimet e mëparshme ishte lene tarifa e perkoheshme prej 25 lekë/m³ deri me 31.03.2018, nderkohe që tarifa e miratuar fillonte zbatimin me 01.01.2018.

Në mbështetje të Nenit 17, gërma "e" e Ligjit Nr.102/2015 "Për Sektorin e Gazit Natyror", i cili parashikon se kur tarifën e miratuar rezultojnë të ndryshme nga ato të përkohshme, ERE vendos masat e përshtatshme kompensuese.

Bordi i ERE, me vendimin Nr. 179, datë 20.08.2018 vendosi: "Miratimin e tarifës së transmetimit të gazit natyror nga shoqëria Albgaz sha, për vitin 2018 prej 28 lekë/m³ ose 2.6457 lekë/kWh, duke filluar nga data 01.01.2018"

Mbi fillimin e procedurave për përcaktimin e çmimit të blerjes së energjisë elektrike të prodhuar nga burimet e vogla të rinovueshme nga dielli me fuqi te instaluar deri 2MW dhe era me fuqi te instaluar deri ne 3MW për vitin 2018

Prodhimi i energjise nga burimet e vogla të rinovueshme nga dielli me fuqi te instaluar deri 2MW dhe era me fuqi te instaluar deri ne 3MW, eshte nje fushe e re qe po gjen zbatim keto vitet e fundit ne vendin tone. Ne keto kushte, VKM nr.369, datë 26.04.2017, "Për miratimin e metodologjisë për përcaktimin e çmimit të blerjes së energjisë elektrike të prodhuar nga burimet e vogla të rinovueshme nga dielli dhe era", në pikën 2 të tij, ngarkon ERE-n me miratimin e çmimit të blerjes së energjisë elektrike të prodhuar nga burimet e vogla të rinovueshme nga dielli dhe era, në përputhje me çmimin e mesatarizuar, sipas parashikimeve të kësaj metodologjie.

Bordi i ERE-s, me Vendimin Nr. 205, Datë 13.09.2018 vendosi: Fillimin e procedurave për përcaktimin e çmimit të blerjes së energjisë elektrike të prodhuar nga burimet e vogla të rinovueshme nga dielli me fuqi të instaluar deri 2 MW dhe era me fuqi te instaluar deri 3MW per vitin 2018.

Viti 2018 regjistroi kërkesa dhe licensime te ketyre prodhuesve të cilët kishin marrë aprovimin nga MIE gjatë vitit 2017. Por per shkak te mungeses se informacionit te nevojshem ne lidhje me lejet e miratuara pergjate vitit 2018 nga MIE per impiantet nga teknologjite e diellit me fuqi te instaluar deri ne 2 MW dhe eres deri 3 MW, procesi i miratimit te çmimeve te shitjes se energjise elektrike per keta impiante per vitin 2018 u shty per periudhen ne vazhdim. Kjo ne funksion te marrjes se nje vendimi sa me te drejte, te bazuar ne nje analize te plote dhe te mbeshetur ne te dhena konkrete.

Mbi procedurat në lidhje me shqyrtimin e tarifave dhe çmimeve për vitin 2019

- a. *Procedura per lenien ne fuqi te tarifes se përdorimit të rrjetit të shpërndarjes sipas nivelit të tensionit dhe çmimet me pakicë për klientët fundorë që shërbehen nga furnizuesi i shërbimit universal për vitin 2019.*

Neni 21 i "Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s" percakton se i licencuari në sektorin e energjisë elektrike dhe të gazit natyror, duhet të paraqesë në ERE jo me vonë se data 1 Shtator e vitit aktual, një kërkesë me shkrim të shoqëruar me të gjithë informacionin e kërkuar sipas rregullores dhe metodologjive përkatëse.

Shoqëritë "OSSH" sha dhe "FSHU" sha, Shoqeri te dala nga ndarja e OSHEE, nuk paraqiten pranë ERE-s aplikimet përkatëse në përputhje me "Metodologjinë e llogaritjes së tarifave të Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes së Energjisë Elektrike".

Nje praktike e plote procedurale eshte zhvilluar midis institucioneve dhe per sa më sipër Bordi i ERE me Vendimin Nr. 268, Datë 21.12.2018 vendosi:

1. Të lërë në fuqi pikën 1 dhe pikën 3 të Vendimit te Bordit të ERE-s nr. 190, datë 30.08.2018, "Mbi shqyrtimin e aplikimit të shoqërisë "OSHEE" sha për tarifat e shërbimit të shpërndarjes së energjisë elektrike sipas nivelit të tensionit dhe lënien në fuqi

të çmimeve me pakicë për klientët që shërbehen nga Furnizuesi i Shërbimit Universal për vitin 2018” sipas tabelës më poshtë:

TIP I AKTIVITETIT	NR. I VENDIMIT	TARIFATE MIRATUARA
Tarifa e shërbimit të shpërndarjes në nivelin e tensionit 35 kV	Nr. 52, Datë 06.04.2017	1.5 Lekë/Kwh
Tarifa e shërbimit të shpërndarjes në nivelin e tensionit 20 kV	Nr. 52, Datë 06.04.2017	3.9 Lekë/Kwh
Tarifa mesatare e shërbimit të shpërndarjes	Nr. 52, Datë 06.04.2017	4.79 Lekë/Kwh
Çmimi i shitjes për Klientët në 20 kV *	Nr. 52, Datë 06.04.2017	11 Lekë/Kwh Në Përkrahje 12.65 Lekë/Kwh
Çmimi i shitjes për Klientët në 10/6 kV *	Nr. 52, Datë 06.04.2017	11 Lekë/Kwh Në Përkrahje 12.65 Lekë/Kwh
* Miratimi i çmimit për klientët që nuk arrijnë të sigurojnë furnizimin në orë për shkak të pabarazimit objektiv të operimit të sistemit të përhapjes në VIKOR nr. 449, datë 15.04.2014, kushtet e mundësive të shërbimit të shërbimit universal të furnizimit me energji elektrike.		
Çmimi i shitjes për Konsumtorët e lidhur në TM dhe me matës në TU	Nr. 52, Datë 06.04.2017	12.4 Lekë/Kwh Në Përkrahje 14.3 Lekë/Kwh
Çmimet e shitjes me pakicë për klientët fundor	Nr. 52, Datë 06.04.2017	*Çmimet paraqiten në tabelën më poshtë
TARIFAT E SHËRBIMEVE TË SHITJES ME PAKICË TË ENERGJISË ELEKTRIKE PËR KLIENTËT FUNDOR		
Niveli i tensionit	Çmimi (Lekë/kWh)	Çmimi pikë (Lekë/kWh)
Furra buke dhe prodhim mielli në 10/6 kV	7.1	8.17
Klientë në 0.4 kV	14	16.1
Furra buke dhe prodhim mielli në 0.4 kV	7.6	8.74
Familjarë	9.5	
Tarifa për konsumin e energjisë elektrike në ambientet e përbushkëta (ndërcim shkollë, pompe, ashenzor)	9.5	
Tarifë fikse e shërbimit për testimin "zero" (Lekë/Muaj)		200
* Çmimi i energjisë reaktive është sa 15% e çmimit të energjisë aktive.		
* Orari pikë gjatë të cilit do të aplikohet tarifa për energjinë e konsumuar në pikë është :		
Për periudhën 1 Nëntor - 31 Mars nga ora 18:00 deri në 22:00		
Për periudhën 1 Prill - 31 Tetor nga ora 19:00 deri në 23:00		

Barimi ERE

2. Rishikimin e të ardhurave të kërkuara të Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes dhe Furnizuesit të Shërbimit Universal në periudhat pasardhëse, për vlerësimin e të ardhurave të kërkuara për vitin 2019.

3. Nëse do të ketë efekte në të ardhurat e kërkuara të shoqërisë "OSHEE" sh.a. do të bëhet përditësimi dhe kompensimi i tyre sipas përcaktimeve të nenit 20, pika "c" e Ligjit nr.43/2015, "Për Sektorin e Energjisë Elektrike", i ndryshuar.

b. *Procedura e miratimit të tarifës së shërbimit të transmetimit të energjisë elektrike nga OST sha për vitin 2019*

Në zbatim të "Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s", përgjatë procesit të shqyrtimit të kërkesës së OST sha u kryen veprimet e nevojshme procedurale për të siguruar transparencën nëpërmjet publikimeve dhe seancave dëgjimore si dhe marrjen e opinioneve nga palët e interesuara.

Shoqëria OST sha, e licensuar për veprimtarinë e transmetimit të energjisë elektrike, paraqiti aplikimin për tarifën e shërbimit të transmetimit të energjisë elektrike për vitin 2019 me shkresën nr. 6879 Prot, datë, 04.10.2018. ERE në kuadër të shqyrtimit të këtij aplikimi zhvilloi një monitorim pranë kësaj shoqërie në lidhje me shpenzimet operative të realizuara për vitet 2017 dhe 2018.

Pas gjithë procedurave të nevojshme të takimeve, analizave për llogaritjen e të ardhurave dhe kostove, me pranimin nga OST sha të sasisë së energjisë për tu transmetuar në vitin 2019 prej 7,158GWh, Bordi i ERE-s me Vendimin Nr. 266, datë 21.12.2018 miratoi tarifën e shërbimit të transmetimit të energjisë elektrike prej 0,75 Lekë/kWh për vitin 2019.

c. Prodhuesit me përparësi të energjisë elektrike dhe impakti i tyre

Prodhimi i energjisë elektrike nga prodhuesit me përparësi të energjisë elektrike (HEC-et me fuqi deri në 15 MW) në vitin 2018, për shkak të kushteve shumë të favorshme hidrike pati një rritje të konsiderueshme prej rreth 61% krahasuar me vitin paraardhës. Futja në operim e 11 centraleve të rinj ndikoi gjithashtu në këtë prodhim të rritur. Ky prodhim i lartë ndikoi në rritjen e të ardhurave nga shitja e energjisë për prodhuesit me përparësi të cilat ishin 80% më të larta krahasuar me vitin 2017. Në rritjen e të ardhurave për prodhuesit me përparësi ndikoi edhe çmimi i blerjes të energjisë së prodhuar nga këta gjenerues për vitin 2018 i cili ishte 15% më i lartë se ai i vitit paraardhës.

Në vitin 2018 energjia elektrike e prodhuar nga Prodhuesit me Përparësi deri 15 MW dhe HEC-Ashta zinte rreth 22% të konsumit kombëtar vjetor të energjisë elektrike.

Shpenzimet e OSHEE sha për blerjen e energjisë elektrike nga prodhuesit me përparësi dhe Hec-Ashta në vitin 2018 përbënin rreth 50.2% të shpenzimeve totale për blerjen e energjisë elektrike nga 22.5% që ishin në periudhën paraardhëse.

U konstatua se sasia e blerë nga OSHEE sha nga këta prodhues (1,696 GWh) i tejkaloi nevojat për mbulimin e humbjeve prej 1,538 GWh sikurse parashikuar në VKM 244 datë 30.03.2016. Diferenca prej 158 GWh ka kaluar për mbulimin e kërkesës për Klientet e Furnizimit Universal. Ky fakt përforcon nevojën e rregullimeve ligjore për të dhënë zgjidhje problematikës së akomodimit në treg të sasisë së energjisë elektrike nga burimet e rinovueshme (RES), që rezultojnë përtej nevojave për mbulimin e humbjeve në rrjetin e shpërndarjes të Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes.

Për ERE-n si ent rregullator dhe gjithë Operatorët e Tregut sfida mbetet gjetja e rugeve për nxitjen e investimeve eficiente, për mundësinë e daljes së tyre në tregun e parregulluar si dhe shtrirjen e kontributit për mbështetjen e prodhimit të energjisë nga burimet e rinovueshme tek të gjithë klientet fundorë.

Nisur nga rritja e aktivitetit të kësaj Drejtorie, bazuar në zhvillimet e reja të sektorit të energjitikës dhe gazit, Ne kemi sugjeruar ngritjen e një sektori të veçantë me synimin e analizës dhe përcaktimit të tarifave për prodhimin e energjisë nga burimet jo hidrike.

d. Procedurat per lënien në fuqi të vendimit të Bordit të ERE-s nr. 19, datë 19.01.2018 mbi çmimin vjetor të blerjes së energjisë elektrike, që do t'u paguhet prodhuesve ekzistues me përparësi të energjisë elektrike për vitin 2018.

VKM nr. 687, datë 22 Nëntor 2017 miratoi "Metodologjinë e përcaktimit të çmimit vjetor të blerjes së energjisë elektrike që do t'u paguhet prodhuesve ekzistues me përparësi". Po kjo VKM përcaktoi gjithashtu edhe kufijtë maksimal dhe minimal të çmimit të blerjes së energjisë elektrike nga prodhuesit ekzistues me përparësi të cilët janë: jo më i ulët se çmimi i miratuar nga ERE për vitin 2016 dhe jo më i lartë se 15% e çmimit të miratuar nga ERE për vitin 2016. Bazuar në këto metodologji, Bordi i ERE-s me vendimin nr. 19 datë 19.01.2018 "Mbi çmimin vjetor të blerjes së energjisë elektrike, që do t'u paguhet prodhuesve ekzistues me përparësi për vitin 2018", miratoi çmimin 8.5652 lekë/kWh, dhe deri në publikimin e raportit vjetor nga HUPEX, Bordit të ERE-s me Vendimin Nr. 267, datë 21.12.2018 vendosi të lërë në fuqi Vendimin nr. 19 datë 19.01.2018, "Mbi çmimin vjetor të blerjes së energjisë elektrike, që do t'u paguhet prodhuesve ekzistues me përparësi për vitin 2018"

e. Procedurat për çmimin e blerjes së energjisë elektrike nga prodhuesit ekzistues me përparësi për vitin 2019

Në zbatim të "Metodologjisë së përcaktimit të çmimit vjetor të blerjes së energjisë elektrike që do t'u paguhet prodhuesve ekzistues me përparësi" të miratuar me VKM Nr. 687, datë 22.11.2017, ERE përcaktoi çmimin përkatës menjëherë pas publikimit të raportit vjetor të Bursës së Energjisë së Hungarisë (HUPEX) për vitin 2018.

Çmimi prej 8.4582 Lekë/kWh i cili rezultoi nga zbatimi i formulës perlllogaritese të cituar në metodologji, ndodhej brenda kufijve minimal e maksimal të përcaktuar në paragrafet 2.ç dhe 2.d, të VKM-së Nr. 667, datë 22.11.2017.

Përsa më sipër, Bordi i ERE-s, me Vendimin Nr. 8, datë 17.01.2019 miratoi çmimin vjetor prej 8.4582 Lekë Lekë/kWh që do t'u paguhet prodhuesve ekzistues me përparësi për vitin 2019.

f. Procedurat mbi miratimin e tarifës së transmetimit të gazit natyror nga shoqëria Albgaz sh.a. për vitin 2019.

Bazuar në rregulloren procedurale të ERE-s, është konstatuar se Shoqëria Albgaz sh.a. nuk ka paraqitur aplikim për rishikimin e tarifës së transmetimit për periudhën pasardhëse rregullatore të vitit 2019, në përputhje me "Metodologjinë për llogaritjen e tarifave të përdorimit të rrjetit të transmetimit dhe shpërndarjes së gazit natyror".

Shoqëria Albgaz sha nuk kishte paraqitur aplikimin për planin e investimeve për vitin 2019. Mungesa e vlerës së investimeve për vitin 2019, si komponent i rëndësishëm i llogaritjes së tarifës bënte të pamundur llogaritjen e të ardhurave të kërkuara dhe përcaktimin e tarifës së transmetimit të gazit natyror për vitin 2019.

Në këto kushte Bordi i ERE, me Vendimin Nr. 269, Datë 21.12.2018, vendosi për shtyrjen deri më datë 31.03.2019 të fuqisë juridike të Vendimit të Bordit të ERE-s nr. 97, datë 23.04.2018 "Mbi miratimin e tarifës së transmetimit të gazit natyror nga shoqëria Albgaz sha, për vitin 2018".

Lidhur me metodiken e planifikimit të pagesave rregullatore, sugjerojmë respektimin e bazes ligjore për afatet e përcaktuara në ligj si dhe përdorimin e penaliteteve në rastet e moszbatimit të dy ligjeve kryesore 43/2015 dhe 102/2015.

➤ **Drejtoria e Burimeve Njerëzore, Administrimit, Finances dhe Mardhenieve me jashte të ERE-s**

Kjo Drejtori ka këtë strukture të miratuar:

- Specialisti i Finances dhe Protokoll Arkives,
- Sektori i mardhenieve me jashte,
- Specialisti i IT-se dhe Sherbimit të Mardhenieveme jashte.

Drejtoria e Burimeve Njerëzore, Administrimit, Financës dhe Marrëdhënieve me Jashtë mbulon veprimtarinë financiare të ERE-s dhe mban përgjegjësi të plotë për të gjitha problemet që kanë të bëjnë me administrimin, si dhe marrëdhëniet me jashtë, konform legjislacionit të shtetit shqiptar. Në bashkëpunim me drejtoritë e tjera përgatit projekt-buxhetin për miratim, kontrollon dhe evidenton shpenzimet e kryera, fondet e përdorura për investime, dhe blerjet e vogla. Merr masa dhe përgjigjet për krijimin e kushteve të nevojshme të punës për personelin teknik dhe Bordin e Komisionerëve. Mbi bazën e buxhetit të miratuar për vitin aktual, kalkulon dhe ndjek pagesat e rregullimit nga të licënsuarit dhe mbi bazën e analizave financiare bën kompensimin e detyrimeve nëse është e domosdoshme. Përgatit dhënie e llogarisë vjetore për institucionin, si pjesë e raportit vjetor të ERE-s. Gjithashtu kjo drejtori mbulon programimin dhe zhvillimin e burimeve njerëzore, si dhe të marrëdhënieve me jashtë duke respektuar legjislacionin në fuqi.

❖ **Mbi administrimin e Burimeve njerëzore**

Bazuar ne Ligjin Nr. 43/2015 "Per Sektorin e Energjisë Elektrike" Neni 11, Pika 1, emerimi i Kryetarit dhe anetareve të bordit behet nga Kuvendi i Shqipërisë. Nderkohe sipas pikes 7 të po ketij neni, Bordi përcakton strukturën organizative të ERE-s dhe numrin e punonjësve, pagën dhe trajtimet financiare të kryetarit, të anëtarëve të bordit, si dhe të personelit teknik. Në përcaktimin e masës së pagës dhe trajtimeve financiare apo jofinanciare të personelit teknik, bordi merr parasysh kushtet e tregut dhe nivelin e pagave në shoqëritë që kontrollohen në sektorin që mbulon.

Sipas pershkrimit të mesipërm, Bordi ka kopetencën për miratimin e strukturës organizative dhe numrit të punonjesve. *Por, panvaresisht te drejtes qe i jep Ligji i mesiperm, ERE ka mbetur nen respektimin dhe percaktimet e Ligjit Nr. 152/2015 "Per nepunesin Civil" dhe Vendimit Nr.181, datë 05.05.2008 të Kuvendit të Shqipërisë mbi percaktimin e organikes së ERE-s.*

Viti 2018 ka sjelle risi ne kete fushe, qe ne zbatim te Ligjit Nr.43/2015 "Per Sektorin e Energjisë Elektrike" ERE *eshte ne proces konsultimi me USAID* per hartimin e rregullores per percaktimin e struktures organizative te ERE-s dhe numrin e punonjësve, pagën dhe trajtimet financiare të kryetarit, të anëtarëve të bordit, si dhe të personelit teknik, si dhe Rregullorja per menyren e përzgjidhjes, emërimit, ngritjes në detyrë dhe largimit nga detyra te personelit teknik.

Gjate vitit 2018 ERE ka patur një strukture të miratuar prej 32 vetash dhe një personel mbeshettes dhe sherbimi me date 31 dhjetor 2018 prej 10 vetash. Personeli prej 32 vetash aktualisht gezon statusin e nepunesit civil sipas Ligjit Nr. 152/2015 "Per nepunesin Civil".

ERE- në përcaktimin e pagave është bazuar në një fushë të gjere legjislacioni e cila ka patur parasysh se personeli i saj trajtohet në kushtet e nepunesit civil.

Ky Legjislacion i renditur si vijon ka gjetur zbatim edhe ne vitin 2018:

Auditues Ligjor: Ludmilla Paluka license nr. 161
Aida Maloku license nr.55

23

- Ligji nr. 9584, datë 11.07.2006, "Për pagat shpërblimet dhe strukturat e institucioneve kushtetuese dhe të institucioneve të tjera të pavarura të krijuara me ligj", i perditesuar me Ligjin nr. 9845, datë 17.12.2007, Vendim i GJK 9/2007, Ligj nr.115/2013, Ligj nr. 58/2014 dhe Ligji nr. 16/2015.
- Vendimi nr. 589 i Këshillit të Ministrave, datë 17.07.2013, për disa ndryshime në vendimin nr. 545, dt 11.08.2011 "Për miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të nëpunësve civil/nëpunësve, zëvendësministrit dhe nëpunësve të kabineteve, në kryeministri, aparatet e ministrive të linjës, administratën e presidentit, kuvendit, komisionit qendror të zgjedhjeve, prokurorinë e përgjithshme, gjykatën e lartë, disa institucione të pavarura, institucionet në varësi të këshillit të ministrave, kryeministrit, institucionet në varësi të ministrive të linjës dhe administratën e prefektit".
- Vendimin nr. 717, datë 23.06.2009 të këshillit të ministrave "Për pagat e punonjësve mbështetës të institucioneve buxhetore dhe të nëpunësve të disa institucioneve buxhetore" të ndryshuar me VKM nr.621, date 8.07.2010, VKM nr.551, date 11.08.2011, VKM nr.690, date 9.10.2012, VKM nr.610, date 24.07.2013, VKM nr. 859, date 21.10.2015, VKM nr. 202, date 15.03.2017.
- VKM nr. 187, datë 08.03.2017 "Për miratimin e strukturës dhe nivelet e pagave të nëpunësve civil/nëpunësve, zvendësministrit dhe nëpunësve të kabineteve, në Kryeministri, aparatet e ministrive të linjës, administratën e Presidentit, Kuvendit, Komisionit Qëndror të Zgjedhjeve, Gjykatën e Lartë, Prokurorinë e Përgjithshme, disa institucione të pavarura, institucionet në varësi të Kryeministrit, institucionet në varësi të ministrave të linjës dhe administratën e Prefektit".
- VKM nr. 524, datë 16.08.2012 "Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 545, datë 11.08.2011 të Këshillit të Ministrave "Për miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të nëpunësve civil/nëpunësve, zëvendësministrit dhe nëpunësve të kabineteve në Kryeministri, aparatet e ministrive të linjës, administratën e Presidentit, Kuvendit, Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, Prokurorinë e Përgjithshme, disa institucione të pavarura, institucionet në varësi të Kryeministrit, institucionet në varësi të ministrave të linjës dhe administratën e prefektit" të ndryshuar, Lidhja nr. 2, Vlera e pagës së grupit për grupet e diplomave të arsimit universitar.
- Ligji nr. 9741, datë 21.05.2007 "Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë i ndryshuar me Ligjet nr. 9832, datë 12.11.2007, nr. 10307, datë 22.07.2010, neni 26 ciklet dhe titujt e studimeve universitare dhe neni 99/1 dhe 99/2 .
- Vendimi nr. 475, datë 13.07.2007 "Për miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të nëpunësve civilë, zëvendësministrit dhe nëpunësve të kabineteve, në kryeministri, aparatet e ministrive të linjës, administratës së presidentit, kuvendit dhe komisionit qendror të zgjedhjeve".
- Udhëzimi nr. 1, datë 18.04.2008 për "Zbatimin e vendimeve nr. 475, datë 13.07.2007 i ndryshuar nr. 476, datë 18.07.2007 i ndryshuar dhe nr. 478, datë 18.07.2007 i ndryshuar të Këshillit të Ministrave" pika 12.
- Udhëzimi nr. 01, datë 16.03.2012 për Zbatimin e vendimit nr. 545, datë 11.08.2011 të Këshillit të Ministrave.
- Vendim nr. 77, datë 28.01.2015 "Për kontributet e detyrueshme dhe përfitimet nga sistemi i sigurimeve shoqërore dhe sigurimi i kujdesit shëndetësor".

- Vendim nr. 809, datë 26.12.2018 "Për përcaktimin e pagës minimale në shkallë vendi", pika 1 "Paga bazë minimale mujore për punonjësit në shkallë vendi, që është e detyrueshme të zbatohet nga çdo person juridik a fizik, vendas ose i huaj, të jetë 26 000 lekë."
- Udhëzim i Ministrisë së Financave nr. 23, datë 09.12.2014 "Për mbledhjen e kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore", kontributet në përqindje në tabelën sipas pikës 10.3.
- VKM nr. 77, datë 28.01.2015 "Për kontributet e detyrueshme dhe përfitimet nga sistemi i sigurimeve shoqërore dhe sigurimi i kujdesit shëndetësor".
- Ligji nr. 9049, datë 10.04.2003 "Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publik" i ndryshuar me ligjin nr.85/2012, datë 18.09.2012 dhe Ligjin nr.45, datë 24.04.2014.

Gjate vitit 2018 është hartuar dhe miratuar me Vendimin Nr. 65, Datë 26.03.2018 "Rregullorja për mbrojtjen e informacionit konfidencial". Kjo Rregullore ka për qëllim të përcaktojë parimet e përgjithshme dhe masat organizative dhe teknike për mbrojtjen, ruajtjen, sigurinë, administrimin dhe asgjësimin e informacionit konfidencial. Ajo përshkruan konceptin dhe llojet e konfidencialitetit, si dhe masat dhe procedurat për identifikimin, përdorimin dhe mbrojtjen e informacionit konfidencial të disponuar nga ERE. Masat e mbrojtjes dhe procedurat për mbrojtjen e informacioneve konfidenciale, të cilat përcaktohen nga kjo rregullore janë të detyrueshme për këdo që përdor informacionin apo dokumenta të klasifikuar konfidencialë.

❖ Administrimi i Burimeve Financiare të ERE-s

Bazuar në Ligjin nr.43/2015 "Per Sektorin e Energjisë Elektrike" neni 17, Ligjin 102/2015 "Per sektorin e gazit natyror" neni 14 Financimi i ERE-s është përcaktuar që "Burimet financiare të ERE-s përbëhen nga pagesat rregullatore dhe pagesat e licencave, të miratuara nga ERE. Drejtoria perkatese, sektori i kontabilitetit mban llogari të plota për shpenzimet e kryera, në përputhje me legjislacionin në fuqi, organizon mbajtjen e një database për të pasqyruar dhe zhvilluar më tej punën e departamentit, përdor programet baze kompjuterike, organizon mbajtjen e kontabilitetit sipas ligjit dhe është përgjegjës për trajtimin kontabël të informacionit që i paraqet Kryetarit, Bordit dhe institucioneve të tjera të interesuara, është përgjegjës për përgatitjen e informacionit financiar zyrtar për arsye publikimi.

Në theksojme si domosdoshmeri te kerkesave bashkekohere perdorimin e programeve kompjuterike per perpunimin e informacionit financiar per te rritur eficensen ne punen e departamentit.

ERE bazuar në metodologjine e miratuar nga Bordi, sipas pikes 4, të nenit të mësipërm llogarit dhe përcakton pagesen rregullatore për çdo Operator të Licensuar. Keta të fundit janë të detyruar të bëjnë pagesen brenda 30 diteve nga data e marjes njoftim, në të kundert duhet të penalizohen sipas nenit 107, të Ligjit nr.43/2015 dhe nenit 106 të Ligjit 102/2015.

Buxheti i ERE-s miratohet nga bordi dhe ERE ka autonomi në përdorimin e buxhetit të tij.

Me vendimin Nr.44, date 27.02.2018 Bordi e ERE-s ka miratuar buxhetin per vitin 2018 me kete strukture

- Shpenzime operative 178.8 milion leke ose 89% te totalit
- Shpenzime per investime 21.2 milion leke ose 11% te totalit

Në fushën e administrimit të burimeve materiale dhe monetare është zbatuar Ligji nr. 9228, datë 29.4.2004 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare", si dhe akte të tjera ligjore e nënligjore.

Kjo Drejtori ka hartuar Pasqyrat Financiare të vitit ushtrimor 2018 së bashku me Shenimet shpjeguese të cilat janë pranuar dhe firmosur nga Kryetari e ERE-s në cilësinë e Administratorit të saj.

Gjithashtu, është kryer inventarizimi i pasurisë që ERE ka në administrim. Inventarizimi i aseteve të institucionit për vitin 2018 u krye sipas Urdhërit nr. 86, datë 31.12.2018 "Mbi ngritjen e komisionit për inventarizimin e aktiveve të ERE-s për vitin 2018".

Struktura e shpenzimevetë realizuara nga ERE-s për vitin 2018, me një vlerë prej 134.8 milion (pa amortizimin) paraqitet si vijon:

- 77% janë përdorur për pagat dhe sigurimet e punonjesve;
- 13% janë përdorur për shpenzime udhetimesh e dietash të personelit;
- 1% janë përdorur për trajnime të personelit;
- 2% janë përdorur për publikime në media e anetaresime
- 7% janë përdorur për blerje dhe shërbime në ndihmë të aktivitetit.

Sa vërehet, në raport me buxhetimin vlera e shpenzimeve operative është me e vogël.

Nuk ka pasur shpenzime për investimet, vlera prej 35.000 leke është e pakonsiderueshme në raport me atë të buxhetuar. Në buxhetin e vitit 2018 ishte parashikuar të investohej në fushën e dixhitalizimit të informacionit, investimi i cili nuk u krye.

Për sa i përket të ardhurave ato përbëhen nga pagesat rregullatore dhe pagesat e licencave të cilat janë llogaritur nga drejtorja e tarifave dhe çmimeve dhe miratuar me Vendim Bordin nr.263, datë 19.12.2018.

Të ardhurat e llogaritura kanë strukturën si vijon:

- Të ardhurat nga tarifat proporcionale të operatoreve të licensuar prej 136,868,000 leke,
- Të ardhura nga tarifat fikse të operatoreve të licensuar prej 6,600,000 leke.

Njohja me këto detyrime të operatoreve të licensuar bëhet nepermjet një shkresë njoftuese nga ana e Drejtorisë së Burimeve Njerëzore, Administrimit, Finances.

Ne sugjerojmë hartimin e një dokumenti faturimi të këtyre të ardhurave me numer serial gjenerues, dokument që do të prezantojë shumën që çdo operator i licensuar është i detyruar të paguaj, duke vendosur edhe afatin kohor të pagesës dhe penalitetet për mos pagesë në kohë sipas ligjit 42/2015 dhe 102/2015.

❖ Prokurimi për blerjet

Kjo Drejtori ka zbatuar afatet kohore në lidhje me kryerjen e prokurimeve të fondeve publike, në përputhje me ligjin e prokurimeve dhe akteve të tjera nën ligjore.

Baza ligjore mbi të cilën zhvillohen procedurat e prokurimit për mallra e shërbime për plotësimin e nevojave të ERE-s është:

- Ligji Nr.9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar,
- Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr. 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik, i ndryshuar,
- Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr.918, datë 29.12.2014 "Për kryerjen e procedurave të prokurimit publik në mënyrë elektronike"

- Udhëzimi i APP-së Nr.1, datë 05.01.2018 “Për hartimin e Regjistrit të parashikimeve të procedurave të prokurimit publik dhe Regjistrit të Realizimeve të procedurave të prokurimit dhe krijimi i tyre në Sistemin e prokurimit elektronik”
- Udhëzimi i APP-së Nr.3, datë 08.01.2018 “Mbi përdorimin e procedurës së prokurimit me vlerë të vogël dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike”.
- Udhëzimi i APP-së Nr.6, datë 16.01.2018 “Për përdorimin e Marrëveshjes Kuadër dhe për zhvillimin e saj me mjete elektronike”.
- Manuali i APP-së Nr.2, datë 06.08.2018 “Për rolin e Administratorit të Sistemit të Autoritetit Kontraktor, për rolin e Nëpunësit të autorizuar të Njësisë së Prokurimit dhe për rolin e anëtarëve të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave në Sistemin e Prokurimit Elektronik”.

si dhe Udhëzime të tjera dhe Rekomandime që nxjerr vazhdimisht Agjencia e Prokurimit Publik për zhvillimin e procedurave të prokurimit.

Gjatë vitit 2018 janë realizuar 36 procedura prokurimi, nga të cilat:

- 24 procedura prokurimi në formë shkresore me vlerë deri në 100.000 lekë pa TVSH për mallra e shërbime me objekt si: Blerje artikuj kancelarie, Blerje shtypshkrime, Blerje letër A4, Blerje ujë i pjshëm, Shërbim dreka/darka zyrtare, Shërbim riparim pajisje elektronike, Blerje artikuj higjienikë, Siguracion TPL për automjetet, Shërbim riparim kondicionerësh etj.
- 5 procedura prokurimi me vlerë të vogël (në formë elektronike) për mallra e shërbime me objekt si: Shërbimi i ruajtjes me roje private; Shërbim interneti, Hostim Web dhe Mail Server; Larje dhe parkim automjete; Blerje bojëra për printera, Siguracion kasko për automjetet e ERE-s.
- 5 procedura prokurimi negociim pa shpallje paraprake (shitesë kontrate në masën 20% të kontratës fillestare) për plotësimin e nevojave të fillim vitit (si Shërbim interneti, Shërbim larje dhe parkim automjete, Shërbim i ruajtjes me roje private; Mirëmbajtje e automjeteve, si dhe Blerje bojëra për printera).
- 1 procedurë Kërkesë për propozim me objekt: Blerje karburanti për automjetet e ERE-s.
- 1 procedurë Kërkesë për propozim (marrëveshje kuadër) me objekt: Shërbimi i ruajtjes me roje private (turni II dhe III).

Veprimtaria ekonomiko-financiare e ERE-s gjatë vitit 2018 është audituar nga një grup audituesish ligjor bazuar në Ligjin nr.10091, datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar” i ndryshuar.

❖ **Sektori i Marrëdhënieve me Jashtë**

Ky sektor kryen detyrat që kanë të bëjnë me veprimtarinë dhe marrëdhëniet që ERE ka me institucionet homologe jashtë vendit, me institucionet ku aderon, si dhe me organizma të ndryshme ndërkombëtare për probleme të caktuara, në përputhje me porositë që merr prej Kryetarit të Bordit të Komisionerëve. Ky sektor drejtohet nga Shefi i Sektorit, i cili raporton në çdo kohë tek Kryetari për realizimin e detyrave të ngarkuara dhe para Bordit.

Specialisti i Informacionit dhe Teknologjisë së Shërbimit të Sektorit të Marrëdhënieve me Jashtë i raporton përgjegjësit të sektorit, merr udhëzime e detyra prej tij, prej Drejtorit të

drejtorisë, Kryetarit të Bordit, kur konsiderohet e arsyeshme nga ky i fundit. Specialisti kryen detyrat instalim dhe mirëmbajtje të rrjetit, përditësimin e faqes elektronike të ERE-s.

Komunikime me Pjesëtarët e Tregut.

Komunikimi me pjesëtarët e tregut të energjisë elektrike është një ndër prioritet e ERE-s, që burojnë nga legjislacioni bazë i sektorit të energjisë elektrike. Në këtë këndvështrim me qëllim ekuilibrimin e interesave të shtetit, të konsumatorëve dhe investitorëve ERE, ka vendosur një bashkëpunim me pjesëtarët e tregut në sektorin e energjisë elektrike për një koordinim sa më të mirë dhe transparent të tregut të energjisë. Konsultimet dhe takimet me operatorët e tregut të energjisë elektrike, përpunimi dhe dhënia në kohë e informacionit të kërkuar nga subjektet e interesuara lidhur me çështjet e tregut të energjisë elektrike, legjislacionit dhe zbatimit të detyrimeve që burojnë prej tij janë pjese e punes se kesaj drejtorie se bashku me drejtorite e tjera.

Informacioni në Faqen Zyrtare të Internetit.

Ashtu sikurse dhe vitet me parë dhe gjatë vitit 2018 ka vijuar puna intesive për përditësimin e faqes zyrtare të internetit të ERE-s, duke ofruar një pasqyrë sa më të plotë e më të saktë të informacioneve dhe shërbimeve të ofruara. Një nga prioritet kryesor ka qënë dhe mbetet azhurnimi sistematik i faqes së Internetit, duke u ofruar të gjithë të interesuarve një informacion të përditësuar mbi legjislacionin primar dhe sekondar në sektorin e energjisë, të gjitha vendimmarrjet e ERE-s, publikimi i akteve nënligjore të miratura dhe ato për të cilat ka filluar procedura e miratimit dhe priten komentet nga palët e treta; regjistrin e të licensuarëve, kushtet e licencimit. Informacion të detajuar për klientët e energjisë elektrike, mbi kontratat e furnizimit me energji elektrike, broshurë informuese mbi të drejtat dhe detyrimet respektive të palëve në tregun energjetik. Gjithashtu në faqen zyrtare vazhdon të sigurohet aksesit dhe plotësimi online i formularit të ankesave nga të gjithë të interesuarit dhe data base i ankesave të trajtuara në ERE dhe përgjigjet e kompanisë "OSHEE" sha, të pasqyruara në menyrë të detajuar.

Gjithashtu, faqja e internetit të ERE-s ka vazhduar të ofrojë informacione mbi legjislacionin primar dhe sekondar në sektor, mbledhjet e Bordit të Komisionerëve, vendimet përkatëse si dhe për veprimtaritë e ERE-s në nivel kombëtar dhe rajonal. Ka vazhduar puna me intensitet për përkthimin në gjuhën Angleze dhe publikimin në faqen zyrtare të ERE-s të të gjitha vendimeve të Bordit si dhe çdo informacion tjetër, i cili lidhet me veprimtarinë e ERE-s.

➤ Drejtoria Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit

Kjo Drejtori ka dy sektore:

1. Sektori i Legjislacionit; Përgjegjes dhe specialist
2. Sektori i Mbrojtjes Konsumatorit dhe Mardhenieve me Publikun dhe specialist.

Drejtoria Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, vepron si përfaqësues ligjor i ERE-s; përgatit vendimet dhe urdhërat e ERE-s në konformitet me legjislacionin që është në fuqi. Përgatit konferenca shtypi, drejton komunikimet zyrtare me publikun; boton në gazetën zyrtare të gjitha vendimet dhe urdhërat e ERE-s. Evidenton në një regjistër të veçante, të gjitha ankesat e paraqitura nga konsumatorët, personat e licensuar dhe institucionet e ndryshme. Në bashkëpunim me drejtoritë, i shqyrton këto ankesa, përgatit përgjigjet në vartësi të zgjidhjeve të mundshme konform ligjit duke respektuar afatet kohore të përcaktuara në të.

✓ **Kuadri Rregullator Sekondar**

Një pjesë e veprimtarisë së kësaj Drejtorie është edhe hartimi i legjislacionit sekondar që përbën edhe kuadrin rregullator në Sektorin e Energjisë Elektrike dhe gazit. Hartimi dhe rishikimi i akteve nënligjore në bashkëpunim me Drejtorite e tjera si dhe me Kryetarin dhe Antaret e Bordit, është bërë në çdo rast duke konsultuar gjerësisht palët e treta që kanë patur interes të drejtëpërdrejtë mbi këto vendimmarrje. Në çdo rast fillimi i procedurave për shqyrtimin e një akti nënligjor nga ana e ERE-s është njoftuar në median e shkruar për ti dhënë mundësi njohjeje publikut me të, por edhe të përcjellë komente apo sugjerime mbi përmbajtjen. Zhvillimi i seancave dëgjimore me prezencën e palëve që kanë shfaqur interes për dokumentat në proces përpunimi nga ERE, të cilat në çdo rast janë bërë publike për palët përmes publikimit të tyre në faqen elektronike të ERE-s, po ashtu edhe finalizimi i procesit të miratimit të një akti, garanton transparencën e vendimmarrjeve të ERE-s përmes mbledhjeve vendimmarrëse të cilat janë të hapura për publikun. Në çdo rast aktet e miratuara nga ERE janë konsultuar me Autoritetin e Konkurrencës, Ministrinë përgjegjëse për energjinë, si dhe me Sekretariatën e Komunitetit të Energjisë. Në miratimin e këtyre akteve është mbajtur në konsideratë opinioni i palëve si më sipër, si një garanci më shumë në plotësimin dhe mbrojtjen shumëplanëshe të interesave të aktorëve të tregut të energjisë elektrike por mbi të gjitha interesave të konsumatorëve.

Vendimmarrjet e ERE-s në plotësim të kudit rregullator sekondar janë:

- Vendim Nr.7, datë 10.01.2018 Mbi miratimin e licencës tip të aktivitetit të shpërndarjes së gazit natyror.
- Vendim Nr.8, datë 10.01.2018 Mbi miratimin e licencës tip të aktivitetit të transmetimit të gazit natyror.
- Vendim Nr.24, datë 30.01.2018 Mbi miratimin e licencës tip të aktivitetit të tregtimit të gazit natyror
- Vendim Nr.25, datë 30.01.2018 Mbi miratimin e licencës tip në aktivitetin e furnizimit të gazit natyror.
- Vendim Nr.161, datë 09.07.2018 Për miratimin e “Rregullores mbi kushtet e përgjithshme të shërbimit të furnizimit me gaz natyror për klientët fundorë”.
- Vendim Nr.168, datë 19. 07.2018 mbi për miratimin e ndryshimeve të propozuara nga TAP AG në metodologjinë e tarifave të TAP AG të miratuar me vendimin e ERE-s nr.127, datë 7.11.2013.
- Vendim Nr.223, datë 16.10.2018 Mbi miratimin e “Kërkesave minimale për zyrtarin e përputhshmërisë, kriteret profesionale si dhe kriteret e tjera përzgjedhëse” dhe miratimin paraprak të zyrtarit të përputhshmërisë së OST të gazit natyror.
- Vendim Nr. 236, datë 02.11.2018 Për një ndryshim në vendimin e bordit të ERE-s, nr. 179, datë 08.11.2017, Mbi certifikimin e shoqërisë “Operatori i Kombinuar i Gazit Natyror” ALBGAS sha.
- Vendim Nr.15, datë 10.01.2018 Mbi miratimin e kushteve të përgjithshme të kontratës së shërbimit universal të furnizimit me energji elektrike për klientët fundorë
- Vendim Nr.16, datë 10.01.2018 Mbi miratimin e rregullave për përcaktimin e formatit të të dhënave dhe procedurën për aksesin e furnizuesve ndaj të dhënave të operatorit të shpërndarjes së energjisë elektrike.

- Vendim Nr.18, datë 10.01.2018 Mbi miratimin e “Rregullores së procedurave të paraqitjes së planit të investimeve nga operatorët e transmetimit dhe shpërndarjes së gazit natyror”.
- Vendim Nr.65, datë 26.03.2018 Mbi miratimin e rregullores për mbrojtjen e informacionit konfidencial.
- Vendim Nr.80, datë 06.04.2018 Mbi miratimin e rregullave operationale për furnizuesin e mundësisë së fundit të gazit natyror.
- Vendim Nr.81, datë 06.04.2018 Mbi miratimin e rregullave për sigurimin e aksesit të palëve të treta në sistemin e transmetimit dhe transparencën në sektorin e gazit natyror.
- Vendim Nr.103, datë 30.04.2018 Mbi miratimin e programit të pajtueshmërisë së OST sha.
- Vendim Nr.14, datë 10.01.2018 mbi shtyrjen e afatit të tarifës së përkohshme të transmetimit të gazit natyror nga shoqëria “ALBGAS” sha, miratuar me Vendimin e Bordit të ERE-s Nr. 90, datë 07.06.2017 si dhe kontratës së transmetimit të gazit natyror të lidhur mes ALBPETROL sha dhe ALBGAS sha.
- Vendimin Nr.19, datë 19.01.2018 Mbi çmimin vjetor të blerjes së energjisë elektrike, që do t’u paguhet prodhuesve ekzistues me përparësi të energjisë elektrike për vitin 2018.
- Vendim Nr.22, datë 30.01.2018 Mbi ankimin e shoqërisë “OST” sha në lidhje me Vendimin e bordit të ERE Nr.210, datë 28.12.2017 “Për miratimin e tarifës së shërbimit të transmetimit të energjisë elektrike nga OST sha për vitin 2018”.
- Vendim Nr.110, datë 14.05.2018 mbi zgjidhjen e mosmarrëveshjes ndërmjet KESH sha dhe OST sha, lidhur me korrigjimet e faturave për shërbimin e balancimit sipas parashikimeve të akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi dhe përllogaritjeve nga OST sha të rakorduara dhe të pranuar nga palët përgjegjëse për periudhën 1 korrik 2016-31 dhjetor 2017.
- Vendim Nr.148, datë 28.06.2018 Mbi kërkesën e OSHEE sha për kontestimin e Vendimit Nr.110, datë, 14.05.2018, të Bordit të ERE-s, lidhur me korrigjimin e faturave për shërbimin e balancimit sipas parashikimeve të akteve ligjore dhe nën ligjore në fuqi dhe përllogaritjeve nga OST sha, të rakorduara dhe të pranuar nga palët përgjegjëse për periudhën 1 korrik 2016-31 dhjetor 2017.
- Vendim Nr.131, datë 07.06.2018 Mbi kërkesën e KESH sha për rishikimin e Vendimit të Bordit të ERE Nr.98 datë, 30.04.2016, Mbi miratimin e kontratës për shit-blerjen e sasisë së tepërt të energjisë elektrike që rezulton pas përmbushjes së kërkesës së klientëve që përfitojnë nga shërbimi universal, me qëllim mbulimin e humbjeve në rrjetin e shpërndarjes për periudhën kohore 01.01.2018-31.12.2018.
- Vendim Nr.59, datë 15.03.2018 Mbi miratimin e kërkesës së OST sha për shtyrjen e afatit të pikës 2 të Vendimit të ERE Nr. 43 datë 15.03.2017 Mbi miratimin përfundimtar të certifikimit të operatorit të sistemit të transmetimit të energjisë elektrike OST sha në përputhje me nenin 54, pika 6, të Ligjit Nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike” dhe nenin 9, pika 6, të direktivës 72/2009 mbas marrjes së opinionit të Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë.
- Vendim Nr.75, datë 26.03.2018 Mbi detyrimin e shoqërisë OSHEE “Kontratës tip për shit/bleje të energjisë elektrike ndërmjet OSHEE sha dhe prodhuesve me përparësi të

energjisë elektrike" të miratuar me Vendimin Nr.101, datë 23.06.2016 të Bordit të ERE-s, i ndryshuar me Vendimin Nr.147, datë 30.09.2016 të Bordit të ERE-s.

- Vendim Nr.127, datë 04.06.2018 "Mbi miratimin e Kodit të rrjetit për kërkesat e lidhjes me rrjetin të sistemeve me tension të lartë me rryme të vazhduar dhe parqet me module të energjisë të lidhur me rrymë të vazhduar (HVDC)"; Nr.128, datë 04.06.2018 "Mbi miratimin e Kodit të rrjetit për ngarkesën"; Nr.129, datë 04.06.2018 "Mbi miratimin e Kodit të rrjetit mbi kërkesat për lidhjen me rrjetin e gjeneruesve".
- Vendim Nr.170, datë 03.08.2018 Mbi miratimin e Memorandumit të Mirekuptimit mbi bashkëpunimin e tregjeve ditore të energjisë elektrike mes palëve, Enti Rregullator i Energjisë së Shqipërisë, Zyra e Rregullatorit të Energjisë të Kosovës, OST sha, KOST sha.
- Vendim Nr.183, datë 20.08.2018 Mbi miratimin e licencës së operimit të Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes së energjisë elektrike.
- Vendimet Nr. 188, datë 20.08.2018; Nr.249, datë 11.12.2018; Nr.250, datë 11.12.2018; Nr.251, datë 11.12.2018; Nr.252, datë 11.12.2018; Nr.253, datë 11.12.2018, kanë miratuar Propozime të të gjithë OST-ve në përputhje me Rregulloret e Komisionit Evropian që lidhen me metodologji të modelit të përbashkët të rrjetit, metodologji të ofrimit të të dhënave të gjenerimit dhe ngarkesës, metodologji të analizës së kostopërfitimit si dhe Udhëzuesit përkatës mbi alokimin e kapaciteteve në avancë, mbi operimin e sistemit të transmetimit të energjisë elektrike si dhe amendimet përkatëse.
- Vendim Nr.200, datë 03.09.2018 Mbi miratimin e disa ndryshimeve në "Rregullat për alokimin e kapaciteteve të interkoneksionit".
- Vendim Nr.214, datë 11.10.2018 Mbi miratimin e kodit të rrjetit mbi rregullat e ndërveprimit dhe shkëmbimit të të dhënave. (Sektori i Gazit Natyror)
- Me Vendimet Nr.198, datë 03.09.2018 dhe Nr. 199, datë 03.09.2018, ERE ka licencuar në veprimtarinë e tregimit dhe furnizimit të energjisë elektrike, shoqërinë Furnizuesi i Tregut të Lirë sha (FTL sha).
- Vendim Nr. 246, datë 11.12.2018 Mbi miratimin e "Rregullores mbi kushtet specifike për ndërprerjen e furnizimit me energji elektrike të klientëve në nevojë"
- Vendim Nr. 247, datë 11.12.2018 Mbi miratimin e "Rregullave për kushtet e shërbimit të furnizimit nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit, dhe kushtet kontraktore të furnizimit me energji elektrike".

Drejtoria ka bashkëpunuar me USAID dhe ENC për hartimin:

1. Rregulla për përcaktimin e strukturës organizative të ERE-s dhe numrin e punonjësve, pagën dhe trajtimet financiare të kryetarit, të anëtarëve të bordit, si dhe të personelit teknik. Rregullorja për menyrën e përzgjedhjes, emërimit, ngritjes në detyrë dhe largimit nga detyra të personelit teknik.
2. Rregulla për përcaktimin e kostove nga përdoruesit në lidhje me kushtet e veçanta të pikës së lidhjes. Kushtet teknike për instalimin e një burimi dytësor të furnizimit me energji elektrike për klientët që kërkojnë këtë shërbim, përfshirë edhe kushtet që duhet të përmbushë burimi dytësor, me qëllim që të parandalohen çrregullimet në rrjet.
3. Sistemi i njësuar dhe standard i llogarive për të gjithë të licencuarit që veprojnë në tregun të energjisë elektrike

✓ **Veprimtaria e ERE-s në fushën e Mbrojtjes së Konsumatorit.**

Autoriteti dhe përgjegjësia e ERE-s në drejtim të zbatimit të masave më efektive për garantimin e mbrojtjes së klienteve të energjisë elektrike, zë një vend të veçantë në veprimtarinë e saj në funksion të Ligjit Nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike” i ndryshuar. Veprimtaria e Sektorit të Mbrojtjes së Konsumatorit mbështetet kryesisht në parimet kryesore që konsistojnë në: Trajtimin dhe zgjidhjen e ankesave dhe konflikteve direkte që lindin në marrëdhëniet midis furnizuesit të energjisë elektrike dhe konsumatorëve/klientëve, duke pasur si qëllim: Mbrojtjen e interesave të konsumatorëve/klienteve në aspektin individual, Mbrojtjen e interesave të konsumatorëve/klientëve në tërësi nga abuzimet e aktoreve dominant në tregun e energjisë elektrike, Trajtim të barabartë dhe jodiskriminues të të gjithë klienteve përmes procedurave ligjore e transparente, Monitorimin dhe kontrollin e shërbimeve që ofron i licensuari ndaj konsumatorëve të energjisë elektrike, Sigurimin e nje shërbimi të furnizimit me energji elektrike të pa ndërprerë dhe brenda standardeve të cilësisë së shërbimit.

Proceset gjyqësore ku ERE është në Cilësinë e Palës së Paditur.

ERE ka qënë palë e paditur në 4 procese gjyqësore përgjatë vitit 2018, 3 nga te cilat Gjykata Administrative Tirane ka vendosur rrezimin e padise dhe per njeren pala paditese ka hequr dore nga padia dhe pritet zbardhja e vendimit te Gjykates Tirane.

Proceset gjyqësore ku ERE merre pjese në Cilësinë e Palës së Tretë.

ERE është thërritur në cilësinë e personit të tretë me të cilin palët paditëse kanë të përbashkët çështjen që kanë paraqitur ne gjykatë. Janë 14 procese gjyqësore në të cilat ERE është thërritur për të ndihmuar palët ndërgjyqësore dhe gjykatën në zgjidhjen e konflikteve të cilat në të gjitha rastet janë shqyrtuar më herët administrativisht pranë sektorit për mbrojtjen e konsumatorit në ERE. 10 procese kanë përfunduar gjykimin pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor dhe janë në proces shqyrtimi në Gjykatën e Apelit, ndërsa për 3 procese të tjera vazhdon procesi gjyqësor pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë. Një proces është pezulluar nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Zhvillimi i seancave Dëgjimore në ERE:

Për vitin 2018 shënohen 26 seanca dëgjimore teknike dhe joteknike, të organizuara nga ERE nga të cilat 20 seanca në kuadër të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve midis operatorëve të licencuar në sektorin e energjisë elektrike dhe gazit natyror, dhe 6 seanca diskutimesh me palët e interesuara në kuadër të rishikimit të akteve nënligjore në zbatim të ligjit nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë”.

Prioriteti i ERE-s në zgjidhjen e mosmarrëveshjeve ndërmjet klientëve të energjisë elektrike dhe të licencuarve, vazhdon të mbetet ndër veprimtarite kryesore te saj qe vijon si detyrim i zbatimit të parashikimeve të nenit 24, të Ligjit Nr.43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike” i ndryshuar dhe nenit 98 të Ligjit Nr. 102/2015 “Për Sektorin e Gazit Natyror”.

Edhe gjatë vitit 2018 ka vijuar veprimtaria e ERE-s në drejtim të mbrojtjes së konsumatorit, me hartimin e miratimin e akteve nënligjore në zbatim të Ligjit Nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike” i ndryshuar; Ligjit Nr. 102/2015 “Për Sektorin e Gazit Natyror”. ERE me Vendimin e Bordit Nr. 201, datë 03.09.2018 miratoi “Planin e masave për Operatorin e Shpërndarjes së Energjisë Elektrike (OSHEE) sha, për respektimin e të drejtave të klientëve të furnizimit me energji elektrike”.

Plani i masave, identifikon qartësisht përgjegjësitë e Furnizuesit në kuadër të detyrimit të shërbimit publik të tillë si: E drejta e informimit, aksesit të konsumatorit ndaj shërbimeve, e

drejta për të paraqitur ankesë ndaj shërbimit të ofruar, e drejta e zgjedhjes, përfshirë dhe të drejtën e zgjedhjes së modaliteteve të pagesave, e drejta e zgjedhjes së furnizuesit, e drejta për t'u informuar për çmimet.

ERE do të monitorojë punën e Furnizuesit të Shërbimit Universal kundrejt standardeve të vendosura në aktet rregullatore dhe në përputhje me detyrat sipas këtij plani masash.

Për vitin 2018 janë paraqitur dhe trajtuar 279 ankesa. Përveç ankesave të paraqitura, Sektori i Mbrojtjes së Konsumatorit në zbatim të përgjegjësisë dhe objektivave të tij ka ofruar asistencë dhe në dhënie informacionit, shpjegimeve dhe konsultimeve verbale nepërmjet faqes zyrtare të ERE-s për të gjithë klientët e energjisë elektrike. Objekti i ankesave të paraqitura ka konsistuar në shkeljen e kushteve të përgjithshme të "Kontratës së Shërbimit Universal të Furnizimit me Energji Elektrike për Klientet Fundorë", të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s Nr. 15, datë 10.01.2018 në të cilat përcaktohen detyrimet reciproke të palëve në kontratë. ERE në referencë të Ligjit Nr.43/2015 "Për Sektorin e Energjisë Elektrike" i ndryshuar dhe akteve nënligjore, si: "Kontratës së Shërbimit Universal të Furnizimit me Energji Elektrike për Klientet Fundorë"; "Rregullores për Trajtimin e Ankesave të Paraqitura nga Klientët dhe për Zgjidhjen e Mosmarrëveshjeve midis të Licencuarve në Sektorin e Energjisë Elektrike dhe të Gazit Natyror" dhe "Rregullave për Organizimin, Funksionimin dhe Procedurat e ERE-s, ka trajtuar dhe analizuar ankesat e klientëve të energjisë elektrike duke ia përcjellë shoqërisë "OSHEE" sha, së bashku me udhëzimet përkatëse.

Nga 279 ankesat e paraqitura në ERE konstatohet se ankesat me objekt "mbifaturim" zënë vendin kryesor në trajtimin e ankesave, të ndjekura nga ankesat me objekt "energji e pamatur" dhe "matje jashtë kushteve teknike".

Nga analiza e tyre rezultojnë: 54 ankesa për "energji të pamatur", prej të cilave janë marrë masa për anulimin e 6 prej tyre; 65 ankesa për "mbifaturim" të energjisë elektrike, prej të cilave janë marrë masa për anulimin e 2 prej tyre; 10 ankesa për "faturim aforfe" të energjisë elektrike, prej të cilave janë marrë masa për anulimin e 3 prej tyre; 20 ankesa për "matje jashtë kushteve teknike"; 15 ankesa për vlerë referuse dhe; 14 ankesa për kontratat fiktive, për të cilat nuk ka patur sistemim nga ana e shoqërisë "OSHEE" sha.

ERE ka miratuar rregulloren për kriteret standarte të cilësisë së shërbimit të furnizimit dhe performancës së sigurisë së rrjetit të shpërndarjes së energjisë elektrike me vendimin nr. 181, datë 10.11.2017. Në lidhje me këtë rregullore OSHEE sha, kërkoi shtyrjen e afateve të përcaktuara në këtë rregullore, duke kërkuar një aplikim të përshkallëzuar për të miratuar nivelin e lejuar të kriterëve standarte të performancës në zona të ndryshme.

ERE në konsultë edhe me MIE, me vendimin nr. 271, datë 21.12.2018, vendosi shtyrjen e afateve për një periudhë 6-mujore me kusht që brenda kësaj periudhe kompania të dorëzojë në ERE një studim të detajuar mbi përshkallëzimin e realizimit të parametrave të kërkuara sipas zonave të sipërcituara.

Vendosja në punë e sistemit të ri të faturimit nga shoqëria OSHEE, lehtëson në mënyrë të ndjeshme matjen e energjisë dhe krijon mundësi dhe opsione të reja të nevojshme, duke përfshirë edhe matjen periodike disa mujore.

Rekomandime

Enti Rregullator i Energjisë në bazë të ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike" dhe nr.102/2015, "Për sektorin e gazit natyror", funksion si rregullatori i vetëm dhe i pavarur për mbikëqyrjen e funksionimit të tregut të energjisë elektrike e të gazit natyror, si dhe për ruajtjen e ekuilibrit ndërmjet interesave të konsumatorëve, shtetit dhe sipërmarrësve në këtë sektor. Ndryshimet në kuadrin ligjor të sipërcituar janë reflektuar edhe në kuadrin rregullator nëpërmjet hartimit të akteve nënligjore të nevojshme, duke mbajtur parasysh që këto akte të jenë në përputhje me Paketën e Tretë të Bashkimit Europian në fushën e energjisë e te gazit, për të bërë të mundur krijimin e një tregu konkurrues, eficient, që rrit sigurinë dhe cilësinë e furnizimit me energji elektrike dhe gaz në vend dhe e integron atë në tregun rajonal. Për këtë qëllim ERE ka vendosur një bashkëpunim të ngushtë me Komunitetin e Energjisë, Minsitrinë e Infrastruktues dhe Energjisë, dhe Autoritetin e Konkurrencës lidhur me çështje që kanë të bëjnë me kuadrin rregullator në sektorin e energjisë, si dhe për çështje të tjera të rëndësishme të këtij sektori.

Mbrojtja e konsumatorëve përbën një aspekt shumë të rëndësishëm të punës së Entit Rregullator të Energjisë jo vetëm në drejtim të trajtimit të ankesave të konsumatorëve por edhe në kuadër të sigurimit të shërbimeve që lidhen me furnizimin e klientëve Universal me çmime të drejta që reflektojnë kostot në sistem.

Duke konsideruar zhvillimet e tregut të energjisë dhe rëndësinë e implementimit të ligjeve 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike" dhe nr.102/2015, "Për sektorin e gazit natyror", veprimtaria e ERE-s në vijim duhet të fokusohet në mënyrë të veçantë në drejtim të:

- *Me rolin e rregullatorit në treg, në kushtet e një tregu me orientim liberalizimin e tij, duhet fokusuar në miratimin e tarifave të reja duke i kushtuar vëmendje të veçantë, nga njëra anë, mbrojtjes së konsumatorëve për tarifa dhe çmime sa më të drejta e të përballueshme dhe nga ana tjetër, rritjes së cilësisë së shërbimit dhe performancës së kompanive që operojnë në tregun e energjisë dhe gazit natyror.*
- *Krijimi i një tregu efektiv për të gjithë klientët dhe furnizuesit, në kuadër të liberalizimit të tregut të energjisë elektrike, duke siguruar shërbime të drejta, të sigurt dhe të argumentuara për klientët dhe përdoruesit e sistemit energjetik në vend, si dhe mbështetja e investimeve strategjike dhe teknologjike, të cilat rrisin konkurrencën dhe përmirësojnë nivelin e shërbimeve në tregun e energjisë elektrike dhe te gazit natyror.*
- *Panvarsisht risive që sollli viti 2018 në fushën e prodhimit të energjisë nga burime të tjera si era, dielli, etj, mbetet fokus i rëndësishëm krijimi i kushteve të nevojshme për nxitjen e investimeve për prodhimin e energjisë nga burimet alternative, duke bërë kështu të mundur rritjen e diversifikimit të burimeve të energjisë, rritjen e sigurisë së furnizimit me energji në vend, si dhe uljen e shkallës së lartë të riskut hidrogjik në stabilitetin e prodhimit të energjisë elektrike.*
- *Në kuadër të ushtrimit të kompetencave lidhur me miratimin e planit të investimeve të Operatorëve të rrjetit një vëmendje të veçantë duhet të kushtohet rritjes së investimeve, të cilat kanë ndikim të drejtpërdrejtë në përmirësimin e cilësisë së furnizimit të konsumatorit me energji elektrike.*

- *Mbetet fokus i rëndësishëm në aktivitetin e ERE-s mbrojtja e konsumatorit, lidhur me hartimin dhe përmirësimin e një sërë aktesh nënligjore të sektorit të mbrojtjes së konsumatorit, të cilat në funksion të ligjit të ri të sektorit, i pajisin palët e interesit me të drejta të plotësuara, por edhe i vendosin përpara detyrimeve të reja.*
- *Viti 2018 solli një analizë të hollësishme të treguesve tekniko ekonomik në mënyrë të vecantë të OSHEE sha i ecurisë së arkëtimeve, humbjeve dhe shpenzimeve të investimeve të saj. Monitorimi i vazhdueshëm është një element i rëndësishëm duke konsideruar ndikimin e drejtpërdrejtë në performancën e kompanisë, rritjen e cilësisë së shërbimit dhe shlyerjen e pagesave ndaj palëve të treta. Monitorimi në vijim i treguesve tekniko ekonomik, i investimeve të shoqërive të ngarkuara me detyrimin e shërbimit publik.*
- *Bashkëpunimi me entet rregullatore të Italisë dhe Greqisë si në kuadër të projektit TAP, ashtu edhe për të përfutur nga eksperiencia e Rregullatorit Italian në sektorin e gazit natyror dhe sektorin e shpërndarjes është një nga objektivat në vijim të veprimtarisë së ERE.*
- *Monitorimi i treguesve tekniko ekonomik, si dhe planit të investimeve të Albagazit, i çertifikuar si operator i transmetimit dhe shpërndarjes së gazit natyror përbën një hap tjetër të rëndësishëm për plotësimin e kuadrit të legjislativitetit sekondar, në përputhje me direktivat dhe rregulloret përkatëse të BE-së.*
- *Sa i takon procesit të protokollimit dhe arkivimit të dokumentacionit, korrespondencës së institucionit, duke parë edhe zhvillimet teknologjike rekomandohet të përshtatet dixhitalizimi i gjithë procesit të protokollimit arkives si një element që do të ndihmonte në ruajtjen dhe gjurmen e çdo informacioni dhe korrespondencës së ERE-s.*
- *ERE në kushtet e zhvillimit dinamik të sektorit të energjisë, gjatë vitit 2018 ka projektuar në bashkëpunim me USAID strukturën organizative dhe funksionale të saj, pas miratimit të së cilës është e nevojshme hartimi i një rregulloreje të brendshme. Duhet synuar në forcimin e profesionalizimit dhe të pavarësisë operacionale të stafit të entit.*
- *Gjatë vitit 2018, megjithë rastet e konstatuara, neni 107- Gjohat dhe Penalitetet nuk ka gjetur zbatim. Në rekomandojmë zbatimin e tij si të rëndësishëm për të rritur eficienten dhe efektivitetin e aktivitetit të ERE-s.*

Grupi i Audituesve Ligjore



Auditues Ligjor: Ludmilla Paluka licensë nr. 161
Aida Maloku license nr.55

35

